Të pranishëm dhe pjesëmarrës në këtë konferencë ishin ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë për të shtjelluar sfidat e privatësisë në epokën digjitale. Në fjalën e tij të rastit, kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa tha se tema e konferencës së sotme është me interes dhe shumë aktuale për t' u trajtuar në një ambient akademik siç është Kolegji AAB.

Ndërsa, kryesuesi i Cyber Security and Privacy, Mentor Hoxhaj u shpreh se flitet shumë mbi privatësinë dhe ruajtjen e saj, por duhet punuar shumë në aspektin e legjislacionit për këtë çeshtje.

Të pranishëm për të shënuar këtë ditë ishin edhe Ministri i Arsimit, Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Jeton Shaqiri dhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Duda Balje. Kjo e fundit, në cilësinë e deputetes shpalosi përvojën e saj të fundit lidhur me sfidat e privatësisë, ndërsa theksoi nevojën që kjo çështje të futet në legjislacion nga organet përgjegjëse të Republikës së Kosovës.











Kjo është hera e tretë që një konferencë e tillë organizohet në Kolegjin AAB.

AAB I PARI NGA INSTITUCIONET JOPUBLIKE NË TROJET SHQIPTARE ME CITIME NË GOOGLE SCHOLAR

27 janar 2022

Nga mbi 30 mijë universitete botërore që vlerësohen në rangimin Transparent Ranking, e që mbështetet në të dhënat e Google Scholar, në edicionin e janarit 2022 për herë të parë lista është zgjeruar duke përfshirë mbi 7 mijë universitete dhe institucione të arsimit të lartë në botë.

Sipas të dhënave të publikuara në Webometrics, Kolegji AAB radhitet i pari nga institucionet jopublike të arsimit të lartë jo vetëm në Kosovë por edhe në të gjithë hapësirën universitare shqiptare (Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut).

AAB radhitet menjëherë pas Universitetit të Prishtinës, duke lënë prapa për mijëra pozita të gjitha universitetet publike dhe kolegjet private në Kosovë.

Në bazë të rezultateve, del se në këtë edicion të rangimit, Kolegjit AAB i janë shtuar rreth 1 mijë citime shtesë, duke mos i llogaritur top 20 autorët me numrin më të madh të citimeve, të cilët sipas metodologjisë së përdorur nuk janë përfshirë në rangim.

Kolegji AAB vazhdon të jetë i përkushtuar në zhvillimin e mëtejmë të komponentes së kërkimit shkencor, duke mbështetur dhe përkrahur projektet dhe hulumtimet e stafit akademik dhe të studentëve. Këtë e dëshmon edhe Revista Ndërkombëtare Shkencore “Thesis”, e cila botohet nga AAB, e që tashmë është indeksuar në rreth 50 plaforma shkencore, duke përfshirë: DOAJ, Hrcak, Base Bielefeld, MIAR, Worldcat, etj..



Transparent Ranking, siç quhet lista e top universiteteve nga citimet në Google Scholar, publikohet nga Këshilli i Lartë për Kërkime Shkencore i Spanjës, pjesë e të cilit është edhe grupi hulumtues Cybermetrix LAB.

#AABAlumniTalk VAZHDON NË DEGËN E FERIZAJIT

28 janar 2022

Në vazhdën e aktiviteteve të Qendrës së Karrierës, #AABAlumniTalk që ka në fokus promovimin e studentëve të diplomuar të suksesshëm, i ftuari i radhës në kampusin e AAB-së në Ferizaj ishte Agim Ademaj.

I diplomuari foli para studentëve të Fakultetit Juridik për eksperiencën gjatë kohës së studimeve, vështirësitë dhe sfidat e vazhdueshme drejt suksesit. Ai, theksoi se koha që ka kaluar në AAB ka qenë përvoja më e mirë dhe më e rëndësishme e jetës së tij. Ndër të tjerash, Agimi inkurajoi studentët dhe i këshilloi që të ndjekin ligjëratat, të jenë të rregullt dhe të mos ndalen duke vazhduar synimin drejt suksesit përgjatë studimeve bachelor dhe master.

28 janar 2022







Agim Ademaj ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB në Ferizaj dhe është i punësuar në Policinë e Kosovës – departamenti kundër krimit të organizuar, drejtoria e përgjithshme regjioni i Ferizajit.

STUDENTËT E KOLEGJIT AAB NË FERIZAJ U TRAJNUAN NGA GIZ DIMAK

28 janar 2022

U organizua trajnimi i radhës nga Qendra e Karrierës dhe GIZ DIMAK në emër të qeverisë gjermane, për studentët e Kolegjit AAB në Ferizaj.

Në këtë trajnim u zhvilluan temat si të shkruajmë një CV, letër motivuese dhe si të përgatitemi për një intervistë të suksesshme me punëdhësin. Studentët e AAB-së, ishin mjaft të interesuar për këtë trajnim dhe patën mundësi të marrin më shumë njohuri për teknikat e nevojshme për tregun e punës.







PROF. DR. MELITA KOVACEVIC NGA UNIVERSITETI I ZAGREBIT MBAJTI TRAJNIM PËR STAFIN AKADEMIK TË KOLEGJIT AAB

29 janar 2022

Pjesëtarë të stafit akademik të Kolegjit AAB vijuan trajnimin mbi integrimin e hulumtimit në mësimdhënie. Ky trajnim njëditor kishte për qëllim t' i trajnojë mësimdhënësit mbi praktikat më të mira se si duhet përfshirë hulumtimi kërkimor në proceset mësimore.

Trajnimin e mbajti ekspertja ndërkombëtare, Prof. dr. Melita Kovacevic, njohëse e arsimit të lartë në rajon dhe ish zëvendës rektore për shkencë në Universitetin e Zagrebit.

Trajnimi u vlerësua i rëndësishëm nga pjesëmarrësit, ndërsa prorektorja për shkencë në AAB, Uranela Demaj tha se AAB fokusohet që të sigurojë për profesorët dhe studentët mjetet e nevojshme që të avancojnë kapacitetet kërkimore dhe të shkëmbejnë dijen e tyre me komunitetet kërkimore dhe shoqërore.






AAB – BASHKORGANIZATOR I KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR SHËNDETIN, MIRËQENIEN, EDUKIMIN DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

Në bashkëpunim me Qendrën për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore, Kolegji AAB do të jetë bashkorganizator i Konferencës së V-të ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve.

Në takimin e përbashkët të organizatorëve, Rektori i Kolegjit AAB, prof. Bujar Demjaha, shprehu zotimin për angazhim maksimal drejt realizimit sa më të mirë të konferencës, duke theksuar prioritizimin e shkencës brenda këtij institucioni. Ndërsa, prorektorja për shkencë, prof.Uranela Demaj, ritheksoi gatishmërinë e Kolegjit AAB për bashkëpunime të tilla të cilat mundësojnë krijimin e platformave për zhvillimin e hulumtimeve shkencore në Kosovë.

Të dyja palët shprehën mirënjohje për bashkëpunimin duke artikuluar pritjet që konferenca e pestë të jetë konferenca më e madhe nga këto të realizuara deri më tani.



AMBASADORI I REPUBLIKËS SË ÇEKISË SH. T. PAVEL BÍLEK, MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

29 janar 2022

Në kuadër të modulit për politikën e jashtme dhe diplomacionë, për studentët e nivelit master të Fakultetit të Administratës Publike, i ftuar në Kolegjin AAB ishte ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, Sh. T. Pavel Bílek.

Diplomati çek ndau me studentët e AAB-së faktet, historinë dhe funksionin politik të shtetit që përfaqëson. Para ligjëratës me studentët, ambasadori çek Pavel Bílek u prit nga rektori i Kolegjit AAB Bujar Demjaha ku u njoftua mbi historikun, zhvillimin dhe synimet e Kolegjit AAB.









DREJTORESHA E QENDRËS "RI-JETA" MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E PSIKOLOGJISË NË DEGËN E FERIZAJT

29 janar 2022

Në kampusin e Ferizajt për studentët e vitit të parë të Fakultetit te Psikologjisë është mbajtur ligjëratë nga drejtoresha e qendrës "Ri-Jeta"

Ndër të tjera, drejtoresha e kësaj qendre foli për arsyet e themelimit të "Ri-Jeta" dhe historinë me djalin e saj, duke dhënë mesazh të qartë sesa të dëmshme janë substancat narkotike dhe si duhet ndihmuar shoqërinë lidhur me një çështje të ndjeshme si kjo.

Dekani i Fakultetit të Psikologjisë, prof.Naim Telaku njoftoi studentët se në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë qendër, studentët e AAB-së do të kenë mundësi të zhvillojnë punën praktike në këtë qendër.





LIGJËRATË E HAPUR VIRTUALE ME STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK

31 janar 2022

Në kuadër të serisë së ligjëratave nga profesorë të huaj, Prof. Dr. Goran Ilik ishte profesori i radhës në Fakultetin Juridik, i cili mbajti ligjëratë të hapur virtuale me studentët me temën "The rise of EU digital constitutionalism". Prof.Ilik është dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin St. "Klement Ohridski" nga Manastiri.

Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB javë më parë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Juridik të Universitetit St. "Klement Ohridski". Në fund të ligjëratës, studentët parashtruan pyetje të shumta.






KOLEGJI AAB

SHKURT 2022

AAB PRIN BINDSHËM NË WEBOMETRICS SI MË I MIRI INSTITUCION JOPUBLIK NË VEND

2 shkurt 2022

Ranglista prestigjioze e universiteteve, Webometrics, ka publikuar rangimin e janarit 2022. Edhe në këtë edicion janë përfshirë institucionet akademike të arsimit të lartë të Kosovës, ku sipas rezultateve Kolegji AAB bindshëm mbetet institucioni më i mirë jopublik në Kosovë.

AAB është ranguar si një ndër institucionet më të mira edhe në nivel të institucioneve të arsimit të lartë në trojet shqiptare.

Ky sukses i jashtëzakonshëm i Kolegjit AAB, duke mbajtur primatin e më të mirit në mesin e institucioneve jopublike të arsimit të lartë në trojet shqiptare, për disa vjet me radhë, ka ardhur si rezultat i angazhimit të vazhdueshëm në fushën e hulumtimit shkencor dhe në ngritjen e cilësisë në të gjitha sferat.

Webometrics është ranglistë e grupit hulumtues Cybermetrics Lab, që është pjesë e institucionit më të madh kërkimor publik në Spanjë, Këshillit të lartë për kërkime shkencore (CSIC). Rezultatet shpallen dy herë në vit, në janar dhe në korrik ndërsa në të përfshihen mbi 31 mijë universitete botërore.



MBAHEN INTERVISTAT ME PARTNERIN E RI GJERMAN, QENDRA PSIKIATRIKE EMMENDINGEN

4 shkurt 2022

Studentët e Infermierisë së Kolegjit AAB, të cilët janë pjesë e Programit për Karrierë dhe Punësim, për dy ditë radhazi janë intervistuar nga drejtori i Infermierisë së Qendrës Psikiatrike në Emmendingen, z. Jeton Himaj.

Spitali Psikiatrik Emmendingen është një ndër spitalet më të mira në Gjermani, i cili mbulon spektrin e kujdesit për shëndetin mendor.

Pas intervistave, z. Himaj është shprehur tejet i kënaqur me cilësinë e aplikantëve për punësim, posaçërisht me nivelin e njohurive të gjuhës gjermane si dhe gatishmërinë e studentëve të Programit për Karrierë dhe Punësim për t' u bërë pjesë e personelit të klinikës të cilën ai e përfaqëson, duke garantuar përkrahje dhe ndihmë profesionale gjatë procesit së përgatitjes së tyre për nisjen në Gjermani dhe mbështetje në integrimin e tyre atje.





STUDENTËT E AAB-së, VAZHDOJNË STUDIMET ME BURSË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E LODZIT NË POLONI

5 shkurt 2022

Për vite me radhë Kolegji AAB është përfitues i projektit "Erasmus+ International Credit Mobility", në kuadër të të cilit studentët mund të vazhdojnë studimet me bursë të plotë për një semestër në Universitetin Lodz, në Poloni.
Prorektorja për bashkëpunim dhe marrëdhënie ndërkombëtare Venera Llunji, bëri të ditur se për këtë vit akademik përfitues të bursave janë pesë studentë të AAB-së, që do të vazhdojnë semestrin veror në Lodz.

"Ndihem mirë, pasi po shkoj të vazhdoj një semestër të studimeve në Poloni dhe një mundësi e tillë nuk duhet lëshuar asnjëherë. Është meritë e Kolegjit AAB pasi gjithmonë dëshmon për studentët që është lider dhe na bën të ndihemi krenar që po studiojmë këtu", tha Ron Ukaj.

Ndërsa, Adea Ademi u shpreh se këtë mundësi po e sheh si eksperiencë që nuk do ta harrojë asnjëherë: "Nga kjo mundësi po përfitojmë ne, nesër mund të jenë ata që do ndjekin studimet në Kolegjin AAB. Jam e lumtur që jam përzgjedhur dhe do ndikojnë shumë mirë tek secili prej nesh njohuritë, sfidat dhe socializimi me të tjerët", u shpreh ajo.











Përveç Ronit dhe Adeas, studentët tjerë që do të ndjekin studimet në Poloni janë: Art Vula, Argjend Berisha dhe Laureta Dervodeli.Universiteti i Lodz me seli në Poloni, është universitet publik, dhe ndër universitet më të mëdha në vend, me bashkëpunim intensiv ndërkombëtar me më se 400 partnerë në përmasa botërore, dhe është anëtar aktiv në projekte të Komisionit Evropian dhe më gjerë.

ÇLIRIM LAJÇI, NJË TJETËR STORJE SUKSESI E STUDIMEVE NË AAB

7 shkurt 2022

Si student i vitit të tretë në Fakultetin e Arteve të Kolegjit AAB, Çlirim Lajçi është një nga shumë studentët tanë që ka arritur të punësohet ende pa diplomuar. E veçanta e Çlirimit është se ai tashmë profesionin si dizajner grafik po e ushtron brenda institucionit ku vijon studimet.

"Për të gjithë që janë në dyshime se ku të fillojnë studimet, padyshim se Kolegji AAB është rekomandimi im, si institucion serioz në çdo drejtim. Angazhimet e studentëve në aktivitete të ndryshme, puna praktike dhe stafi profesional, janë faktorë kyç që të bëjnë të zgjedhesh AAB-në. Suksese si këto kanë bërë që Kolegji AAB të cilësohet vendi ideal i studimeve cilësore dhe ngritjes profesionale për shumë studentë", u shpreh ai.

Ai falënderon Kolegjin AAB që i dha mundësi të jetë pjesë e stafit profesional, sepse sipas tij të kontribuosh për institucionin më të madh të arsimit të lartë në vend është privilegj i madh.



FAKULTETI I ARKITEKTURËS PJESË E PROJEKTIT "URBAN DATA KOSOVO"

13 shkurt 2022

Është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit në mes Fakultetit të Arkitekturës dhe KAF (Fondacioni Kosovar për Arkitekturë), të dy si pjesë e projektit "Urban Data Kosovo", projekt ky i financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe i administruar nga KUSA.

Objektiv kryesor i "Urban Data Kosovo" është shkëmbimi i ekspertizës së urbanizmit të avancuar nga hulumtues dhe staf akademik të MIT-së, me stafin akademik të fakulteteve të arkitekturës në Kosovë. Qëllimi i këtij programi është të sjellë njohuri të reja mbi mbledhjen e të dhënave urbane, trajnimin dhe shkëmbimin e informacionit në universitetet e Kosovës.

Ky projekt deri më tani ka përfshirë faza si takimi i liderëve të projektit me institucionet që do të përfshihen në këtë projekt. Faza tjera janë vizita e stafit akademik kosovar në SHBA, në qendrën për urbanizëm të avancuar, MIT; duke vazhduar me disa punëtori javore në Kosovë ndërsa i gjithë projekti është planifikuar të përfundojë në korrik 2022.







Si rezultat kryesor i këtij projekti është reflektimi në kurrikulat ekzistuese në fakultetet e arkitekturës në Kosovë, në veçanti lëndët e urbanizmit, me fokus në integrimin e mjeteve dhe metodologjive bashkëkohore analitike hapësinore.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME "CYBER SECURITY AND PRIVACY"

9 shkurt 2022

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB përfaqësuar nga dekani Jusuf Qarkaxhija, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Cyber Security and Privacy" përfaqësuar nga drejtori menaxhues Mentor Hoxhaj.

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, siç janë realizimi i punës praktike të studentëve, promovimi i nismave të përbashkëta profesionale dhe akademike.

Po ashtu, të dy institucionet do të bashkëpunojnë reciprokisht dhe do t' i ofrojnë njëra tjetrës ndihmën e duhur gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.



KOLEGJI AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME KOMUNËN E GJILANIT

11 shkurt 2022

Kolegji AAB dhe Komuna e Gjilanit tani e tutje do të jenë partnerë bashkëpunues përmes marrëveshjes së nënshkruar nga Rektori i AAB-së, Bujar Demjaha dhe kryetari i Komunës së Gjilanit,
z.Alban Hyseni.
Marrëveshja mes dy institucioneve ngërthen promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta; kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, drejtoritë, agjencitë, institucionet shkollore dhe parashkollore të komunës; shkëmbimin e vizitave të organizuara për studentët dhe mësimdhënësit.
Mbi të gjitha u theksua rëndësia e aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe artistike që nënkupton interesin e të dy palëve për të mirën e qytetarëve dhe në këtë rast të mirën ndaj të rinjve.









Bashkëpunimi mes të dy palëve do të realizohet falë angazhimit dhe përkushtimit të përbashkët.


PROFESORI I KOLEGJIT AAB, LUAN TASHI SJELL 67 ARTEFAKTE TË SKËNDERBEUT NË GALERINË KOMBËTARE

11 shkurt 2022

"Portrete të Skënderbeut gjatë shekujve" titullohet ekspozita e profesorit të Kolegjit AAB, Luan Tashi, i cili ka sjellë 67 artefakte në Galerinë Kombëtare të Kosovës.

Fjala është për ekspozimin e artefakteve të ndryshme që paraqesin historinë e Skënderbeut, si: monedha, dorëshkrime, vula, gravura, litografi, piktura, mozaikë, medalje e pulla postare të Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Në këtë ekspozitë e cila do të qëndrojë e hapur deri më 8 mars, vizitorët gjithashtu kanë mundësi të shohin edhe portretin e Skënderbeut, i skalitur në gur nga skulptori Andrea Aleksi.





Sipas artistit Tashi, ekspozita është pjesë e librit, i cili është botuar në vitin 2018, në 550-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, ndërsa artefaktet janë marrë nga arkiva të ndryshme, si nga Arkivi i Dubrovnikut, nga arkiva të ndryshëm në Itali, Stamboll, nga Shqipëria, por edhe nga bibliotekat në Washington dhe New York.

Profesor Tashi është ligjërues dhe bartës i disa lëndëve në Kolegjin AAB, në Fakultetin e Komunikimeve dhe atë të Arteve.

DIPLOMOJNË DY KANDIDATET E PARA NË PROGRAMIN MASTER PËR MENAXHIM SHËNDETËSOR

12 shkurt 2022

Kandidatet Kimete Musliu dhe Vlorë Emini, janë dy studentet e para që diplomuan në programin master Menaxhim Shëndetësor të Kolegjit AAB.

Ato mbrojtën me sukses temat e tyre dhe u vlerësuan për punën e bërë nga komisioni vlerësues.

Kimete Musliu kishte temën "Efektet e sjelljeve të ngacmimit (bullizmit) në studentët e infermiesisë në mjedisin klinik", ndërsa Vlorë Emini mbrojti temën "Menaxhimi i stresit të infemierëve të cilët punojnë në departmentin e urgjencave në nivelet sekondare".



FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "MOLLËKUQJA"

15 shkurt 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale i Kolegjit AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Mollëkuqja". Kjo marrëveshje ka për qëllim t' i bëjë bashkë të dy institucionet në organizimin e tryezave të përbashkëta në fushën e edukimit parashkollor, ligjërata shtesë për studentët por edhe angazhimin e tyre në punë praktikë pranë këtij institucioni.

Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në hapësirat e Kolegjit AAB nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, prof.dr. Hysen Kasumi dhe nga drejtoresha e IP "Mollëkuqja", znj. Almana Mujaj.



"GISHT" I AUTORES DORUNTINA BASHA, JEPET NË TEATRIN KAMERTAL TË KOLEGJIT AAB

16 shkurt 2022

Në vazhdën e aktiviteteve të përbashkëta me Ambasadën e Francës dhe Aleancën Franceze, përmes SADC (Shoqëria e autorëve dhe kompozitorëve dramatikë) në Paris, në Teatrin Kamertal AAB, në transmetim direkt online u dha drama "Gishti" e autores Doruntina Basha.

Drama "Gishti" tregon historinë e dy grave, vjehrrës dhe nuses, të cilat edhe dhjetë vjet pas zhdukjes së burrave të tyre në luftën e Kosovës, jetojnë së bashku, të paafta për t' i vajtuar siç duhet të vdekurit e tyre, të paafta për të vazhduar jetën.

Tregimi ngërthen sa vetminë e madhe dhe mallin për të zhdukurit e të vrarët po aq edhe shpresën, fuqinë e fantazisë dhe bindjes se tragjedia ka ndodhur dhe se me të duhet vazhduar jetën ashtu siç ndodhë në çdo shoqëri të pas luftës, në shoqëri që ballafaqohen me dukuritë dhe traumat e luftës dhe asaj çfarë vjen pas saj.











Bazuar në ngjarje të vërteta të cilat autorja i kishte dëgjuar nga anëtarë të familjeve të cilët ishin viktima të tilla, e bënin këtë dramë të mbushur me plot emocione.

KOLEGJI AAB DHE "DEVOLLI GROUP" ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

18 shkurt 2022

Kolegji AAB dhe Devolli Group kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi, e cila përfshin angazhimin e studentëve të AAB në punë praktike, punë sezonale por edhe punë të përhershme sipas nevojave të kompanisë në fjalë.

Marrëveshja po ashtu përfshin krijimin apo realizimin e projekteve të tjera të përbashkëta me qëllime inovative, shkencore, zhvillimore e hulumtuese.

Ky bashkëpunim u nënshkrua nga Prorektorja Venera Llunji dhe udhëheqësi i sektorit për resurse njerëzore të "Devolli Group", z. Leutrim Osmani







PËRMBYLLET FUSHATA "NJË LIBËR MË SHUMË PËR BIBLIOTEKËN TIME AAB"

18 shkurt 2022

Fushata "Një libër më shumë për bibliotekën time AAB" ka nisur që nga fillimi i vitit 2021, e cila për qëllim ka pasur sensibilizmin e lexuesve dhe dhurimin e librave nga donatorë të ndryshëm.





Që nga fillimi i fushatës ka pasur dhurues të ndryshëm, duke përfshirë studentë, profesorë të Kolegjit AAB dhe të jashtëm, fondacione të ndryshme, autorë, etj.. Gjithashtu dhuruesit kanë qenë nga shtete të ndryshme, si: Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Italia, Gjermania, Danimarka, etj..
Librat e dhuruar janë kryesisht libra të fushave të ndryshme: letërsi, libra akademikë, kritika letrare, kulturore, etj.







Si shenjë falënderimi, Biblioteka Universitare e Kolegjit AAB ka vendosur që në mbyllje të fushatës, t' u ndajë mirënjohje të gjithë atyre që kanë dhuruar libra.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT ORGANIZOI TURNE NË SHAH

21 shkurt 2022

Për nder të Ditës së Pavarësisë, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në bashkëpunim me Federatën e Shahut të Kosovës organizuan turneun në shah "PËRVJETORI I PAVARËSISË".
Turneun e shpallën të hapur dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Prof. Asoc. Dr. Fatmir Pireva dhe sekretari i përgjithshëm i Federatës së Shahut të Kosovës, z. Burhan Misini.

Turneu u organizua sipas sistemit zviceran me 9 xhiro të luajtura ku morën pjesë 93 shahistë. Për më të mirët e këtij turneu u ndanë kupa, mirënjohje dhe shpërblime të ndryshme.









NISIN APLIKIMET PËR KURSET E EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP) NË KOLEGJIN AAB

22 shkurt 2022

Nga muaji mars Kolegji AAB do të startojë me kurset e akredituara nga Oda e Infermierëve të Kosovës, në mënyrë që shumë profesionistë shëndetësorë të sigurojnë pikë kredituese për rilicensimet e tyre.

Trajnimi i parë do të mbahet më 9 mars dhe do të trajtojë temën "Komunikimi në fazën e fundit të jetës" nga ligjëruesja, Teuta Bujupi. Secili pjesëmarrës aktiv do të vlerësohet me 10 pikë kredituese, ndërsa çdo pjesëmarrës pasiv me nga 8 pikë kredituese.

Forma e mbarëvajtjes së këtyre kurseve do të jetë fizikisht në objektin e AAB. Kohëzgjatja e kursit është një ditore, 6 orë akademike, nga ora 09:00 – 14:30.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES KOLEGJIT AAB DHE OJQ-SË "4-H KOSOVA"

24 shkurt 2022

Kolegji AAB dhe OJQ "4-H Kosova", nënshkruan memorandum bashkëpunimi për realizimin e programit "Empower Kosovo Youth Identity". Ky program është i financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë dhe synon të përgatisë 120 të rinj të Kosovës përmes zhvillimit personal dhe profesional që të jenë të aftë për të kontribuar në të ardhmen e vendit tonë. Në mënyrë të veçantë, ky program do t' i pajisë të rinjtë e Kosovës me shkathtësi dhe aftësi të nevojshme të marketingut digjital sipas kërkesës së tregut.

Programi do zgjasë gjithsej 11 muaj dhe do përfshijë aktivitete të ndryshme të aftësimit të të rinjëve, siç janë videot edukative, fushatën për promovimin e Kosovës sipas motos "Kosova është shtëpia ime" dhe angazhimin në organizata dhe iniciativa të ndryshme për të mirën e shoqërisë.

Pas përfundimit të programit, pjesëmarrësit më të sukesshëm do përfitojnë mundësi për praktikë/internship në fushën e marketingut digjital, në kompani të ndryshme të Kosovës, dhe mundësi për punësim më afatgjatë.



NIS ZYRTARISHT PROJEKTI "APPEAR" NË BASHKËPUNIM ME DANUBE UNIVERSITY KREMS

24 shkurt 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB dhe Danube University Krems kanë mbajtur takim virtual, me rastin e fillimit zyrtar të projektit APPEAR, me ç' rast janë dakorduar mbi hapat e mëtutjeshëm që të dy universitetet duhet ndjekur në përmbushjen e detyrave.

Dekani i Fakultetit të Edukimit, Arteve dhe Arkitektures, UWK Univ.Prof. Dipl. Ing. Dr. Stefan Oppl, dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale mbajtën nga një fjalim mikpritës për të pranishmit dhe pjesëmarrësit e Projektit APPEAR.
Me këtë rast u themelua edhe grupi themelor për një bashkëpunim të qëndrueshëm përgjatë projektit.





ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA E V-TË STUDENTORE E STUDENTËVE TË SHKENCAVE SOCIALE

28 shkurt 2022

Nën organizimin e Fakultetit të Shkencave Sociale, zhvilloi punimet Konferenca e V-të Studentore "Qasja bashkëkohore në edukimin e fëmijërisë së hershme nga pikëpamjet studentore".

Në hapje të kësaj konference, Prof.ass.dr. Hysen Kasumi, dekan i fakultetit, tha se qëllimi i organizimit të kësaj konference është që t' iu ofrojmë studentëve të rrisin interesimin për të kontribuar në aspektin shkencor dhe për të ndarë njohuritë me studentët tjerë pjesëmarrës.

Kjo konferencë mblodhi studentë të ndryshëm të cilët prezentuan tema që lidhen ngushtë me qasjen në edukimin e fëmijërisë së hershme.








Punimet e pjesëmarrësve të konferencës "Qasja bashkëkohore në edukimin e fëmijrisë së hershme nga pikëpamjet studentore", u përmbyllën me diskutime dhe pyetje të ndryshme rreth temave të prezantuara.

U CERTIFIKUAN STUDENTËT PJESËMARRËS NË TRAJNIMIN ORGANIZUAR NGA FAKULTETI EKONOMIK DHE UN WOMEN

28 shkurt 2022

Fakulteti Ekonomik në bashkëpunim me organizatën UN Women ndau certifikata për pjesëmarrje të studentëve në trajnimin me tematikë "Përgatitja e planeve të biznesit, njohja e tregjeve ndërkombëtare dhe buxhetimi i kapitalit", trajnim ky që u zhvillua në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë si dhe në kuadër të programit për barazi gjinore që implementohet nga organizata UN Women.











Ndarja e certifikatave u bë nga Dekani i Fakultetit Ekonomik, z. Medain Hashani, si dhe shefja e organizatës UN Women Kosovo, znj. Vlora Nushi, të cilët përshëndetën dhe e vlerësuan si të suksesshëm trajnimin dhe u zotuan në organizime dhe bashkëpunime të radhës.

MARS 2022

STUDENTËT E FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT NDOQËN KURSIN E SKIJIMIT

1 mars 2022

Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, sikur edhe të gjitha gjeneratat e mëhershme edhe sivjet kanë ndjekur kursin e skijimit në Qendrën e Skijimit në Kodrën e Diellit, në Tetovë të Maqedonisë së Veriut. Dhjetëra studentë pjesëmarrës në këtë kurs kanë shijuar qëndrimin bashkë me kolegë, ndërsa u shprehën se çdo student duhet t' i shfrytëzojë mundësitë që Kolegji AAB, në veçanti Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, ofron për përgatitjen e mëtutjeshme të tyre.

Studentët janë njohur në mënyrë profesionale me teknikat e skijimit, duke treguar performanca të shkëlqyera në këtë sport, duke e ditur që skijimi është një sport i vështirë dhe si çdo sport tjetër ka specifikat e veta.



Kujtojmë se mbështetja e vazhdueshme e Kolegjit AAB për aktivitete të këtilla praktike për studentët e sporteve, ka dhënë jo rrallë edhe rezultate kulminante të studentëve në disiplina të ndryshme sportive.

DEKANI I FAKULTETIT TË INFERMIERISË PJESË E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE NGA URDHËRI I INFERMIERËVE TË SHQIPËRISË 2022

4 mars 2022

Dekani i Fakultetit të Infermierisë të Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr Idriz Sopjani mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare, organizuar për herë të parë nga Urdhëri i Infermierëve të Shqipërisë. Tema e kësaj konference ishte "Roli i Infermierëve në Shërbimin e Kujdesit Shëndetësor Parësor Përballë Sfidave të Reja Shëndetësore".







Seanca e parë përfshiu prezantimin e figurës infermierore nga ligjërues të huaj, ndërsa në seancën e dytë u trajtuan disa tema të ndryshme të ndara në katër sesione.

FAKULTETI I STOMATOLOGJISË ME SHËRBIME FALAS PËR FËMIJËT E SOS FSHATIT

4 mars 2022

Java e Stomatologjisë po shënohet me aktiviteteve nga studentët dhe profesorët e Fakultetit të Stomatologjisë. Një ndër to është vizita e fëmijëve të SOS Fshatit në Kolegjin AAB, të cilëve iu ofruan shërbime dentare nga studentët e vitit të katërt dhe të pestë të këtij fakulteti.





Këto shërbime përfshijnë vizitën stomatologjike, nxjerrje apo mbushje të dhëmbit, trajtime endodontike, pastrim dhe polirim të dhëmbëve. Të gjitha këto shërbime janë kryer nga studentët tanë në mbikqyrje të profesorëvë dhe asistentëve.





Java e Stomatologjisë do të vazhdojë edhe me aktivitete të tjera.

PROMOVOHEN LIBRAT E FERHAT DINOSHËS E BAKI REXHEPIT

5 mars 2022

Sot në Kolegjin AAB u bë promovimi i dy librave të autorëve Ferhat Dinosha dhe Baki Rexhepi. Të dy librat u cilësuan të rëndësishëm për historinë dhe faktet të cilat bartin.

Kryetari i Këshilit Drejtues të Kolegjit AAB, z. Lulzim Tafa, u shpreh i nderuar për organizimin e promovimeve të tilla në Kolegjin AAB.
"Nga Pavarësia në Pavarësi" është libër i cili flet për çështjet e rëndësishme në ecjen e Malit të Zi drejt pavarësimit të saj dhe ndikimi që ky proces ka pasur te shqiptarët e Malit të Zi si dhe për politikën e Kosovës. Ndërsa "Kronika nga Lugina" libër i cili përmbledh dhe paraqet realitetin historik të shqiptarëve nga Lugina.
Në fjalën e tij autori i librit "Nga Pavarësia në Pavarësi", Ferhat Dinosha, derisa falënderoi të gjithë ata që e bënë të mundur botimin e librit të tij, shtoi se është munduar që gjithçka që është shkruar në libër ta shpreh drejt.
Në anën tjetër, Baki Rexhepi autor i librit "Kronika nga Lugina", tha se ky libër do të jetë dëshmi e veprave të mëdha që kanë ndodhur në Luginë.











Panelistët të cilët morën pjesë në promovimin e këtyre dy librave ishin: Fatmir Sejdiu, Arsim Bajrami, Hajredin Kuçi, Shaip Kamberi, Fatmir Arifi dhe profesorë e studentë të Kolegjit AAB. Këta dy libra u vlerësuan të rëndësishëm për historinë kombëtare.

AKTORI ILIR TAFA, AMBASADOR KULTUROR I KOSOVËS NË VENDET E ISH-JUGOSLLAVISË

7 mars 2022

Ilir Tafa ka promovuar Kosovën në vendet e ish-Jugosllavisë në kohën kur këtë nuk ka mundur ta bëjë politika, në vitet e para të pas shpalljes së pavarësisë. Kjo thuhet në një studim të botuar këtë javë nga Vilnius University Press i Lituanisë.





Sipas këtij studimi të indeksuar në Scopus, Kosova pas shpalljes së pavarësisë e ka pasur mjaft të vështirë që ta promovojë veten ndaj audiencave të huaja dhe këtë e kanë bërë kryesisht sukseset e artistëve dhe sportistëve të talentuar.

Nga ana tjetër, thuhet në këtë studim, komunikimi i aktorëve kosovarë, veçanërisht me publikun në rajonin e ish-Jugosllavisë, ka qenë i vështirë në pesë vitet e para pas shpalljes së pavarësisë. Por, Ilir Tafa, një aktor nga Prishtina, në atë kohë ushtronte diplomaci kulturore me vende me të cilat Kosova nuk kishte asnjë komunikim zyrtar, si Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia.

"Përmes serialit boshnjak "Lud, zbunjen, normalan", Tafa interpretoi personazhin e një të riu nga Kosova. Në personazhin e Mentor Kosovës, Tafa ka komunikuar me publikun e vendeve të ish-Jugosllavisë, pasi ky serial është transmetuar në Televizionin Federal të Bosnjës, Nova TV të Kroacisë, Televizionin A1 dhe Channel 5 të Maqedonisë së Veriut, në Televizionin Publik të Serbisë RTS dhe në Mal të Zi në RTV News. Për katër vite me radhë, në disa episode, personazhi i Tafës flet shqip, diskuton muzikën e Kosovës, shkallën e tolerancës që ka shoqëria shqiptare e Kosovës ndaj kategorive të frustruara, si homoseksualët etj.", thuhet në këtë studim, i cili titullohet "Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence".

Komunikimi i Tafës me publikët në Ballkan, thuhet më tej në këtë studim, është mjaft i rëndësishëm sepse që nga vitet 1990 komunikimi vleror i Kosovës me serbët dhe boshnjakët është ndërprerë dhe, siç thekson njëri nga studiuesit më të cituar të praktikimit të diplomacisë publike në botë, Mark Lenonard, "diplomacia publike dhe kulturore duhet të fokusohen në vendet që janë më të vështira dhe të rëndësishme për interesat e një vendi dhe jo në ato që janë më të lehta për t'u ndikuar".

Sipas këtij studimi, përcjellja e mesazheve promovuese të artistëve, aktorëve dhe sportistëve të suksesshëm të Kosovës në botë, si Rita Ora, Ilir Tafa, Arta Dobroshi, Majlinda Kelmendi etj., është mjaft e rëndësishme në rritjen e imazhit ndërkombëtar të vendit, të cilët praktikisht disiplina i njeh si ambasadorë publikë kulturorë të një vendi në botë.

NË AAB KA FILLUAR IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT TË MBËSHTETUR NGA KE, PROGRAMI ERASMUS + JEAN MONNET

7 mars 2022

Qëllimi i këtij projekti 3 vjeçar është dizajnimi dhe ofrimi i një moduli akademik ndërdisiplinor lidhur me ndikimin e BE-së në ndërtimin e paqes, pajtimit dhe demokratizimit në Kosovë.

BE ka pasur një rol udhëheqës në demokratizimin, shtet-ndërtimin dhe promovimin e vlerave Evropiane në Kosovë. Misionet e BE-së në Kosovë, vazhdimisht kanë promovuar paqen, sundimin e ligjit, stabilitetin, prosperitetin dhe cilësinë e jetës, bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, duke u mundësuar qytetarëve në Kosovë që të ekspozohen dhe të përqafojnë vlerat evropiane.



Prandaj, përmes kësaj lënde studentët do të kuptojnë se si secili prej tyre përmes aplikimit të vlerave evropiane në kuadër të jetës së përditshme dhe punës së tyre profesionale, mund të kontribuojnë që Kosova të jetë një vend sa më demokratik në të ardhmen duke kontribuar kështu në aspiratat e shtetit tonë për integrim në BE.

Studentët do të kenë mundësi të përfshihen në punë kërkimore për të analizuar ndikimin e BE-së në shtet ndërtimin e Kosovës.

Gjithashtu studentët do të angazhohen në aktivitete promovuese për të shpërndarë mesazhin që secili profesion mund të ushtrohet më suksesshëm në kontekstin e një vendi demokratik dhe secili prej nesh mund të kontribuojë që Kosova t' iu përngjajë sa më shumë vendeve Evropiane.

STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK TË KOLEGJIT AAB U NJOFTUAN MBI PROGRAMIN "BPB JUNIOR"

8 mars 2022

Qendra e Karrierës e Kolegjit AAB në bashkëpunim me Bankën për Biznes, organizuan prezantimin e programit "BPP Junior" para studentëve të Fakultetit Ekonomik. Studentët në këtë ligjëratë, u njoftuan në detaje lidhur me dobitë që ofron ky program pasi u mundëson që të kalojnë një seri të moduleve të trajnimeve që janë të përqendruara në aftësi të buta dhe profesionale si dhe përgatitje në fusha të ndryshme të industrisë, për periudhën 3-4 mujore.

Programi "BPB Junior" do të zhvillohet nga ekspertë të specializuar dhe do mbështesë zhvillimin e studentëve me hulumtimet, teoritë dhe praktikat më të fundit. Studentët e Fakultetit Ekonomik, u njoftuan poashtu për mënyrën e aplikimit, ndërsa të drejtë aplikimi kanë edhe studentët nga fakultetet e tjera të Kolegjit AAB.







Studentët e interesuar duhet të plotësojnë aplikimin online.

PËRMBYLLET JAVA E STOMATOLOGJISË NË KOLEGJIN AAB

9 mars 2022

Java e Stomatologjisë ka përmbyllur aktivitetet e saj, organizuar për nder të 6 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Stomatologëve. Përgjatë javës u organizuan kontrolla stomatologjike falas për fëmijë si dhe u shënuan aktivitete të tjera me qëllim të vetëdijësimit për kujdesin dentar.









Në kuadër të këtyre aktiviteteve u ofruan shërbime që përfshijnë vizitën stomatologjike, nxjerrje apo mbushje të dhëmbit, trajtime endodontike, pastrim dhe polirim të dhëmbëve. Të gjitha këto shërbime janë kryer nga studentët tanë në mbikqyrje të profesorëvë dhe asistentëve.

Në ditën e fundit të aktiviteteve, studentët e Fakultetit të Stomatologjisë prezantuan hulumtime shkencore që i kanë realizuar me ndihmën e profesorëve

U MBAJT SESION MEDITUES TAO PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË PSIKOLOGJISË

9 mars 2022

Studentët e Fakultetit të Psikologjisë patën mundësinë të jenë pjesë e sesionit meditues TAO nga Amadea Stefa, trajnere dhe terapiste e artit për komunikim dhe kompetencë ndërkulturor. Kjo e fundit ka ndarë ekspertizën e saj profesionale dhe bashkëpunimin me kompani me renome siç janë Siemens apo Telekom Austria. Më pastaj, studentët u familjarizuan me teorinë mjekësore kineze Shen Qi Jing, me pjesët përbërëse të saj si shpirti, zemra, mendja, energjia dhe materia, të ndërlidhura me gjetjet me të reja shkencore për mirëqenien e njeriut.







Aktiviteti u përmbyll me ushtrimin e meditimit TAO me theks në ndërgjegjësim, përqendrim, vizuelizim dhe meditim ku janë komunikuar edhe përvojat e të pranishmëve. Në fund studentëve u janë prezantuar edhe materialet fizike për këtë teknikë.

PËR HERË TË TRETË NIS PROGRAMI VULLNETAR – PROFESIONAL "ANGLISHTJA NGA UNË TE TI" NË FSHATIN SOS

10 mars 2022

Studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze prej tri vitesh tashmë japin kontributin e tyre profesional në programin "Anglishtja nga Unë te Ti", prej të cilit përfitojnë shërbimin falas në të mësuarit e gjuhës angleze rreth 100 fëmijë të SOS Fshatit Prishtinë. Këtë vit, rreth 40 studentë të vitit të tretë të këtij fakulteti janë përfshirë në këtë program.



Fillimisht studentët u trajnuan për të marrë njohuri pedagogjike rreth mësimdhënies në mënyrë që ora e mësimit të jetë sa më efikase. Studentët u shprehën të lumtur që po u jepet mundësia që të kontribuojnë në komunitet.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES KOLEGJIT AAB DHE ELKOS GROUP

10 mars 2022





Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit reciprok mes tyre, Kolegji AAB dhe Elkos Group tashmë janë partnerë për të zhvilluar interesa të përbashkëta që kontribuojnë në promovimin e të dyja palëve.

Ky memorandum bashkëpunimi u nënshkrua nga Prorektorja e Kolegjit AAB Venera Llunji dhe dy përfaqësueset e Elkos Group Zana Lipoveci-Kastrati dhe Donjeta Kelmendi-Mujaj.

Ndër të tjera, në kuadër të këtij memorandumi bashkëpunimi parashihet angazhim për mundësi punësimi, praktikë për studentët e Kolegjit AAB, ligjërata dhe panaire, tryeza të përbashkëta dhe implementim i aktiviteteve të ndryshme.

QENDRA E KARRIERËS DHE GIZ DIMAK ORGANIZUAN TRAJNIM PËR STUDENTËT E AAB-së NË DEGËN E GJAKOVËS

11 mars 2022

Qendra e Karrierës në bashkëpunim me GIZ DIMAK, në emër të qeverisë gjermane, zhvilluan trajnim për studentët e vitit të dytë dhe të tretë të fakulteteve: Juridik, Gjuhë Angleze, Ekonomik dhe Shkenca Sociale. Në këtë trajnim, studentët patën mundësi të njihen më shumë mbi teknikat e të shkruarit të CV, letrës motivuese si dhe për përgatitjen e një interviste të suksesshme pune.

Përveç shembujve të ndryshëm që u dhanë nga trajnerja Arnisa Aliqkaj lidhur me shkresa të rëndësishme të cilat do ju duhen për të ardhmen, u mbajtën edhe simulime të intervistave të punës.



Studentët e AAB-së nga Kampusi i Gjakovës, u panë të interesuar për të qenë pjesë në këtë trajnim, të cilin e konsideruan të rëndësishëm për arritje të tyre profesionale.

STUDENTËT E FAKULTETIT TË GJUHËS ANGLEZE ISHIN NË VIZITË STUDIMORE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

11 mars 2022

Në kuadër të vizitave studimore, studentët e Fakutletit të Gjuhës Angleze vizituan Drejtorinë e Shëbimeve Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Gjatë kësaj vizite ata ndoqën një prezantim nga zyrtarja e lartë për harmonizim gjuhësor për gjuhën angleze, znj. Vjollca Sogojeva. Ata u informuan në përgjithësi rreth rëndësisë së gjuhës ligjore, specifikave të saj dhe problematikave që hasen gjatë procesit të përkthimit dhe harmonizimit të ligjeve nga gjuha shqipe në gjuhë angleze dhe anasjelltas.













Më pas studentët vijuan me pyetje për znj. Sogojeva dhe shprehën dëshirën që të kontribuojnë edhe me kryerjen e praktikës profesionale.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën rastin të vizitojnë sallën kryesore të Kuvendit si dhe ambientet e tjera të shfrytëzueshme për vizitorët.

AAB NË KONFERENCË TË PËRBASHKËT SHKENCORE ME UNIVERSITETIN E FIRENCES, TIRANËS DHE ELBASANIT

11 mars 2022

"Kujtesa kolektive në letërsi dhe media" është tema e konferencës shkencore ndërkombëtare e cila ka bërë bashkë Fakultetin e Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, Shkollën e Shkencave Politike të Universitetit të Firences (Itali), Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimeve të Universitetit të Tiranës dhe nikoqirin, Departamentin Letërsi-Gazetari të Universiteti të Elbasanit.

Në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare e cila do të mbahet më 12 maj, pritet të marrin pjesë studiues të mediave e komunikimeve dhe letërsisë nga Shqipëria, Kosova dhe Italia.



Qëllimi kryesor i kësaj konference është që të ofrojë këndvështrime të reja për dilema të vjetra që kanë të bëjnë me fushën e kujtesës kolektive kryesisht në letërsi dhe në media, në mënyrë që të zgjerojë studimet në këto fusha si dhe në ndërlidhjet mes formësimit të kujtesës kolektive dhe rolit të letërsisë dhe masmedias në ndryshimin e konteksteve politike, sociale dhe kulturore.

Konferenca në thirrjen për abstrakte ka vendosur disa akse tematike e fokusuar në katër panele: Politika e kujtesës, Shkrimi i kujtesës, Kujtesa kolektive në media, Kujtesa e të shenjtës, ndërsa afati për dërgimin e abstrakteve është deri më 31 mars.

Kjo është konferenca e dytë e përbashkët e Kolegjit AAB me Universitetin e Firences dhe Elbasanit, ndërsa me Universitetin e Tiranës deri më tani ka pasur disa konferenca të përbashkëta në fushën e mediave dhe komunikimeve.

STUDENTË TË AAB-së SHPËRBLEHEN SI SPORTISTË TË VITIT NGA KOK

12 mars 2022

Nën organizimin e Komitetit Olimpik të Kosovës u mbajt "Ceremonia e Laureatëve", ku u bë shpallja e sportistëve më të mirë për vitin 2021. Në një konkurrencë të madhe dhe kategori të ndryshme për sukseset sportive, ndër shumë emra u shpërblyen tre studentë të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB.







Studentët e shpërblyer janë:

Akil Gjakova (xhudo) – “Sportisti i vitit 2021” në konkurrencën e meshkujve,

Muhamet Ramadani (atletikë) – “Shpresa Olimpike 2021” në konkurrencën e meshkujve dhe

Agon Bajqinovci (hendboll) – “Kombëtarja e vitit 2021”.

Kolegji AAB ju uron suksese studentëve dhe çmime të shumta nga arena sportive.



MINISTRIA E MBROJTJES E MBRETËRISË SË BASHKUAR SHPËRBLEN ME MIRËNJOHJE ISH STUDENTIN E KOLEGJIT AAB

12 mars 2022

Pasi identifikoi një dobësi në sistemin e sigurisë kibernetike në njërën nga ministritë e Mbretërisë së Bashkuar, Florian Konushevci u shpërblye me mirënjohje nga Minstria e Mbrojtjes së këtij vendi.



Floriani ishte student i dalluar i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB dhe suksese të tilla të studentëve janë nder dhe kënaqësi për Kolegjin AAB.

"TË JESH ARTIST I SË ARDHMES" LIGJËRATË PËR STUDENTË ME ARTISTIN KUSHTRIM SOGOJEVA

14 mars 2022

Fakulteti i Arteve ka filluar një seri ligjëratash me të ftuar të ndryshëm me qëllim të informimit rreth temave me interes për studentët. I ftuar ishte Kushtrim Sogojeva, drejtor i "Trokit", që trajtoi temën "Të jesh artist i së ardhmes".





Kjo ligjëratë u bazua në nevojat për ekspertë në fushën e dizajnit grafik në Kosovë dhe rajon. Përmes orientimit ndërkombëtar dhe aftësive të avancuara në rezultatet e studimit për studentët, ndër të tjera Sogojeva foli për fushat klasike të aplikimit në agjencitë, kompanitë e ndryshme botuese dhe të mediave, nëpërmjet mundësive të ndryshme dhe premtuese në udhëheqjen institucionale të kulturës, artit dhe punës së mediave, si në nivel komunal ashtu dhe në atë shtetëror.

Kushtrim Sogojeva është artist dhe ndërmarrës i suksesshëm në Kosovë, ndërsa studimet në fushën e dizajnit grafik i ka mbaruar në Kolegjin AAB.

EDWARD ANDERSON, LIGJËROI PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË PSIKOLOGJISË

14 mars 2022

Edward Anderson, ushtarak dhe detektiv në pension nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbajti një ligjëratë speciale për studentët e Fakultetit të Psikologjisë me temën “Psikologjia Kriminale – gjendja mendore e kundërvajtësve, personaliteti i tyre”.









Gjatë kësaj ligjërate studentët patën mundësinë të mësojnë se si duhet të menaxhohen situatat në rastet e ballafaqimit me mendje kriminale, pyetjet dhe mënyrat specifike që duhet të përdoren gjatë intervistimit të tyre. Gjithashtu ata mësuan për përvojat e z. Anderson në Irak dhe Afganistan, dhe vështirësitë e hasura gjatë shërbimit të tij atje.

z. Anderson e vlerësoi lartë Kolegjin AAB, si dhe interesimin e studentëve për këtë ligjëratë dhe në përgjithësi për të studiuar Psikologjinë, pasi që sipas tij Kosova ka nevojë edhe për më shumë ekspertë të kësaj fushe.

POLYMATH LABS PREZANTOI PROGRAMIN E PUNËS PRAKTIKE PËR STUDENTËT E AAB-së

14 mars 2022

Qendra e Karrierës së Kolegjit AAB në bashkëpunim me Polymath Labs, kompani e cila ofron produkte softuerike dhe shërbime të zhvillimit të softuerit, mbajtën prezantimin lidhur me programin e punës praktike para studentëve të vitit të tretë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike. Studentët patën mundësi të njihen për së afërmi me programin që ofrohet nga kjo kompani në cilësinë si Inxhinier i Automatizimit për Sigurimin e Cilësisë.







Programi i praktikës zgjat 6 muaj dhe është i ndarë në pjesën teorike dhe praktike si dhe me mundësi punësimi në këtë kompani. Afati i aplikimit do të jetë i hapur der më 14 mars.

NË AAB U MBAJT KONFERENCA PËR DIPLOMACINË SPORTIVE

15 mars 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegji AAB në partneritet me Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ambasadën e Francës në Republikën e Kosovës, mbajti konferencë rreth diplomacisë sportive, e cila u organizua në kuadër të programit të përgatitjes për Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike që do të mbahen në Paris, në vitin 2024. Të pranishëm ishin Laurence Fisher, ambasadore e Francës për Sport; Liza Gashi, zv.ministre e Punëve të Jashtme të Diasporës; Marie Kristine Butell, ambasadore e Francës në Kosovë, Daulina Osmani, zv.ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; si dhe Shemsedin Vehapi, prorektor në Kolegjin AAB.

Konferencën e hapi z. Vehapi i cili u shpreh se AAB ka një program masteri që lidhet me diplomacinë, ku në të ardhmen do të përgatisin profile edukative si dhe shprehu gatishmërinë e kolegjit për zhvillimin e talentëve të rinj.







“Më lejoni t’ ju uroj për medaljet dhe sukseset e mahnitshme të atleteve kosovare në xhudo, si dhe më lejoni të ju njoftoj se Franca do të jetë nikoqire e lojërave të ardhshme që do oraganizohen në vitin 2024. Aty ku ne do të mundohemi të promovojmë sa më shumë vlerat e të rinjve në sport”.

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB në vazhdimësi krahas procesimt mësimor organizon edhe aktivitete të ndryshme të cilat kanë ndikim të drejtëpërdrejtë për të gjithë studentët e këtij fakulteti.

AAB PJESË E AKTIVITETEVE NË KUADËR TË JAVËS SË FRANKOFONISË

15 mars 2022

Ambasada e Francës dhe Kolegji AAB janë bërë bashkë për organizimin e Javës së Frankofonisë. Në ceremoninë e hapjes ishte e pranishme Prorektorja Venera Llunji dhe personalitete të tjera ndërkombëtare dhe vendore përfshirë ambasadoren e Francës në Kosovë, Marie-Christine Butel, ambasadorin e Zvicrës, Thomas Kolly, ambasadori i Kanadasë për Kosovë në Kroaci, Sh.T Alan Bowman, shefi i ri Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, z. Julien Sassel, Ministri i Kulturës, z. Hajrulla Çeku e të tjerë.







Kjo ngjarje shënon edicionin e 22-të të saj, ku do të sjell program të pasur kulturor artistik që përfshin aktivitete të shumta në fushën e artit, kulturës, sportit, trashëgimisë, inxhinierisë, njohurive mbi BE-në, dhe tema të tjera mbi aktualitetin.

STUDENTI I AAB-së FITON MEDALJE TË ARGJENDTË NË LEIRA TË PORTUGALISË

16 mars 2022

Studenti i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB, Muhamet Ramadani është kthyer me medalje të argjendtë nga Leira e Portugalisë, duke zënë vendin e dytë për Kupën Evropiane të Hedhjeve.

Këtë rezultat ai e arriti si U23 në disiplinën e hedhjes së gjyles 7 kg me një rezultat prej 18.60 metra në një garë me konkurrencë të madhe.

Studentët e këtij fakulteti, përveç pjesëmarrjes arrijnë të jenë edhe fitues pothuajse në të gjitha garat e atletikës që zhvillohen në nivel vendi si dhe në gara ndërkombëtare.



DIZAJNERJA NITA QENA MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË ARTEVE

16 mars 2022

E ftuara e radhës për ligjëratë para studentëve të Fakultetit të Arteve ishte dizajnerja Nita Qena nga kompania e marketingut "Karrota". Studentët u njoftuan nga perspektiva e një punëdhënësi, për punën e një dizjaneri në agjenci marektingu mbi punën, pritmshmëritë dhe dallimet nga teoria në fakultet dhe vendosja në praktikë.

Krahas kësaj, studentët do të jenë në gjendje të marrin pozicionin kritik në lidhje me teoritë ekzistuese dhe të gjenerojnë lidhje të reja në fushën bashkëkohore të dizajnit grafik dhe të sfidojnë kufijtë tradicional të dizajnimit.







STUDENTËT E AAB-së SËRISH TË ANGAZHUAR NGA NDI NË KUADËR TË "JAVËS SË GRUAS 2022"

17 mars 2022

Studentët e vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike edhe këtë vit do të zhvillojnë dhe mirëmbajnë webfaqen kryesore të "Javës së Gruas 2022", duke vazhduar traditën e bashkëpunimit tashmë disa vjeçar në përkrahjen e projektit "Java e Gruas" (Week of Women) që organizohet për të disatën herë me radhë.



Në vazhdën e bashkëpunimit shumëvjeçar të këtij fakulteti me organizatën amerikane, NDI (National Democratic Institute), këtë vit studentët tanë do të mirëmbajnë bazën e të dhënave e krijuar kjo vite më parë nga studentët paraprakë.

Studentët e AAB-së, vite më parë kishin krijuar edhe databazën e Kuvendit të Kosovës, si ndihmë e NDI për punën e Kuvendit.

"EDUGRUA" ZHVILLOI SESIONIN E TETË NË KOLEGJIN AAB

17 mars 2022

Sot u mbajt moduli i tetë i 'EduGrua' në Kolegjin AAB, i cili ka për qëllim risocilaizimin e grave dhe vajzave, viktima të dhunës në familje dhe përkrahja e tyre në zhvillimin e ideve të biznesit.

E ftuar në sesionin e parë ishte Lirika Tafa-Bajrami, themeluese dhe pronare e Vivienne Academy si dhe Lirie Hoti, menaxhere e projektit EduGrua për Kosovë. Gjatë këtij sesioni znj. Tafa-Bajrami ndau me të pranishmet storjen e saj të suksesit, duke folur mbi akademinë që ajo ka themeluar, idenë se si ka filluar një projekt të tillë sipërmarrës dhe mundësitë të cilat kjo akademi ofron.

Ajo u shpreh e gatshme që të ndihmojë këto vajza dhe gra në idetë që ato japin dhe se do të jenë të mirëpritura në Vivienne Academy. Ndërsa zn.Hoti menaxhere e projektit për Kosovë u shpreh falënderuese ndaj Kolegjit AAB për përkrahjen dhe bashkëpunimin në realizim e këtij projekti, si dhe të gjithë trajnerët të cilët kanë marrë pjesë gjatë moduleve të EduGrua.







PROMOVOHET LIBRI "SOVRANITETI VERSUS INTEGRITETI" I AUTORIT ARBEN ÇEJKU

17 mars 2022

Me pjesëmarrjen e figurave politike, diplomatike, letrare e kulturore në Kolegjin AAB u bë promovimi i librit "Sovraniteti versus Integriteti" i autorit Arben Çejku.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Bordit të Kolegjit AAB, z. Lulzim Tafa, foli mbi tematikën e librit dhe rëndësinë e një promovimi të tillë në hapësirat e AAB. Ndërsa, ish-ambasadori Avni Spahiu foli për lidhshmërinë e krijimit të politikave të vendit me librin për të arritur një marrëveshje përfundimtare me shtetin e Serbisë. Dekani i Fakultetit të Administratës Publike në Kolegjin AAB, Petrit Bushi, ndër të tjera shpreh-hu rëndësinë e librit për studim nga ana e studentëve të fakultetit ku ai drejton dhe ndarjet historike që i trajton autori në brendësi të librit.







Vetë autori i këtij libri, z. Arben Çejku, shpreh mirënjohje për organizimin e promovimit të librit në ambientet e Kolegjit AAB duke treguar për përpjekjet e tij dhe sfidat që ka kaluar deri në përfundimin e këtij libri. Si autor, ai tha se duhej të hiqte petkun e diplomatit i cili duhet të përgjigjet mbi të gjitha informacionet që jep dhe të japë kontribut në shprehjen dhe tregimin e prapaskenave të një dialogu me rëndësi të veçantë për shtetin e Kosovës.



Në fund, Çejku u përgjigj në pyetjet e studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë promovim, të cilët shprehën interesim mbi zhvillimet e sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës.

KOLEGJI AAB DO TË KONTRIBUOJË NË HARTIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK TË FERIZAJT

18 mars 2022

Drejtori i degës së Kolegjit AAB në Ferizaj, Shaip Bytyqi, priti në takim drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Ferizaj, Balton Dërguti.

Qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi rreth hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Ferizajt, për pesë vitet e ardhshme. Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik do të bëhet në bashkëpunim me profesorët tanë së bashku me zyrtarë komunal dhe bashkëpunëtorë tjerë.



STUDENTËT DHE STAFI I AAB-së MBËSHTESIN PERSONAT ME SYNDROME DOWN

21 mars 2022

Në kuadër të aktiviteteve të shumta për kontributin ndaj shoqërisë, AAB sërish ka mirëpritur Shoqatën "Down Syndrome Kosova". 21 Marsi, në mbarë botën shënohet si Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down. Përmës kësaj, anëtarët e kësaj shoqate kanë sjellë kartolina të punuara nga ta, të cilat po blihen me shumë dëshirë nga studentët tanë dhe stafi akademik.







Kjo datë shënohet me aktivitete të shumta, qëllimi i të cilave është ngritja e vetëdijes për mbështetjen psiko-sociale ndaj personave me sindromën down dhe integrimin e tyre në shoqëri.

U ORGANIZUA TRYEZË DISKUTIMI PËR PERSONAT ME SINDROMËN DOWN

22 mars 2022





Në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down, Fakulteti i Psikologjisë dhe ai i Shkencave Sociale, organizuan një tryezë diskutimi. Në këtë panel, për projektet, sfidat dhe përfshirjen e personave me sindromën Down, diskutuan përfaqësuesit e Shoqatës Down Syndrome Kosova, Ermira Shabani dhe Dionis Ferataj si dhe profesoresha e Kolegjit AAB, Vjollca Berisha.

Diskutuesit, njëzëri potencuan se është bërë shumë kundrejt përfshirjes edukative dhe profesionale të personave me nevoja të veçanta në vendin tonë, porse barra kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e kësaj kategorie, ende i mbetet organizatave jo-qeveritare dhe shoqërisë civile, përderisa institucionet shtetërore akoma nuk tregojnë angazhim serioz në ndihmë fëmijëve me nevoja të veçanta.

Për fund fare, Dionis Ferataj nga shoqata DSK dhe njëkohësisht bartës i trizonomisë kromozomale, rrëfeu për punën e tij të zellshme në kuadër të shoqatës, që njëherit tregon për kapacitetin që kanë personat me sindromën Down për të dhënë kontribut social dhe profesional.

SPITALIN PSIKIATRIK NË EMMENDINGEN REKRUTON STUDENTËT E PARË TË INFERMIERISË PËR PUNËSIM

22 mars 2022

Studentët e Fakultetit të Infermierisë së Kolegjit AAB, pjesë e Programit për Karrierë dhe Punësim janë pajisur sot me kontrata nga punëdhënësi i tyre Spitali Psikiatrik në Emmendingen.

Studentët e Programit për Karrierë dhe Punësim, të cilët para një muaji janë intervistuar nga z.Jeton Himaj, Drejtor i Infermierisë në Qendrën Psikiatrike Emmendingen të cilët kanë marrë konfirmimin e pranimit të tyre në punë, sot zyrtarisht kanë në duart e tyre kontratat e punës me spitalin Psikiatrik në Emmendingen-Gjermani.

Studentët janë shprehur jashtëzakonisht të lumtur për nënshkrimin e kontratateve e cila iu mundëson që shume shpejt do të jenë pjesë përbërëse e stafit të njërit nga spitalet më të mira në Gjermani.









Studentëve të Programit për Karrierë dhe Punësim të cilët do të punojnë në këtë spital përveç mundësisë së punësimit, iu ofrohen shanse të mëdha të aftësimit dhe avansimit të tyre profesional

NË KAMPUSIN E FERIZAJT U MBAJT LIGJËRATË PËR "DREJTËSINË TRANZICIONALE"

23 mars 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj u mbajt ligjërata mbi temën "Drejtësia Tranzicionale" nga organizata "Humanitarian Law Center Kosovo", me studentët e vitit të II-të të drejtimit Juridik i Përgjithshëm. Kjo ligjëratë kishte në fokus ngjarjet e luftës në Kosovë, të drejtat e viktimave dhe familjeve të viktimave sot, gjykimet për krime lufte dhe format tjera të ballafaqimit me të kaluarën.





Ligjërata të tilla mbahen që nga viti 2013 në universitete dhe shkolla të mesme të Kosovës, me miratimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe DKA-së.

KLUBI I EKONOMISTËVE TË RINJ MBAJTËN DEBATIN "LIDERËT LINDIN APO ZHVILLOHEN"

23 mars 2022

Klubi i Ekonomistëve të Rinj zhvilloi një debat të hapur me studentët e Fakultetit Ekonomik, me temën nëse liderët lindin apo zhvillohen. Takimi u hap nga profesoresha Adelina Gashi, e cila fillimisht falëndero i studentët e Klubit të Ekonomistëve të Rinj për iniciativa të tilla dhe fto i ata që të nxis in pjesëmarrjen edhe të studentëve tjerë nga fusha të tjera për të marrë pjesë në evente të tilla. Organizimin e përshëndeti edhe d ekani Medain Hashani, i cili inkurajo i studentët për të tilla aktivitete dhe premto i mbështetje të pa rezervë nga menaxhmenti i Fakultetit Ekonomik dhe i Kolegjit AAB, po ashtu.



Qëllimi i këtij debati ishte që studentët të shpërfaqin aftësi të diskutimit konstruktiv, kreativ dhe argumentues duke përfshirë këtu edhe inkurajimin e studentëve në hulumtim mbi liderët më të mëdhenj që njeh historia. Pjesë e diskutimit ishin edhe studentët e vitit të dytë dhe vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik.

Debati u përmbyll me argumente dhe kundër argumente të cilat diktuan nevojën për takime të radhës të përmasave edhe më të mëdha të përfshirjes së studentëve dhe profesorëve





RRJETI I KLINIKAVE SANA NË GJERMANI MBAJTI INTERVISTA PUNE ME STUDENTËT

24 mars 2022

Për dy ditë radhazi, një numër i madh i studentëve të Infermierisë së Kolegjit AAB, të cilët janë pjesë e Programit për Karrierë dhe Punësim, janë intervistuar nga drejtorët e klinikave të rrjetit SANA në zonën e Stuttgartit dhe München-it në Gjermani.







Intervistat u realizuan online, ku partneri gjerman SANA pati mundësinë që të njohë dhe të intervistojë studentët potencial të cilët do jenë pjesë përbërëse e stafit të klinikave të cilat operojnë në ombrellën e SANA. Intervistat janë realizuar në gjuhën gjermane, pasi që studentët e Programit të cilët janë intervistuar tashmë janë në përfundim të nivelit B2, të gjuhës gjermane, në kurset të cilat i organizon LINGUA në Kolegjin AAB.

Përfaqësuesit e klinikave janë shprehur jashtëzakonisht të kënaqur me performancën dhe përgatitjen e studentëve të Programit si në gjuhën gjermane po ashtu edhe për përgatitjen e tyre profesionale. Ndërsa studentët e Programit për Karrierë dhe Punësim, janë shprehur mirënjohës për mundësitë e pafundme që ofron ky Program, ndër të tjera edhe mundësinë që të njohin paraprakisht punëdhënësin e tyre gjerman.

THIRRJE PËR PJESËMARRJE – KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE PËR LINGUISTIKË

24 mars 2022

Kolegji AAB, si bashkorganizator, ka kënaqësinë të ndajë thirrjen për pjesëmarrje në Konferencën Ndërkomëbtare Shkencore, që do të mbahet në Universitetin “Fan S.Noli”, në Korçë, Shqipëri.



Konferenca "Linguistic perspectives in the light of social developements"; "e-Learning approaches to linguistic acquisition", organizohet nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhëve të Huaja.

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCËN E 6-TË NDËRKOMBËTARE NË SHKENCAT E APLIKUARA

24 mars 2022

Kolegji AAB, si bashkorganizator, ka kënaqësinë të ndajë thirrjen për pjesëmarrje në Konferencën e 6-të Ndërkombëtare në Shkencat e Aplikuara, që do të mbahet në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Maqedoninë e Veriut.



Konferenca ka për qëllim të promovojë shkëmbimin e ideve akademike dhe kërkimit, ku janë të ftuar arkitektë, projektues, inxhinierë, teknologë, studiues të shkencave të aplikuara, studentë dhe pedagogë, kolegje dhe universitete, dhe të tjerë në fusha të ngjashme të kërkimit për të paraqitur propozimet e tyre.

Organizatorë të konferencës janë:

Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanizmit

Kolegji AAB, Fakulteti i Arkitekturës

Universiteti Epoka

GIZ DIMAK DHE UNDP PREZANTUAN "PROGRAMIN PËR AFTËSIM DIGJITAL"

24 mars 2022

Qendra për Karrierë e Kolegjit AAB në bashkëpunim me GIZ DIMAK dhe UNDP, mbajtën sesion informues për projektin e "Programit për Aftësim Digjital", për studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike.





Ky program ka për qëllim që t' i përkrahë punëkërkuesit e rinj në zhvillimin e aftësive digjitale, përmes trajnimeve intensive në fushën e teknologjisë. Trajnimet të cilat do të organizohen në kuadër të këtij projekti do të jenë: aplikacione celulari, web-zhvillim, inxhineri e të dhënave, marketing digjital dhe dizajn digjital. Pas përfundimit të këtyre trajnimeve 50 të përzgjedhurit nga 110 përfituesit e trajnimeve, do të kenë mundësi për praktikë në punë me pagesë në kompani private, me kohëzgjatje prej 6 muaj.

Të drejtë aplikimi përveç studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, kanë edhe studentët nga drejtimet e tjera të Kolegjit AAB.

Thirrja për aplikim është e hapur deri më 08 prill 2022.

ZV. REKTORJA E UNIVERSITETI TË GHENTIT, PROF. DR. MIEKE VAN HERREWEGHE, MBAN LIGJËRATË NË AAB

25 mars 2022

Zv. Rektorja e Universitetit të Ghentit në Belgjikë, Prof. dr. Mieke Van Herreweghe, viziton për herë të parë Kosovën dhe ekskluzivisht Kolegjin AAB. Ajo gjithashtu është eksperte dhe hulumtuese e gjuhës së shenjave në Evropën Perëndimore.

Të gjithë studentët e Kolegjit AAB janë të mirëseardhur në Qendrën Mediale, në katin e III-të, me datën 30 mars nga ora 14:00, për një ligjeratë të veçantë mbi gjuhën e shenjave.



VIZITË STUDIMORE NË SHOQATËN E PARAPLEGJIKËVE DHE PARALIZËS SË FËMIJËVE HANDIKOS/GJAKOVË

25 mars 2022

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, programi Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve, dega në Gjakovë, vizituan Shoqatën e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve Handikos/Gjakovë. Studentët u shoqëruan nga prodekanja znj. Diana Qarkaxhija dhe Prof. ass. dr. Violeta Buza.







Kjo vizitë studimore dhe aktivitete të tjera u realizuan me synim të rritjes së vetëdijesimit. Përpos kësaj studentët ndanë edhe dhurata për fëmijët e kësaj shoqate.

VIZITË STUDIMORE NË AGJENCINË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

25 mars 2022

Studentët e Klubit të Debatit të Fakultetit të Administratës Publike, zhvilluan një vizitë studimore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në kuadër të aktivitetit të përvitshëm „Java e arkivit të hapur" ku u mirëpritën edhe nga Kryeshefi Ekzekutiv i Arkivit, z. Bedri Zyberaj.

Në këtë takim, studentët patën mundësinë që të njihen më shumë për punët që zhvillohen në këtë institucioni, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacioneve me vlerë historike dhe jo vetëm.






Në vazhdën e informacioneve që studentët morën nga kjo vizitë, ata u njoftuan nga afër edhe për mundësitë hulumtuese jo vetëm mbi dokumentacionin që posedon Arkivi Shtetëror i Kosovës mirëpo edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë e cila përfaqësohet me këndin arkivor brenda këtij institucioni.

Studentët morën këshilla që në asnjë formë të mos heqin dorë nga studimet dhe u motivuan për t' u bërë pjesë e studimeve hulumtuese mbi dokumentacione të vjetra, të cilat gjithnjë e më shumë i nevojiten shtetit të Kosovës.

KOLEGJI AAB PJESË E WEBINARIT TË ORGANIZUAR NGA ASOCIACIONI I UNIVERSITETEVE EVROPIANE

26 mars 2022



Asociacioni i Universiteteve Evropiane, anëtar i të cilit është edhe Kolegji AAB, mbajti sesionin e dytë ndërkombëtar këtë vit me webinarin e radhës të titulluar: “The pandemic two years on – what consequences for international cooperation?” (Dy vitet e pandemisë – çfarë pasojash pati bashkëpunimi ndërkombëtar?)

Folësit e këtij webinari ishin: Thomas Jorgensen, Koordinator i Politikave të Asociacionit EUA; Inge Van Nieuwerburgh, Koordinatore për Komunikim Akademik dhe Shkencor, Ghent University; Ulrich Grothus, President i Academic Cooperation Association dhe Giorgio Marinoni, Menaxher në International Association of Universities.

Në këtë webinar morën pjesë prorektorja Venera Llunji dhe koordinatori për cilësi nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Ersan Hamdiu.

PROF. ERJONA REBI NGA TIRANA MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK

28 mars 2022

Fakulteti Ekonomik priti Prof. Erjona Rebi nga Tirana për një ligjëratë speciale për studentët e këtij fakulteti. Prof. Erjona Rebi ka përvojë shumëvjeçare institucionale dhe akademike si dhe është bashkautore e librit 'Menaxhimi Bankar dhe Rregullativa'.



Në ligjëratën e saj, znj. Rebi theksoi rëndësinë që kanë besimi, pasiguria dhe sjellja psikologjike për sektorin financiar, duke e bërë analizën e këtij sektori sa sfiduese ashtu edhe atraktive, pavarësisht zhvillimit të madh që mund të pësojnë instrumentet financiare në shërbim të nevojave të agjentëve ekonomik.

Në bashkëbisedim me studentët u trajtuan edhe disa aspekte tjera të rëndësishme të krizave financiare, të cilat duhen parandaluar dhe menaxhuar me kujdes në përputhje me kushtet makroekonomike, sjelljen dhe besimin e publikut dhe duke nxjerrë përfundimin se nuk ekziston një recetë shëruese që mund të aplikohet për secilin vend.

PSIKOLOGJA DAFINA PROKSHI, E DIPLOMUAR NË AAB, MBAJTI LIGJËRATË MOTIVUESE PËR STUDENTËT

28 mars 2022

Ish-studentja e Fakultetit të Psikologjisë e Kolegjit AAB, Dafina Prokshi, njëherësh edhe themeluese e 'Parenting Program of Kosovo' dhe 'Pro Early Education', ka mbajtur ligjëratën motivuese: "Zhvillimi i njohurive drejt aftësimit për punësim", për studentët e Psikologjisë.





Në këtë mes janë trajtuar çështjet e prioriteteve dhe rëndësia e punëtorive që të frymëzohet eksplorimi i mëtejmë dhe të promovohen praktikat aktuale për një perspektivë sa më të mirë të punësimit.

Ndërsa, studentët tanë ishin edhe përfitues për të ndjekur punëtorinë e radhës në fushën e psikoterapisë.

STORJE SUKSESI: GENTIJANA PAÇARIZI, ANGAZHOHET NË PLAY INTERNATIONAL

29 mars 2022

Gentijana Paçarizi, si studente e vitit të parë në nivelin Master në drejtimin Kulturë Fizike dhe Sport, ka marrë pjesë në trajnimin "Ndryshimi i mentalitetit për aftësitë e kufizuara përmes Sportit" në kuadër të projektit "Play In Together" e mbajtur nga PLAY International Kosova



Të gjitha sesionet edukative dhe sportive të mësuara nga ky trajnim, Gentijana i ka implementuar te fëmijët e shkollës "The British School of Kosova", kështu duke finalizuar suksesshëm trajnimin.

Si rezultat, Gentijanës i është ofruar punë praktike për 3 muaj duke mbështetur stafin e PLAY International në implementimin e projekteve edukativo-sportive. Kjo praktikë do të jetë mundësi interesante dhe shpërblyese për karrierë dhe zhvillim personal.

THIRRJE PËR STUDENTË: SHKOLLA VERORE NË UNIVERSITETIN RADBOUD, HOLANDË

29 mars 2022

Shkolla Verore Ndërkombëtare në Universitetin Radboud në Holandë ka hapur aplikimet për të gjithë studentët që dëshirojnë të jenë pjesë e një aventure të re.

Shkolla Verore 2022 në Metodat e Kërkimit Social e organizuar nga Shkolla e Menaxhimit Nijmegen, Universiteti Radboud, Holandë do të mbahet nga 20 qershori deri më 1 korrik.



MBAHET MODULI I TRAJNIMIT PËR INFERMIERINË GERIATRIKE DHE REHABILITIMIN

29 mars 2022

Në kuadër të kurseve ndërkombëtare të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, Fakulteti i Infermierisë organizon trajnimin e dytë për EVP të paraparë me datën 06.04.2022. Tematika e këtij kursi është ''Infermieria geriatrike dhe rehabilitimi'' me ligjëruesin nga Shqipëria, Elidon Dingo.



Kursi do të mbahet fizikisht brenda hapësirave të Fakultetit të Infermierisë në Kolegjin AAB. Pjesëmarrja fizike është obligative dhe e limituar maksimumi deri në 100 pjesëmarrës. Kursi është një ditor dhe fillon nga ora 09:00-14:30, salla A-113.

Këto kurse janë te kredituar nga Oda e Infermiereve të Kosovës, me 8 pikë për pjesëmarrësit pasivë, dhe 10 pikë për pjesëmarrësin aktivë.

FAKULTETI JURIDIK NËNSHKROI MEMORANDUM ME "CHECCHI AND INC.", IMPLEMENTUES I PROGRAMIT TË USAID "DREJTËSIA KOMERCIALE"

30 mars 2022

Në Kolegjin AAB është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes Fakultetit Juridik, i përfaqësuar nga Dekani Prof. Ass. Dr. Veton Vula, dhe Kompanisë Këshilldhënëse "Checchi and Inc.", implementues i Programit të USAID "Drejtësia Komerciale", përfaqësuar nga drejtori i këtij Programi z. Christopher Thompson.



Memorandumi ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese në fushën e promovimit dhe avancimit të drejtësisë komerciale, përkatësisht bashkëpunimit në aktivitete ku studentëve të vitit të III-të dhe të IV-të të Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, iu ofrohet mundësi që të jenë pjesë e punës teorike dhe simulimeve praktike të ndërmjetësimit si mekanizëm alternativ i zgjidhjes së kontesteve.



Programi Drejtësia Komerciale është një iniciativë pesë-vjeçare e financuar nga USAID për të zvogëluar mundësitë për korrupsion dhe për të përmirësuar perceptimin e bizneseve dhe publikut për korrupsionin duke përmirësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare, përmbarimin dhe nxitjen e të kuptuarit të proceseve që rrisin investimet dhe promovojnë rritjen ekonomike në Kosovë. Ndër tjera, Programi promovon zgjerimin e mundësive dhe mbështetjen e mekanizmave alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Kosovë. Qëllimi i Programit është gjithashtu të angazhojë të rinjtë në mënyrë më aktive në Zgjidhjen Alternative të Kontesteve.

VIZITË STUDIMORE NË QENDRËN SHTETËRORE TË TË DHËNAVE

31 mars 2022

Një grup i studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike së bashku me profesorin Gani Zogaj vizituan Qendrën Shtetërore të të Dhënave.



Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të fitojnë njohuri praktike. Duke qenë pjesë e mësimit ndërveprues, vizita të tilla u japin studentëve një ekspozim ndaj mjediseve të punës së bashku me një perspektivë praktike të një koncepti teorik të përshtatshëm për fushën e tyre.

Përveç kësaj, vizitat e tilla mbushin hendekun në rritje midis mësimit teorik dhe ekspozimit praktik. Po ashtu u ofrojnë studentëve mundësi për të takuar udhëheqës të industrisë, profesionistë, dhe politikëbërës që ndajnë njohuritë, mësimin dhe përvojat e tyre.

Këto ndërveprime janë të dobishme për studentët në karrierën e tyre dhe i ndihmojnë ata në zhvillimin e cilësive të lidershipit, aftësive profesionale dhe të mësojnë rreth industrisë së fushës të Teknologjisë së informacionit.

ZV. REKTORJA E UNIVERSITETIT TË GHENTIT NË BELGJIKË VIZITON KOLEGJIN AAB

31 mars 2022









Prof. dr. Mieke Van Herreweghe, Prof. dr. Mieke Van Herreweghe, zv. Rektore në Universitetin e Ghentit në Belgjikë, mbajti një ligjëratë të veçantë për studimet në gjuhën e shenjave në Evropë.

Studentët e AAB patën mundësinë të kuptojnë mekanizmat komunikues të gjuhës së shenjave dhe mënyrat se si studiuesit në Evropë i kanë shqyrtuar strukturat gjuhësore të gjuhës së shenjave.

Dr. Uranela Demaj, Prorektore për Shkencë dhe Kërkime në Kolegjin AAB, theksoi se tema e gjuhës së shenjave në Kosovë ende nuk është studiuar thellësisht nga këndvështrimi akademik. Prandaj, ligjërata ofroi një bazë për studentët e Kolegjit AAB që të hulumtojnë tutje këtë temë dhe të kryejnë një projekt kërkimor mbi gjuhën e shenjave në Kosovë.


KOLEGJI AAB

PRILL 2022

FAKULTETI EKONOMIK NËNSHKROI MARRËVESHJE ME RRJETIN E MARKETEVE "MAXI"

1 prill 2022



Dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. Medain Hashani, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me rrjetin e marketeve "MAXI", të përfaqësuar nga shefi ekzektutiv, z. Ylli Çollaku.
Qëllimi i marrëveshjes është që të përfitojnë të dy palët përmes shkëmbimit të shërbimeve cilësore si dhe bashkëpunimeve si: trajnime të përbashkëta për rritje të kapaciteteve, organizime të seminareve edhe konferencave, realizimi i praktikës studentore, mundësi punësimi për studentë, lehtësimi i aktiviteteve hulumtuese për nevoja të dy anshme, etj.

Të dyja palët premtuan në realizim dhe organizim cilësorë të këtyre aktiviteteve duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e zgjerimit të aktiviteteve dhe bashkëpunimeve të natyrave të ndryshme varësisht nga paraqitja e nevojës.

KOLEGJI AAB MBLEDH FONDE PËR FËMIJËT AUTIK NË NDER TË SHËNIMIT TË DITËS NDËRKOMBËTARE TË AUTIZMI

2 prill 2022









Në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Autizmit, studentë të nivelit master në Fakultetin e Psikologjisë kanë filluar një iniciativë për grumbullim të fondeve për të kontribuar në zhvillimin dhe aftësimin e fëmijëve autikë. Studentet Sumeja Hoxhaxhiku, Dardane Bublaku, Shkurte Topanica, Arbenita Shala dhe Liberta Uka, kanë realizuar punime dore të cilat i kanë vënë në shitje për ata që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë nismë.

Autizmi është një çrregullim neurologjik që ndikon në zhvillimin normal të trurit në fushat e ndërveprimit shoqëror dhe ne aftësitë e komunikimit.

SPECIALISTJA ELONA MUSTAFARAJ MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E PSIKOLOGJISË

4 prill 2022

Specialistja në fushën e Tyflopsikologjisë (psikologjia e personave me dëmtime në të parë), znj. Elona Mustafaraj mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB.

Ajo ndau me studentët eksperiencën e saj disa vjeçare në këtë fushë, derisa në këtë ligjëratë u realizuan ushtrime praktike të cilat synonin t' i vendosnin studentët në pozitat e personave me paaftësi në shikim, gjithashtu për të kuptuar dhe një pjesë të përjetimeve të tyre. Një vend të rëndësishëm u tha se pati edhe pjesa biologjike e dëmtimit e cila mund të shkaktojë këtë paaftësi.

Në këtë ligjëratë studentët morën një panoramë mbi fazat psikologjike në të cilat kalon procesi i pranimit të verbërisë, ndërsa në fund të ligjëratës u zhvillua diskutim mes studentëve dhe të ftuarës.



SHËNOHET DITA BOTËRORE E AUTIZMIT

4 prill 2022





Fakulteti i Psikologjisë i Kolegjit AAB në bashkëpunim me Klinikën "Empatia" dhe Qendrën për Shërbime Humane dhe Zhvillim, organizuan shënimin e Ditës Botërore të Autizmit. Me këtë rast, prof. Fitim Uka nga Klinika "Empatia" mbajti ligjëratë vetëdijësuese për studentët. Përmes kësaj ligjërate, ndër të tjera, studentët patën rastin të dëgjojnë për zhvillimet e fundit në aspektin shkencor dhe trajtues të autizmit, për diversitetin dhe pasurinë që e karakterizon botën e fëmijëve autikë dhe për rëndësinë e intervenimit të hershëm në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Studentët e Fakultetit të Psikologjisë, organizuan edhe një ekspozitë shitëse të aksesorëve punim dore, ndërsa të hyrat e fituara nga shitja do të përdoren për t' u dalë në ndihmë fëmijëve autik.

FILLON VOTIMI PËR ZGJEDHJET STUDENTORE 2022

5 prill 2022

Unioni i Studentëve të Kolegjit AAB, ka filluar votimin për anëtarësinë e re. Çdonjëri nga ju mund të jetë zëri i studentëve të fakultetit tuaj në Parlamentin e Studentëve të Kolegjit AAB, dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë njërën nga pozitat në Kryesinë e Unionit të Studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të rinj bëhet online përmes platformës e-service, ndërsa votimi tashmë është i hapur deri më 09 prill.

Pas shpalljes së rezultateve, do të mbahen zgjedhjet e brendshme për kryesinë e Parlamentit Studentor. Mbi procesin e zgjedhjeve dhe certifikimin e rezultateve do të njoftoheni në ditët në vijim përmes faqeve tona zyrtare.



STUDENTËT E ARKITEKTURËS TË KOLEGJIT AAB, VIZITUAN KOMUNËN E JUNIKUT

6 prill 2022

Sudentët e Fakultetit të Arkitekturës në kuadër të lëndës së nivelit master "Konteksti Urban-Regjioni" të udhëhequr nga prof. Ilir Gjinolli, kanë vizituar komunën e Junikut. Praktikat si kjo ndihmojnë në qëllimin e lëndës për aftësimin e studentëve për të marrë pjesë në mënyrë efektive në hartimin e planeve hapësinore të komunës apo planeve hapësinore të zonave të veçanta.







Gjatë kësaj vizite studentët u njohën me gjendjen ekzistuese dhe sfidat zhvillimore të komunës së Junikut dhe se si ato mund të adresohen përmes planit zhvillimor komunal. Grupi i studentëve të Kolegjit AAB u prit nga kryetari i komunës Ruzhdi Shehu dhe zyrtarë të tjerë në qeverisjen komunale të cilët diskutuan mbi problemet dhe potencialet e zhvillimit të komunës.





NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FEDERATËN E GJIMNASTIKËS SË KOSOVËS

6 prill 2022

Kolegji AAB gjegjësisht Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Gjimnastikës së Kosovës duke u bazuar në përcaktimin e programeve të përbashkëta në realizimin e pjesës praktike të studentëve, për mbrojtjen e interesit të studentëve, për zhvillimin e njohurive të reja respektivisht atyre praktike në kuadër të lëndës së gjimnastikës.

Kjo marrëveshje u nënshkrua nga dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Prof.Asoc.Dr. Fatmir Pireva, dhe nënkryetarja e Federatës së Gjimanstikës, Abeliana Bregu.







Ndër të tjera, në saje të këtij bashkëpunimi do të bëhen edhe organizime të konferencave shkencore dhe shkëmbim i përvojave me synim të fuqizimit të politikave edukativo-arsimore, emancipimin dhe afirmimin e vlerave të mirëfillta të studentëve.

PUNËTORI SIMULUESE: NDËRMJETËSIMI SI PROCEDURË ALTERNATIVE E ZGJIDHJES SË KONTESTEVE

6 prill 2022

USAID dhe Kolegji AAB në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ftojnë studentët e Fakultetit Juridik të vitit të tretë dhe të katërt bachelor, dhe ata të programit Juridik-civil në nivelin master, të aplikojnë për të marrë pjesë në punëtorinë simuluese për ndërmjetësimin si procedurë alterantive e zgjidhjes së kontesteve.



THIRRJE PËR PJESËMARRJE: KONFERENCA E PESTË NDËRKOMBËTARE PËR SHËNDETIN, MIRËQENIEN, EDUKIMIN DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

6 prill 2022

Kolegji AAB dhe Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) organizojnë edicionin e pestë të Konferencës Ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve.

Kjo ngjarje realizohet për të mbështetur fëmijët, të cilët përfaqësojnë 34% të popullsisë së Kosovës (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018), që ata të mund të lulëzojnë në çdo aspekt të jetës së tyre, veçanërisht në lidhje me shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, qëllimi i kësaj konference është të mbledhë studiues nga e gjithë bota për të paraqitur avancimet në lidhje me edukimin, shëndetin, mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve dhe për të nxitur një mjedis të favorshëm për shkëmbimin e ideve dhe informacioneve duke integruar përbërës teorikë dhe praktikë të kësaj çështje



Kësaj radhe, konferenca do të përqendrohet kryesisht në mirëqenien e fëmijëve për shkak të dukurive të fundit në botë. Shumë fëmijë janë në disavantazh për shkak të pandemisë COVID-19, kështu që aspiratat e tyre fizike dhe mendore do të preken. Pra, mirëqenia post-pandemike dhe rikuperimi psikologjik është tema kryesore e konferencës. Kjo konferencë synon të inkurajojë debatin e mirëfilltë shkencor dhe politik-bërjen e bazuar në evidencë duke promovuar shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve.

PROFESORË NGA DANUBE UNIVERSITY NË VIZITË TREDITORE NË KOLEGJIN AAB

7 prill 2022

Në kuadër të projektit "APPEAR" dy profesoresha nga Danube University për tre ditë qëndruan për vizitë në Kolegjin AAB.
Gjatë këtyre ditëve, Monika Kil dhe Sonja Brachtl u mirëpritën nga Rektori i Kolegjit AAB Prof. Bujar Demjaha, dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale Prof. Hysen Kasumi, zv. Rektori Shemsedin Vehapi dhe drejtoresha për zhvillim të projekteve Prof. Ilirjana Geci.









Ato vizituan hapësirat dhe ofrimin e kushteve të mësimit në Kolegjin AAB. Sipas agjendës u realizua vizitë në kampusin e komunës së Ferizajt ku u pritën nga stafi drejtues.

Prof. Monika dhe prof. Sonja më pas zhvilluan edhe një ligjëratë në kuadër të "APPEAR" për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale.

AAB DHE ALEANCA FRANCEZE FILLOJNË ME KURSE FALAS TË GJUHËS FRËNGE

8 prill 2022



Kolegji AAB dhe Aleanca Franceze në Kosovë, njoftojnë të gjithë studentët dhe stafin akademik e administrativ për fillimin e kurseve të gjuhës frënge nga data 19 prill. Studentët dhe stafi i AAB-së mund të aplikojnë duke dërguar email tek venera.llunji@aab-edu.net.

Numri i grupit në kurs do të jetë vetëm 13 persona (studentë, staf akademik ose adminstrativ). Më pas do bëhet përzgjedhja nga një komisioni i caktuar. Kursi do të jetë falas për këtë nivel dhe do të mbahet në hapësirat e Kolegjit AAB në orare të caktuara.

STUDENTËT E ARTIT REALIZOJNË MURAL PËR QENDRËN PËR PRAKTIKË PEDAGOGJIKE

9 prill 2022

Bashkëpunimi ndërmjet gjithë fakulteteve të Kolegjit AAB, bën që kolegialitet i tillë të përcillet edhe mes studentëve të programeve të ndryshme në projekte të përbashkëta me qëllim të avancimit profesional të tyre.
Së fundi, studente nga Fakulteti i Arteve të Kolegjit AAB kanë realizuar një mural në Qendrën për Praktikë Pedagogjike, ku studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale do të kryjnë punë praktike. Studentet autore të muralit janë: Luiza Musollaj, Elmedina Aliu dhe Elita Shala.

Jo rrallëherë, Kolegji AAB dhe studentët veprojnë në baza vullnetare për të bërë punë të mëdha e në shërbim të shoqërisë.



PROF. SHLOMO ARIEL MBAN LIGJËRATË PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË PSIKOLOGJISË

9 prill 2022

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Psikologjisë ishin të nderuar të dëgjonin një ligjëratë online nga njëri ndër autoritetet kryesore botërore të Psikoterapisë Familjare dhe njëkohësisht themeluesit të Qendrës për Psikoterapi Integrative, prof. Shlomo Ariel.

Gjatë kësaj ligjërate, studentët u informuan për ndikimin e kulturës në fizionominë e simptomave dhe shprehjen emocionale të tyre, rolin e terapistit në menaxhimin e traumës personale dhe krijimin e ekulibrave në psikoterapi.







Në fund të ligjëratës, prof. Shlomo ndau informacione nga përvoja e tij për mënyrat dhe domosdoshmërinë e shmangies së ritraumatizimit që mund të vie nga nxitësit momental.

Fakulteti i Psikologjisë do të vazhdojë të sjellë para studentëve profesionistët më të mirë, të cilët kanë përvoja të dëshmuara në fusha të ndryshme të psikologjisë.

KOLEGJI AAB BASHKORGANIZATOR NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE

12 prill 2022

"Intearnational Conference on Innovation in Business and Technology (ICIBT)", është një nga ngjarjet më të mëdha akademike kombëtare dhe rajonale që bashkon studime në teknologji, biznes dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Qëllimi kryesor i konferencës është të bashkojë ekspertët nga biznesi dhe sektori publik, si dhe komuniteti akademik në fushën e inovacionit, duke mundësuar prezantimin e praktikave të mira dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojave.

Në fokus të konferencës është një nga sfidat më të rëndësishme zhvillimore të kohës sonë, e ajo është se si të adoptohen dhe zbatohen sa më mirë proceset e inovacionit në biznes dhe teknologji duke kontribuar në të njëjtën kohë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.



Kjo konferencë do të mbahet më 10 qershor 2022. Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve është 01 qershor.

PROF. DR. STEFAN QIRICI NGA SHQIPËRIA MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK

12 prill 2022

Zëvendës Rektori i Universitetit Luarasi në Shqipëri Prof. Dr Stefan Qirici, njëherit edhe bashkëautor i librit "Hyrje në Ekonomi", zhvilloi ligjëratë virtuale për studentët e Fakultetit Ekonomik me temën: "Realitete të zhvillimeve në tregun e punës – probleme dhe sfida".







Tematika që trajtoi profesori ishte shumë e rëndësishme dhe nxiti pyetje e diskutime të shumta tek studentët. Profesor Qirici ndër të tjera foli për papunësinë, llojet e saj dhe diskutoi mbi pasojat socio-ekonomike të kësaj dukurie në Kosovë dhe Shqipëri.

Në mes tjerash profesori cilësoi papunësinë si një "sëmundje" të rëndë të "shëndetit" ekonomik dhe bashkudhëtare të pandarë në ekonominë e tregut.

Ligjërata u përmbyll me sugjerime për të tejkaluar sfidat socio-ekonomike të papunësisë si dhe u propozua një analizë e kërkesave për shkathtësi në tregun e punës e po ashtu hartimin e kurrikulave studimore bazuar në kërkesat e tregut të punës si parakushte për të zvogëluar papunësinë në vend.

"ELKOS GROUP" PREZANTOI PROGRAMIN E PUNËS PRAKTIKE PËR STUDENTËT

13 prill 2022

Në vazhdën e aktiviteteve të Qendrës së Karrierës të Kolegjit AAB, u organizua aktiviteti i radhës në bashkëpunim me Elkos Group, për studentët e vitit të dytë të Fakultetit Ekonomik, drejtimi Marketing, ku ndër të tjera në këtë ligjëratë u ofrua për studentët edhe mundësia për punë praktike me pagesë dhe punësim.







Në këtë ligjëratë, studentët patën mundësi të njihen për metodat, mënyrën dhe strategjinë e zhvillimit të marketingut në kuadër të kësaj kompanie si dhe përvojat se sa i rëndësishëm është marketingu në përmirësimin e efikasitetit në treg. Të pranishme për të diskutuar me studentët, ishin Zana Lipoveci – Kastrati, njëherësh ish studente e diplomuar e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB dhe Donjeta Kelmendi, nga departamenti i burimeve njerëzore, ndërsa në fund të kësaj ligjërate studentët patën mundësi të bëjnë edhe pyetje.

ORGANIZOHET DITA E PREZANZIMIT TË PROJEKTEVE DHE HULUMTIMEVE TË STUDENTËVE TË KOMPJUTERIKËS

13 prill 2022

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike më 08.05.2022 do të organizojë ditën e hapur të prezantimit të projekteve dhe hulumtimeve të studentëve. Kjo do të jetë një mundësi e mirë për të nxitur kërkimin shkencor dhe diskutimin akademik mes komunitetit të studentëve. Qëllimi i këtij organizimi është që të inkurajojë studentët të kontribuojnë në kërkimin dhe hulumtimin shkencor.

Abstraktet e punimeve të përzgjedhura nga komiteti shkencor i konferencës do të botohen në librin e abstrakteve dhe pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje. Prezantimi i punimeve do të bëhet në mënyrë verbale përmes platformave të ndryshme të ndryshme të prezantimeve.
Dërgimi i abstrakteve dhe punimeve bëhet në e-mail adresën: fshk@universitetiaab.com



STUDENTËT E ARTEVE DHE ATA TË ARKITEKTURËS, VIZITË STUDIMORE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI

14 prill 2022

Studentë të Fakultetit të Arteve dhe Arkitekturës të Kolegjit AAB, ligjëratat e semestrit veror po i gërshetojnë me vizita studimore në vende me rëndësi artistike e arkitektonike, jo vetëm në Kosovë por edhe në vende të ndryshme të rajonit. Të udhëhequr nga profesorët e tyre vizituan vende të rëndësishme në Mal të Zi, me qëllim ndërlidhjen dhe konkretizimin e temave respektive nga planprogramet studimore.







Gjatë kësaj vizite, studentët patën rastin të shohin nga afër: qytetin e vjetër të Kotorit dhe Budvës, Risanin, Shën Stefani, si dhe në Shqipëri, Muzeun Kombëtar të Fotografisë Marubi në Shkodër.

Studentët përfituan shumë nga kjo vizitë duke analizuar secili nga këndvështrimi i vet vlerat artistike e arkitektonike të këtyre institucioneve të rëndësishme, ndërsa agjenda e vizitave në vende të tilla të rëndësishme do të zgjerohet dhe do të vazhdojë edhe ditëve në vazhdim.

U MBAJT SEMINARI "PËRGATITJE PËR TREGUN E PUNËS" PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

15 prill 2022

Qendra e Karrierës së Kolegjit AAB në bashkëpunim me kompaninë "Hoja" mbajtën seminar me temën "Përgatitje për tregun e punës", për studentët e nivelit bachelor dhe master. Ky seminar kishte për qëllim informimin e studentëve për hapat profesionalë drejt një karriere të suksseshme.



Studentët pjesëmarrës gjatë këtij seminari patën mundësi të marrin këshilla për aftësitë dhe shkathtësitë bazike duke diskutuar për profesionalizimin dhe etikën e punës, komunikimin e mirëfilltë dhe punën në ekip. Ata u informuan edhe për metodat dhe strategjitë për kërkimin e punës.

Studentët pjesëmarrës në këtë seminar shprehën interes të madh lidhur me këtë aktivitet, duke zhvilluar edhe bashkëbisedim me përfaqësuesin e kompanisë "Hoja", Gent Shala.





STUDENTËT E AAB-së NË FERIZAJ DO TË TRAJNOHEN PËR "SHKATHTËSI TË BUTA DHE MENAXHIM PROJEKTI"

16 prill 2022





Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj është zhvilluar takim për realizimin e trajnimit "Shkathtësi të buta dhe Menaxhim Projekti", projekt i financuar nga Qeveria Japoneze e që do të implementohet nga Banka Botërore. Takimi u zhvillua mes drejtorit të këtij kampusi Shaip Bytyqi dhe menaxherit të projektit "Komunat për të rinjtë", Sovran Nrecaj.

Ky trajnim do të përfshijë module mbi aftësitë e lidershipit, kreativitetit, zgjidhjen e problemeve, komunikimin dhe punën në grup.
Prandaj, ftohen të gjithë studentët e interesuar të jenë pjesë e trajnimeve që kanë për qëllim zhvillimin profesional të tyre. Pas përfundimit të trajnimit, të studentët pjesëmarrës certifikohen dhe kanë mundësi të aplikojnë për grante me ide të ndryshme deri në 25.000 mijë euro.

Email kontaktues për pjesëmarrje: sektoririnise@gmail.com ose arbnoraa.salihu@gmail.com

THIRRJE PËR PJESËMARRJE: KONFERENCA E DYTË SHKENCORE ALUMNI "GJUHËSI, LETËRSI DHE DIDAKTIKË"

19 prill 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze i Kolegjit AAB ka hapur thirrjen për pjesëmarrje në Konferencën e Dytë Shkencore Alumni – Gjuhësi, Letërsi dhe Didaktikë.

Konferenca do të mbahet më 25 qershor, në ambientet e Kolegjit AAB dhe online përmes platformës GoogleMeet. Pjesëmarrja online vlen vetëm për ata të cilët ndodhen jashtë Kosovës dhe si rrjedhojë nuk mund të marrin pjesë fizikisht.



U PREZANTUA DORACAKU PËR VLERËSIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTËN ZONALE TË KOMUNËS

19 prill 2022

Studentët e arkitkturës në Kolegjin AAB, ndoqën ligjëratën me arkitekten Lumnije Gashi Shabani, MA. Arch. Veprimtaria e saj ka variuar nga arkitektura dhe dizajni, në shkallën e planifikimit strategjik urban dhe planifikimin mjedisor, politikëbërjen dhe kornizën institucionale në Kosovë.







Ajo para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës trajtoi pikërisht temën "Doracaku për vlerësimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të komunës". Qëllimi i këtij doracaku është të krijojë një metodologji të standardizuar, për vlerësimin e cilësisë së Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) dhe Hartës Zonale të komunës (HZK), e bazuar në tregues dhe kritere të përcaktuara, gjatë procesit të hartimit dhe para miratimit përfundimtar të tyre. Ky doracak është përgatitur si pjesë e projektit të GIZ "Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës në Kosovë" në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe koordinim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Ligjërata u përmbyll me një sesion diskutimi në lidhje me doracakun e prezantuar.

U PREZANTUA DORACAKU PËR VLERËSIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTËN ZONALE TË KOMUNËS

21 prill 2022

Pas një procesi transparent zgjedhor, të zhvilluar nga studentët, u zgjodh kryesia e re e Unionit të Studentëve të Kolegjit AAB. Procesi për zgjedhjen e Kryesisë së Unionit të Studentëve këtë herë u mbajt dy ditë. Në ditën e parë kandidatët prezantuan planprogramet e tyre, sipas të cilëve do të punojnë në krye të Unionit Studentor. Anëtarët e tjerë patën mundësinë të parashtrojnë pyetje dhe të diskutonin mbi të njëjtat plane.









Në ditën e dytë anëtarët zgjodhën për kryetare të Unionit të Studentëve, Agnesa Vishesellën, studente e Fakultetit të Gjuhës Angleze. Ajo u zotua në bashkëpunim mes të gjitha departamenteve dhe kampuseve të Kolegjit AAB, si dhe rritje të bashkëpunimit me parlamente të tjera studentore. Ndërsa, nënkryetar i këtij Unioni u zgjodh Donat Fuga, student i Fakultetit Ekonomik.

Kryetarja e deritanishme e Unionit të Studentëve, Gentiana Uruqi, ka uruar përfaqësuesit e zgjedhur, duke shtuar se kjo është detyrë që kërkon përkushtim. Ajo mes tjerash u shpreh se udhëheqja e Unionit Studentor të Kolegjit AAB ka qenë përgjegjësi por edhe një privilegj i madh, i cili do të mbetet rrugëtimi më i rëndësishëm për të.

FAKULTETI EKONOMIK NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME KOORPORATËN "DONI"

21 prill 2022

Dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. Medain Hashani, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me korporatën "Doni", të përfaqësuar nga z. Bekim Sinanin, drejtor për financa dhe administratë.

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim ofrimin e aftësimit profesional të studentëve, përmes punës praktike dhe shqyrtimit të mundësisë së punësimit, mbajtjen e takimeve informuese dhe aktiviteteve të ndryshme profesionale të cilat ofrohen nga tri kompanitë e kësaj korporate, "Doni produkt", "Doni fruis" dhe "Frutaria".



ROLI I SKEMAVE GARANTUESE, LIGJËRATË TEMATIKE PËR STUDENTËT E EKONOMISË

22 prill 2022

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) mbajti ligjëratë në Kolegjin AAB me temën "Roli i skemave garantuese". Ligjëratën para studentëve e zhvilloi z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut. Ai shpalosi rolin e FKGK në financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në ekonominë e Kosovës, sidomos në ata sektorë që bankat komerciale hezitojnë të ndërmarrin rrezik financiar, si në bujqësi, startaup-e, kredi për biznese të grave, kredi për ekonomi të gjelbër, etj..





Studentët e Kolegjit AAB ishin kurreshtarë të dijnë më shumë për rolin e FKGK në ekonominë e Kosovës, prandaj gjatë gjithë ligjëratës parashtruan pyetje të ndryshme.

MBAHET TRYEZA E DISKUTIMIT PËR SFIDAT E GRAVE NË BIZNESET INOVATIVE

23 prill 2022

Java Botërore e Kreativitetit dhe Inovacionit po shënohet me aktivitete të ndryshme të organizuara nga Fakulteti Ekonomik. Me këtë rast u mbajt edhe një tryezë diskutimi që trajtoi sfidat e grave në bizneset inovative. Të pranishme në panel ishin Fatbardha Dallku, themeluese e "Innovation Academy", Lorika Govori, themeluese e biznesit "Punë N'Dorë" dhe profesoresha e Fakultetit Ekonomik, Fëllënza Pula.

Gjatë tryezës së diskutimit, Fatbardha foli për përvojën dhe sfidat e saj që nga fillimi i studimeve në Inxhinieri Kompjuterike, përvoja e punës në Gjermani, sfidat pas kthimit nga Gjermania ku tregoi për paragjykimet qe njerëzit kishin mbi aftësitë e saja si programere vetëm pse ishte vajzë, e deri te idea e hapjes së biznesit, pra Akademisë së Innovacionit.

"Unë fillova të mendoj se si rrobat që kisha në shtëpi t' i ri-dizajnoj edhe t' i shes. Fillova nga rrobat e mia, kurse sot biznesi ynë fillon eksportin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës" tha Lorika Govori, themeluese e kompanisë "Punë N'Dorë". Lorika tregoi sfidat e saj gjatë hapjes së biznesit të cilat ishin reduktuar me shumë mund dhe përkushtim.

Ndërmarrëset Fatbardha dhe Lorika inkurajuan studentët që të kenë guxim për hapjen e bizneseve të reja dhe me punë e përkushtim do të tejkalojnë çdo sfidë.





NDAHET ÇMIMI "MASAR STAVILECI" PËR VITIN 2021

23 prill 2022

Në shënim të 23 Prillit, Ditës Botërore të Librit, në Kolegjin AAB u mbajt ceremonia e ndarjes së Çmimit "Masar Stavileci". Ky çmim i themeluar nga Kolegji AAB, për çdo vit u ndahet studentëve të cilët kanë qenë lexuesit më të rregullt në Bibliotekën Universitare AAB. Çmimi "Masar Stavileci" u themelua në vitin 2018, në nderim të rektorit të parë të Kolegjit AAB, prof.dr. Masar Stavileci.







Në ceremoninë e ndarjes së çmimit, drejtori i Bibliotekës Universitare AAB, Urim Sallauka përgëzoi fituesit e çmimit dhe tha se biblioteka është vendi më i rëndësishëm i Kolegjit. Ndërsa, fituesit e çmimit falënderuan Kolegjin AAB për shpërblimet e fituara.

LIGJËRATË PËR RËNDËSINË E TË DHËNAVE NË MENAXHIMIN E BIZNESIT

26 prill 2022




Në kuadër të Javës Globale të Inovacionit dhe Kreativitetit u zhvillua ligjëratë në lidhje me temën "Inovacioni nëpërmjet të dhënave" ku studentët e Fakultetit Ekonomik patën mundësi të diskutojnë me të ftuarin z.Shkëlqim Meqa, drejtor i departamentit për të Dhëna dhe Analiza në Raiffeisen Bank Kosovë.



Gjatë prezantimit z.Meqa theksoi rëndësinë e të dhënave në menaxhimin e bizneseve të sotme por edhe mundësitë që nëpërmjet të dhënave të përmirësohen proceset ekzistuese, si dhe të krijohen procese dhe modele të reja të biznesit. Në këtë debat u trajtuan edhe tema në lidhje me rëndësinë e të dhënave të mëdha, intelegjencës biznesore si dhe trendeve të fundit të infrastrukturës së menaxhimit të të dhënave.

Diskutimi përfundoi me një measazh domethënës për studentët, "Krijo dicka të re dhe bëj që të dhënat të punojnë për JU"!

THIRRJE PËR SHKËMBIM TË STAFIT NË UNIVERSITETIN E LODZIT

26 prill 2022

Universiteti i Lodz nga Polonia, ka hapur thirrjen për aplikim në shkëmbimin e stafit, për vitin akademik 2022/2023.

Nga kjo përvojë mund të përfitojnë stafi i fakulteteve:

- Ekonomik
- Gjuhë Angleze
- Shkenca Kompjuterike
- Administratë Publike
- Juridik

Këtu mund të informoheni më shumë rreth kësaj thirrje.



KOLEGJI AAB DHE "NEW BULGARIAN UNIVERSITY" NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

27 prill 2022

Kolegji AAB gjithmonë u ka kushtuar rëndësi bashkëpunimeve me partnerë akademik dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të zhvillimit institucional dhe ofrimit të mundësive për studentë. Së fundi, Kolegji AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me "New Bulgarian University" me të cilin u dakorduan për zhvillimit e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme.

Universiteti nga Bullgaria u përfaqësua nga Kryetari i Bordit të Administrimit Prof. Dr. Veselin Metodiev ndërsa Kolegji AAB nga rektori Dr. Sc. Bujar Demjaha.

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE DHE IP "BRILANT" NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

27 prill 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, së fundi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Brilant" duke përshtatur interesat e përbashkëta për zhvillimin e pjesës praktike të studentëve të këtij fakulteti.



Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti Prof. Hysen Kasumi dhe drejtoresha e IP "Brilant", znj. Nerxhivane Gashi, ndërsa ky bashkëpunim ndër të tjera premton avancim të studentëve në praktikën e tyre përgjatë studimeve.

STUDENTËT E DIZAJNIT TË MODËS CERTIFIKOHEN PËR "PATRONA" DHE "RROBAQEPËSI"

28 prill 2022

Janë ndarë certifikata për studentët e Fakultetit të Dizajnit të Modës të cilët kanë ndjekur kurset gjashtëmujore për "Patrona" dhe "Rrobaqepësi".



Studentët arritën të praktikojnë teknikat e prerjes së veshjeve të ndryshme që përbëjnë një koleksion të modës, si dhe aplikuan 'patternmaking' e deri te realizimi i një libri përfundimtar ku të gjitha skemat dhe variantet e tyre për një koleksion të plotë janë katologuar.

Studentët falënderuan Kolegjin AAB për organzimin e kurseve, përmes të cilave arritën të zhvillojnë disa prototipe duke përdorur teknika industriale dhe rrobaqepësinë.





Në ndarjen e certifikatave, profesoresha e Kolegjit AAB Laura Ukshini, përgëzoi studentët dhe e vlerërsoi të suksesshëm organizimin e kurseve nga Fakulteti i Arteve.

DR. SC. SAFET BEQIRI ZHVILLOI LIGJËRATË NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+ NË KOLEGJIN AAB

28 prill 2022

Në kuadër të lëndës 'Impakti i BE-së në Kosovë', e cila mbahet si pjesë e projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian, Erasmus +, i ftuar për një ligjëratë speciale ishte Dr.sc Safet Beqiri.

Programi në fjalë zhvillohet me studentë nga pesë fakultete (Jurdik, Ekonomik, Admistratë Publike, Psikologji dhe Shkenca Sociale).





U MBAJT MANIFESTIMI ARTISTIK I STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË GJUHËS ANGLEZE

29 prill 2022

Është mbajtur manifestimi artistik vjetor i studentëve të Fakultetit të Gjuhës Angleze, ku u përfshinë recitime, deklamime dhe interpertime këngësh. Me anë të këtij manifestimi, studentët shprehin talentin e tyre për të interpretuar para të pranishmëve mbi të gjitha pasionin për artin.







Këtë vit ky recital iu dedikua studentes së ndjerë Adonita Kadrijaj. Ajo ishte edhe fituese e edicionit të kaluar, ku ishte shpallur recituesja më e mirë.

Organizime të tilla promovojnë leximin dhe rrisin pasionin për letërsinë, në përgjithësi për kulturën.

FAKULTETI I ARTEVE DHE "ANSAMBLI NACIONAL I KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE SHQIPTARE" NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

30 prill 2022

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes Fakultetit të Muzikologjisë dhe Koreografisë të Kolegjit AAB dhe Ansamblit Nacional të Këngëve dhe Valleve Populllore Shqiptare të Maqedonisë së Veriut.





Ky bashkëpunim synon përshtatjen e interesave të përbashkëta për t' u zhvilluar në aspektin akademik e kulturor të të dyja palëve. Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti Prof. Fitim Aliu dhe drejtori i Ansamblit Nacional të këngëve dhe valleve, Shkodran Tolaj. Ndër të tjera u premtua avancim profesional i studentëve në fushën e mësimdhënies, master classave, praktikave artistike si dhe praktikave profesionale.


KOLEGJI AAB

MAJ 2022

NË FAKULTETIN EKONOMIK U MBAJT LIGJËRATË PËR SISTEMIN TATIMOR TË KOSOVËS

4 maj 2022

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ishte i ftuar i Fakultetit Ekonomik për të mbajtur një ligjëratë për studentët. Ai para tyre, shpalosi informacione të shumta në lidhje me sistemin tatimor të Kosovës ku përmendi përparësitë e sistemit tatimor të Kosovës, tatimet të cilat aplikohen në Kosovë, normat tatimore, të hyrat e realizuara nga ATK-ja, pikat kryesore të TVSH-së, pikat kryesore të tatimit në të ardhura personale, tatimit në të ardhura të korporatave, deklarimin elektronik EDI, raportin e FMN-së 2022, raportin e Komisionit Evropian 2021 dhe synimet për të ardhmen.







Ligjërata përfundoi me një bashkëbisedim në mes studentëve dhe drejtorit të ATK-së, z. Ilir Murtezaj.

AAB NË QENDËR TË VËMENDJES NGA VIZITORËT NË PANAIRIN E EDUKIMIT 2022

5 maj 2022

Kolegji AAB po merr pjesë në Edicionin e 14-të të Panairit të Edukimit që po mbahet në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë.

Në këtë Panair ku po marrin pjesë dhjetëra institucione arsimore nga vendi, rajoni e më gjerë, hapësira e Kolegjit AAB sikur edhe herët e tjera ishte ndër më të vizituara që në orët e para të Panairit.

"Panairi i Edukimit është një manifestim arsimor dhe një rast i mirë për të promovuar punën dhe arritjet tona për të gjithë ata që nuk kanë pasur rastin të vizitojnë AAB-në dhe që nuk kanë qenë të përshirë në proces", tha Prorektori për Komunikim dhe Inovacion në Kolegjin AAB, Zija Rexhepi.













Ai theksoi se e veçanta e pjesëmarrjes së Kolegjit AAB në këtë edicion të Panairit të Edukimit është se krahas prezantimit të programeve e mundësive të studimit, kampusi i AAB-së për të gjithë të interesuarit vjen edhe në formatin virtual VR (virtual reality), gjë që ka zgjuar interesim te vizitorët.

Krahas kësaj, Kolegji AAB ka ofruar edhe një ofertë promovuese prej 10% në shumicën e programeve studimore, çfarë ka bërë që qysh në orët e para të panairit të ketë dhjetëra aplikacione nga maturantët.

Kujtojmë se Panairi do të jetë i hapur edhe të premten, më 06 maj 2022, ndërsa të interesuarit mund të informohen për mundësitë që ofron Kolegji AAB për vitin akademik 2022/23.

AMBASADORI I ZVICRËS SH. T. THOMAS KOLLY, MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB NË FERIZAJ

6 maj 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj, ishte për vizitë dhe takim me studentë Sh.T. Thomas Kolly, Ambasador i Zvicrës.
Ambasadori Kolly në praninë e një numri të madh studentësh të Fakultetit të Gjuhës Angleze dhe Fakultetit Juridik shtjelloi tema interesante nga përvoja e tij personale në ngritjen e tij profesionale dhe rëndësinë që njohja e gjuhëve të huaja luan në jetën e secilit. Ai përshkroi përvojat e tij gjatë punës së tij si diplomat në shumë vende të botës, për mundësitë e njohjes nga afër të kulturave dhe traditave të ndryshme të popujve të ndryshëm, për sfidat dhe vështirësitë të cilat i kishte përjetuar gjatë gjithë viteve të ndërtimit të tij si diplomat, që nga koha e studimeve, ndikimit që familja mund ta ketë në zhvillimin e një individi.

"Jepini qëllim jetës tuaj dhe pastaj ndiqeni atë qëllim. Mos u dorëzoni ndaj sfidave dhe vështirësive që mund t' i keni gjatë rrugës për ta realizuar qëllimin tuaj. Po të ndalesha unë, nuk do të bëhesha diplomat. Por unë kisha qëllim më të madh në jetë, të shkollohesha e ta ndërtoja jetën time ashtu siç e ëndërroja vet. Prandaj, ndiqni ëndrrën sepse një ditë e mbërrini.", i porositi ambasdori zviceran studentët e AAB-së.










TË PUNËSUAR NË GJERMANI, ALUMNI AAB NDAJNË PËRVOJËN E TYRE ME STUDENTËT

6 maj 2022

Qendra e Karrierës, në kuadër të #AABAlumniTalk organizoi aktivitet me studentët e diplomuar të suksesshëm nga Fakultetit i Infermierisë, të cilët përmes Programit për Karrierë dhe Punësim tashmë punojnë në institucione shëndetësore prestigjioze në Gjermani.



Dekani i Fakultetit të Infermierisë, Idriz Sopjani, e përshëndeti këtë aktivitet duke i falënderuar edhe ish studentët për gatishmërinë që të rrëfejnë suksesin e arritur. Ai theksoi se nevoja për kujdes do ekzistojë gjithmonë, prandaj edhe është kaq i rëndësishëm profesioni i Infermierit.

Nga studentët alumni të pranishëm ishin Mirlinda Uka, Kushtrim Haliti dhe Endrit Bunjaku, të cilët theksuan se falë përkrahjes nga Kolegji AAB, përkushtimit të madh të tyre dhe dëshirës për punësim në Gjermani, kanë arritur që të fitojnë atë që kanë ëndërruar në këtë moshë të re. Ata treguan edhe vështirësitë nëpër të cilat kaluan, por vullneti dhe përkrahja i drejtuan drejt rrugës së suksesit. Mirlinda Uka theksoi se fillimi i kësaj eksperience nuk ishte aspak i lehtë, veçanërisht fillimi i kursit të gjuhës gjermane, pasi që nuk ka pasur njohuri më herët për gjuhën që është kërkuar për punësim. Vendet në të cilat janë punësuar studentët e diplomuar janë: Kushtrim Haliti në Sana Klinik Hürth, Mirlinda Uka në Sana Klinik Köln dhe Endrit Bunjaku në MiCura Nürnberg.

Përveç interesimit për prani fizike nga studentët aktual për të dëgjuar storjet e suksesit nga Mirlinda, Kushtrimi dhe Endriti, nuk munguan as studentët që u kyçën në mënyrë virtuale





U MBAJT SEANCË STIMULUESE ME ABA TERAPI PËR STUDENTËT E PSIKOLOGJISË

7 maj 2022

Në kuadër të ligjëratës nga lënda "Bazat e psikologjisë klinike për fëmijë dhe adoleshentë" prof. Mimoza Shahini për studentët e vitit të tretë ka demonstruar një seancë stimuluese me ABA terapi, në koordinim me studentët e nivelit master të programit "Shëndet Mendor".
Dardane Bublaku dhe Sumeja Hoxhaxhiku ishin dy protagonistet e këtij aktiviteti me qëllim të praktikës sa më të mirë të kësaj seance para studentëve.

Dardane Bublaku është terapiste ABA me përvojë më shumë se pesë vjeçare në këtë fushë dhe aktualisht është e angazhuar në "Qendrën për shërbime humane dhe zhvillim" ndërsa Sumeja Hoxhaxhiku punon me fëmijë me nevoja të veçanta si asistente me përvojë mbi dy vjeçare.

Fakulteti i Psikologjisë ofron edhe laboratorin klinik për studentë, të pajisur me mjete dhe pajisje të sofistikuara profesionale.





KOLEGJI AAB SHËNON DITËN E INFERMIERISË ME AKTIVITETE TË SHUMTA

7 maj 2022

Fakulteti i Infermierisë në Kolegjin AAB, në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë, organizon aktivitete të cilat simbolizojnë më së miri këtë profesion.

10 maj – Dhurim vullnetar i gjakut

11 maj – Kursi për EVP; "Diversiteti dhe përceptimet kulturore në Infermieri"

12 maj – Shërbime shëndetësore falas nga studentët nëpër komuna të vendit.



Fakulteti i Infermierisë ka planifikuar që në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut të zhvillojnë aktivitet për dhurimin vullnetar të gjakut më 10 maj nga ora 10:00-13:00 në Lab.2-Infermieri në AAB.

Aksioni humanitar i gjakut është tradicional dhe organizohet çdo vit nga Kolegji AAB duke shënuar edhe shifra rekorde të dhurimit të gjakut në Kosovë.

Dhuroni gjak – shpëtoni jetë!

KURSI I RADHËS NDËRKOMBËTAR NË KUADËR TË EVP-SË DO MBAHET MË 11 MAJ

7 maj 2022

Në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, në Kolegjin AAB do të mbahet trajnimi "Diversiteti dhe përceptimet kulturore në Infermieri", i akreditуar nga Oda e Infermierëve të Kosovës me pikë kredituese, për të gjitha profilet shëndetësore.
Kursi do të mbahet me 11 maj nga ora 09:00-14:30, në sallën 113 të Fakultetit të Infermierisë, ndërsa ligjërues është Prof. Eroll Reshtani.

Pjesëmarrja pasive do të vlerësohet me 8 pikë, dhe si e tillë është obligative prezenca fizike në institucion.

Të interesuarit fillimisht duhet të aplikojnë nga participuesi në këtë link.



UPAY CARD NJË MUNDËSI E RE PËR STUDENTËT E AAB-së NGA WESTER UNION

10 maj 2022

Kolegji AAB ka një shtrirje të gjerë të bashkëpunimeve me shumë institucione dhe kompani që mund të kontribuojnë në lehtësimin e shumë çështjeve për studentë. Së fundi, përmes bashkëpunimit me Western Union është mbajtur ligjëratë për stafin dhe studentët e Kolegjit AAB, në të cilën u shpalosën shumë detaje të kartelës së vetme pa llogari bankare në Kosovë "UPAY CARD".

Pajisja me këtë kartelë ndër të tjera do të ndihmojë studentët në kryerjen e shërbimeve, duke përfshirë biznese të ndryshme në vend dhe duke përfituar bonuse gjatë blerjeve. Ndër të tjera, stafi dhe studentët e Kolegjit AAB për informim më të gjerë rreth benefiteve dhe dobive të kësaj kartele do të mund të paraqiten në pikën e Western Union brenda kampusit të Kolegjit AAB në katin përdhesë.









PRISHTINA INTERNATIONAL THEATER FESTIVAL NIS EDICIONIN E GJASHTË

10 maj 2022

Ka nisur rrugëtimin edicioni i gjashtë i PITF2022, i cili mban emrin e ish-drejtoreshës artistike "Burbuqe Berisha". Në prani të shumë mediave u mbajt edhe konferenca e parë, ku folën drejtoresha e edicionit të sivjetmë të PITF2022, Doruntina Alshiqi dhe aktori e regjisori i shfaqjes së sotme, Enric Lizano Sans.









Drejtoresha e festivalit, Doruntina Alshiqi, foli mbi sfidat dhe përgatitjet finale të këtij edicioni. "Në kuadër të programit garues të këtij edicioni në skenat e dy teatrove do të ngjiten trupa teatrale nga Spanja, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova. Ndërsa sikur në edicionet e kaluara sërish vlerësimi do të bëhet nga tri juri: juria kryesore, juria e medias dhe juria e studentëve.", tha ajo.

PITF 2022 do të zgjasë deri të hënën më 16 maj, kur do të mbahet edhe ceremonia solemne e ndarjes së çmimeve.

Garën e festivalit të vetëm ndërkombëtar të teatrit në Kosovë, e hap shfaqja "I left" nga shteti i Spanjës. I pyetur se si u prit në Kosovë, ekipi spanjoll u shprehën të lumtur duke cilësuar Kosovën si një vend mikpritës pavarësisht marrëdhënieve politike mes këtyre dy shteteve.

THIRRJE PËR PJESËMARRJE: KONFERENCA STUDENTORE SHKENCORE E FKM-së

11 maj 2022

Si institucion i arsimit të lartë, Kolegji AAB, një vëmendje të veçantë i kushton hulumtimit dhe punës kërimore të studentëve. Me qëllim të zgjerimit të njohurive, për të ngritur debat dhe për të krahasuar këto njohuri nga perspektiva të ndryshme akademike, Fakulteti i Komunikimit Masiv i Kolegjit AAB ju fton të merrni pjesë në Konferencën studentore shkencore "Komunikimin dhe Informacionin në Epokën e Mediave Sociale dhe Fake News".



Konferenca mbahet më 11 qershor në ambientet e Kolegjit AAB nga ora 11:00.

Të gjithë të interesuarit mund t'i dërgojnë abstraktet e tyre deri më 25 maj në: konferencastudentore@aab-edu.net

Ju mirëpresim!

ME SHFAQJEN "I LEFT" NGA SPANJA, NISI EDICIONI I GJASHTË I PITF 2022

11 maj 2022

Ka nisur rrugëtimin e tij edicioni i gjashtë i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove, Prishtina International Theater Festival "Burbuqe Berisha", PITF 2022, me hapjen zyrtare në ambientet e Teatrit Kamertal në Kolegjin AAB. Në këtë edicion të PITF në programin garues do të paraqiten gjashtë shfaqje teatrore që vijnë nga Spanja, Maqedonia e Veriut, Italia, Mali i Zi dhe Kosova.

Në hapje të festivalit, drejtoresha e këtij edicioni, Doruntina Alshiqi, tha se ndihet krenare për ekipin dhe punën e palodhshme.











"Marrë parasysh faktin që jemi festivali i vetëm ndërkombëtar i teatrove në Kosovë edhe në këtë edicion jemi munduar që t' ia dalim me tërë stafin. Është bërë punë e madhe nga i tërë stafi dhe mezi po presim edhe ne që të shohim shfaqjet dhe le të fitojë më i miri".

Pas ceremonisë hapëse, publiku pati mundësinë të shohë shfaqjen "I left" nga Instituti i Kulturës nga Barcelona, me regji të Enric Lizano Sans dhe Aida Flores. Shfaqja u mirëprit dhe u përcoll me duartrokitje nga shikuesit.

Festivali PITF2022, vazhdon sonte me shfaqjen "The M Word" në regji të Fatos Berishës, që në garë vjen për të përfaqësuar Maqedoninë e Veriut.

AAB ORGANIZOI TURNIRIN E MATURANTËVE NË FUTSALL

12 maj 2022

Turniri i maturantëve në futsall u zhvillua brenda hapësirave të Kolegjit AAB, ku morën pjesë ekipe nga disa shkolla të mesme të vendit. Turniri u zhvillua me sistem të eliminimit direkt, dhe në finale arritën Shkolla e Mesme e Mjekësisë "Rezonanca" nga Prishtina dhe Gjimnazi "Andrea Durrsaku" nga Kamenica.
Pas një loje me rezultat bindës, garën e fituan maturantët nga Gjimnazi "Andrea Durrsaku" nga Kamenica. Në fund u ndanë edhe mirënjohjet dhe shpërblimet për tre vendet e para.

Vendi i parë 1000 euro, kupa, mirënjohje dhe medalje;
Vendi i dytë 500 euro, mirënjohje dhe medalje;
Vendi i tretë bursa studimore në masën 100% mirënjohje dhe medalje.










Fakulteti i Kulturës Fizike të Kolegjit AAB është organizator i shumë turnireve në vend me qëllim të përkrahjes së sportistëve të talentuar.

ADELHEID FEILCKE, NGA RADIO DW MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E KOMUNIKIMIT MASIV

12 maj 2022

"Viktima e parë e luftës është e vërteta", me këtë thënie e filloi ligjëratën speciale me studentët e Komunikimit Masiv, drejtoresha e programeve për Evropën në Radion Deutsche Welle, Adelheid Feilcke, me temën "Media dhe raportimi në kohë krizash".




Sipas Feilcke, gënjeshtra si gjithmonë vazhdon të përhapet më shpejt se sa e vërteta, duke treguar se si në çdo luftë, qoftë në LPB apo LDB, luftërat në ish-Jugosllavi, apo lufta e vendeve të Lindjes së Mesme, në parim gënjeshtra është e njëjtë. "Humbjet ose fshihen ose nuk publikohen ndërsa humbjet tek kundërshtari ekzagjerohen, kurse shpesh agresiviteti shfaqet si mbrojtje", tha ajo.
Për gënjeshtrat dhe grackat e shumta, zonja Feickle ka disa këshilla që çdo përdorues e gazetar duhet t' i ndjekë: të mos maskojmë raportin, analizën apo komentin sikur lajm, t' i kontrollojmë burimet e lajmit si përdorues, të gjejmë së paku një burim të dytë, e të bëjmë një verifikim të thellë të lajmit, shifrave e vendeve.

Ajo ndau poashtu një dukuri që sot shpesh ndodh, ajo e "Lost in translation" ku informacioni humb gjatë përkthimit. Po ashtu i kushtoi shumë rëndësi redaksive për "Fact checking", të cilat kanë për qëllim t' i zbulojnë lajmet e rreme. Kur u pyet nga studentët se çfarë këshilla ka për raportimin në kohë krize për gazetarët e rinj, Feilcke u shpreh se gjithmonë duhet t' u rrimë besnik rregullave pa marrë parasysh situatën, dhe gjithmonë të kemi si gazetarë të rinj vullnet të mirë për të raportuar.





FAKULTETI JURIDIK NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE

13 maj 2022

Dekani i Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr. Veton Vula dhe drejtoresha e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas znj. Anita Kalender, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje studentëve të Fakultetit Juridik do t' u mundësohet të kryejnë punë praktike në zyret e kësaj agjencie nëpër të gjitha komunat e Kosovës.

Përfaqësuesit e kësaj marrëveshje zotohen se do të angazhohen me të gjitha kapacitetet në mënyrë që kjo marrëveshje të gjejë zbatim sa më të suksesshëm.





STUDENTËT MASTER TË PSIKOLOGJISË DEMONSTRUAN TESTIN MMPI-201

13 maj 2022

Studentët e nivelit master të Fakultetit të Psikologjisë, në kuadër të lëndës "Vlerësim dhe testim psikologjik", me pedagog Manolita Hida i kanë kushtuar vëmendje të veçantë edhe aplikimit të testeve të ndryshme.

Këtë javë janë fokusuar në inventarin e personalitetit shumë fazik Minesota (MMPI-201). Përgjatë kësaj ore studentët patën mundësinë të ndajnë njohuritë e tyre mbi këtë inventar, duke kaluar më tej në aplikimin, administrimin dhe interpretimin e tij.



PROFESORË NGA UNIVERSITETI I SAVONIAS NË FINLANDË, VIZITUAN KOLEGJIN AAB

13 maj 2022

Profesorët finlandezë prof.Jorma Korhonen dhe prof.Virpi Oskanen, nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara Savonia, u pritën nga prorektorja për marrëdhënie ndërkombëtare dhe bashkëpunim, Prof. Venera Llunji.

Ata diskutuan për implementimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmejt dy institucioneve, përmes projekteve të cilat do të realizohen, shkëmbimit të studentëve dhe stafit, ligjëratave të përbashkëta dhe vizitave të cilat do të organizohen për ligjërues vizitorë por edhe planifikimi i vizitave studimore për studentët nga të dy palët përmes shkollave verore ose dimërore.

Në takim u bisedua për organizim edhe të aspektit shkencor dhe mundësisë për konferenca të përbashkëta por edhe mundësi të ndryshme të organizimit të studimeve me diploma të përbashkëta. Ky aspekt u mbulua nga prorektorja për shkencë dhe hulumtime, prof. Uranela Demaj. Në takim mori pjesë edhe zyrtarja për projekte dhe marrëdhënie ndërkombëtare, Erëza Mehmeti.



Profesorët finlandezë vizituan hapësirat e Kolegjit AAB dhe treguan entuziazëm për të gjitha sukseset dhe të arriturat e Kolegjit AAB.

ORGANIZOHET EDICIONI I PARË I PANAIRIT TË KARRIERËS DHE PUNËSIMIT, AAB 2022

13 maj 2022

Kolegji AAB më 27 e 28 maj 2022, në bashkëpunim me dhjetëra kompani, institucione e organizata do të organizojë edicionin e parë të Panairit të Karrierës dhe të Punësimit, në kampusin e Kolegjit AAB në Prishtinë.

Panairi i Karrierës dhe Punësimit AAB 2022, synon të jetë një burim i mundësive për zhvillimin e karrierës për studentët e vet. Qëllimi primar i panairit është vendosja e kontakteve mes përfaqësuesve të tregut të punës dhe studentëve, por edhe të studentëve të diplomuar të cilët kërkojnë punë.

Organizimi i këtij panairi dhe bashkëpunimi me tregun e punës si dhe krijimi i mundësive për qasje të studentëve në tregun e punës është tregues për angazhmin e vazhdueshëm të Kolegjit AAB për përmbushjen e rekomandimeve të Bordit Industria, për përshtatjen e programeve studimore konform kërkesave të tregut të punës.



Panairi do të jetë i hapur gjatë dy ditëve nga ora 10.00 deri në orën 15.00.

MBYLLI PUNIMET KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, "KUJTESA KOLEKTIVE NË LETËRSI DHE MEDIA"

13 maj 2022

Organizuar nga Universiteti i Elbasanit, Kolegji AAB, Universiteti i Firences dhe Universiteti i Tiranës, në konferencën shkencore "Kujtesa kolektive në letërsi dhe media" u prezantuan 46 kumtesa nga studiues shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe Italia. Në fokus të veçantë ata kishin kujtesën kolektive nga e kaluara dhe të cilën e kthen në aktualitet media në ditët e sotme, qoftë për sensibilitetin dhe vuajtjet e njerëzve që kanë pasur, apo edhe me tendencë të rehabilitimit të disa figurave diktatoriale të këtyre vendeve. Diktatura enveriste, fashizmi në Itali dhe periudha e luftës 1999 në Kosovë, ishin temat e një pjese të kumtesave shkencore të cilat u prezantuan nga studiuesit në këtë konferencë.



Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit, Edlira Fetahu, falënderoi Kolegjin AAB (Kosovë) dhe Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit të Firences (Itali) për shkak se kjo konferencë për mediat dhe letërsinë është e dyta me radhë e organizuar në partneritet me këto dy institucione.

Sipas dekanit të Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, Hasan Saliu, FKM tashmë ka konsoliduar bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës, Universitetin e Elbasanit dhe Universitetin e Firences. "Fryt i këtij bashkëpunimi është organizimi i përbashkët i disa konferencave shkencore ndërkombëtare me Tiranën, Elbasanin dhe Firencen, ndërsa prof. Pezzoli nga Firence vitin e kaluar ka qenë ligjëruese vizitore në Kolegjin AAB", tha ai. Në këtë konferencë me punimet e tyre u prezantuan edhe profesorët nga Fakulteti i Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, Dr. Gazmend Abrashi, Dr. Ardita Reçi, Dr. Xhevahire Izmaku, Dr. Hasan Saliu etj..



STUDENTË TË FAKULTETIT TË GJUHËS ANGLEZE VIZITUAN UNIVERSITETIN METROPOLITAN TIRANA

14 maj 2022

Studentët e Klubit të Debatit të Fakultetit të Gjuhës Angleze u mikëpritën në Universitetin Metropolitan Tirana për të marrë pjesë në një sërë aktivitetesh studentore dy-ditore. Aktivitetet përfshinë edhe një seancë debati, gjatë së cilës studentët shpalosën aftësitë e tyre komunikuese, argumentuese dhe të menduarit kritik.

Ky aktivitet u pasua me një mbledhje të përbashkët midis Këshillit Studentor të universitetit mikëpritës dhe studentëve të Kolegjit AAB si edhe vizita kulturore në muze dhe pika të tjera turistike në Tiranë. Këto aktivitete shërbyen si shkëmbim përvoje dhe krijim të rrjetëzimit midis studentëve. Të dy palët u zotuan se do të vazhdojnë traditën e aktiviteteve të përbashkëta.







SHËNOHET JAVA E INFERMIERISË NGA STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

14 maj 2022

Në shënim të Javës së Infermierisë, studentët të Kolegjit AAB, infermierë të ardhshëm organizuan disa aktivitete të cilat simbolizojnë më së miri këtë profesion.

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut u zhvillua aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut, aktivitet ky humanitar që organizohet tradicionalisht nga Kolegji AAB.















Aktiviteti i radhës ishte kursi ndërkombëtar për EVP i akreditуar nga Oda e Infermierëve të Kosovës me temën: "Diversiteti dhe përceptimet kulturore në Infermieri", ku ligjërues ishte prof. Eroll Reshtani. Ai para pjesëmarrësve tregoi për diversitetet kulturore në Infermieri, në trendet vendore dhe ato ndërkombëtare, si dhe rëndësinë e kuptimit të këtyre diversiteteve kulturore në mëshrimin e profesionit të Infermierisë. Këto informata kanë qenë mjaft të rëndësishme në përfitimin e njohurive mbi diferencat kulturore për të gjithë pjesëmarrësit në këtë kurs.

Aktivitetet u mbyllën me organizimin e studentëve për të ofruar shërbime shëndetësore falas dhe këshilla sensibilizuese nëpër komunat kryesore të Kosovës. Këto shërbime kanë pasur për qëllim vetëdijësimin e popullatës duke promovuar përmes këshillave një stil të shëndetshëm të jetesës dhe vlerave të profesionit të Infermierisë për të përmirësuar cilësinë e komunitetit. Ky aktivitet u zhvillua në shtatë komuna të Kosovës, me tetë lokacione, ku në kryeqytet bashkëpunuam për së afërmi edhe me komunën e Prishtinës, si dhe me përfaquesit e Euromelanoma të Kosovës.

PROF. JUAN MANUEL MONTORO NGA UNIVERSITETI SANTIAGO de COMPOSTELA, MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E AAB-së

14 maj 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB ka organizuar për studentët e këtij drejtimi ligjëratë online me prof. Juan Manuel Montoro nga Fakulteti i Komunikimit, Universiteti i Santiago de Compostela, Spanjë.
Tema e cila u trajtua në këtë ligjëratë kishte të bëjë me diplomacinë sportive dhe digjitale dhe si mund të përdorë Kosova platforma digjitale për të nxitur marrëdhëniet e saj në sport me vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ligjërata u ndjek nga profesorë dhe studentë të vitit të tretë dhe të katërt nga të dy programet e këtij fakulteti. Nga kjo ligjëratë patën interesim sidomos studentët të cilët edhe ishin aktiv me pyetje rreth temës.

Po ashtu Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit u nderua me mirënjohje nga Federata e Badmintonit për kontributin e dhënë në rritjen dhe zhvillimin e Badmintonit në Kosovë. Mirënjohja u nda nga Sekretari Gjeneral, prof. ass. dr. Blerim Sylejmani.









PËRFAQËSUES TË UCL ODENSE NGA DANIMARKA DHE IBC-M, VIZITUAN KOLEGJIN AAB

16 maj 2022

Përfaqësueset e Kolegjit Universitar UCL të Odense në Danimarkë, me në krye koordinatoren për bashkëpunim ndërkombëtar, prof. Heather D. Johannsen, si dhe prof. Bujar Gallopeni, profesor dhe hulumtues nga IBC-M në Mitrovicë, vizituan Kolegjin AAB.



Në takim u diskutua për nevojën e realizimit të marrëveshjes edhe përmes trajnimeve të stafit dhe studentëve në fushë e edukimit special, edukimit për punë sociale, edukimit për punë me fëmijë të moshave 0-6 vjeçare, si dhe edukimit për punë me fëmijët me nevoja të veçanta.

Nga Kolegji AAB, zv.dekanet e Fakultetit të Shkencave Sociale, prof. Saranda Shatri dhe prof. Diana Qarkaxhija, prezantuan punën që bëhet në fakultet dhe për mundësitë e shumta për organizim të aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta.

Palët u dakorduan që së shpejti të organizojnë aktivitetin e radhës në mes të tri institucioneve, ndërkohë që pritjet përgjigjja pozitive për projektin për të cilin është aplikuar në partneritet tre-palësh në kuadër të programit Erasmus+.

NDAHEN ÇMIMET E EDICIONIT TË GJASHTË TË PITF2022, ENVER PETROVCI RRËMBEN ÇMIMIN KRYESOR

17 maj 2022

Prishtina International Theater Festival "Burbuqe Berisha" PITF2022, ka përmbyllur me sukses edicionin e gjashtë të festivalit, që për shtatë ditë ishte edhe epiqendra e kulturës në kryeqytet.

Me një ceremoni festive të ndarjes së çmimeve të organizuar në bashkëpunim më Kolegjin AAB, Art Image dhe ATV, kjo natë ishte e paharruar sidomos për garuesit e këtij edicioni që vinin nga: Spanja, Italia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova.

Para fillimit të ceremonisë, të pranishmit ndoqën dokumentarin mbi jetën dhe veprën e Besim Sahatçiut, në të cilin ishte duke punuar e ndjera Burbuqe Berisha.





Drejtoresha e festivalit, Doruntina Alshiqi u shpreh e lumtur që ky edicion përfundoi me sukses, duke theksuar se ishte një garë e ngushtë për jurinë. "Marrë parasysh faktin se shfaqjet ishin të gjitha të mira dhe pothuajse të të njëjtit nivel, për jurinë nuk ka qenë e lehtë të vendoset për çmimet por dua të falënderojë përzemërsisht të gjithë pjesëmarrësit që përfaqësuan shtetin e tyre dhe i uroj për çmimet e fituara", u shpreh Alshiqi.

Edicioni i sivjetmë në program pati gjashtë shfaqje nga vendi, rajoni dhe bota.

Këtë vit çmimin kryesor të PITF 2022, çmimin për aktorin më të mirë në rolin kryesor e gëzoi aktori dhe regjisori i shfaqjes "Muslimani", Enver Petrovci.
Ai falënderoi organizatorët e festivalit, duke cilësuar se janë të paktë njerëzit në Kosovë që i kushtojnë rëndësi dhe i japing vlerë kulturës.

"Jam krenar me ju me të vërtetë shumë! Jeni ndër të paktit për mos me thënë të vetmit që kontribuoni në organizimin e një festivali kaq të kompletuar dhe që na bëni të ndjehemi si është më së miri sidomos neve artistëve, ju faleminderit të gjitha jurive për vlerësimin", tha Petrovci.

Kjo është lista e plotë e çmimeve këtë vit në "Prishtina International Theater Festival" (PITF 2022)

Çmimi "Best Play: Student Choice" – "Muslimani" – Kosova

Çmimi "Best Play: Media Choice" – "Muslimani" – Kosova

Çmimi "Best Supporting Actor" – Jelena Dukic "Iphigenia" – Mali i Zi

Çmimi "Best Director" – Fatos Berisha "The M Word" – Maqedonia e Veriut

Çmimi "Best Play" – "Iphigenia" – Mali i Zi

Çmimi kryesor i PITF 2022 "Best Actor" – Enver Petrovci "Muslimani" – Kosova

PËRMBYLLET ME SUKSES PROJEKTI EDUGRUA

17 maj 2022

Kolegji AAB ka qenë i përfshirë në projektin EDUGRUA, i cili është realizuar në bashkëpunim me Ambasadën Suedeze dhe Universitetin Lund që mbështetën projektin në fjalë e i cili u realizua nga znj.Lirie Hoti si udhëheqëse e projektit në Kosovë.

I financuar nga Instituti Suedez dhe Univeristeti Lund, projekti synonte të futej në shoqërinë dhe familjen në Kosovë por edhe në Shqipëri dhe të prekte temën më të dhembshme, atë të dhunës në familje. Qëllimi perfundimtar i projektit ishte risocializimi i një grupi të targetuar të pjesëmarrëseve në të.







EDUGRUA ngërthen në vete një domethënie të veçantë në gjuhën shqipe: ta arsimosh një grua, një vajzë dhe t' ia krijosh mundësitë që ajo ta japë kontributin e saj në shoqëri, e që do të thotë shumë. Përmbylljes së projektit i kontribuan në takim me fjalët e tyre mjaft domethënëse edhe prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim, Venera Llunji, mysafiret e çmuara: Znj. Malin Pahlmblad nga universiteti Lund, zyrtarja politike Katja Hollboll nga Ambasada e Suedisë, znj Nazlie Bala, keshilltare e Ministres së Drejtësisë, deputetja Floreta Zejnullahu, dekani Veton Vula dhe po ashtu drejtoresha e "Vivienne Academy" Lirika Tafa, e cila edhe ndau një çmim për përgatitje profesionale të njërës nga pjesëmarreset e projektit.

Të gjithë folësit në përmbyllje treguan se ky projekt do të jetë një ndihmë sado e vogël edhe për politikëbërësit në Kosovë në nivele të ndryshme qeverisëse.

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE FILLON BASHKËPUNIM ME AKADEMINË E FËMIJËVE "LAPSI"

18 maj 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Fëmijëve "Lapsi". Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunimin për zhvillimin e pjesës praktike të studentëve të Shkencave Sociale në këtë akademi, duke ndikuar në aftësimin dhe zhvillimin profesional të fushës së edukimit.

Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në hapësirat e Kolegjit AAB nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, prof.dr. Hysen Kasumi dhe nga drejtoresha e Institucionit Parashkollor "Lapsi", znj. Diana Dina.





FAKULTETI I STOMATOLOGJISË ORGANIZON KONGRESIN E PARË NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E STOMATOLOGJISË

18 maj 2022

Fakulteti i Stomatologjisë organizon Kongresin e Parë Ndërkombëtar në fushën e Stomatologjisë. Kongresi do të mbahet nga data 23 deri më 25 shtator 2022 dhe në kuadër të tij do të ofrohen trajnime, prezantime, ligjërata me të ftuar ndërkombëtar dhe poster prezantime.



Detaje më të hollësishme rreth regjistrimit dhe pjesëmarrjes do të publikohen ditët në vijim.

PRESIDENTI I MALIT TË ZI, MILO ĐUKANOVIĆ: "KOLEGJI AAB, INSTITUCION PRESTIGJIOZ NË FUSHËN E ARSIMIT JO VETËM NË KOSOVË"

19 maj 2022

Për herë të parë në Kosovë po qëndron presidenti i Malit të Zi, Milo Đukanović, i cili sot u nderua me Çmimin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut nga Kolegji AAB. Ky çmim presidentit malazez iu nda për pritjen dhe akomodimin e refugjatëve nga Kosova gjatë luftës së vitit 1999 si dhe kontributin në përmirësimin e të drejtave civile në Mal të Zi.










Me këtë rast, në Teatrin AAB "Faruk Begolli", presidenti malazez mbajti edhe një ligjëratë për studentët dhe të pranishmit e tjerë me temën "Mali i Zi si faktor stabiliteti në rajon". Pas pranimit të çmimit nga rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, presidenti malazez u shpreh mirënjohës këtë vizitë.

"Kam kënaqësinë e veçantë dhe privilegjin që gjatë vizitës time dy ditore në Kosovë, të takohem edhe me ju dhe të vizitoj këtë kolegj kaq prestigjioz, i cili në fushën e arsimit ju ka ndihmuar shumë gjeneratave të reja, jo vetëm në Kosovë por në gjithë Ballkanin Perëndimor. Dua të ju uroj për suksesin në këtë mision edhe në të ardhmen. Ndërsa sa i përket çmimit që ma dorëzuat, këto çmime i kam parë gjithmonë si inkurajim të mëtejshëm, faleminderit për të gjitha fjalët e mira edhe për Malin e Zi", tha Sh.T. Milo Đukanović.

Ligjërata e sotme e presidentit malazez Milo Đukanović, u pasua edhe me një seancë pyetje përgjigje, ku z. Đukanović u përgjigj në pyetjet e studentëve.

CERTIFIKOHET PROJEKTI "NDRYSHIMI I MENTALITETIT PËR AFTËSITË E KUFIZUARA PËRMES SPORTIT" I STUDENTES GENTIJANA PAÇARIZI

20 maj 2022

Edukimi përmes sportit është një qasje arsimore joformale që punon me aktivitete sportive dhe fizike e që i referohet zhvillimit të kompetencave kyçe të individëve dhe grupeve në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin personal dhe transforminin e qëndrueshëm shoqëror.

Kjo metodë pedagogjike e implementuar ka provuar të adresojë problemet e komunikimit, të promovojë të drejtat e njeriut, të ulë normat e sjelljeve të devijuara dhe të krijojë ndjenja të përkatësisë së komunitetit. Studentja e Kolegjit AAB, Gentijana Paçarizi përmes projektit të saj synon arritjen e objektivave te saj lidhur me këtë temë duke zhvilluar aktivitete të shumta.



Projekti është certifikuar nga Play Internatioanl ndërsa është i strukturuar në 3 faza dhe do të mbahet një herë në javë. Pjesëmarrës do të jenë 15 studentë nga tri programe studimore: Kulturë Fizike dhe Sport, Psikologji dhe Shkenca Sociale të vitit të parë akademik.

SHËNOHET DHJETË VJETORI I VDEKJES SË POETIT ALI PODRIMJA

20 maj 2022

Në bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë, në Teatrin AAB "Faruk Begolli", u mbajt koncert/recital përkujtimor në dhjetë vjetorin e vdekjes së poetit tonë të njohur, Ali Podrimja.

Mbrëmjen e hapi Venera Llunji, prorektore për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe bashkëpunim bashkë me atasheun për kulturë në Ambasadën e Francës, z. Donato Giulianni.

Pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të ambasadës së Francës si dhe personeli dhe studentët e Kolegjit AAB. Të pranishmit e ndoqën me vëmendje koncertin dhe recitalin e përgatitur nga poetja dhe pianistja e njohur parisiene znj. Laure Cambau dhe poetja dhe profesoresha, znj. Ilire Zajmi.







Të dy poetet, nën tinguj melankolik të pianos, lexuan vargje të poezive të poetit Ali Podrimja në të dy gjuhët duke krijuar kështu një atmosferë sa të melankolike ashtu edhe të bukur.

PROF.BASHKIM RRAHMANI PJESË E PROGRAMIT "BUILD UP YOUR INTERNATIONALIZATION" NË POLONI

21 maj 2022

Prof.Dr. Bashkim Rrahmani mori pjesë si përfaqësues i Kolegjit AAB në javën e "Build Up Internationalization" në Universitetin Lodz të Polonisë. Atje, ai po shkëmben përvoja për mësimdhënie e kërkime shkencore, komunikim ndërkombëtar e ndikim në komunitete, për programe edukimi e projekte zhvillimore, për kulturën e gjenerata të ndryshme.

"Ndihem i privilegjuar të isha i përzgjedhur nga Kolegji AAB që të isha pjesë e javës së personelit, ndërkohë që jam i bindur që nga kjo javë do të rrjedhin ide dhe inciativa të reja. Universiteti i Lodz është një institucion i përgjegjshëm i arsimit të lartë, që veprimet e veta i fokuson në integrimet ndërkulturore dhe integrimet sociale", u shpreh Rrahmani.









Përfaqësuesit tjerë që morën pjesë ishin nga shumë vende të zhvilluara evropiane si: Spanja, Gjermania, Franca, Turqia, Mali i Zi, Armenia etj.

MBAHET EDICIONI I TRETË I FESTIVALIT TË STUDENTËVE TË AAB, PAAF

21 maj 2022

I konceptuar për të promovuar punën e studentëve të Fakultetit të Arteve, festivali i vetëm i studentëve në Kosovë, Prishtina Arts & Architecture Festival, nis të martën edicionin e tij të tretë.

Ky edicion që do të mbahet më 24 e 25 maj 2022, në hapësirat moderne të Kolegjit AAB do të sjellë risi në përmbajtjen e tij, ndërsa do të prezantohet krijimtaria njëvjeçare e studentëve të të gjitha programeve: pikturë, dizajn grafik, dizajn mode, arkitekturë, enterier, koreografi,muzikë.


PAAF
Prishtina Arts and Architecture Festival 2022
Third Edition
24, 25 May 2022
Concert - Faculty of Music
Performance of Choreography students
Exhibition (paintings, photography, architectural works, graphic design, interior design, conceptual art)
The Artistic Colony of Students
Runway - Fashion Design
Workshop (Art & Architecture)


PAAF
Prishtina Arts and Architecture Festival 2022
Third Edition
Concert by Musicology students


PAAF
Prishtina Arts and Architecture Festival 2022
Third Edition
Fashion Show
This tradicional activity of AAB College aims to promote student work and their progress over the years in various professional subjects.
This year's showcase will bring designer clothing designed, stylized and realized by students who combine fashion trends, and the in-depth information they receive during their studies.
The activity will be under the care of fashion design director Kismore Rugova.
AAB College, Prishtina - Kosova


PAAF
Prishtina Arts and Architecture Festival 2022
Third Edition
Art Colony

Në ditën e parë të festivalit, PAAF2022 do të sjellë një program artistik të studentëve të Fakultetit të Muzikologjisë dhe Koreografisë. Ndërsa për kontributin shumëvjeçar dhënë në fushën e arsimit dhe të artit, si dhe kontributit të pareshtur në avancimin e studentëve, Fakulteti i Arteve i Kolegjit AAB, akademikut Shyqri Nimani, do t' ia ndajë titullin "Profesor Nderi".

Po kështu, dita e parë e PAAF 2022, do të jetë edhe dita hapëse e Ekspozitës Kolektive të Studentëve, ku do të prezantohen dhjetëra punime të studentëve dhe vëmendja e veçantë i është kushtuar programit Dizajnit Mode ku studentët do të sjellin kreacionet e tyre në dizajnin e veshjeve, të cilat janë punuar nën përkujdesjen e mësimdhënëses Krenare Rugova.

Dita e tretë e festivalit, do të fokusohet gjithashtu edhe në fushën e arkitekturës dhe enterierit në kuadër të së cilës do të mbahen workshope për studentë.

Veçanti tjetër e edicionit të tretë të PAAF 2022 do të jetë edhe Kolonia Artistike, ku studentët e programit të arteve vizuele nga Kolegji AAB dhe Universiteti i Prishtinës, për dy ditë radhë do të punojnë në Shëngjin për të shkëmbyer përvojat e tyre dhe për të krijuar vepra që do të mbeten gjatë në Galeritë e Kolegjit AAB.

PAAF 2022 do të jetë më ndryshe, andaj ftohen të gjithë të interesuarit të vijnë dhe të vizitojnë nga afër punimet artistike të studentëve.

U MBAJT TRAJNIM PËR STUDENTËT MBI STANDARDET EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

23 maj 2022

Qendra Evropiane dhe Rrjeti për Shtetin e së Drejtës së Ambasadës Holandeze organizuan trajnim për studentët e Fakultetit të Administratës Publike, me temën: Standardet e gjykatës së Strasburgut në shoqëritë në zhvillim: kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës, me ligjërues Prof. Dr. Mentor Borovci.

Në këtë trajnim, studentët patën mundësi të zgjerojnë dhe përmirësojnë njohuritë e tyre mbi Standardet Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Studentët pjesëmarrës u certifikuan për trajnimin e ndjekur.





FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE FILLON BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR "DIJA-S"

23 maj 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale i Kolegjit AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Dija-S". Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunimin për zhvillimin e pjesës praktike të studentëve të Shkencave Sociale në këtë institucion, duke ndikuar në aftësimin dhe zhvillimin profesional të fushës së edukimit parashkollor.





Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në hapësirat e Kolegjit AAB nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, prof.dr. Hysen Kasumi dhe nga drejtoresha e Institucionit Parashkollor "Dija-S", znj. Selvigona Jasiqi Hoxha.

STUDENTËT E PROGRAMIT MASTER, FITNES DHE NUTRICION, VIZITUAN KOMITETIN OLIMPIK TË KOSOVËS

23 maj 2022

Studentët e Kolegjit AAB të shoqëruar nga profesorët Dr.Nazim Myrtaj dhe Dr.Blerim Sylejmani, në kuadër të bashkëpunimit që tashmë Fakulteti i Kulturës dhe Sportit ka me Komitetin Olimpik të Kosovës, vizituan ambientet e këtij Komiteti.

Studentët u njoftuan nga udhëheqësit Fitim Arifi dhe Diellza Kelmendi për programin e Akademisë Olimpike, që do të funksionojë si Departament i ri brenda KOK-ut.





Bashkëpunimet e tilla janë gjithmonë të duhura për ngritjen profesionale të studentëve, të cilëve njëkohësisht u mundësohet zgjerimi i aktiviteteve të tyre të edukimit.

U MBAJT TRYEZA E DISKUTIMIT PËR ROLIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM NË QEVERISJEN EFEKTIVE

24 maj 2022

Fakulteti Ekonomik i Kolegjit AAB në bashkëpunim me Institutin për Auditim të Brendshëm dhe Kontrolle (IABK) zhvilluan një tryezë diskutimi me studentët e nivelit master të Fakultetit Ekonomik, ku temë ishte "Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, dhe roli i auditimit në qeverisje efektive dhe menaxhim financiar adekuat". Panelistë në këtë ngjarje ishin dekani Prof.ass.dr. Medain Hashani, Prof.ass.dr. Ilir Rexhepi dhe Prof.ass.dr. Fëllanzë Pula nga Kolegji AAB. Përderisa, nga IABK panelistë ishin Mirlinda Kadriu-Ahmeti, drejtoreshë e Institutit si dhe Shukrije Morina, anëtare e Bordit të Institutit.





Temat të cilat u diskutuan ishin: raportimi financiar, standardet e raportimit financiar dhe të auditimit, besueshmëria në raportet e auditimit, si të procedohet një rast i cili nga auditorët konsiderohet si mashtrim, ndërlidhja mes auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, ofrimi i ekspertizës gjatë kryerjes së auditimeve të performancës si në menaxhim të kontratave, auditime në fushën e shëndetësisë dhe TI-së, etj..

Studentët patën rastin të përfitojnë nga shkëmbimi i njohurive nga panelistët lidhur me auditimin si nga aspekti teorik-procedural poashtu edhe nga aspekti praktik.

NIS FESTIVALI I STUDENTËVE PRISHTINA ARTS AND ARCHITECTURE FESTIVAL – PAAF 2022

24 maj 2022

Me një ceremoni solemne në Kolegjin AAB, sot nisi i vetmi festival i studentëve në vendin tonë, "Prishtina Arts and Architecture Festival", ku të pranishëm ishin dashamirë të artit, studentë e fytyra eminente të fushës së kulturës në Kosovë. Festivali PAAF 2022 këtë vit numëron edicionin e tij të tretë dhe do të zgjasë dy ditë.



















Hapjen e festivalit, e bëri rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, ndërsa Drejtori i Bordit të Festivalit PAAF2022, Prof. Shyqri Nimani u shpreh i lumtur që puna e studentëve po arrin të shpaloset përgjatë festivalit.

Në këtë ceremoni, prof.Shyqri Nimanit iu nda Çmimi "Profesor Nderi" për kontributin shumëvjeçar dhënë në fushën e arsimit dhe ngritjen e cilësisë në këta sektorë si dhe kontributit të pareshtur në avancimin e studentëve të Fakultetit të Arteve të Kolegjit AAB.

Dita e parë e festivalit PAAF 2022 vazhdoi me ekspozitën kolektive të studentëve të Fakultetit të Arteve, ku u prezantuan qindra punime të studentëve të cilat në vete përmbajnë mesazhe të ndryshme.

Prishtina Arts and Architecture Festival do të vazhdojë të mbahet edhe nesër në hapësirat e Kolegjit AAB (24-25 maj 2022), dhe për vizitorët do të ofrojë edhe një varg aktivitetesh të tjera e punëtorish artistike për studentë.

PROFESORËT ARIANIT MARAJ E KRENAR KËPUSKA, PJESË E "2022 BALKANS INTERNATIONAL CYBERSECURITY FELLOWSHIP"

24 maj 2022

Profesorët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, Arianit Maraj dhe Krenar Këpuska, janë ndër 12 pjesëmarrësit nga vendet e Ballkanit në projektin "2022 Balkans International Cybersecurity Fellowship" që po zhvillohet në Lublanë të Sllovenisë. Ky projekt i organizuar nga CRDF Global dhe PURDUE University po zhvillohet me mbështetjen e "US Department of State".



Suksesin dhe përvojën e tyre profesorët do e ndajnë bashkë me studentët e këtij fakulteti pasi të kthehen nga atje duke i informuar mbi temën të cilën e zhvillon projekti.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT, BASHKËORGANIZATOR i KONFERENCËS SË 7-TË BALLKANIKE NË SHKENCAT SPORTIVE

25 maj 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit mori pjesë në Konferencën e 7-të Ballkanike në Shkencat Sportive organizuar nga Universiteti i Tetovës. Kolegji AAB në cilësinë e bashkëorganizatorit mori një mirënjohje të veçantë në zhvillimin dhe promovimin e të arriturave shkencore në fushën e sportit. Pjesëmarrja në këtë ngjarje ishte e një rëndësie të veçantë pasi ishte e një natyre ndërkombëtare dhe u ndanë shumë përvoja mes pjesëmarrësve.





Prezantimet nga mësimdhënësit e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit nga Kolegji AAB zgjuan interesim tek pjesëmarrësit në konferencë. Konferenca i zhvilloi punimet me datën 18 dhe 19 maj 2022.

Pjesëmarrja në konferencë kishte rendësi të shumëfishtë sepse përveç prezantimeve të punimeve ishte një mundësi e vendosjes së raporteve me pjesëmarrësit e tjerë.

OSBE MBAJTI LIGJËRATË PËR "KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT"

25 maj 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj është zhvilluar një ligjëratë speciale për studentët e Fakultetit Juridik për Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Ligjërues ishte Besnik Begaj ndërsa e pranishme ishte edhe koordinatorja e OSBE-së, Arijeta Rrotlla.





Punëtoria, respektivisht ligjërata me karakter trajnues, kishte për qëllim që studentëve të Kolegjit AAB në Ferizaj, t' u ofrohet mundësia që të rrisin njohuritë e tyre mbi vendimet e GJEDNJ-së për të drejtat pronësore dhe të rrisë ndërgjegjësimin e tyre për standardet dhe parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për më tepër, trajnimi i përgatiti studentët për të përmirësuar performancën e tyre në provimet e së drejtës civile dhe për të forcuar aftësitë e tyre kërkimore.

NË AAB U MBAJT TRYEZA PËR Ë ARRITURAT DHE SFIDAT E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE NË KOSOVË

25 maj 2022

"Të arriturat dhe sfidat e insitucioneve parashkollore në Kosovë", ishte tema e tryezës së organizuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale, ku pjesëmarrës ishin stafi akademik dhe studentët e këtij fakulteti.



Pjesë e panelit ishin prof. Saranda Shatri, znj. Gëzime Rexhepi Çollaku në cilësinë e Kryetares së Asociacionit të Institucioneve Parashkollore Private dhe drejtoreshë e IP "Bardha", znj. Sadete Bucolli Gërbeshi drejtoreshë e IP "Kopshti i Ëndërrave", znj. Selvigone Jasiqi Hoxha – drejtoreshë e IP "Dija -S" dhe znj. Njomza Bajrami – drejtoreshë e IP "Kopshti Dua".

Takimin e hapi prodekanja e Fakultetit të Shkencave Sociale, prof. Saranda Shatri, e cila falënderoi pjesëmarrësit e panelit dhe të pranishmit si dhe foli për qëllimin dhe rëndësinë e trajtimit të një teme të tillë. Znj. Gëzime Rexhepi-Çollaku foli për punën e palodhshme që bëjnë edukatoret në kuadër të institucioneve parashkollore. Ajo sqaroi për mbështejen e edukatoreve për fëmijët por edhe bashkëpunimin e tyre me prindërit për qëllimin e vetëm që të rrisin performancën e fëmijëve dhe po ashtu cilësinë në edukim. Gjatë diskutimit u përmend se edukimi në fëmijërinë e hershme duhet të bëhet edukim i obliguar.

Studentët patën rastin të përfitojnë nga shkëmbimi i njohurive nga panelistët lidhur me sfidat e insitucioneve parashkollore edhe nga aspekti praktik.

ORGANIZOHET JAVA E SPORTIT NË KOLEGJIN AAB

26 maj 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit organizon Javën e Sportit për të gjithë studentët nga të gjitha fakultetet e Kolegjit AAB. Ky aktivitet është planifikuar të zhvillohet nga 01-04 qershor 2022, në sallat e sportit të kampusit në Prishtinë. Paraqitja e ekipeve do të bëhet deri të hënën më 30 maj 2022 ndërsa për fituesit e tre vendeve të para do te ketë shpërblime.



SHËNOHET DITA E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË MBROJTJES TË SË DHËNAVE

26 maj 2022

Në kuadër të bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB dhe kompanisë "Cybersecurity and Privacy", më 25 maj u shënua dita e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes të së Dhënave (General Data Protection Regulation).







Kjo rregullore u jep individëve më shumë të drejta mbi përdorimin e të dhënave të tyre personale dhe i mban organizatat përgjegjëse për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre.

Në lidhje me këtë rregullore studentët u informuan nga përfaqësuesi i kompanisë "Cybersecurity and Privacy", Mentor Hoxhaj. Pas ligjëratës e cila kishte të bënte edhe me atë se çfarë duhet të dimë ne, nga studentët e pranishëm u shtruan shumë pyetje.

NESËR NË KOLEGJIN AAB NIS EDICIONI I PARË I PANAIRIT TË KARRIERËS DHE PUNËSIMIT AAB 2022

26 maj 2022

Në edicionin e parë të këtij panairi do të marrin pjesë rreth 50 kompani vendore e ndërkombëtare të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në pothuaj të gjitha qendrat e Kosovës, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre ofrojnë shërbime edhe për vendet evropiane e amerikane



Pjesëmarrësit e panairit do të takohen drejtpërdrejt me studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit AAB, me ç'rast ata do të njoftohen për pozitat e lira që ofrohen nga këto kompani qoftë si internshipe apo edhe vende të lira pune.

Kompanitë që marrin pjesë në edicionin e parë të Panairit të Karrierës dhe Punësimit AAB 2022 mbulojnë të gjitha fushat studimore që ofrohen në Kolegjin AAB, duke filluar nga ekonomia, drejtësia, shkencat kompjuterike, psikologjia, komunikimi, edukimi i fëmijëve, artet, shkencat sportive, shkencat mjekësore, etj..

Panairi do të jetë i hapur gjatë dy ditëve të premten dhe të shtunën (27 dhe 28 maj 2022), ndërsa studentët e interesuar për t' u takuar me punëdhënësit e mundshsëm, inkurajohen të përgatisin CV-të e tyre dhe të paraqiten në shtandet e pjesëmarrësve.

PROJEKTI "STUDENTËT SI GAZETARË PROFESIONISTË", SJELL NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME NË AAB

26 maj 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Prishtinë është zhvilluar ligjëratë për nxënësit e shkollave të mesme, në kuadër të projektit studentor "Students as Professional Journalists", ku ligjërues ishte profesor Resul Sinani.





Ligjërata kishte për qëllim të ngrisë vetëdijësimin e nxënësve për marrjen e informacioneve të sakta dhe jo atyre "fake news", si dhe rëndësinë e profesionit të gazetarisë. Nxënësit shprehën interesim për profesionin e gazetarisë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen çdo ditë gazetarët.

Prof. Resul Sinani ndau përvojën e tij shumëvjeçare nga fusha mediale, prezantoi para studentëve teknikat dhe praktikat që ndiqen për të zhvilluar një emision të suksesshëm. Ndër të tjera, së bashku vizituan ambientet e televizionit ATV, duke u njohur me infrastrukturën dhe punën e cila bëhet për të arritur shikueshmërinë një medium i suksesshëm.







Ligjërata kishte për qëllim të ngrisë vetëdijësimin e nxënësve për marrjen e informacioneve të sakta dhe jo atyre "fake news", si dhe rëndësinë e profesionit të gazetarisë. Nxënësit shprehën interesim për profesionin e gazetarisë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen çdo ditë gazetarët.

Prof. Resul Sinani ndau përvojën e tij shumëvjeçare nga fusha mediale, prezantoi para studentëve teknikat dhe praktikat që ndiqen për të zhvilluar një emision të suksesshëm. Ndër të tjera, së bashku vizituan ambientet e televizionit ATV, duke u njohur me infrastrukturën dhe punën e cila bëhet për të arritur shikueshmërinë një medium i suksesshëm.

U MBAJT KONFERENCA E PARË SHKENCORE E STUDENTËVE TË FSHK

27 maj 2022

Në Qendrën Mediale të Kolegjit AAB u mbajt Konferenca e Parë Shkencore Studentore nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike e quajtur "Dita e hapur e projekteve dhe hulumtimeve". Në këtë konferencë u prezantuan temat e përzgjedhura nga komisioni i fakultetit, i përbërë nga Ersan Hamdiu, Xhevdet Spahiu, Rahmil Limani, Elissa Mollakuqe dhe Samir Jakupi.
Temat e prezentuara përfshinë të gjitha fushat e shkencave kompjuterike si: programim, siguri kibernetike, inxhinieri softuerike, IoT, rrjeta, telekomunikim si dhe hulumtime të tjera.









Kjo konferencë ishte rast i mirë për studentët të cilët mendojnë të vazhdojnë zhvillimin akademik, duke parë rëndësinë e punës shkencore dhe si hap i parë drejt formimit të tyre si shkencëtar. Po ashtu, studentë të shumtë prezantuan edhe produkte të gatshme të tyre, si softuerë të cilët janë krijuar gjatë projekteve të ndryshme në fakultet. Konferenca u mbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT ORGANIZOI ECJE NJËDITORE NË MALET E SHARRIT

27 maj 2022

Në mesin e shumë aktiviteteve që organizohen në Kolegjin AAB, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit organizoi ecje njëditore me studentët e këtij drejtimi.









Destinacioni i shtegut nëpër të cilin kaluan ishin Malet e Sharrit dhe Liqeni i Jazhincës, liqen ky në një lartësi mbidetare prej 2180m, ku ngjitja në këtë terren llogaritet mesatarisht e vështirë. Shtegu ishte i gjatë 16 km dhe ecja zgjati gjithsej 6 orë. Studentët shijuan pamjet e maleve të dendura, natyrën, ujëvaret, etj.

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në AAB zhvillon aktivitete të tilla në kuadër të lëndëve të ndryshme, duke u përpjekur që studentët krahas ligjëratave të konkretizojnë të gjitha njësitë mësimore edhe në praktikë.

PËRFAQËSUES TË KOLEGJIT AAB PO QËNDROJNË PËR VIZITË ZYRTARE NË GJERMANI

28 maj 2022

Drejtoria e Kompanisë Lingua së bashku me Dekanin e Fakultetit të Infermierisë në Kolegjin AAB, Idriz Sopjani, si përfaqësues të Programit për Karrierë dhe Punësim në Kolegjin AAB janë duke zhvilluar vizita disa ditore në Gjermani, me përfaqësuesit e klinikave partnere gjermane.





Këto takime po realizohen me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit, njëherit me hartimin e strategjive me partnerët kryesorë gjermanë të programit, SANA Klinikum Offenbach dhe AGAPLESION, Frankfurt. Po ashtu në këto takime janë planifikuar intervistat e radhës me këto klinika për studentët e Fakultetit të Infermierisë në Kolegjin AAB.

Përfaqësuesja e programit, znj.Blerina Osmani ndër të tjera është shprehur tejet e kënaqur nga rezultatet e këtyre takimeve dhe ka konfirmuar gatishmërinë e partnerëve për vazhdim bashkëpunimi. Raundi tjetër i intervistave pritet të jetë gjatë muajit qershor.

INTERESIM I MADH I STUDENTËVE NË EDICIONIN E PARË TË PANAIRIT PËR KARRIERË DHE PUNËSIM AAB 2022

28 maj 2022

Po vazhdon dita e dytë e edicionit të parë të Panairit për Karrierë dhe Punësim në kuadër të të cilit po marrin pjesë rreth 50 kompani vendore e ndërkombëtare. Pjesëmarrësit e panairit po mirëpriten ngrohtë nga studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit AAB, me ç'rast ata po njoftohen nga afër mbi pozitat e lira që po ofrojnë këto kompani qoftë si internshipe apo edhe vende të lira pune.



Në hapje të Panarit, Kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, prof.dr. Lulzim Tafa, përshëndeti këtë panair duke e cilësuar si një vlerë dhe mundësi tjetër të shtuar për studentët e Kolegjit AAB.

Ndërsa, Kryetari i Bordit Këshillues Industrial të Kolegjit AAB, z. Arian Zeka përgëzoi pjesëmarrësit dhe i motivoi studentët që të bëhen pjesë e kompanive dhe ndërmarrjeve pjesëmarrëse në këtë panair qoftë si praktikantë apo punëtor të rregullt.

Kompanitë që po marrin pjesë në edicionin e parë të Panairit të Karrierës dhe Punësimit AAB 2022 mbulojnë të gjitha fushat studimore që ofrohen në Kolegjin AAB, duke filluar nga ekonomia, drejtësia, shkencat kompjuterike, psikologjia, komunikimi, edukimi i fëmijëve, artet, shkencat sportive, shkencat mjekësore, etj..

Panairi do të jetë i hapur edhe sot, derisa inkurajohen studentët e interesuar për t' u takuar me punëdhënësit e mundshëm, për të përgatitur CV-të e tyre dhe të paraqiten në shtandet e pjesëmarrësve.

EVP TRAJNIMET: "NDIHMA E PARË"

30 maj 2022

Trajnimet e organizuara nga Kolegji AAB në kudër të edukimit të vazhdueshem profesional, do të vazhdojnë më 8 qershor, me trajnimin një ditor "Ndihma e parë", ku ligjërues do të jetë Albin Morina.

Ky trajnim sikur edhe të tjerët është i akreditуar nga Oda e Infermierëve të Kosoves me 8 pikë kredituese për pjesëmarrje pasive. Në këtë kurs mund të aplikojnë të gjitha profilet shëndetësore dhe jo shëndetësore me interes për të mësuar shkathtësitë e ofrimit të ndihmës së parë në situata të ndryshme.



AMBASADORI I FINLANDËS SH. T. JOHAN SCHALIN MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

30 maj 2022

Në kuadër të ligjëratave me diplomatë të huaj në Kolegjin AAB, ambasadori finlandez, Sh. T. Johan Schalin ishte ambasadori i radhës i cili mbajti ligjëratë në lidhje me diplomacinë finlandeze.

Nën udhëheqjen e prof. Nexhmedin Spahiut, ambasadori Schalin shpalosi tema interesante që kishin të bëjnë me historinë e shtetit finlandez nëpër periudha të ndryshme historike. Gjatë dekadave të fundit, Finlanda ka luajtur një rol aktiv në promovimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor përmes ndërmjetësimit të paqes dhe detyrave të tjera ndërkombëtare. Ambasadori Schalin theksoi se krijimi i stabilitetit dhe mirëqenies në Ballkanin Perëndimor është në interesin e Finlandës.





Ligjërata e diplomatit finlandez për studentë vazhdoi edhe me një seancë diskutimi ku studentët patën mundësi të marrin përgjigjet e tyre në pyetjet e shtruara për të ftuarin special.

PREZANTOHEN PROJEKTE INOVATIVE TË REALIZUARA NGA STUDENTËT E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

31 maj 2022



Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, prezantuan projektet e tyre në kuadër të lëndës "Sensorët dhe Interfejset". Projektet e realizuara përfshijnë fusha të ndryshme të aplikimit, që nga aplikimet nga jeta e përditshme deri te energjia e ripërtëritshme.







Profesori i lëndës, Shkëlqim Miftari, duke vlerësuar projektet e studentëve, njoftoi se disa nga këto projekte janë: paneli solar, centrali elektrik i erës, shporta e mençur, kontrollimi i pajisjeve të ndryshme nga distanca, robotët e pastrimit, etj. Arduino, Rasperry PI, kontrollere dhe module të tjera elektrike dhe mekanike janë disa prej pajisjeve përmes të cilave janë realizuar projektet e studentëve, duke gjendur zbatim në Smart Home dhe në industri.

Këto projekte janë të dobishme për studentët në karrierën e tyre dhe i ndihmojnë ata në zhvillimin e cilësive të ndryshme për të ardhmen.

KOLEGJI AAB ORGANIZON KURSE PËRGATITORE FALAS PËR TESTIN E MATURËS

31 maj 2022

Mijëra maturantë nga e gjithë Kosova, edhe këtë vit do mirëpriten në Shkollën Përgatitore të Testit të Maturës të organizuar nga Kolegji AAB, që ka për qëllim përgatitjen e tyre sa më të mirë për Testin Kombëtar të Maturës.



Kurset përgatitore fillojnë nga data 10 qeshor prej orës 09:00, derisa përgatitja zhvillohet në lëndët: Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze dhe Matematikë.

Mësimi organizohet në tri kampuset e Kolegjit AAB (Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë), të drejtë pjesëmarjeje kanë nxënësit e të gjitha shkollave në Kosovë.

Linku për regjistrim në këto kurse: https://aab-edu.net/matura/

KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN PUBLIK "HAXHI ZEKA" PEJË

31 maj 2022

Në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit me universitetet ndërkombëtare dhe vendore, Kolegji AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Publik "Haxhi Zeka" të Pejës. Marrëveshja u nënshkrua nga Rektori i Kolegjit AAB, Dr.Sc. Bujar Demjaha, dhe Rektori i Universitetit Publik të Pejës, Prof.Dr. Armand Krasniqi.







Marrëveshja parasheh bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, si dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, seminare dhe takime të tjera për çështje akademike e shkencore.
Po ashtu me këtë marrëveshje është vlerësuar të bëhet edhe shkëmbimi i materialeve akademike si dhe informacioneve të tjera të nevojshme.

NË AAB MBAHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR SHËNDETIN, MIRËQENIEN, EDUKIMIN DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

31 maj 2022

Për të pestën herë me rradhë Kolegji AAB në bashkëpunim me Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) do të organizojë Konferencën e Pestë për Shëndetin, Mirëqenien, Edukimin dhe të Drejtat e Fëmijëve. Kjo ngjarje realizohet për të mbështetur mbështetur fëmijët, të cilët përfaqësojnë 34% të popullsisë së Kosovës (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018), që ata të mund të lulëzojnë në çdo aspekt të jetës së tyre, veçanërisht në lidhje me shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, qëllimi i kësaj konference është të mbledhë studiues nga e gjithë bota për të paraqitur avancimet në lidhje me edukimin, shëndetin, mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve dhe për të nxitur një mjedis të favorshëm për shkëmbimin e ideve dhe informacioneve duke integruar përbërës teorikë dhe praktikë të kësaj çështjeje.



Kësaj radhe, konferenca do të përqendrohet kryesisht në mirëqenien e fëmijëve për shkak të dukurive të fundit në botë. Shumë fëmijë janë në disavantazh për shkak të pandemisë COVID-19, kështu që aspiratat e tyre fizike dhe mendore do të preken. Pra, mirëqenia post-pandemike dhe rikuperimi psikologjik është tema kryesore në literaturën botërore. Andaj, të dhënat më të reja në këto fusha do të ndihmojnë orientimin e vendimmarrësve me gjetje të bazuara në evidencë për të parandaluar dhe ndërhyrë në mënyrën e duhur sa më shpejt dhe me mençuri të jetë e mundur.

Si përfundim, konferenca synon të inkurajojë debatin e mirëfilltë shkencor dhe politik-bërjen e bazuar në evidencë duke promovuar shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve.


KOLEGJI AAB

QERSHOR 2022

STUDENTET E KAMPUSIT TË GJAKOVËS SHËNUAN DITËN NDËRKOMBËTARE TË FËMIJËVE

1 qershor 2022

1 Qershori nuk është vetëm një festë, është dita për t' i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve, për t' u respektuar të drejtat e tyre në shoqëri.

Me këtë moto studentet e Fakultetit të Shkencave Sociale, të kampusit të Gjakovës, shënuan Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Ato përgatitën aktivitete të ndryshme, edukative e arsimore e zbavitëse për fëmijët e Kopshtit "Amelia".

Studentët e Përkujdesjes dhe Mirëqenies së Fëmijëve në mbështetje të prof. Diana Qarkaxhija dhe Prof. Violeta Buza, u ndanë shumë të kënaqur nga ky organizim, meqenëse fëmijët ishin shumë të lumtur dhe të interesuar për aktivitetet e organizuara.









SHËNOHET AKTIVITETI I RADHËS NË KËNDIN FRANCEZ TË KOLEGJIT AAB

1 qershor 2022

Në këndin francez të Kolegjit AAB u mbajt aktiviteti i radhës në kuadër të kursit të gjuhës frënge, kurs ky i organizuar nga Aleanca Franceze në Prishtinë. Aktiviteti kishte për qëllim promovimin e ushqimeve dhe pijeve që kanë origjinë nga Franca.

Studentët dhe stafi i Kolegjit AAB të cilët vijojnë mësimin e gjuhës frënge prezantuan ushqime dhe pije të ndryshme të cilat i kishin përgatitur vet, derisa edhe i shijuan ato së bashku.

Ata u shprehën që aktivitetet e tilla që promovojnë kulturën franceze janë të mirëseardhura, pasi që është në interesin e tyre që të kenë sa më shumë informata për kulturën dhe historinë e shtetit francez.







STUDENTËT SIMULOJNË RASTET CIVILE DHE PENALE NË KUADËR TË PROJEKTIT "DREJTËSIA KOMERCIALE"

1 qershor 2022

Në kuadër të bashkëpunimit mes Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB me USAID për realizimin e projektit "Drejtësia Komerciale", dje u finalizua simulimi i dy rasteve në aspektin civil dhe penal, sipas procedurës së ndërmjetësimit si metodë alternative dhe veprimtari jashtëgjyqësore e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve e rregulluar me ligj. Në përcjellje të këtij aktiviteti simulues, ishin prezentë edhe përfaqësues të programit Drejtësia Komerciale, profesorë dhe studentë.

Studentët të cilët realizuan procedurën e ndërmjetësimit treguan performancë të shkëlqyeshme dhe me këtë rast u pajisën edhe me certifikata nga USAID dhe Kolegji AAB.










PROFESORESHA E AAB-së URANELA DEMAJ LIGJËRON NË UNIVERSITETIN E LODZ-IT NË POLONI

2 qershor 2022

Dr. Uranela Demaj, Prorektore për Shkencë dhe Hulumtime Kërkimore në Kolegjin AAB, njëherësh edhe profesoreshë e sociolinguistikës, ftohet si profesoreshë vizitore në Universitetin e Lodz-it në Poloni. Dr. Demaj do të mbajë ligjërata në kurset e nivelit MA në lëndën e sociolinguistikës. Fokusi i ligjëratave do të jetë roli i gjuhës në politikën e ndërtimit të identitetit në kontekste të ndryshme gjeopolitike, të cilat kanë pësuar ndryshime të regjimit socio-politik dhe transformime ekonomike e kulturore. Nëpërmjet ligjëratave të saj, Dr. Demaj do të nxjerrë në pah kontekstin e Kosovës dhe transformimin e saj sociopolitik drejt pavarësisë pas luftës ndëretnike (1998).



Ligjëratat e saj do të jenë një shpalosje historike se si panorama gjuhësore e qendrës së qytetit të Prishtinës ka ndryshuar në përputhje me vizionet e ndryshme të përkatësisë identitare në Kosovë gjatë shekullit të njëzetë e deri më sot.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME KOMPANINË ECONNECT

2 qershor 2022

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB përfaqësuar nga dekani Jusuf Qarkaxhija, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë eConnect, përfaqësuar nga drejtori menaxhues Ilir Salihu.





Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, siç janë realizimi i punës praktike të studentëve dhe punësimi i tyre, shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave, pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të përbashkëta, promovimi i nismave të përbashkëta profesionale dhe akademike, etj..

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke dhe do t' i ofrojnë njëra tjetrës ndihmën e duhur gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.

FKF DHE "PLAY INTERNATIONAL KOSOVO" ORGANIZOJNË TRAJNIM PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

2 qershor 2022

"PLAY International Kosovo" dhe Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB në kuadër të projektit PLAY'In Together kanë organizuar trajnimin dy ditor "Të gjithë lojtarë, të gjithë miq" me fokus në temën e gjithpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në aktivitete fizike.

Në këtë trajnim të ftuar ishin studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit nga Kolegji AAB, si një nga institucionet partnere të PLAY International.






Studentët e trajnuar do të jenë në gjendje të përdorin metodat e PLAY për të implementuar aktivitete sportive të rregullta me fëmijë. Në trajnim ishin të përzgjedhur edhe dhjetëra mësimdhënës nga vendet e ndryshme të Kosovës.

FGH NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME ACADEMIC EDUCATION CENTER KS

2 qershor 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me qendrën e edukimit akademik AEC KS. Të dyja palët u zotuan që të vazhdojnë bashkëpunimin në mënyrë që studentët të kenë hapësira në shërbimet e lartëpërmendura.







Një ndër prioritet e Fakultetit të Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB është zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit me partnerë potencialë për t' i dhënë mundësinë studentëve që të kryejnë punën praktike por edhe të punësohen.

DY LIGJËRUESE NGA LITUANIA LIGJËROJNË NË AAB NË KUADËR TË ERASMUS+

3 qershor 2022

Vitalija Gerikiene dhe Vilija Vaikasiene janë pjesë e shkëmbimit të mësimdhënësve përmes projektit ERASMUS+ nga Universiteti Siauliu Valstesbyne nga Lituania. Ato zhvilluan ligjëratë për studentët e Fakultetit të Infermierisë me temën "Komunikimi mes profesionistëve shëndetësor".









Dy ligjëruesit do qëndrojnë për një javë në Kolegjin AAB, në mënyrë që të shkëmbejnë përvojat e tyre në fushën e infermierisë me studentët.

Studentët ndoqën me shumë interes videoprezantimet e ligjëruesve dhe ishin kurioz për shumë çështje që përkojnë me fushën e studimit.

MENTOR LECAJ, MËSIMDHËNËS NË AAB PJESË E TRAJNIMEVE PROFESIONALE NË LITUANI PËRMES ERASMUS+

3 qershor 2022

Profesori i të Drejtës Ndërkombëtare, Mentor Lecaj, është ftuar të marrë pjesë në trajnimet për mësimdhënie dhe kërkimi shkencor që do të organizohen në Universitetin e Šiauliai në Lituani, në kuadër të programit të shkëmbimit në Erasmus+.



Pjesëmarrja e prof. Lecaj në këto trajnime do të sjellë shkëmbimin e përvojave të reja ndërinstitucionale dhe avanacimin e mëtutjeshëm në fushën e mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore. Gjithashtu do të krijohen iniciativa të reja të bashkëpunimit institucional dhe më gjerë që do të ngrisin pozitivisht imazhin e Kolegjit AAB.

Pjesëmarrja e prof. Lecaj në këto trajnime do të sjellë shkëmbimin e përvojave të reja ndërinstitucionale dhe avanacimin e mëtutjeshëm në fushën e mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore. Gjithashtu do të krijohen iniciativa të reja të bashkëpunimit institucional dhe më gjerë që do të ngrisin pozitivisht imazhin e Kolegjit AAB.

Prof. Mentor Lecaj muajin e kaluar ka qenë i ftuar si profesor vizitor në Fakultetin Jurdik të Universitetit Masaryk, në Republikën e Çekisë. Ai mbajti ligjëratë në lidhje me të Drejtën Ndërkombëtare, duke u fokusur në shtetin e Kosovës.

PËRFUNDOI KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE PËR SHËNDETIN, MIRËQENIEN, EDUKIMIN DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

3 qershor 2022

Me 1 dhe 2 qershor, në shënim të Ditës Botërore të Fëmijëve, Kolegji AAB në bashkëorganizim me Qendrën për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore, organizuan Konferencën Shkencore Ndërkombëtare për Shëndetin, Mirëqenien, Edukimin dhe të Drejtat e Fëmijëve.









Konferenca u mbajt në ambientet e Kolegjit AAB, ku të pranishëm ishin studentët e Kolegjit AAB dhe të institucioneve tjera. Në këtë konferencë u prezantuan mbi 30 hulumtime të ndara në 11 sesione. Studentët patën rastin që nga prezantues vendorë e ndërkombëtarë, të ndëgjojnë për tema të shumta që prekin shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve. Gjatë prezantimeve dhe tryezave të diskutimit, ku morën pjesë përfaqësues institucionesh dhe të organizatave që punojnë drejtpërdrejt në fushën e kujdesit ndaj fëmijëve, studentët patën rastin të parashtrojnë pyetje dhe të bëhen pjesë e diskutimeve.

PROF. AIDA ALLA, PJESË E JAVËS SË TRAJNIMEVE ERASMUS+, NË UNIVERSITETIN E MASARYK TË ÇEKISË

4 qershor 2022

Dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Dr. Aida Alla do të marrë pjesë në javën e trajnimit në Universitetin e Masaryk-ut në Çeki në kuadër të parneritetit mes Kolegjit AAB dhe Universitetit të Masaryk-ut përmes Erasmus+.

Në kuadër të këtij trajnimi në të cilin do të marrin pjesë rreth 50 profesorë universitetesh, në fokus është avancimi i aftësive menaxheriale në nivel fakulteti. Temat kryesore që do të trajtohen në këtë trajnim janë: menaxhimi i projekteve, mobiliteti i studentëve, marrëdhëniet me publikun, aplikimi i sistemit dixhital në mësimdhënie, manaxhimi i qendrave të gjuhëve, qasja për studentët me nevoja të veçanta, etj..

Prof. Aida do të prezantojë praktikat e mira në Fakultetin e Gjuhës Angleze por edhe do t' i shpalosë njohuritë e reja me kolegët e tjerë në Kolegjin AAB.



DR. BUJAR RUSHITI, PJESË E KONFERENCËS "COLLOQUIUM ON GENERATIVE GRAMMAR" NË SPANJË

6 qershor 2022

Dr. Bujar Rushiti, profesor në Fakutetin e Gjuhës Angleze, në Kolegjin AAB, mori pjesë në konferencën e 31 "Colloquium on Generative Grammar", e organizuar nga Universiteti "Baleraic Islands" në Palma de Mallorca, Spanjë. Kjo konferencë organizohet çdo vit në Spanjë, Francë ose Portugali ku studiues të ndryshëm prezantojne çështjet më të fundit rreth sintaksës, semantikës dhe fonologjisë së gjuhëve të ndryshme brenda shkollës gjenerative të gjuhësisë. Tema e prof. Bujar ishte rreth rolit të nyjës së shquar në formimin dhe intepretimin e sipërorës së gjuhës shqipe.



STUDENTI I AAB-SË, GËZIM MORINA NGRITI KUPËN E KAMPIONIT TË KOSOVËS NË BASKETBOLL

6 qershor 2022

Golden Eagle Ylli ka mbrojtur titullin e kampionit të Kosovës në basketboll. Gëzim Morina, student i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, ishte ai që vendosi për triumfin e kësaj finale, duke realizuar dy gjuajtje të lira për rezultatin përfundimtar, 70:64.

Gëzimi u shqua për performancë të jashtëzakonshme gjatë ndeshjeve të Play off-it, duke qenë vendimtar në rrëmbimin e titullit.
Vlen të theksohet se Gëzimi shquhet edhe si student i dalluar në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në AAB.







SHTËPIA BOTUESE AAB PJESËMARRËSE NË PANAIRIN E LIBRIT 2022 NË PRISHTINË

7 qershor 2022

Pas dy vjetësh mungesë për shkak të pandemisë Covid-19, rikthehet Panairi i Librit në Prishtinë. Panairi i 22-të i Librit edhe zyrtarisht u hap sot dhe do të zgjasë deri më 12 qershor, në ambientet e Pallatit të Rinisë, organizuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës.

Shtëpia Botuese AAB edhe këtë vit do të jetë pjesë e Panairit, kësaj radhe me mbi 70 tituj si dhe me zbritje nga 20% deri në 30%.


AAB


F3
F5






E DREJTA
KUSHTETUESE

Në këtë panair do të marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Panairi do të jetë i hapur për vizitorë çdo ditë nga ora 9:00 deri në orën 20:00.

LULZIM TAFA NDEROHET ME TITULLIN DOKTOR HONORIS CAUSA NË UKRAINË

8 qershor 2022

Edhe pse në luftë Ukraina ka vendosur që të nderojë disa personalitete ndërkombëtare që në këto kohë të vështira po i qëndrojnë pranë në mënyra të ndryshme Ukrainës.

Instituti për Studime të Larta Historike dhe Kulturore në Kiev e ka nderuar me titullin Doktor Honoris Causa, Kryetarin e KD të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa.



Pak kohë para shpërthimit të luftës në Ukrainë, është botuar një libër me poezi të zgjedhura të Lulzim Tafës atje. Lulzim Tafa po ashtu u bë i njohur me përpjekjet kundër luftës me poezi dhe duke u shkruar letra shumë poetëve të njohur në Rusi dhe Ukrainë, me lutje që të përdorin autoritetin e tyre kundër kësaj lufte ende pa filluar ajo.

Tafa ka marr një letër të gjatë falenderuese edhe nga Akademia Kombëtare e Ukrainës ku falënderohet përpjekja e tij antiluftë. Ne ju falenderojmë që po na qëndroni pranë në këto momente dramatike por historike për vendin tonë, thuhet ndër të tjera në letrën që Akademia i ka dërguar poetit Lulzim Tafa.

E DIPLOMUARA SUZANA GUSTURANAJ, CERTIFIKOHET NË SHBA SI TRAJNERE NDËRKOMBËTARE PËR TRAJNER

8 qershor 2022

Suzana ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale të Kolegjit AAB dhe së fundi është certifikuar nga Akademia Ndërkombëtare e Trajnimeve në Colorado të SHBA-së. Në Kosovë, Suzana punon në Shërbimin Korrektues në Dubravë, duke kontribuar si zhvilluese e programeve rehabilituese.

Në Kolegjin AAB, ajo ka ndjekur studimet bachelor në Fakultetin e Shkencave Sociale ndërsa studimet e nivelit master në programin Psikologji Organizative dhe Sociale në kuadër të Fakulteti të Psikologjisë. Ndër të tjera, ajo falënderon Kolegjin AAB për të gjitha zgjedhjet e mundshme për rrugëtim sa më të suksesshëm në karrierë.



PËRFUNDON ME SUKSES JAVA E SPORTIT NË KOLEGJIN AAB

9 qershor 2022

Aktiviteti i organizuar nga Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB mblodhi pjesëmarrës të shumtë të studentëve në sporte të caktuara. Për gjashtë ditë me radhë u shënua Java e Sportit, organizim i përvitshëm për studentët sportdashës.

Ky aktivitet u nda në turnire ku morën pjesë 38 ekipe për futsall, volejboll, streetboll, dhe 20 studentë për garat e ping pongut nga të gjitha fakultetet e Kolegjit AAB.
Në finale triumfuan studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në të gjitha disiplinat.











Të gjitha turniret e sporteve të ndryshme u zhvilluan në frymë sportive dhe fairplay. Në fund u ndanë shpërblimet, mirënjohjet, kupat dhe medaljet për ekipet dhe studentët fitues.

DONJETA MURTEZAJ PJESË E RADBOUD SUMMER SCHOOL NË NIJMEGEN, HOLANDË, NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+

9 qershor 2022

Koordinatorja e cilësisë të Fakultetit të Psikologjisë, Donjeta Murtezaj do të jetë pjesë e Shkollës Verore "Radboud Summer School" projekt i financuar nga programI i Bashkimit Europian, Erasmus+. Fusha e ekspertizës do të jetë nga fusha e metodologjisë shkencore e avancuar. Në këtë mes do të prezantohen trendët më të fundit të aplikacionit softuerik R dhe Rstudio për analiza përshkruese, parashikuese dhe shkakore të të dhënave sasiore. Vlen te ceket se ky mjet softuerik është gjithnjë më i miratuar për vizualizime të rezultateve të kërkimit me shumë variacione.



Pjesëmarrja në këtë projekt është mundësuar si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit AAB dhe Universitetit Radboud në Holandë.

STUDENTËT E FAKULTETI JURIDIK TË KAMPUSIT TË AAB NË FERIZAJ VIZITUAN GJYKATËN THEMELORE

9 qershor 2022

Në objektin e Gjykatës Themelore të Ferizajt në bashkëpunim me organizatën USAID, u zhvillua ligjëratë me studentët e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB. Aty studentët patën mundësi të njoftoheshin me kryetarin e kësaj gjykate z. Mustafë Tahiri dhe të ndiqnin nga afër rregullat dhe procedurat e një rasti gjyqësor.







Kjo ligjëratë kishtë të bëjë me qasjen në gjykatë, shërbimet dhe praktikat që ofrohen për studentët tanë. I pranishëm ishte edhe Drejtori i Kampusit të Kolegjit AAB në Ferizaj prof. dr. Shaip Bytyqi, i cili inkurajoi studentët për praktikë dhe avancim të mëtutjeshëm në fushën e drejtësisë.

AIDA THAQI E FTUAR NË RADBOUD SUMMER SCHOOL NË NIJMEGEN, HOLANDË, NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+

9 qershor 2022

Kordinatorja për sigurimin e cilësisë dhe asistentja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, MA. Aida Thaqi, do të marrë pjesë në Radboud Summer School në Nijmegen, Holandë, në kuadër të partneritetit mes Kolegjit AAB, Radboud University dhe Erasmus +.

Ajo ka përzgjedhur kursin "Trends in the Cognitive Neuroscience of Language". Qëllimi i këtij kursi është të hapë një dritare në studimin neuroshkencor të gjuhës, duke testuar teori dhe pikëpamje të ndryshme mbi mekanizmat e trurit që mbështesin prodhimin dhe të kuptuarit e gjuhës për qëllime komunikimi



Një trajnim i tillë është i rëndësishëm sepse arritja e një kuptimi më të thellë se si truri mbështet gjuhën dhe komunikimin, rrit aftësitë dhe ndihmon në zhvillimin si mësimdhënëse e gjuhës por edhe hap rrugë për studime të mëtutjeshme.

NIS SUKSESSHËM SHKOLLA PËRGATITORE PËR TESTIN E MATURËS 2021/22, ORGANIZUAR NGA KOLEGJI AAB

10 qershor 2022

Mijëra maturantë nga e gjithë Kosova, edhe sivjet e nisën rrugëtimin e tyre në Shkollën Përgatitore të Testit të Maturës të organizuar nga Kolegji AAB, që ka për qëllim përgatitjen e tyre sa më të mirë për Testin Kombëtar të Maturës, e që pritet të mbahet gjatë muajit qershor.








Kurset ofrohen falas, ndërsa edhe maturantët të cilët mund të kenë qenë të painformuar deri tani, mund të bëhen pjesë e grupit.

Në hapje të programit të sivjetmë të Shkollës Përgatitore për Testin e Maturës, mësimdhënësit e angazhuar në këtë projekt, të përzgjedhur nga më të mirët e shkollave të mesme të Kosovës, njoftuan maturantët me programin që do të realizohet gjatë periudhës së zhvillimit të kurseve përgatitore. Ligjëratat përgatitore për test të maturës vazhdojnë prej 12 qershorit deri më 17 qershor, nga ora 09:00.

SPEC. DR. DONIKA ILIJAZI SHAHIQI, E FTUAR NË RADBOUD SUMMER SCHOOL NË NIJMEGEN, HOLANDË, NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS +

10 qershor 2022

Ligjëruesja në Fakultetin e Stomatologjisë të Kolegjit AAB, Dr. Donika Ilijazi Shahiqi do të marrë pjesë në shkollën verore në Radboud Summer School ku do të ndjekë kurset rreth metodave të hulumtimit social, në veçanti për anketa dhe hartim të pyetësorëve.

Ky projekt është i financuar nga Erasmus +, program i Bashkimit Evropian në bashkëpunim me Kolegjin AAB dhe Universitetin Radboud në Holandë.

Njohuritë e fituara nga ky trajnim do të ndihmojnë në përmirësimin e hulumtimeve sociale dhe shkencore në Kolegjin AAB.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES KOLEGJIT AAB DHE UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

11 qershor 2022

Në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit me universitete ndërkombëtare dhe vendore, Kolegji AAB së fundi ka nënshkruar marrëveshje me Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës.

Me anë të kësaj marrëveshjeje do të zbatohet intensifikim i bashkëpunimit mes palëve në fushën arsimore, shkencore dhe profesionale që përfshinë të gjitha programet e studimit të organizuara nga palët nënshkruese.

Marrëveshja u nënshkrua nga Prof.Dr. Suzana Golemi, Rektore e Universitetit të Shkodrës dhe Prof.Asoc.Dr. Shemsedin Vehapi, zv. Rektor i Kolegjit AAB. Ndër të tjera ky bashkëpunim synon zhvillimin e institucioneve duke shkëmbyer staf akademik apo administrativ, shkëmbimin e studentëve për cikle të ndryshme të studimit, publikime të përbashkëta në kërkim shkencor, etj..





FSHK BASHKOORGANIZATOR I KONFERENCËS ICIBT

11 qershor 2022

Është mbajtur në Tiranë konferenca e parë ndërkombëtare për Inovacion në Biznes dhe Teknologji, në të cilën Kolegji AAB ishte bashkëorganizator së bashku me Kolegjin Universitar Bedër të Tiranës. Në këtë konferencë morën pjesë profesorët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike Jusuf Qarkaxhija, Rahmil Limani dhe Xhevdet Spahiu. Dekani i Fakultetit Jusuf Qarkaxhija ishte në cilësinë e keynote speaker dhe prezantoi temën "Siguria e të dhënave dhe sfidat e privatësisë".





Falë marrëveshjes së Kolegjit AAB me Kolegjin Universitar Bedër, ky është hapi i parë i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve e që do të pasohet me forma tjera të bashkëpunimit.

U ZHVILLUA KONFERENCA STUDENTORE SHKENCORE E KOMUNIKIMEVE MEDIALE

13 qershor 2022

Fakulteti i Komunikimit Masiv i Kolegjit AAB organizoi Konferencën Studentore Shkencore "Komunikimi dhe Informacioni në Epokën e Mediave Sociale dhe Fake News", me qëllim të zgjerimit të njohurive, për të ngritur debat dhe për të krahasuar këto njohuri nga perspektiva të ndryshme akademike.

Konferenca u hap nga dekani i Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, Hasan Saliu, i cili u dëshiroi mirëseardhje pjesëmarrësve dhe përshëndeti këtë organizim të përvitshëm në kuadër të fakultetit përkatës. Hulumtimet shkencore trajtuan tema të ndryshme të shoqërisë, disa prej tyre ishin: "Imazhi i Shqipërisë gjatë pandemisë COVID-19, rasti i dërgimit të mjekëve dhe infermierëve në Itali", "Imazhi ndërkombëtar i Kosovës nëpërmjet raportimit të mediave ndërkombëtare për zgjedhjen e presidentes Osmani", "Lajmet e rreme gjatë periudhës së pandemisë në mediat sociale të Kosovës", etj.









Kontribut me punimet e tyre shkencore në konferencë kanë dhënë studentët nga Kosova dhe Shqipëria. Studentët pjesëmarrës potencuan se kjo konferencë është një mundësi mjaft e mirë për të prezantuar kërkimet e tyre dhe për të krijuar miq të rinj.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES FGH DHE 'V&T CONSULTING'

13 qershor 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB i jep një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me partnerë, të cilët janë burim potencial për punë praktike për studentët aktualë dhe për punësime për të diplomuarit e këtij fakulteti. Në këtë kuadër, Fakulteti i Gjuhës Angleze, dega Gjakovë, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 'V&T Consulting' SH.P.K, një kompani e cila është e specilatizuar në telemarketing ndërkombëtar dhe operon në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera.





Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i kësaj dege, z. Rifat Haxhija dhe drejtori i kompanisë, z. Besnik Berisha. Ky bashkëpunim do të zgjerohet edhe më tej duke patur parasysh se kompania është duke u zgjeruar edhe më shumë me klientë ndërkombëtarë.

KLUBI I DEBATIT TË STUDENTËVE TË FAP ZHVILLOI VIZITË NË ZYRËN LIGJORE TË KRYEMINISTRISË

14 qershor 2022

Studentët e Klubit të Debatit nga Fakulteti i Administratës Publike të Kolegjit AAB, u mirëpritën në Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Aktiviteti përfshiu një seancë debati me drejtorin e kësaj zyre, z. Mentor Borovci, gjatë së cilës studentët patën mundësi të njoftohen nga afër me punën e kësaj zyre dhe në mënyrë të veçantë u njoftuan për mënyrën dhe procesin e hartimit të ligjeve në Republikën e Kosovës, në përputhshmëri të plotë me standardet dhe normat e Bashkimit Evropian.







Klubi i Debatit funksionon në kuadër të Fakultetit të Administratës Publike dhe afron studentët me përvojën dhe praktikën në institucione të ndryshme të vendit.

NIS PROJEKTI STUDENTOR "BËHU NJË MIK, JO NJË BULLIZUES"

14 qershor 2022

Me qëllim të fuqizimit të rolit të studentëve, rritjes së aktiviteteve jashtë kurrikulare si dhe pasurimit të jetës studentore, Kolegji AAB ofron mbështetje financiare për studentët përmes granteve për projekte. Në një garë të ngushtë mes projekteve studentore, fitues doli të jetë projekti i studentëve të vitit të tretë në Fakultetin e Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB. Projekti studentor "Bëhu një mik, jo një bullizues" është projekt i financuar nga Kolegji AAB dhe është në implementim e sipër nga studentët e nivelit bachelor të Fakultetit të Gjuhës Angleze.



Projekti me titull "Bëhu një mik, jo një bullizues" është implementuar nga koordinatorja e projektit Artiola Kajtazi dhe studentët: Erleta Morina, Njomzë Hajrizi, Valdete Menxhiqi dhe Leart Halili. Projekti ka për qëllim të rrisë vetëdijen e studentëve rreth bullizmit si fenomen, me theks të veçantë brenda institucioneve arsimore. Objektivat e projektit janë informimi i studentëve rreth pasojave, masave parandaluese dhe ballafaqimit me bullizëm si dhe të inkurajojë studentët të ndajnë historitë e tyre personale, me shpresë që kjo do t' i vetëdijesojë studentët tjerë rreth pasojave të këtij fenomeni.

Diskutimet me panelistë do të mbahen më 18 dhe 22 qershor, derisa do të marrin pjesë studentë, psikologë dhe ata që ranë pre e bullizmit në shoqëri qoftë edhe ndërkombëtarisht.

SHKËLQIM MIFTARI, I FTUAR NË RADBOUD UNIVERSITY TË HOLANDËS, NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+

15 qershor 2022

Mësimdhënësi i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, Shkëlqim Miftari është ftuar në Shkollën Verore Radboud Summer School, e cila do mbahet këtë vit akademik në Radboud University, Nijmegen, Holandë, në kuadër të programit ERASMUS +. Me pjesëmarrjen në Radboud Summer School ai do përfitojë njohuri shtesë lidhur me njerën nga fushat e Inteligjencës Artificiale, përmes së cilës është e mundur që softuerët e ndryshëm të bëhen më të saktë në parashikimin e rezultateve në përdorimin e të dhënave dhe algoritmeve ashtu që të imitohet të mësuarit njerëzor.

Ky projekt është i financuar nga Erasmus +, program i Bashkimit Evropian në bashkëpunim me Kolegjin AAB dhe Universitetin Radboud në Holandë. Njohuritë e fituara nga ky trajnim do të ndihmojnë në implementimin e algoritmeve të kësaj teknologjie në sistemet e ndryshme të Kolegjit AAB.



KOLEGJIT AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "VIP KIDS"

16 qershor 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, së fundi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "VIP Kids" duke përshtatur interesat e përbashkëta për zhvillimin e pjesës praktike të studentëve të këtij fakulteti.



Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti Prof. Hysen Kasumi dhe drejtoresha e institucionit znj. Jehona Mjeku, ndërsa ky bashkëpunim ndër të tjera premton avancim të studentëve në praktikën e tyre përgjatë studimeve.

MIJËRA MATURANTË PËRFUNDUAN SHKOLLËN PËRGATITORE TË MATURËS NË AAB

17 qershor 2022

Me një pjesëmarrje rekorde në të tre kampuset e Kolegjit AAB në Prishtinë, Ferizaj e Gjakovë, maturantë nga të gjitha komunat e Kosovës, përfituan nga kjo mundësi duke bërë përsëritje të materialit mësimor të të gjitha viteve të shkollimit të mesëm, me çka edhe do të sfidohen në testin e matures.









Dhjetëra arsimtarë nga më të mirët e shkollave të mesme shprehin besimin se të gjithë vijuesit e këtyre kurseve do t' ia dalin me sukses të përfundojnë testin e maturës. Ndërsa, të lumtur dhe plot entuziazëm maturantët nuk hezitojnë të shprehin edhe gëzimin e tyre që në tetor do të rikthehen sërish në Kolegjin AAB për të nisur vitin akademik si studentë.

KOLEGJI AAB PËRMBYLL PROJEKTIN SHKENCOR TË FINANCUAR NGA MASHT: "FËMIJËT ONLINE NË KOSOVË"

17 qershor 2022

Rreth 92% e nxënësve kosovarë të moshës 11-16 vjeç kohën më të madhe në internet e kalojnë duke parë videoklipe në Youtube apo duke dëgjuar muzikë; fëmijët kosovarë kanë më shumë smartphonë se fëmijët zviceranë; materiale me përmbajtje seksuale në internet konsumojmë dyfish më pak se bashkëmoshatarët e tyre serbë, ndërsa 21% e fëmijëve kosovarë janë takuar fizikisht me njerëzit që janë njohur në internet, që është dyfish më e lartë se mesatarja e fëmijëve europianë.

Këto janë disa nga gjetjet e një studimi të sapopublikuar, i realizuar nga një grup studiuesish të komunikimeve, shkencave sociale dhe psikologjisë nga Kolegji AAB në bashkëpunim me ekspertë nga Universiteti i Peruxhas (Itali) dhe i financuar nga Ministria e Arsimit.

Studimi ka përfshirë 437 nxënës të moshës 11-16 vjeç nga 34 shkolla të Kosovës në qytete dhe në fshatra dhe ka përdorur pyetësorin e projektit shkencor europian "Kids Online".

Studimi i ndan gjetjet në tri grupime: përdorimi apo eksperiencat e nxënësve online, rreziqet dhe kontrolli prindëror. Sipas rezultateve të këtij studimi, fëmijët kosovarë janë përdorues të mëdhenj të internetit: 97% e fëmijëve e përdorin internetin 1-6 orë në ditë, ndërsa atë e përdorin kryesisht për argëtim, komunikim me miqtë dhe më pas për mësim. Koha që kalojnë fëmijët kosovarë online nuk dallon shumë nga koha që kalojnë online fëmijët e vendeve të BE-së, thuhet në studim. Interneti përdoret gjithashtu për njohje të reja. Rreth 19% e kanë takuar fizikisht personin që e kanë njohur në internet, ndërsa mesatarja e këtyre takimeve të fëmijëve europianë është vetëm 9%.

Ngacmimi online gjatë 12 muajve të fundit	Mashkull %	Femër %	Total %
Ata më dërguan mesazhe fyese ose të dëmshme në internet (fjalë, fotografi ose video)	25.88	23.75	24.82
Në internet janë përhapur mesazhe fyese ose të dëmshme për mua (fjalë, foto, video)	5.58	6.25	5.92
Më lanë jashtë gjatë një aktiviteti grupor në internet	5.58	6.66	6.12
Unë u kërcënova në internet	3.08	2.96	3.02
Gjëra të tjera fyese ose të dëmshme	10.15	9.58	9.86
Diçka tjetër	17.76	27.9	22.83
Preferoj të mos them	31,97	22.9	27.43

Burimi: shtjellimi nga anketimi.

Mbi 20% e kësaj grup-moshe konsumojnë produkte online me përmbajtje seksuale çdo javë, si foto, vizatime ose video me imazhe seksuale. Nga këta, 7.8% thanë se i shihnin këto imazhe çdo ditë ose pothuajse çdo ditë dhe 13.7% i shihnin ato një ose dy herë në javë.

Bullizmi online është një shqetësim tjetër dhe i pranishëm te kjo grup-moshë. Rreth 25% deklaruan se gjatë muajve të fundit dikush kishte vepruar në mënyrë të dëmshme ose fyese në internet, ndërsa rreth 6% pranuan se grupi i ka përjashtuar nga aktivitetet dhe komunikimet.

Në studim gjithashtu theksohet se shumica e nxënësve dhe prindërve të anketuar kanë pranuar se fëmijët e njohin më mirë teknologjinë dhe se prindërit e kanë të pamundur t' i kontrollojnë fëmijët e tyre se çfarë produktesh mediatike konsumojnë ata në internet. Studimi vlerëson se ndërmjetësimi prindëror dhe edukimi mediatik deri më tani kanë vepruar ndaras dhe për këtë arsye ndërlidhja dhe ndërveprimi më i mirë midis prindërve si edukatorë mediatikë për fëmijët dhe edukimi mediatik në shkollë do të ishte më efektiv.

Studimi është realizuar duke u mbështetur në projektin shkencor të BE-së të realizuar tashmë që disa vjet në vendet europiane i njohur si "Kids Online" dhe i drejtuar nga Sonia Livingstone e London School of Economics. Në dallim prej disa vendeve të rajonit, Kosova asnjëherë nuk është përfshirë në këtë projekt europian dhe studimi i realizuar nga Kolegji AAB i mbështetur nga MASh është i vetmi studim i kësaj natyre i realizuar në Kosovë.



Studimi është realizuar nga profesorët e AAB-së, Hasan Saliu e Zija Rexhepi nga Fakulteti i Komunikimeve, Saranda Shatri nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Mimoza Kamberi nga Fakulteti i Psikologjisë, ndërsa konsultant i jashtëm ka qenë prof. Rolando Marini nga Universiteti i Peruxhas (Itali). Punimi i plotë mund të lexohet në revistën Journal of Elementary Education, e indeksuar në Scopus.

NISIN AKTIVITETET E PROJEKTIT VETËDIJËSUES TË STUDENTËVE "BËHU NJË MIK, JO NJË BULLIZUES"

21 qershor 2022

U mbajt paneli i diskutimit në kuadër të projektit studentor "Bëhu një mik, jo një bullizues". Me organizimin e panelit dhe aktiviteteve në kuadër të këtij projekti u morën studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, në krye me koordinatoren Artiola Kajtazi dhe pjesëmarrësve Erleta Morina, Njomzë Hajrizi, Valdete Menxhiqi, Leart Halili.

Pjesë e diskutimit ishin Arjeta Ukelli-Gashi, psikologe dhe psikoterapeute nga Qendra për Shërime Humane dhe Zhvillim; Ardijan Krasniqi, aktivist i të drejtave të komuniteteve dhe lider i grupit joformal United Towards Arts; dhe Leart Halili, aktivist i të drejtave të njeriut.

Ky panel kishte moton "Ndaje storjen tënde", një iniciativë për fuqizimin e viktimave të bullizmit përmes ndarjes së eksperiencave. Në këtë takim u diskutua fenomeni i bullzimit brenda dhe jashtë institucioneve arsimore, pasojat që le ky fenomen si dhe masat që duhen të ndërmerren në mënyrë që të reduktojmë e parandalojmë atë.

Takimi i radhës do të organizohet nesër në Qendrën Mediale të Kolegjit AAB nga ora 12:00.








PROGRAMI PËR KARRIERË DHE PUNËSIM I KOLEGJIT AAB SHËNON 4 VJETORIN E THEMELIMIT

21 qershor 2022

Programi për Karrierë dhe Punësim sot shënon 4 vjetorin e themelimit të tij. Për katër vjet radhazi ky program është bërë adresa e duhur për studentët e Infermierisë të cilët synojnë që profesionin e tyre ta ushtrojnë në Gjermani dhe të zhvillojnë edhe më tutje elanin e tyre profesional.

Zyra e Programit për Karrierë dhe Punësim është themeluar me 21 Qershor të vitit 2018, si projekt bashkëpunimi në mes të Kolegjit AAB, klinikave më të mëdha në Gjermani si dhe Institucionit për aftësim të gjuhës gjermane LINGUA.








Programi për Karrierë dhe Punësim tashmë është kthyer në sinonim të mundësisë dhe një shansi jetësor për studentët e Infermierisë në Kolegjin AAB. Programi si i tillë që nga themelimi e tutje, ofron mundësinë e përgatitjes së gjuhës gjermane pa pagesë për studentët e Infermierisë, ofron një kontratë pune në klinika presitigjioze gjermane që janë partnerë të Programit tonë, barasvlerësimin e titullit akademik nga shteti gjerman, kompletimin dhe përkthimin e gjithë dokumentacionit në gjuhën gjermane dhe mbështetje në procedurat e aplikimit në ambasadën gjermane në Prishtinë për vizë të punës. Ndër të tjera, zyra e Programit ofron orë shtesë në fushën e infermierisë dhe me profesionistë shëndetësorë të ardhur nga Gjermania, për provim të licencës në Gjermani për të gjithë studentët e Programit.

Përgjatë punës katërvjeqare, Dekanati i Fakultetit të Infermierisë në Kolegjin AAB në bashkëpunim të ngushtë me partnerët gjerman dhe Lingua-në, kanë hartuar një planprogram të ri për studentët e Fakultetit të Infermierisë, respektivisht për studentë e programit tonë. Në planprogram janë adaptuar lëndë dhe praktika të nevojshme për parapërgatitje sa më të mirë të studentëve, për t' iu përgjigjur cilësisë së punës dhe profesionalizmit të kërkuar në tregun gjerman.

STUDENTËT E KLUBIT TË EKONOMISTËVE TË RINJ ORGANIZOJNË SHËTITJE NË RUGOVË

22 qershor 2022

Në përmbyllje të aktiviteteve të realizuara për vitin akademik 2021/2022, studentët e Klubit të Ekonomistëve të Rinj organizuan shëtitje në Parkun Nacional të Rugovës. Qëllimi i këtij organizimi ishte përmbyllja me sukses aktivitetet e Klubit të Ekonomistëve të Rinj të organizuar në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit Ekonomik, tha Andi Vehapi, kryetar i Klubit. Ai falënderoi të gjithë anëtarët e Klubit, profesorët e Fakultetit Ekonomik dhe menaxhmentin e Kolegjit AAB të cilët mbështetën realizimin e të gjitha aktiviteteve të organizuara nga Klubi.





Klubi i Ekonomistëve të Rinj për vitin akademik 2021/2022 gjithsej ka realizuar rreth 35 aktivitete studentore në kuadër të Fakultetit Ekonomik.

NË SHËNIM TË DITËS OLIMPIKE NDËRKOMBËTARE, STUDENTËT E AAB-SË U NGJITËN NË MALET E SHARRIT

23 qershor 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB ka shënuar 23 Qershorin, Ditën Olimpike Ndërkombëtare, duke u ngjitur në Malet e Sharrit. Destinacioni i shtegut nëpër të cilin kaluan ishin Malet e Sharrit dhe Liqeni i Jazhincës, liqen ky me një lartësi mbidetare prej 2180m, ku ngjitja në këtë terren llogaritet mesatarisht e vështirë. Shtegu ishte i gjatë 16 km dhe ecja zgjati gjithsej 6 orë. Studentët shijuan pamjet e maleve të dendura, natyrën, ujëvaret, etj..

Në ekspeditën e organizuar me këtë rast, e që për Kolegjin AAB tashmë ka kaluar në traditë të përvitshme, morën pjesë profesorë dhe studentë të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit. Këtë vit ky aktivitet u mbështet edhe nga Komiteti Olimpik i Kosovës.






Shënimi i Ditës Olimpike Ndërkombëtare me ngjitje në Malet e Sharrit ishte edhe një paralajmërim për sfidën dhe ekspeditën e radhës, sepse në muajin korrik studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit do të përshkojnë majën më të lartë në Alpet Shqiptare, Majën e Gjeravicës me lartësi mbidetare 2,656 metra.

PROFESORI I AAB-së, FATMIR RAMADANI, MBAJTI LIGJËRATË NË UNIVERSITETIN E GRAZ TË AUSTRISË

24 qershor 2022

Profesori i Fakultetit të Gjuhës Angleze, Dr. Fatmir Ramadani, me ftesë të CIAS (Qendrës për Studime Inter – Amerikane), ishte pjesë e simpoziumit interdisiplinar të Universitetit të Gracit në Austri. Ai prezantoi temën "Stories of Female Travelers Edith Durham and Rose Wilder Lane".





Tema e tij kishte të bënte me dy udhëtare, njëra nga Britania dhe tjetra nga Amerika, të cilat e vizituan dhe eksploruan Shqipërinë dhe Kosovën gjatë dy dekadave të para të shekullit XX. Ato lanë pas dëshmi të këtyre vizitave me shkrimin e librave të ndryshëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, strukturën e tyre shoqërore, jetën, kulturën, traditat dhe zakonet.

Në fund të ligjëratës, Ramadani u certifikua nga ky universitet për temën dhe pjesëmarrjen në këtë simpozium.

FTOHEN STUDENTËT E KOLEGJIT AAB PËR PJESËMARRJE NË SHKOLLËN VERORE NË LILLE TË FRANCËS

24 qershor 2022

Universiteti Lille në Francë është duke organizuar shkollën verore nga data 4 deri me 12 korrik dhe për pjesëmarrje ka ftuar edhe studentët e Kolegjit AAB. Studentët pjesëmarrës do të kenë akomodimin, drekën dhe shkollën falas, derisa kusht është njohja e gjuhës frënge.

Studentët e interesuar mund të aplikojnë përmes email-it: offres.lille.2022@univ-lille



KOLEGJI AAB BASHKËORGANIZATOR I KONGRESIT TË XV-TË EUROPIAN "PËRFUNDIMI I PANDEMISË DHE EMERGJENCAT PAS SAJ"

25 qershor 2022

Sot, ka zhvilluar punimet Kongresi i XV-të europian mbi rolin e pandemisë dhe efekteve pas saj në spektrin mjekësor. Gjatë ditës u mbajtën dy panele me doktorë dhe specialistë të mjekësisë, derisa bashkëorganizator i kongresit ishte edhe Kolegji AAB.








Hapjen e kongresit e bëri dekani i Fakultetit të Stomatologjisë të Kolegjit AAB, Prof. Dr. Astrit Kuçi i cili u uroi mirëseardhje pjesëmarrësve dhe u shpreh i lumtur që Kolegji AAB është partner në këtë konferencë bashkë me përfaqësues të tjerë nga fusha e mjekësisë. Konferenca ishte e ndarë në dy panele, që përbëheshin nga doktorë, specialistë, pedagogë social, psikiatër, etj..

Kolegji AAB po vazhdon të dëshmojë se gëzon partneritet të ngushtë me institucione vendore dhe ndërkombëtare në fushën e mjekësisë.

PROFESORI I KOLEGJIT AAB, AGRON MUSTAFA, VIZITË NË HARVARD BUSINESS SCHOOL

27 qershor 2022

Profesori i AAB-së, Agron Mustafa ka qëndruar për vizitë dy ditore në Harvard Business School, si alumni i këtij institucioni prestigjioz. Arsyeja e vizitës ka qenë ri-bashkimi dhe zgjerimi i rrjetit me kolegët me të vetmin qëllim të socializimit të të gjithë atyre që kanë studiuar në Shkollën e Biznesit të Harvardit.









Gjatë këtij eventi janë organizuar 25 aktivitete të ndryshme edukative, profesionale dhe shoqërore për të gjithë të pranishmit në kampusin e HBS. Prof. Mustafa u shpreh se përvoja nga pjesëmarrja në aktivitete të tilla është e veçantë për shkak të diversitetit të lartë të të pranishmëve duke krijuar kështu iniciativa të reja të bashkëpunimit me institucione të tjera ndërkombëtare të arsimit të lartë, pjesëmarrëse në këto aktivitete.

U MBAJT ME SUKSES KONFERENCA E DYTË SHKENCORE ALUMNI 2022 PËR GJUHËSI, LETËRSI DHE DIDAKTIKË

27 qershor 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB mbajti Konferencën e Dytë Shkencore Alumni 2022 për Gjuhësi, Letërsi dhe Didaktikë.











Në këtë Konferencë u mbulua një gamë e gjerë temash duke përfshirë gjuhësinë, studimet e përkthimit, metodologjitë e mësimdhënies, përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme arsimore dhe profesionale, etj. Veçanërisht u vlerësuan hulumtimet ku analiza e gjuhës angleze vendoset në fokus të këndvështrimeve të ndryshme investigative.

Në fjalën e saj përshëndetëse, dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Aida Alla shprehu vlerësimin e saj për pjesëmarrësit si edhe falënderoi ish-mentorët për bashkëpunimin e ngushtë me kandidatët e tyre.

Konferenca mirëpriti mbi 30 hulumtues të cilët dhanë prezantimet e tyre në gjuhën angleze dhe shqipe. Profesorët e Kolegjit AAB gjithashtu morën pjesë në diskutime, duke parashtruar pyetje dhe duke dhënë komente në mënyrë të vazhdueshme. Konferenca rezultoi e suksesshme dhe pjesëmarrësve iu ndanë certifikata nga mentorët e tyre respektivë.

KOLEGJI AAB TRIUMFON NË GARAT E ORGANIZUARA NGA FEDERATA E SPORTEVE UNIVERSITARE E KOSOVËS

28 qershor 2022

Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike të Kolegjit AAB u dalluan me sukseset e arritura në Ligat Universitare. Garat u organizuan nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës, e ku morën pjesë studentë nga universitetet publike dhe private të Kosovës.
Studentët e Kolegjit AAB ngadhënjyen në disiplinën e ping pongut, duke zënë vendin e parë në kategorinë e meshkujve, si dhe u shpërblyen me vendin e katërt në futsall. Me këtë rast ekipet fituese u shpërblyen me kupa, mirënjohje dhe medalje.

Në ceremoninë e organizuar nga dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB, z. Fatmir Pireva, uroi studentët fitues dhe falënderoi FSUNK-në për organizimin e këtyre aktiviteteve sportive për studentët.













FSHK NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME KOMPANINË POLYMATH LABS

28 qershor 2022

Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi mes Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB dhe Polymath Labs. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti, Jusuf Qarkaxhija dhe drejtori menaxhues i Polymath Labs, Muharrem Shefkiu.





Me anë të këtij memorandumi synohet përcaktimi i fushave të bashkëpunimit, siç janë realizimi i punës praktike të studentëve dhe punësimi i tyre, shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave, pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të përbashkëta, promovimi i nismave të përbashkëta profesionale dhe akademike, etj..

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke dhe do t' i ofrojnë njëra tjetrës ndihmën e duhur gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.

3500 TITUJ TË RI LIBRASH DHURATË NGA MIQTË FRANKOFONË PËR KOLEGJIN AAB

29 qershor 2022

Deputeti nga kantoni i Gjenevës z. Eric Leyvraz, i cili për dy mandate ka qenë edhe President i Parlamentit të Gjenevës dhuroi 3500 tituj librash në gjuhën frënge, të cilët libra ai i ka mbledhur nga bibliotekat personale të shkrimtarëve, artistëve, shkencëtarëve e studiuesve frankofonë.
Shumica e këtyre librave do të jenë në bibliotekën e Kolegjit AAB, kurse një pjesë të tyre edhe në këndin e frakofonisë i cili është i vendosur në ambientet e kampusit në Prishtinë. Librat do të jenë në përdorim të lirë për gjithë komunitetin frankofon të vendit tonë.






Me këtë rast, kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, ndau mirënjohje për mysafirin Leyvraz në shenjë falënderimi për fondin e dhuruar të bibliotekës personale, për pasurimin e Bibliotekës Universitare të Kolegjit AAB. Pjesë e këtij takimi ishte edhe z. Tahir Shabani, Ambasador për Paqen Botërore.

LIGJËRUESJA HANA ZEQA ËSHTË FTUAR NGA BUNKA FASHION COLLEGE NË TOKIO TË JAPONISË

30 qershor 2022

Ligjëruesja në departamentin e dizajnit të modës në Fakultetin e Arteve të Kolegjit AAB, Hana Zeqa është dizajnere dhe themeluese e studios së kostumeve 'Fight or Flight'. Ajo ligjëron lëndën "Histori e Kostumeve dhe Modës", ndërsa së fundmi është ftuar nga Bunka Fashion College në Tokio të Japonisë, për një seminar i cili ka të bëjë me teknologjinë dhe të ardhmen e modës.



Ajo ka diplomuar në London College of Fashion për dizajn të kostumeve për performancë, ku ka hulumtuar për teknologjinë në veshje. Puna e saj me "Fight or Flight" është shfaqur në festivalin Ars Electronica, Kostumet e shekullit XXI në Moskë, Teatri Sadlers Wells në Londër, Oxo Tower në Londër, H&M starting house Berlin, etj..

KOLEGJI AAB BASHKËORGANIZATOR I KONFERENCËS VJETORE TË AKADEMISË SË BALLKANIT PËR SHKENCA FORENZIKE (BAFS)

30 qershor 2022

Objektivat e shkencave forenzike në përgjithësi bazohen në ndërtimin e platformave dhe standardeve unike globale drejt inovacionit, dokumentimit dhe interpretimit të fakteve kriminalistike në shërbim të institucioneve të drejtësisë. Kjo konferencë e Akademisë së Ballkanit për Shkenca Forenzike e cila do të mbahet me 27 dhe 28 tetor në Kolegjin AAB do të mbledhë shkencëtarë të shkencave forenzike, patologë forenzikë, hetues forenzikë, infermierë forenzikë dhe studiues në shkencat forenzike me qëllim rritjen e nivelit të shërbimeve tona përmes prezentimeve të ndryshme shkencore në fusha të ndryshme të disiplinës.



Në konferencë do të marrin pjesë ekspertë me renome botërore në fushën e shkencave forenzike, përfshirë prof. Duarte Nuno Vieires, Kryetar i Bordit Këshillimor Shkencor të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Folës kryesor është gjithashtu Dr. John Clark, i cili ka qenë patologu kryesor në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë pas krimeve në Bosnjë dhe Kroaci si dhe pastaj në Kosovë. Pjesëmarrjen e tyre si folës kryesorë e kanë konfirmuar edhe Prof. dr. Jason Payne, autor i shumë librash universitarë mbi studime forenzike, dhe Dr. Isabel Riege, e cila është udhëheqëse e DVI ekipit të Interpolit.

Në veçanti, studentët dhe studiuesit e rinj inkurajohen të marrin pjesë nga fusha të ndryshme të shkencave forenzike si patologjia forenzike, antropologjia, arkeologjia, odontologjia, duke përfshirë fushat e së drejtës, kriminalistikës, sigurisë, avokatisë, sistemeve gjyqësore dhe të prokurorisë, për të cilët shkencat forenzike ofrojnë shërbimet e tyre profesionale dhe shkencore. Për më shumë informacione dhe për të dërguar abstraktin, ju mund të klikoni në këtë link: https://www.balkanacademy.org/abstract-submission

KAMPUSI I KOLEGJIT AAB NË FERIZAJ PROMOVON PROGRAMET E VETA NË PANAIRIN E ORGANIZUAR NGA KOMUNA

30 qershor 2022

Përfaqësuesit e Kolegjit AAB, nga kampusi i Ferizajit ishin pjesë e Panairit të Punës në edicionin e katërt që u orgnaizua në saje të bashkëpunimit me komunën, me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës dhe Qeverinë Gjermane.







Në shtandin e AAB-së, u paraqitën numër i madh i maturantëve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme dhe ishin të interesuar për programet që ofrohen në Kolegjin AAB në Ferizaj, si dhe plotësuan aplikacionet për ndjekjen e studimeve në këtë kampus.

Qëllimi i pjesëmarrjes në këto aktivitete është afërsia me të gjithë ata që duan të informohen detajisht me veprimtarinë dhe kushtet që ofrojnë institucionet arsimore, bizneset, etj.

KORRIK 2022

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES PRITI NË TAKIM STUDENTËT PJESËMARRËS NË GARAT E LIGËS UNIVERSITARE

1 korrik 2022

Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike të Kolegjit AAB u dalluan me sukseset e arritura në Ligat Universitare, organizuar nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës ku morën pjesë studentë nga universitetet publike dhe private të vendit.





Me këtë rast Kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, organizoni një pritje ceremoniale për ta, ku tha që ndihet shumë krenar me suksesin e arritur të studentëve tanë dhe u premtoi përkrahje të vazhdueshme studentëve dhe profesorëve të cilët kanë dhënë kontribut për arritjen e këtij rezultati. Ndërsa, Prorektori për çështje mësimore në AAB, Shemsedin Vehapi gjithashtu i uroi studentët për rezultatin e arritur dhe njëkohësisht tha se kjo është një përvojë e jashtëzakonshme sepse në të ardhmen do të jenë ata të cilët do organizojnë aktivitete të ndryshme sportive. Edhe Dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Fatmir Pireva i përshëndeti studentët dhe profesorët të cilët kanë dhënë kontribut lidhur me pjesëmarrjen në këto gara dhe u shpreh inkurajues që në të ardhmen marrë parasysh kapacitetet rezultati do të jetë i garantuar.









KOLEGJI AAB PROMOVON PROGRAMET STUDIMORE NË PANAIRIN E PUNËS NË GJAKOVË

1 korrik 2022

Përfaqësuesit e Kolegjit AAB, nga kampusi i Gjakovës ishin pjesë e Panairit të Punës të organizuar në saje të bashkëpunimit me komunën, me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës dhe Qeverinë Gjermane.

Në shtandin e Kolegjit AAB, janë paraqitur numër i madh i maturantëve që shprehën interesim për programet studimore që ofrohen në degën e Kolegjit AAB në Gjakovë duke plotësuar aplikacione për ndjekjen e studimeve në këtë kampus.





Qëllimi i pjesëmarrjes në këto aktivitete është afërsia me të gjithë ata që duan të informohen detajisht me veprimtarinë dhe kushtet që ofrojnë institucionet arsimore, bizneset, etj.

STUDENTËT E GJUHËS ANGLEZE VIZITUAN KOMPANINË E PËRKTHIMEVE "TRANKOS"

2 korrik 2022

Ndërlidhja e studimeve me praktikën profesionale në veçanti dhe me tregun e punës në përgjithësi është një domosdoshmëri në kontekstin e sotëm arsimor. Në këtë kuadër, në prag të diplomimit, studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Gjuhës Angleze kryen një vizitë studimore në kompaninë "TranKos", ku u mirëpritën nga drejtori i përgjithshëm i kësaj kompanie, z. Afrim Hyseni.




Gjatë kësaj vizite, studentët u njohën me procesin e përkthimit të teksteve teknike me anë të software-it të specilaizuar të përkthimit, Trados. Drejtori i kompanisë gjithashtu foli për aftësitë që një përkthyes duhet të ketë në mënyrë që të jetë i suksesshëm. Më pas, takimi vazhdoi me diskutime dhe pyetje nga ana e studentëve. "TranKos" është një partner i rëndësishëm për Fakultetin e Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, pasi siguron praktikë profesionale për studentët të cilët aspirojnë të bëhen përkthyes në të ardhmen.

LIGJËRATË SPECIALE NGA PROF. DR. BURÇAK GÜMÜS PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

4 korrik 2022

Fakulteti i Radiologjisë i Kolegjit AAB në bashkëpunim me Poliklinikën AMD organizuan ligjëratë speciale me prof. dr. Burçak Gümüs, specialist i radiologjisë intervente. Ai në këtë ligjëratë ndau përvojat e tij personale që i kishte me pacientë ndër vite.











Ligjërata zgjoi vëmendje të shumë sudentëve të Fakultetit të Radiologjisë si dhe doktor specialistë të fushave te ndryshme të mjekësisë që ishin prezentë. Vlen të theksohet se prof. dr. Burçak Gümüs është ndër të paktit që realizon intervenime unike në radiologji, prandaj emri i tij është i njohur edhe ndërkombëtarisht.



Profesori Gümüs gjatë kësaj kohe po ashtu ka realizuar edhe 30 vizita në Poliklinikën AMD tek pacientët me probleme të ndryshme. Ai u shpreh mjaft mirënjohës dhe i nderuar me pritjen nga bashkëpuntorët.

QAPI – PROGRAMI VEROR PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË PERSONELIT 2022

4 korrik 2022

Në kuadër të Programit Veror 2022, për zhvillimin profesional të personelit, QAPI (Qendra për Aftësim Profesional dhe Inovacion), fton të gjithë të interesuarit të bëhen pjesë e trajnimeve profesionale që do të zhvillohen gjatë muajit korrik 2022, në Kolegjin AAB.



Trajnimet do të jenë njëditore (09:00-16:00) dhe do të zhvillohen në ambientet e kampusit të Kolegjit AAB në Prishtinë, ndërsa për stafin e Kolegjit AAB ofrohen pa pagesë.

Në përfundim të suksesshëm të trajnimit pjesëmarrësit do të certifikohen nga QAPI dhe Rektorati i AAB.

Certifikata u jepet vetëm kandidatëve që kryejnë të gjitha kërkesat e programit dhe që marrin pjesë në 100% të seancave gjatë ditës.

Për t' u bërë pjesë e trajnimeve ju duhet të regjistroheni në këtë link.
Numri i lejuar i pjesëmarrësve në trajnim do të jetë 24. Një kandidat nuk mund të regjistrohet në dy trajnime për të njëjtën datë.

KOLEGJI AAB SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTËVE TË RINJ NË VITIN AKADEMIK 2022/23

5 korrik 2022

Kolegji AAB shpall konkurs për regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2022/23, në të gjitha kampuset: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë.

Të gjithë të interesuarit, të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme dhe maturën shtetërore mund të regjistrohen në programet e akredituara në nivelin Bachelor, ndërsa kandidatët që kanë mbaruar studimet e nivelit themelor, mund të regjistrohen në nivelin Master.
Listën e programeve mund ta gjeni këtu:
Konkursi 2022/23
Aplikoni online



KOLEGJI AAB KRIJON NJË VARG MUNDËSISH PËR BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE TË NDRYSHME NË FRANCË

5 korrik 2022

Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha dhe prorektorja Venera Llunji zhvilluan një vizitë një javore në Francë, në regjionin Hauts-de-France, në kuadër të delegacionit që përfaqësonte Kosovën si shtet në fushën e arsimit dhe të kulturës.



Nën organizimin e Ambasadës së Francës në Kosovë dhe Aleancës Franceze në Prishtinë, gjatë kësaj vizite përfaqësuesit e AAB-së patën mundësinë të zhvillojnë vizita e takime në institucione të rëndësishme arsimore e kulturore, në qytetet Amiens, Cambrai, Torcoing, Lens, Lille, Graveline, Dunkerque, etj..

Gjatë takimit në Maison de la culture d'Amiens, Demjaha dhe Llunji diskutuan me udhëheqësit e këtij institucioni praktikat e projektit arsimor të Amiens, që ka për qëllim angazhimin e gjithë komunës ndaj moshave 0-25 vjeç bazuar në problematikat e fushat prioritare. Në Amiens ata u pritën edhe nga udhëheqësit e komunës, ku u diskutuan shumë tema interesante që lidhen me arsim dhe kulturë dhe u vunë kontaktet për bashkëpunim me qëllim të krijimit të rrjetit mes palësh.

Një mundësi tjetër bashkëpunimi, për Fakultetin e Arteve të Kolegjit AAB u krijua gjatë vizitës në Le Fresnoy-National Contemporary Art Studio, në qytetin Torcoing. Në takimin me kryetaren e Komunës së Tourcoing, rektori Demjaha foli për zhvillimin e Kolegjit AAB, rëndësinë e Kolegjit AAB për shoqërinë tonë në Kosovë dhe jo vetëm, kurse prorektorja Llunji takoi nënkryetaren për marrëdhënie ndërkombëtare dhe bashkëpunim duke ndarë përvojat dhe mundësitë për bashkëpunim për studentët tanë dhe ata të Tourcoing-ut.









Në vizitën e realizuar në Dunkerque, një qytet i sportit dhe rekreacionit me fokus te të rinjtë, u iniciuan edhe mundësitë e fillimit të bashkëpunimit të Kolegjit AAB sidomos në sport.
Gjatë kësaj vizite përfaqësuesit e AAB-së u pritën edhe në institucione e galeri të ndryshme si Lewarde Mining History centre dhe Louvre Lens, centrali bërthamor i Gravelines, Harbour Museum of Dankerque, FRAC Grand Large, Theatre de la Licorne, Opera e Lille, etj..

I gjithë organizimi i kësaj vizite dhe takimeve të shumta u organizuan nga Sh.S. Ambasadorja Butel dhe u realizua me ndihmën e atasheut Donato Giulianni, anëtarëve të stafit: Valon Ibraj dhe Fikrije Pllashniku, si dhe nga Aleanca Franceze, si rezultat i bashkëpunimit mes Kolegjit AAB dhe Ambasadës së Francës në Kosovë.

REKTORI DEMJAHA DHE PROREKTORJA LLUNJI U PRITËN NË TAKIM NË UNIVERSITETIN LILLE NË FRANCË

5 korrik 2022

Në kuadër të vizitës një javore në Francë, Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha dhe prorektorja Venera Llunji u pritën në një takim miqësor në Rektoratin e Universitetin Lille.

Në këtë takim përfaqësuesit e Kolegjit AAB takuan përfaqësues të rektoratit, të instituteve, fondacioneve, dekanë dhe profesorë të përfshirë në të gjitha aktivitetet dhe projektet e Univeristetit Lille.









Me këtë rast, rektori Demjaha foli për Kolegjin AAB, historikun e zhvillimit, rezultatet e shkëlqyeshme të punës në Kolegj, për sfidat me të cilat ballafaqohemi, për pritshmëritë tona që të jemi sa më të pranueshëm dhe aktivë në fushën e arsimit të lartë në Francë, si një ndër partnerët tanë dhe me institucione të tjera të arsimit të lartë. Veçanërisht, rektori Demjaha foli për rëndësinë e madhe për të qenë partnerë në projektet të cilat propozohen dhe realizohen në BE.

Nga ana tjetër, prorektorja për bashkëpunim ndërkombëtar Venera Llunji, foli për rëndësinë që ka për Kolegjin AAB, ndërtimi dhe forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione të arsimit të lartë në Francë, dhe po ashtu edhe me vendet e tjera. Ajo foli për projektet të cilat janë realizuar, ato të cilat do të fillojnë të realizohen, për partneritetin me vendet e BE në projekte të shkëmbimit të stafit dhe studentëve, për rëndësinë e rrjetëzimit të institucioneve të arsimit të lartë përmes programit ERASMUS+ dhe jo vetëm.

Zv.rektorja për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Lille, prof. Nil Ozcaglar- Toulouse dhe i gjithë personeli akademik dhe menaxhues i universitetit Lille e dhanë pëlqimin e tyre që të kenë bashkëpunim të ngushtë me Kolegjin AAB në të gjitha fushat dhe me të gjitha fakultetet tona.

KOLEGJI AAB ORGANIZON KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE VIRTUALE "LUFTË, KONFLIKT DHE SHOQËRI"

7 korrik 2022

Kolegji AAB me 9 dhe 10 dhjetor 2022 do të zhvillojë konferencën ndërkombëtare virtuale me temën "Lufta, Konflikti dhe Shoqëria". Kjo temë do të ndërlidhet me proceset transformuese të shkaktuara nga konfliktet në kontekste të ndryshme gjeopolitike. Së fundmi, lufta në Ukrainë ka sjellur ndryshime sizmike në kontekstin evropian në lidhje me çështjet e sigurisë dhe rrethanat socio-politike dhe humanitare të Evropës. Nga pikëpamja akademike, konferenca ofron një platformë unike në të cilën diskutohen dinamikat transformuese të konfliktit ndër-grupor në kuptimin e tyre më të gjerë.



Qëllimi është të identifikohen dhe të shkëmbehen studimet akademike mbi konfliktet nga një shumëllojshmëri e gjerë disiplinash dhe përmes fokuseve të ndryshme teorike dhe metodologjike. Konferenca mirëpret hulumtime kërkimore mbi mënyrat në të cilat lufta dhe konflikti i japin formë shoqërisë, çështjet e zgjidhjes së konflikteve, drejtësisë tranzicionale, nacionalizmit, lëvizjeve kundër luftës, gjenocidit, etj.

Pjesëmarrës janë akademikë dhe hulumtues nga disa fusha të ndryshme përfshirë Sebastian Muth nga Lancaster University në Angli, Furtuna Sheremeti nga Université Louvain në Belgjikë, dhe Mieke Vandenbroucke nga University of Antwerp në Belgjikë.
Pjesëmarrësit e interesuar mund të dërgojnë një abstrakt me jo më shumë se 200 fjalë në këtë adresë: onlineconference@universitetiaab.com

Afati i fundit për aplikim është 15 tetor 2022.

Për më shumë informata, ju mund të kontaktoni Prorektoren për Shkencë, Dr. Uranela Demaj: uranela.demaj@universitetiaab.com

PËRFUNDON ME SUKSES PROGRAMI VULLNETAR – PROFESIONAL "ANGLISHTJA NGA UNË TE TI" NË FSHATIN SOS

7 korrik 2022

Prej tri vitesh, studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB japin kontributin e tyre në mësimdhënien e gjuhës angleze te fëmijët e Fshatit SOS. Prej këtij programi profesional vullnetar përfitojnë 100 fëmijë të cilët kanë nevojë për mbështetje sociale dhe financiare. Mësuesit vullnetarë fillimisht i nënshtrohen një trajnimi disa javësh në lidhje me metodologjinë e mësimdhënies.



Sot u mbajt ceremonia e ndarjes së certifikatave për studentët e angazhuar, me ç' rast ata i falënderuan përfaqësuesit e Fshatit SOS, drejtoresha Ora Bytyçi dhe koordinatorja e programit Hana Shala.






Disa prej vullnetarëve folën për eksperiencat e tyre me fëmijët në Fshatin SOS dhe e konsideruan programin "Anglishtja nga Unë te Ti" si një ndër aktivitetet që do të mbetet gjatë në kujtesën e tyre. Dekanati i fakultetit u zotua se kjo traditë do të vazhdojë edhe vitin tjetër me një mbështetje edhe më të madhe.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE PËRFITUES I PROGRAMIT "FULBRIGHT SPECIALIST"

15 korrik 2022

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike i Kolegjit AAB ka shënuar edhe një sukses, duke u përzgjedhur përfitues në njërin nga programet më prestigjioze në mbarë botën "Fulbright Specialist" 2022. Ky program që ndërlidhet me fushën e sigurisë kibernetike, është i mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë.

"Fulbright Specialist", pritet të sjellë në Kolegjin AAB ekspertë të shumtë nga fusha e sigurisë kibernetike nga SHBA, ndërsa do të menaxhohet nga ligjëruesi në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, Krenar Këpuska.



Disa nga objektivat e këtij programi pritet të jenë:

-Adresimi i sfidave, kërcënimeve dhe sulmeve moderne të sigurisë kibernetike,
-Si të rritet ndërgjegjësimi për sigurinë në internet dhe sigurinë kibernetike,
-Si krijohen politikat dhe procedurat e sigurisë kibernetike nga sulmet kibernetike.

Ndër aktivitetet kryesore të projektit pritet të jenë seminaret me tema të ndryshme të sigurisë kibernetike si: bazat e sigurisë, mbrojtja dhe siguria e rrjetit, kërcënimet dhe dobësitë, menaxhimi i riskut, forenzika kompjuterike, kriptografia, zhvillimi i një karriere në sigurinë kibernetike etj. Ky projekt parashihet të zgjasë 15 ditë, ndërsa datat e mundshme për zhvillimin e këtij projekti do jenë gjatë muajit shtator, tetor dhe nëntor.

Bashkëpunimet, metodat dhe ofrimi i kushteve moderne e bën Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Kolegjin AAB, të jetë shembull suksesi dhe lider në studimet e fushës së teknologjisë.

U MBAJT MODULI I PARË I TRAJNIMEVE TË QAPI PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË PERSONELIT

18 korrik 2022

"Metodologjia e arsimit të lartë nga perspektiva e parimeve të mësuarit të të rriturve" ishte tema që u trajtua në kuadër të modulit të parë për stafin akademik nga trajnerët Naser Zabeli dhe Arbërore Bicaj. Ky modul i shndërron parimet e pedagogjisë së të rriturve në praktika të mësimdhënies në arsimin e lartë.

Tetë parimet e të mësuarit të të rriturve u diskutuan në kontekstin e praktikave të tanishme dhe në kontekstin e shkëmbimit / ndërtimit të praktikave të mësimdhënies me qëllim të sigurimit të qasjes me studentin në qendër dhe për rritjen e efikasitetit të studimeve.








Fokus kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë ngritja e kapaciteteve të personelit për mësimdhënie me të rriturit dhe shtjellimi i qasjes teorike.

Në kuadër të "Programit Veror 2022" të organizuar nga QAPI për zhvillim profesional të personelit, këto trajnime do të vazhdojnë edhe me 18 dhe 21 korrik prej orës 09:00-16:30.

Të gjithë të interesuarit për trajnimet që ofrohen në kuadër të Programit Veror 2022 të QAPI, për më shumë informata mund të kontaktojnë me koordinatoret: Diana Qarkaxhija (diana.qarkaxhija@aab-edu.net, dhe Gresa Makolli (gresa.makolli@aab-edu.net).

VAZHDOJNË TRAJNIMET E QAPI PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË STAFIT AKADEMIK

19 korrik 2022

Në kuadër të "Programit Veror 2022" të QAPI, kanë vazhduar për ditën e dytë me radhë trajnimet për zhvillimin profesional të stafit akademik.

Zv. rektori i Kolegjit AAB, Shemsedin Vehapi dhe Xhavit Rexhaj, profesor në Fakultetin e Gjuhës Angleze, folën për "Format e vlerësimit dhe ndërtimi i notës", duke shpjeguar metodat dhe përgjegjësinë profesionale gjatë vlerësimit.








Ndërsa në trajnimin tjetër profesoresha Venera Llunji, dhe Karolina Adamiak nga Universiteti i Lodz-it, trajtuan temën "Kultura dhe udhëheqja organizative" duke folur mbi përvojat e tyre në lidhje me mësimdhënien dhe mënyrën se si universitetet përcaktojnë rolet e secilit individ që ka rol kyç në këto institucione. Ndër të tjera, ligjëruesja nga Lodz, ndau eksperiencën dhe mënyrat me të cilat punohet në universitetin ku punon.

"Universitetet dhe komunikimi i shkencës me publikun", ishte trajnimi tjetër që u mbajt nga profesori Mirvan Xhemaili. Edhe në këtë trajnim pjesëmarrësve u janë ofruar detaje dhe njohuri në lidhje se si universiteti ka rol të rëndësishëm për komunikimin e shkencës me publikun. Kjo temë është cilësuar me peshë të madhe, dhe faktor kyç që ndikon në zhvillimin dhe profesionalizimin e stafit akademik.

Pesë trajnimet e radhës vazhdojnë të enjten më 21 korrik prej orës 09:00 deri në 16:30.

KOLEGJI AAB, INSTITUCIONI I VETËM NGA KOSOVA QË PO PËRFAQËSOHET NË UNIVERSITETIN E GRACIT NË AUSTRI

21 korrik 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, vazhdimisht shpalos sukseset e studentëve që dëshmojnë angazhim dhe vullnet me të cilin punohet e mësohet në këtë drejtim. Studentët e këtij fakulteti së fundi kanë fituar bursë në njërën nga shkollat verore në Universitetin e Gracit, Austri. Kështu Kolegji AAB, është bërë institucioni i i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë që po përfaqësohet në këtë shkollë prestigjioze.

Shkolla Verore Ndërkombëtare e Grazit në Austri, Seggau (GUSEGG), është progam akademik ndërkombëtar ku marrin pjesë studentë nga të gjitha fushat e studimit. Ndërsa për studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, kjo është hera e dytë që janë pjesë e saj.

Mbi 80 studentë dhe 20 profesorë nga e gjithë bota marrin pjesë në leksione, seminare e panele që zhvillohen në ambientin unik në kampusin e këtij universiteti.








Qëllimi i kësaj shkolle verore është që studentët të thellojnë njohuritë e tyre në fushat e caktuara, të krijojnë miqësi e shkëmbejnë përvoja që lidhen me të ardhmen profesionale të tyre.

PËRMBYLLEN ME SUKSES TRAJNIMET PËR STAFIN AKADEMIK

22 korrik 2022

Sot janë mbajtur trajnimet e fundit për zhvillimin profesional të stafit akademik, ku u trajtuan tema dhe alternativa kyçe që e bëjnë më të lehtë punën, por edhe rezultatin më pas.

Trajnimet u mbajtën në Kolegjin AAB në kuadër të "Programit Veror 2022" të QAPI, derisa u pa numër i madh i të interesuarve për të ndjekur këto trajnime në avancimin profesional të tyre.








Disa prej temave të trajtuar përgjatë këtyre trajnimeve ishin: "Vlerësimi i studentëve bazuar në kompetenca dhe në ndërtimin e notës", "Komunikimi dhe ndërlidhja e hulumtimeve me politikat publike", "Metodologjia e arsimit të lartë nga perspektiva e parimeve të mësuarit të të rriturve", "Kultura dhe udhëheqja organizative" etj.

QAPI është qendër e themeluar nga Kolegji AAB me qëllim të ofrimit të shërbimeve të certifikuara të aftësimit dhe përkrahjes profesionale për personelin akademik dhe administrativ në AAB.

STUDENTËT E KOLEGJIT AAB ZËNË VENDIN E DYTË NË LOJËRAT AKADEMIKE TË FUTSALLIT ÇEK

22 korrik 2022

Melisa Osmani, studente e Fakultetit të Kulturës Fizike në Kolegjin AAB, ka bërë një përfaqësim dinjitoz derisa u rendit në vendin e dytë në Lojërat Akademike Çeke në Futsall , duke përmbyllur me sukses edhe vitin akademik si studente në programin ERASMUS.





Këto lojëra organizohen çdo vit nga Shoqata Çeke e Sporteve Universitare (ČAUS), dhe mbahen në universitetin e përzgjedhur. Këtë vit ato u organizuan në Universitetin e Bohemisë Jugore, derisa studentja Melisa Osmani e Kolegjit AAB, arriti sukses të madh si pjesëmarrëse, ku përfaqësoi njërën nga universitetet më të njohura çeke, atë të Masaryk.

Ajo zuri vendin e dytë në garat e futsall në konkurrencën e femrave, duke u shpallur nënkampion të Republikës çeke në këtë sport.
Melisa Osmani falënderoi Kolegjin AAB për mundësinë e dhënë, ndërsa foli edhe për arritjen në këto gara.



Këto lojëra organizohen çdo vit nga Shoqata Çeke e Sporteve Universitare (ČAUS), dhe mbahen në universitetin e përzgjedhur. Këtë vit ato u organizuan në Universitetin e Bohemisë Jugore, derisa studentja Melisa Osmani e Kolegjit AAB, arriti sukses të madh si pjesëmarrëse, ku përfaqësoi njërën nga universitetet më të njohura çeke, atë të Masaryk.

Ajo zuri vendin e dytë në garat e futsall në konkurrencën e femrave, duke u shpallur nënkampion të Republikës çeke në këtë sport.
Melisa Osmani falënderoi Kolegjin AAB për mundësinë e dhënë, ndërsa foli edhe për arritjen në këto gara.

GUSHT 2022

EDHE DY STUDENTË TË SHKENCAVE KOMPJUTERIKE REKRUTOHEN NGA INSTITUCIONI MË I RI BANKAR NË KOSOVË

10 gusht 2022

Dy studentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, Arbër Qelaj dhe Eltan Hoxha, me njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë studimeve dhe praktikës, tanimë janë bërë pjesë e njërit nga institucionet më të reja bankare në Kosovë, PriBank.





Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, është në spikamë të institucioneve të ndryshme që janë në kërkim të studentëve me potencial për të kryer detyrat e kërkuara.

Suksesi i arritur nga këta studentë dhe shumë të tjerë në vazhdimësi, dëshmojnë edhe njëherë tjetër angazhimin maksimal dhe metodat unike me të cilat punohet në Kolegjin AAB, për të përgatitur studentët për sfidat dhe detyrat që i presin pas studimeve.

EDON IBRAHIMI I DIPLOMUAR NË AAB, TRAJNER I EKIPIT TË VOLEJBOLLIT NË HUNGARI

16 gusht 2022

Edon Ibrahimi, ish student në Kolegjin AAB, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, ka trasuar rrugën e të diplomuarve të suksesshëm, ku menjëherë pas studimeve arrijnë rezultate edhe në karrierë. Ai është zgjedhur trajner i ekipit të volejbollit "CoreComm-VESC Röplabda" në Hungari, duke shënuar kështu një sukses të madh në aspektin profesional.







Edoni, që dikur ishte pjesë e klubit të volejbollit "Kastrioti" nga Ferizaj, tani ka nënshkruar kontratë 3 vjeçare me një nga ekipet më të njohura hungareze. "Rruga më e lehtë e më profesionale drejt suksesit kalon nga dyert e Kolegjit AAB", tha Edoni derisa u shpreh tejet mirënjohës e falënderues ndaj stafit akademik, dhe angazhimit të madh gjatë viteve të studimit. "Falë diplomimit në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, tani do të udhëheq një nga ekipet e volejbollit më të njohura në Hungari. Përveç kësaj më presin edhe shumë projekte të reja, që shpejt pritet të bëhen zyrtare", u shpreh Edoni.
Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, ofron studime në dy nivele, bachelor dhe master ndërsa iu mundëson të diplomuarve të vënë në zbatim mësimet e aftësitë në tregun e punës, si brenda dhe jashtë vendit.
Programet që ofrohen në kuadër të këtij fakulteti janë Kulturë Fizike dhe Sport (bachelor dhe master) si dhe Fitnes dhe Nutricion (master).

DIPLOMA E KOLEGJIT AAB KALON SËRISH KUFIJTË, NJIHET EDHE NË SUEDI

18 gusht 2022

Të diplomosh në Kolegjin AAB, nënkupton njëkohësisht të jesh në hap e të njihesh edhe në Evropë e më tej. Kjo është dëshmuar së fundmi nga një tjetër studente e Kolegjit AAB, që përfundoi studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Gjuhës Angleze.

Qëndresa Lubovci, tha se Këshilli Suedez për Universitetet dhe Kolegjet Universitare (UHR), ka dhënë dritën e gjelbër për diplomat e Kolegjit AAB, duke i vlerësuar ato të barabarta me diplomat suedeze bachelor dhe master. Ajo u shpreh tejet e lumtur, dhe krenare që ishte pjesë e Kolegjit AAB: "Jam e lumtur që isha pjesë e Kolegjit AAB, tash edhe më krenare kur e di se diplomat dhe njohuritë që mora në Fakultetin e Gjuhës Angleze më vlerësohen edhe në Suedi".



KLINIKA SANA NGA GJERMANIA REKRUTON EDHE NJË NUMËR STUDENTËSH TË INFERMERISË

19 gusht 2022

Studentët e Fakultetit të Infermierisë të Kolegjit AAB, po vazhdojnë të intervistohen nga klinikat më prestigjioze në Gjermani, për t' u bërë pjesë e stafit të tyre. Së fundi, janë intervistuar studentët e radhës nga drejtoresha e Klinikës Sana, në Biberach. Të gjitha intervistat u realizuan në gjuhën gjermane, pasi studentët tanimë kanë arritur njohuri të shkëlqyera përmes kurseve intensive të ofruara nga "Lingua" në kuadër të Programit të Karrierës dhe Punësimit.






Drejtoresha e klinikës në Biberach, Röder, ka vlerësuar pozitivisht përgatitjet e studentëve, qoftë në aspektin profesional, ashtu edhe në njohjen e gjuhës gjermane.

Rezultatet e intervistave pritet të publikohen javën e ardhshme, ndërsa studentët e intervistuar do iu bashkohen shumë shpejt pjesës tjetër të studentëve nga Kolegji AAB, që tashmë janë bërë pjesë e klinikave në Gjermani.

PËRMES ERASMUS+, STUDENTJA REA LOCI PËRFUNDOI NJË SEMESTËR NË UNIVERSITETIN MASARYK NË ÇEKI

20 gusht 2022

Aftësimi për punë dhe ndërtimi i karrierës së studentëve mbetet qëllim primar i Kolegjit AAB, derisa të diplomuarit janë të gatshëm të ndjekin ëndrrat e tyre edhe në arenën ndërkombëtare.



Së fundi Rea Loci, ish studente e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, u pranua të kryejë semestrin veror si studente e ERASMUS+ në një nga universitetet e njohura çeke, Universitetin Masaryk në Brno. Në kuadër të këtij programi, përpos lëndëve teorike në auditor, Rea kreu edhe praktikën profesionale si mësimdhënëse e gjuhës angleze në një shkollë në qytetin e Brnos.

"I inkurajoj të gjithë të rinjtë të punojnë për ëndrrat e tyre, dhe ato t' i ndjekin përmes studimeve në Kolegjin AAB, si dhe dua të falënderoj gjithë stafin akademik për përkrahjen dhe dijen e fituar", u shpreh Rea.

Universiteti Masaryk, renditet për vite me radhë si një ndër 10 universitetet më të mira në shtetet e reja anëtare të BE-së.

Fakulteti i Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB, ka ndihmuar çdo gjeneratë të studentëve të kenë një jetë të pasur studentore si brenda ashtu edhe jashtë kampusit. Aftësimi i studentëve bëhet përmes stafit profesional, të cilët merren me përgatitjen e kuadrove të reja për suksese të njëpasnjëshme.

STUDENTËT E KOLEGJIT AAB VAZHDOJNË STUDIMET NË POLONI PËRMES ERASMUS+

23 gusht 2022

Në kuadër të programit për shkëmbimin e studentëve Erasmus+, edhe tre studentë nga Kolegji AAB po ndjekin semestrin veror në Universitetin Lodz të Polonisë. Argjend Berisha, Art Vula dhe Laureta Dervodeli, nga Lodzi kanë ndarë përvojat e tyre duke qenë falënderues për mundësinë e ofruar nga Kolegji AAB dhe Programi Erasmus+.



"Ne jemi të gjithë falënderues! Kjo do të jetë një shtysë e madhe në aspektin profesional e akademik", u shprehën ata.

Përmes Programit Erasmus+ për mobilitetin e studentëve, shumë studentë të AAB-së kanë pasur mundësinë të vizitojnë universitete të ndryshme evropiane për një semestër sa zgjat kjo përvojë.

AAB po punon vazhdimisht që listës së universiteteve partnere ku studentët mund të ndjekin studimet përmes këtij programi, t' i shtohen sa më shumë të tilla.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FEDERATËN E KARATESË TË KOSOVËS

29 gusht 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit ka nënshkruar marrëveshje me Federatën e Karatesë të Kosovës, duke zgjeruar gamën e bashkëpunimeve me institucione relevante për studentë.







Përmes kësaj marrëveshjeje ndër të tjera synohet: realizim i praktikës së studentëve në sportin e karatesë, licensimi i studentëve si trajnerë të karatesë, shkëmbimi i stafit akademik dhe literaturës profesionale, organizime të përbashkëta të konferencave shkencore, aplikim të përbashkët për fonde në fushën e sportit (përfshirë pajisjet sportive), etj..

Të dyja palët premtuan në realizim dhe organizim cilësor të këtyre aktiviteteve duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e zgjerimit të aktiviteteve dhe bashkëpunimeve.

BEHAR BUNJAKUT I NJIHET DIPLOMA E KOLEGJIT AAB NË SHTETIN SUEDEZ

29 gusht 2022

Behar Bunjaku i diplomuar në Fakultetin e Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, është njoftuar se diploma e studimeve BA i është njohur nga (UHR) Këshilli Suedez për Universitete dhe Kolegje Universitare. Ai shprehet krenar dhe falënderues ndaj Kolegjit AAB, për suksesin e arritur: "Jam shumë krenar me vlerësimin që bëri shteti suedez duke krahasuar të barasvlefshme diplomën e Kolegjit AAB në Suedi. Përvoja ime e përgjithshme ka qenë e dobishme për shkak të stafit akademik dhe mësimdhënies cilësore që ndoqa gjatë studimeve", u shpreh ai.

Pas suksesit të studimeve në AAB, Behari planifikon që studimet t' i vazhdojë në Suedi.



TJETËR STUDENT I SUKSESSHËM NGA FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE TË KOLEGJIT AAB, PUNËSOHET NË KOMPANI VENDORE SI IT

30 gusht 2022

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, vazhdojnë të jenë të kërkuar në tregun e punës. Këtë e dëshmojnë në vazhdimësi studentët e rekrutuar nga kompani vendore e ndërkombëtare.



Edhe Sokol Gashi, i cili është student në Kolegjin AAB tanimë është punësuar në pozitën e IT, dhe do të ketë mundësinë të dëshmojë mësimet që mori në studime nga stafi akademik në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Ky fakultet në të gjitha programet studimore po synon që të implementojë metodat më moderne të teknologjisë, duke qenë në hap me zhvillimet bashkëkohore në mënyrë që të përgatisë studentët për zhvillimet e hovshme që ndodhin në këtë fushë.

EDHE STUDENTI RON UKAJ ME SUKSES PËRFUNDOI MOBILITETIN STUDENTOR NË KUADËR TË ERASMUS+

31 gusht 2022

Ron Ukaj, student i Kolegjit AAB, ka përfunduar me sukses semestrin veror në Universitetin e Lodz në Poloni, në kuadër të Erasmus+. Ai e cilësoi si eksperiencë të paharrueshme derisa tha se pati mundësinë të krijojë njohje të reja dhe për këtë e falënderoi Kolegjin AAB.

"Kam njohur studentë nga e gjithë bota falë mundësisë së dhënë nga Kolegji AAB, e që jam shumë falenderues. Patëm rastin të përfaqësojmë Kosovën, të shpalosim të mirat rreth kulturës, historisë e bukurive që ka", tha Ron Ukaj, i cili në AAB studion në Fakultetin e Gjuhës Angleze.




KOLEGJI AAB

SHTATOR 2022

PËRFUNDON SUKSESSHËM PROJEKTI STUDENTOR "STUDENTS AS PROFESSIONAL JOURNALISTS"

1 shtator 2022

Ka përfunduar edhe aktiviteti i fundit i projektit studentor "Students as Professional Journalists", krahas aktiviteteve tjera paraprake. Koordinatorja e projektit Lularta Buja, në përmbyllje bashkë me studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv (niveli MA) të Kolegjit AAB, dhuruan 5 "Gift Cards" për nxënësit e shkollave të mesme, të cilët kanë përfunduar me sukses shkrimin e artikujve, që tanimë janë publikuar në ATVLIVE.TV





Dhuratat për nxënësit kanë përfshirë përzgjedhjen e librave nga titujt e shumtë në librarinë e Kolegjit AAB, ndërsa thanë se ishin mirënjohës dhe të privilegjuar për mundësinë e dhënë. Këto aktivitete u mundësuan nxënësve të identifikojnë burimet, të realizojnë intervista dhe të verifikojnë informacionet para se t' i publikojnë ato.

Pjesëmarrësit falënderuan studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, të cilët ndihmuan dhe mbikqyrën mbarëvajtjen e projektit.

EVP TRAJNIMET "SHËNDETI MENDOR"

1 shtator 2022

Në kuadër të trajnimeve për edukimine vazhdueshëm profesional, trajnimi i radhës do të mbahet më datën 07.09.2022. Tema e këtij trajnimi do të jetë "Shëndeti Mendor", ku ligjëruese do të jetë Velide Pulomemoj.



Ky kurs si të gjithë kurset e tjera është i akreditуar nga Oda e Infermierëve të Kosoves me 8 pikë kredituese për pjesëmarrje pasive. Në këtë kurs mund të aplikojnë të gjitha profilet shëndetësore dhe jo shëndetësore me interes për të mësuar shkathtësitë e ofrimit të ndihmës së parë në situata të ndryshme.

AAB DHE ALEANCA FRANCEZE ORGANIZOJNË NJË JAVË ME AKTIVITETE KULTURORE

2 shtator 2022

Në Kolegjin AAB u mbajt takim me përfaqësuesit e Aleancës Franceze për të finalizuar detajet e javës me aktivitete kulturore. Aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kësaj jave do të jenë: rrjeti i bibliotekave, ekspozita digjitale "Escape" që do të hapet në Galerinë e Fakultetit të Arteve në AAB, dhe Festivali i filmit francez që mbahet në muajin nëntor.





Aleanca Franceze në Prishtinë, ka rreth 35 mijë libra/burime të zhanreve të ndryshme, derisa planifikon të hapë biblioteka me një numër të caktuar librash, që mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit. Gjatë takimit u diskutua edhe për mbajtjen e trajnimeve dhe funksionimin e platformës online nga Aleanca Franceze, trajnime këto që do të mbahen në Kolegjin AAB.

Ndërsa ekspozita digjitale e titulluar "Escape" pritet të hapet në Kolegjin AAB nga data 1-6 nëntor, ku përmes një katalogu secili partner do ketë mundësinë të zgjedhë 8 punime që do prezentohen.

AAB NDEROHET ME PLLAKATËN "JEAN MONNET" PËR MODULIN E SUKSESSHËM ERASMUS+ NGA KOMISIONI EVROPIAN

5 shtator 2022

Agjencia Ekzekutive e Arsimit, Audiovizive dhe Kulturës në kuadër të Komisionit Evropian në shenjë falënderimi ka nderuar Kolegjin AAB, me një pllakatë të veçantë "Jean Monnet", për aktivitetet dhe zhvillimin e modulit Erasmus+ gjatë vitit 2021.





Kjo pllakatë sipas agjencisë ka rol të dyfishtë, pasi në rend të parë tregon cilësinë në studimet e integrimit evropian dhe arritjet e modulit Erasmus+ nga Kolegji AAB. "Qëllimi i kësaj pllakate është i dyfishtë. Ajo shërben kryesisht si një etiketë që tregon cilësinë në studimet e integrimit evropian dhe përfaqëson arritjet e modulit tuaj në këtë fushë", thuhet në letrën përcjellëse nga kjo agjenci.

Kjo pllakatë gjithashtu do të jetë pikë promovuese për çështjet evropiane, si brenda Kolegjit AAB ashtu edhe jashtë institucionit, thuhet më tutje në letrën dërguar Kolegjit AAB.
Kolegji AAB, në kuadër të programit Erasmus+ iu mundëson studentëve shkëmbimin në universitetet e njohura, nga ku krijojnë përvoja të paharrueshme duke zgjeruar kështu horizontin profesional dhe akademik me njohuritë që ata fitojnë.

PAS DIPLOMIMIT NË AAB, STUDIMET I VAZHDON NË SAMK UNIVERSITY NË FINLANDË

6 shtator 2022

Agon Dahsyla ka mbaruar studimet bachelor në Kolegjin AAB, ndërsa tani e tutje do të vazhdojë në njërin nga universitetet më të njohura për shkenca të aplikuara në Finlandë, Universitetin SAMK.

Ai është përzgjedhur në mesin e 50 studentëve që ky universitet i pranon në vit. Agoni tha se një pjesë të madhe të suksesit padyshim që ia dedikon stafit akademik të Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB.

"Jam mirënjohës ndaj stafit akademik, më ofruan vazhdimisht ndihmë pa u kursyer. Fakti që tani jam në këtë universitet tregon qartë angazhimin e madh të tyre, dhe disiplinën me të cilën punohet në Kolegjin AAB", tha ndër të tjera Dahsyla.



FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "BUZËQESHJA"

7 shtator 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale në Kolegjin AAB, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Buzëqeshja", me seli në Fushë Kosovë.





Kjo marrëveshje u arrit në mes të dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Hysen Kasumi dhe drejtoreshës së këtij institucioni parashkollor, Kujtesa Gashi.

Bashkëpunimi i Fakultetit të Shkencave Sociale në Kolegjin AAB me institucionet shkollore, u mundëson studentëve që në të ardhmen të kryejnë praktikë dhe të krijojnë përvojë në njërën prej tyre, duke qenë kështu të përgatitur për ndërtimin e karrierës më vonë.

DEKANJA AIDA ALLA, MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE SHKENCORE NË IZRAEL

14 shtator 2022

Bashkëpunimi ndërkombëtar që Kolegji AAB ka ndërtuar ndër vite me institucione prestigjioze përbën një rëndësi të veçantë për studentët dhe stafin akademik.

Shumë profesorë janë ftuar të japin ligjërata dhe të prezantojnë në simpoziume të ndryshme shkencore. Falë këtij rrjetizimi, Dr. Aida Alla, dekane e Fakultetit të Gjuhës Angleze, ishte e ftuar si folëse në temën "Linguistic peculiarities of the Albanian persuasive language: the case of Kosovo", në Konferencën Ndërkombëtare me temën bosht rreth multikulturalizmit, organizuar nga Western Galilee College, Izrael.

Prezantimi i prof. Alla kishte të bënte me veçoritë gjuhësore të shqipes në tekstet bindëse, me fokus të veçantë te sloganet. Alla ndër të tjera, shprehet se ky ishte vetem aktiviteti i parë me këtë kolegj dhe se tashmë po diskutohen aktivitete të tjera të përbashkëta në mirëqenie të studentëve.



DY STUDENTË TË FAKULTETIT EKONOMIK FILLOJNË PUNËN PRAKTIKE NË "RAIFFEISEN BANK"

15 shtator 2022

Dy studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Gent Sejdija dhe Aulona Morina, tanimë kanë filluar praktikën në "Raiffeisen Bank" falë Panairit për Punë dhe Karrierë të organizuar nga Kolegji AAB. Të dy studentët dolën të suksesshëm gjatë testimeve dhe intervistave që u zhvilluan, kështu duke treguar aftësitë dhe njohuritë që kanë fituar gjatë studimeve në Fakultetin Ekonomik në Kolegjin AAB.



Kjo praktikë do t' iu mundësojë Gentit dhe Aulonës të thellojnë njohuritë e tyre, ta shohin se si funksionojnë institucionet financiare, dhe të krijojnë një përvojë që do t' i ndihmonte të kualifikohen në të ardhmen më lehtësisht në tregun e punës.

FKF ZHVILLOI TESTET E AFTËSIVE FIZIKE PËR PËRFAQËSUESEN E KOSOVËS NË KARATE

16 shtator 2022

Në vazhdën e bashkëpunimeve të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, është mbajtur testimi i aftësive fizike të përfaqësuesve nga Kosova në karate për dy kategoritë. Ky testim u mbajt në Kolegjin AAB, ndërsa u administrua nga stafi akademik i përbërë nga dekani i këtij fakulteti Fatmir Pireva, prodekani Zenel Metaj, trajneri i karatesë prof. Shkëlzen Shala, selektori Ylber Syla, dhe dy trajnerët Agron Tosuni e Shkëlzen Berisha.





Kryetari i Federatës së Karatesë në Kosovë, Avni Gashi, falënderoi Kolegjin AAB, dhe profesorët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, për mundësinë e dhënë dhe qasjen profesionale që u ofrua gjatë testimit.

Këto testime dhe të tjera në të ardhmen me grupmosha të ndryshme, bëhet me qëllim që garuesit të kenë rezultate sa më të mira, dhe të bëjnë përfaqësim dinjitoz.

"KAMPIONI I KOLEGJIT AAB", MUHAMET RAMADANI, THYEN REKORD NË HEDHJEN E GJYLES NË KAMPIONATIN MESDHETAR

17 shtator 2022

Studenti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, Muhamet Ramadani, ka shënuar rekord në kampionatin mesdhetar për grupmoshat U23. Muhamet Ramadani u kthye në Kosovë si kampion pas suksesit të madh që pati në Itali, në hedhjen e gjylës me rezultat 19.3 metra. Ai tha se me punë mund të arrihet çdo gjë, anipse e kishte ndjerë se do bënte përfaqësim dinjitoz por jo edhe të thyente rekord. Tutje shtoi se studimet në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sport në Kolegjin AAB, i kanë ndihmuar tejmase për rezultatet që ka arritur.



"Kolegji AAB më ka ndihmuar shumë, pasi e pashë që duhej të vazhdoja diçka tjetër përveç sportit. Erdha në Kolegjin AAB ku më kanë pritur tepër ngrohtë, duke më ndihmuar gjatë gjithë kohës në lidhje me ushtrime, e kjo ka qenë një shtytje e madhe për mua", u shpreh Muhameti.

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB ka për qëllim aftësimin e studentëve përmes ushtrimeve e bashkëpunimeve me federata të sportit, duke iu dhënë mundësinë të jenë pjesë e garave vendore e ndërkombëtare.

PRO-REKTORJA VENERA LLUNJI PJESË E KONFERENCËS "I LOVE BALKAN"

19 shtator 2022

Prof.ass.dr.Venera Llunji, Pro-rektore për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim në Kolegjin AAB, ka marrë pjesë në konferencën "I love Balkan". Qëllimi i konferencës ishte debati dhe diskutimi lidhur me gratë lidere në ndërmarrësi dhe shoqëri civile, ku të ftuara ishin pjesëmarrëset nga vendet e Ballkanit: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbia.







Llunji, foli si paneliste për rolin që ka në Kolegjin AAB, një nga institucionet më të suksessshme të arsimit në vend dhe jo vetëm. Ajo tregoi për barazinë gjinore në Kolegjin AAB, ku deri 50% e pozitave udhëheqëse dhe menaxhuese u takojnë grave. Tutje Llunji shtoi se kjo përkrahje që gëzojnë gratë në Kolegjin AAB, duhet të merret shembull nga të gjitha institucionet në Kosovë.

Kjo konferencë u organizua nga Balkan Women Association, WBF Western Balkans, UN Women Kosovo dhe NGO Lady-CC4 Women e udhëhequr nga Sanija Murati, drejtoreshë e Balkan Women Association.

EDHE NJË STUDENT I KOLEGJIT AAB, FILLON PUNËN PRAKTIKE NË "RAIFFEISEN BANK"

20 shtator 2022

Eduard Shillova, student nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike në Kolegjin AAB, është bërë pjesë e "Raiffeisen Bank", duke filluar punën praktike në këtë institucion. Eduardi, si edhe shumë studentë të tjerë u rekrutua në këtë program, përmes Panairit për Punë dhe Karrierë të organizuar në Kolegjin AAB, ku studentët patën rastin të takojnë punëdhënësit potencialë.



Ai arriti të dalë i suksesshëm në intervistat dhe testimet e zhvilluara para fillimit të praktikës, duke u përzgjedhur në mesin e kandidatëve të shumtë. Gërshetimi i punës praktike në institucione respektive me pjesën tjetër të studimeve, e bën Kolegjin AAB të dallohet me cilësinë e programeve që ofron.

DY FAKULTETE TË AAB-së NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME YMCA – KOSOVA

21 shtator 2022

Bashkëpunimet ndërdisiplinare midis fakulteteve në Kolegjin AAB janë një praktikë e zakonshme, qofshin këto konferenca shkencore, projekte sociale, artistike apo vullnetare. I tillë është edhe projekti i rradhës midis YMCA – Kosova dhe dy fakulteve me traditë në aktivitete studentore, respektivisht Fakultetit të Gjuhës Angleze dhe Fakultetit të Psikologjisë.





Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje jetëson projektin "E Ardhmja për Rininë: Të rinjtë si udhëheqës të arsimit të aftësive jetësore në Ballkan", përmes të cilit studentët e Kolegjit AAB do të përfitojnë në mënyra të ndryshme.

Qëllimi i këtij projekti është që me anë të zbatimit të hulumtimit dhe implementimit të punëtorive edukative, të rritet vetëdija dhe promovimi i vlerave themelore dhe objektivave të projektit siç janë barazia gjinore, parandalimi i dhunës, ekstremizmit dhe promovimi i stileve të shëndetshme të jetesës. Bashkëpunimi do bazohet në parimet e partneritetit të mirë dhe do të menaxhohet në përputhje me interesat e studentëve.

UNIVERSITETI SAVONIA NË FINLANDË FTON STUDENTËT E KOLEGJIT AAB TË APLIKOJNË NË ERASMUS+

22 shtator 2022

Universiteti Savonia për Shkenca të Aplikuara në Finlandë ka hapur thirrjen për aplikim për studentët e Kolegjit AAB, në kuadër të programit Erasmus+. Hapësirë për aplikim do kenë të gjithë studentët të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB.



Afati për aplikim do të zgjasë deri me 15 tetor 2022. Studentët e përzgjedhur do të intervistohen nga komisioni përkatës. Kriteret themelore janë që studentët të jenë të semestrit të dytë deri në semestrin e pestë. Nota mesatare të jetë mbi 9, derisa kërkohet të kenë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze, niveli B2, C1 ose C2.

Përmes programit Erasmus+, mundësohet shkëmbimi i studentëve duke krijuar kështu përvoja të rëndësishme akademike, të cilat më vonë do jenë bazë për ndërtimin e karrierës.

STUDENTJA ARDITA BLAKAJ NDEROHET ME TITULLIN "AMBASADORE E PAQES"

23 shtator 2022

Ardita Blakaj, studente e nivelit master në Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB, është nderuar me çmimin "Ambasadore e Paqes" në Kosovë, nga organizata botërore Global Socio-Economic and Financial Evolution Network.



Përveç kësaj, Ardita është inkuadruar edhe në Akademinë e Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, ndërsa punon si udhëheqëse në qendrën korrektuese në Dubravë, dhe ligjëruese në Akademinë për siguri publike për psikologji të burgjeve.

Fakulteti i Psikologjisë në Kolegjin AAB, angazhohet që studentët e suksesshëm të promovohen në mënyrë të denjë dhe të nisin hapat e parë të karrierës, duke u vërtetuar më vonë se kanë bërë zgjedhjen e duhur për studime.

STUDENTËT E FKF PJESË E TRAJNIMEVE NGA PLAY INTERNATIONAL KOSOVA

26 shtator 2022

Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB janë bashkangjitur në gjeneratën e pestë të projektit EJO, i implementuar nga PLAY International Kosova. Pjesëmarrës në trajnim ishin 18 të rinj, të cilët morën pjesë në trajnimet treditore të aktiviteteve socio-sportive dhe aftësive jetësore. Trajnimi ishte i përbërë nga 6 sesione, të testuara dhe implementuara nga trajnerët e PLAY International Kosova, bashkë me pjesëmarrësit e trajnimit. Sesionet përmbanin tema si: bashkëpunimi, menaxhimi i emocioneve, mendimi kritik dhe vendimmarrja.







Dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, Fatmir Pireva, ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i njoftuar për rëndësinë e këtyre trajnimeve dhe njohurive që ata do fitojnë më pas.

Këto sesione sportive do të ndihmojnë studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, që t' i implementojnë ato me nxënësit e shkollave fillore ose qendrave rinore në komunitetin e tyre.

PROFESORI I AAB-së ALEKSANDAR TAKOVSKI FTOHET TË MBAJË LIGJËRATË NË UNIVERSITETIN E HELSINKIT

28 shtator 2022

Profesori i Fakultetit të Gjuhës Angleze, Prof.asoc.dr.Aleksandar Takovski, është ftuar të mbajë ligjëratë në Universitetin e Helsinkit në Finlandë. Takovski është ftuar të mbajë një ligjëratë në një takim shkencor të organizuar nga "Programi për Antropologji Kulturore dhe Sociale", i Universitetit të Helsinkit, në kuadër të projektit "Brand Nationalism...".



Pjesëmarrësit në ligjëratë do të jenë profesorë e hulumtues të lëmisë së "Analizës së diskursit", "Studimeve për Europën Juglindore".

Ftesat për ligjërata jashtë vendit të stafit akademik në Kolegjin AAB, dëshmojnë përgatitjen e tyre profesionale dhe angazhimin akademik si brenda ashtu edhe jashtë Kolegjit AAB.

EVP TRAJNIMET: "KUJDESI PALIATIV"

29 shtator 2022

Në kuadër të trajnimeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, Fakulteti i Infermierisë organizon trajnimin njëditor me temën "Kujdesi Paliativ", me ligjëruese Vlora Ejupi.

Ky trajnim sikur edhe të gjitha modulet tjera të EVP, janë të akredituara nga Oda e Infermierëve të Kosovës, ku mund të aplikojnë për pjesëmarrje të gjitha profilet shëndetësore dhe jo-shëndetësore, të cilët do informohen në lidhje me sfidat në kujdesin paliativ, ofrimin dhe ndërlidhjet në shëndetësi.

Trajnimi do të mbahet më 05 tetor 2022.



AAB SHËNON 30 SHTATORIN, DITËN NDËRKOMBËTARE TË PËRKTHIMIT

30 shtator 2022

30 Shtatori, Dita Ndërkombëtare e Përkthimit, është shënuar nga Fakulteti i Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, me aktivitete nga studentët dhe dekanati i fakultetit.

Përmes një aktiviteti në sheshin e Prishtinës, studentët dhe profesorët e këtij fakulteti kanë bashkëbiseduar me qytetarët për këtë ditë duke i informuar ata më shumë rreth rëndësisë dhe sfidave të profesionit të përkthyesit. Ndërsa aktiviteti tjetër u mbajt në Kolegjin AAB, ku në një tryezë diskutimi u shtjelluan dy pika kryesore: përkthimi në epokën e digjitalizimit: konteksti i Kosovës dhe roli i akademisë në profesionin e përkthyesit.



Dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB, Aida Alla, falënderoi të pranishmit derisa theksoi rolin e rëndësishëm që kanë përkthyesit. Dy panelistët tjerë, Bruno Neziraj dhe Afrim Hyseni treguan për të pranishmit ndikimin e madh që zhvillimi teknologjik ka pasur në fushën e përkthimit dhe përmirësimet që duhen bërë nga akademia në Kosovë në këtë fushë.






Profesorët e Fakultetit të Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB, folën për angazhimin maksimal që bëhet për studentët, në mënyrë që në të ardhmen të jenë të gatshëm për tregun e punës dhe të mësojnë saktë etikën e punës që i takon një përkthyesi.

TETOR 2022

NXËNËS NGA KOMUNITETI ROM, ASHKALINJ DHE EGJIPTIAN VIZITOJNË KOLEGJIN AAB

1 tetor 2022

Kolegji AAB ka mirëpritur nxënës nga komuniteti egjiptian, rom dhe ashkalinj të cilët kanë parë nga afër kampusin dhe mundësitë që ofrohen për të ardhmen e tyre. Ata u takuan me Kryetarin e Bordit të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, ndërsa vizituan kampusin, të udhëhequr nga dekanati i Fakultetit të Administratës Publike, Prof.Petrit Bushi.









Secili nga ta ishin kuriozë për të parë se si zhvillohet mësimi në ambientet e Kolegjit AAB, dhe disa nga ta shprehën dëshirën që në të ardhmen të studiojnë në programet e shumta që ofrohen.

STUDENTJA ORHIDEA GUTA NIS PUNËN PRAKTIKE NË OSBE

3 tetor 2022

Në sajë të angazhimit të Qendrës për Karrierë të Kolegjit AAB, qendër kjo që përkujdeset ti këshillojë dhe udhëzojë studentët për punë praktike në institucione të ndryshme relevante me fushën e studimeve, studentja e Fakultetit Juridik, Orhidea Guta, ka filluar punën praktike në Misionin e OSBE-së.



Ajo është studentja e cila është angazhuar për punë praktike në Departamentin për Siguri Publike, ku përmes kësaj praktike do të arrijë të mësojë më shumë për punën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, si dhe t' i thellojë njohuritë e saj lidhur me projektet, detyrat administrative dhe operacionale që lidhen me menaxhimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ndryshme në këtë institucion.

Studentja Orhidea Guta, u shpreh e lumtur për mundësinë që të realizojë këtë praktikë në OSBE, duke shtuar se ky është vetëm fillimi i suksesit.

KOLEGJI AAB NIS VITIN AKADEMIK 2022/23 ME CEREMONI MADHËSHTORE

5 tetor 2022

Sot në Kolegjin AAB, është organizuar ceremonia solemne e pritjes së studentëve, që do të fillojnë studimet themelore në programet e ndryshme në vitin e ri akademik 2022/23.

Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha iu uroi suksese studentëve, ndërsa tha se tani kanë mundësinë që të studiojnë fushat që kanë përzgjedhur, ku më pas me shkathtësitë që do fitojnë do t' i qasen tregut të punës.








"Duke zgjedhur Kolegjin AAB, ju tanimë keni një mik të sigurt për rrugën e suksesit", tha rektori Demjaha.

Deri tani nga AAB kanë dalë dhjetëra gjenerata studentësh të diplomuar në profile të ndryshme akademike, ndërsa AAB vazhdon të jetë lider i arsimit të lartë jopublik në rajon.

STUDENTJA GRESA IBRAHIMI PUNËSOHET NË KOMPANIN Ë PRESTIGJIOZE AMERIKANE "RLN Advisors"

6 tetor 2022

Gresa Ibrahimi, studente në nivelin Master, në Fakultetin Ekonomik të Kolegjit AAB, falë Panairit për Karrierë dhe Punësim, të organizuar nga Kolegji AAB, tashmë është punësuar në RLN Advisors, kompani kjo që ofron shërbime të kontabilitetit dhe auditimit për bizneset në Amerikë.

Gresa pati rastin të njihej me kushtet që ofronte kompania, derisa më vonë iu nënshtrua dy testeve dhe intervistës në gjuhën angleze. Nga atje Gresa doli me rezultate tejet të kënaqshme, duke dëshmuar punën dhe mësimin e palodhshëm që bëhet nga stafi akademik i Kolegjit AAB me studentët.



AAB dega në Gjakovë nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me IP "Andrra"

6 tetor 2022

Listës së partnerëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike i është shtuar edhe kompania "KIT-Kosova Information Technology". Kjo përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga këto dy subjekte.
Marrëveshja do të jetë ndihmë e madhe për studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Kolegjin AAB, të cilët gjatë dhe pas studimeve mund të kryejnë praktikë, dhe të punësohen në këtë kompani.
Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Kolegjin AAB, Jusuf Qarkaxhija, me këtë rast ka falënderuar KIT për marrëveshjen e arritur, derisa tregoi për punën që zhvillohet brenda këtij fakulteti me programet e shumta që përkojnë me zhvillimin e hovshëm teknologjik kudo në botë.





STUDENTJA ANDUENA SHAQIRI PUNËSOHET NË KOPSHTIN E FËMIJËVE "LAPSI"

7 tetor 2022

Anduena Shaqiri është studentja e radhës nga Fakulteti i Shkencave Sociale në Kolegjin AAB, që është angazhuar nga viti i parë i studimeve në praktika të ndryshme, derisa tani është punësuar si edukatore në Akademinë e Fëmijëve "Lapsi"



Ajo u shpreh tejet e kënaqur me suksesin e arritur, derisa tha se studimet në Kolegjin AAB e kanë përgatitur për përgjegësitë dhe sfidat që do të ketë. Fakulteti i Shkencave Sociale në Kolegjin AAB, përmes programit Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve përgatit kuadro profesionale edukative për grupmoshat 0-6 vjeç, që e bën një nga programet më të kërkuara në tregun arsimor.

PO VJEN EDICIONI I TRETË I PANAIRIT VJESHTOR TË LIBRIT AAB 2022

7 tetor 2022

Panairi Vjeshtor i Librit AAB 2022, pas një pauze dyvjeçare, po rikthehet me edicionin e tij të tretë në ambientet moderne të Kolegjit AAB në Prishtinë.



Ky festival i librit, që është nismë e Kolegjit AAB, institucionit më të madh jopublik në rajonin e Evropës Juglindore, tashmë është dëshmuar si storje e suksesit, me dy edicionet e kaluara ku krahas numrit të madh të botuesve pjesëmarrës, janë zhvilluar edhe ngjarje të rëndësishme kulturore dhe janë promovuar dhjetëra tituj.

Tradita gati dy dekadëshe e Kolegjit AAB, fryma moderne dhe përcaktimi i qartë i tij për të qenë lider në zhvillimet e arsimit të lartë në vend dhe më gjerë, janë indikatorë të rëndësishëm se edhe Panairi Vjeshtor i Librit 2022, do të jetë një ngjarje e rëndësishme kulturore e cila në fokus do të ketë librin dhe promovimin e tij.

Edicioni i tretë i Panairit Vjeshtor të Librit AAB 2022, do të mbahet nga data 13 deri më 15 tetor 2022, ndërsa janë mbi 39 shtëpi botuese të cilat e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në këtë edicion.

Pjesë e pandashme e Panairit Vjeshtor të Librit do të jenë edhe ngjarjet kulturore që do të organizohen gjatë kohës sa do të mbahet panairi, si promovime librash, punëtori, orë letrare e takime me shkrimtarë.

E veçanta e Panairit Vjeshtor të Librit edhe në këtë edicion është se do të ofrojë çmime të volitshme për të gjithë studentët që do ta vizitojnë.

NIS VITI I RI AKADEMIK 2022/23, NË TË TRI DEGËT E KOLEGJIT AAB

11 tetor 2022

Ka filluar mbajtja e ligjëratave në Kolegjin AAB, duke hapur kështu edhe zyrtarisht vitin akademik 2022/23.

Studentët e viteve të para me entuziazëm të madh janë ambientuar në sallat e ligjëratave, të gatshëm për kapitullin e ri në jetën e tyre. Kolegji AAB ka mirëpritur të gjithë studentët e rinj, duke i siguruar se nga stafi akademik do të gjejnë çdoherë përkrahjen, angazhimin dhe përkushtimin.

Urime të gjithë studentëve viti i ri akademik, shëndet dhe suksese!







PROFESORË E STUDENTË TË KOLEGJIT AAB VIZITUAN UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË

12 tetor 2022

Në kuadër të marrëveshjes bashkëpunuese mes Kolegjit AAB dhe Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", profesorë dhe studentë nga Fakulteti Ekonomik i Kolegjit AAB kanë vizituar universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, ku u pritën nga rektori prof. Armand Krasniqi dhe stafi i tij.

Thellimi i bashkëpunimit, përfshirë këtu punimet shkencore në revista të indeksuara në SCOPUS dhe platforma të tjera të rekomanduara, trajnime të stafit akademik, tryeza të stafit akademik e menaxherial dhe bashkëpunimet ndërmjet dy qendrave të karrierës, ishin disa nga pikat kryesore që u diskutuan në këtë vizitë.







Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka", Armand Krasniqi,tha se ishte kënaqësi të mirëpres stafin bashkë me studentët nga Kolegji AAB, kurse Prorektorja për Bashkëpunim e Kolegjit AAB, Venera Llunji, theksoi se vazhdojnë të jenë të hapur për bashkëpunim dhe aktivitete që kontribuojnë në të mirë të studentëve.

Me këtë rast Universitetit "Haxhi Zeka" iu dhuran dhjetëra tituj të librave të botuar nga Shtëpia Botuese AAB.

HAPET PANAIRI VJESHTOR I LIBRIT AAB 2022

13 tetor 2022

Sot është hapur edicioni i tretë i Panairit Vjeshtor të Librit AAB 2022, pas dy vitesh mungesë për shkak të pandemisë, ku për tre ditë me radhë të interesuarit mund të gjejnë qindra tituj të librave, e dhjetëra shtëpi botuese në hapësirat e Kolegjit AAB.








Këtë radhë Panairi Vjeshtor i Librit AAB 2022, përveç botuesve nga Kosova e Shqipëria ka sjellur edhe botues nga Maqedonia e Veriut, dhe botues ndërkombëtarë.

Duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve, në një fjalë rasti, kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, prof. Lulzim Tafa, tha se Kolegji AAB si organizator i këtij panairi e ka për nder të mirëpresë të pranishmit në AAB, duke thënë se kjo dëshmon që Kolegji AAB nuk është vetëm qendra kryesore arsimore në vend, por edhe qendra kryesore kulturore.

Ndërsa kryetari i Shtëpisë Botuese "Faik Konica", Nazmi Rrahmani, tha se organizimi i panaireve të librit në Kolegjin AAB ka rëndësi të madhe e po ashtu e mira e kësaj është që të informohemi se çfarë është botuar kohëve të fundit.

Panairi Vjeshtor i Librit AAB 2022, është i hapur për të gjithë të interesuarit nga ora 08:00-18:00 deri me 15 tetor, në ambientet e Kolegjit AAB.

PROMOVOHET LIBRI "MARSI I ACARTË", I AUTORES MELIHATE TËRMKOLLI

13 tetor 2022

Në kuadër të Panairit Vjeshtor të Librit AAB 2022, është bërë promovimi i librit "Marsi i acartë" i autores Melihate Tërmkolli. Ky libër flet për shtetformimin e Kosovës dhe fazat e rëndësishme që kanë kaluar shqiptarët



Autorja Tërmkolli tha se ky libër në veçanti duhet të lexohet nga gjeneratat e reja, për ta mësuar edhe më mirë historinë dhe për të ditur proceset e sfidat që ka kaluar shteti i Kosovës. Ajo tutje falënderoi të pranishmit në Kolegjin AAB, derisa për studentët uroi që të bëhen ata që duhet të jenë, në mënyrë që t' i shërbejnë vendit të tyre.

U MBAJT TRYEZË E PËRBASHKËT DISKUTIMI E STUDENTËVE TË AAB DHE TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"

14 tetor 2022

Studentët e Klubit të Ekonomistëve të Rinj të Kolegjit AAB u mirëpriten nga studentët e Klubit të Debatit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.






Qëllimi i kësaj vizite të studentëve të AAB-së në Fakultetin e Biznesit në Pejë ishte socializimi i të dy palëve dhe shkëmbimi i eksperiencave dhe përvojave akademike e studentore. Me këtë rast studentët në prani të stafit menaxherial dhe akademik të të dy institucioneve zhvilluan debatin me temën "Sfidat e menaxhimi të inflacionit në Republikën e Kosovës".

Punimet e debatit i përshëndetën prof. Roberta Bajrami nga Kolegji AAB dhe prof. Emin Neziraj nga Universiteti Haxhi Zeka.

Ndërsa, studentët nga të dy institucionet debatuan për gjetjet dhe hulumtimet e ndryshme rreth inflacionit në Kosovë dhe vendet e tjera botërore, ku prezantuan modele dhe përvoja të ndryshme për menaxhimin e inflacionit që ndërlidhet me masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës.
Në fund të takimit studentët shprehen gatishmërinë e vazhdimit të bashkëpunimit në projekte të tjera studentore.

PËRKUJTOHET JETA DHE VEPRA E SHKRIMTARIT ALI PODRIMJA NË KUADËR TË PANAIRIT TË LIBRIT AAB 2022

14 tetor 2022

Në kuadër të Panirit Vjeshtor të Librit AAB 2022, u përkujtua njëri nga kolosët e poezisë shqipe, poeti Ali Podrimja. Ky edicion i Panairit AAB 2022 përkoi me 80 vjetorin e lindjes së shkrimtarit të madh Ali Podrimja, dhe 40 vjetorin e botimit të kryeveprës së tij "Lum Lumi", me ç' rast u vlerësua kontributi i tij në fushën letrare duke çmuar veprat që ai ka lënë pas.
Profesori i Kolegjit AAB, Bujar Tafa që është marrë me interpretimin e librit poetik "Lum lumi" në librin e tij "Biografemat dhe idiografemat", e cilësoi si vepër të jashtëzakonshme, duke shtuar se poetët e mëdhenj mbahen mend përmes veprave të tyre. Ai tha se fatin e tij të trishtë Podrimja e bëri të pavdekshëm përmes poezisë. Ndërsa, mikja e Ali Podrimjes e cila po merret me studimin e veprës "Lum lumi", poetja Naime Beqiraj, tha se me këtë vepër autori kishe krijuar identitetin e vet poetik.
Nga ana tjetër profesoresha e Kolegjit AAB, Ilire Zajmi, kujtoi takimin e fundit me Ali Podrimjen ku kishin marrë pjesë bashkë në festivalin e poezisë në Francë, dhe deri te momenti kur poeti u gjend i pajetë. Zajmi tha se si vetëm poetët si Podrimja kanë ditur të jetojnë dhe të vdesin siç vdiq ai.

Aktorët Shkëlzen Veseli dhe Xhejlane Tërbunja, interpretuan disa nga poezitë e veprës "Lum lumi", të cilat emocionuan të pranishmit.



Shkrimtari Ali Podrimaj, është përjetësuar edhe në Kolegjin AAB, ku në emër të tij çdo vit ndahet çmimi ndërkombëtar për letërsi.

VEPRIMTARI RESHAT SAHITAJ DHURON LIBRA PËR BIBLIOTEKËN E KOLEGJIT AAB

15 tetor 2022

Veprimtari Reshat Sahitaj, i ka dhuruar Bibliotekës së Kolegjit AAB nëntë libra, ndërsa vlerësoi organizimin e Panairit Vjeshtor të Librit AAB 2022. Sahitaj, tha se panaire të tilla shërbejnë në të mirë të njerëzve, duke i pajisur me dituri përmes leximit të titujve që ata zgjedhin.





Eriona, Laureta e Adea para studentëve të pranishëm treguan se në kuadër të Erasmus+ kishin përfunduar një semestër në Poloni, ku thanë se kjo përvojë i kishte bërë të shihnin ndryshe shoqërinë, duke parë kultura të shumëllojshme dhe duke ndarë përjetime me studentët e tjerë nga vendet e botës.

Ato thanë se kjo eksperiencë, iu kishte ndihmuar që të krijojnë shoqëri të reja, të dinë se si organizohet jeta akademike, njëkohësisht duke i njoftuar të tjerët për studimet në Kolegjin AAB.
Kolegji AAB ka marrëveshje me dhjetëra universitete evropiane në programin e mobilitetit të studentëve, ku studentët mund të aplikojnë për të ndjekur një semestër akademik në njdonjërin nga ta.

STUDENTËT QË ISHIN PJESË E ERASMUS+ SJELLIN PËRVOJAT E TYRE NGA UNIVERSITETET EVROPIANE

15 tetor 2022

Me qëllim të sensibilizimit të studentëve të AAB për mundësitë e pjesëmarrjes në programin e mobilitetit Erasmus+, në Kolegjin AAB u mbajt një sesion informues, ku tre studente kanë folur në lidhje me përvojën e tyre që patën në universitetet evropiane.

Eriona, Laureta e Adea para studentëve të pranishëm treguan se në kuadër të Erasmus+ kishin përfunduar një semestër në Poloni, ku thanë se kjo përvojë i kishte bërë të shihnin ndryshe shoqërinë, duke parë kultura të shumëllojshme dhe duke ndarë përjetime me studentët e tjerë nga vendet e botës.









Ato thanë se kjo eksperiencë, iu kishte ndihmuar që të krijojnë shoqëri të reja, të dinë se si organizohet jeta akademike, njëkohësisht duke i njoftuar të tjerët për studimet në Kolegjin AAB.

Kolegji AAB ka marrëveshje me dhjetëra universitete evropiane në programin e mobilitetit të studentëve, ku studentët mund të aplikojnë për të ndjekur një semestër akademik në njdonjërin nga ta.

SHËNOHET MUAJI NDËRKOMBËTAR I LUFTËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

17 tetor 2022

Në Kolegjin AAB është mbajtur një ligjëratë sensibilizuese në kuadër tetorit rozë, muajit ndërkombëtar të luftës kundër kancerit të gjirit. Në këtë ligjëratë para studentëve është theksuar rëndësia që ata kanë në përçimin e mesazhit dhe njoftimit të familjarëve në mënyrë që të parandalohet kjo sëmundje e rrezikshme në fillet e saj.

Nafije Latifi, udhëheqëse e Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit "Jeta/Vita", e cila mbijetoi në luftën me këtë sëmundje, tha se ndërgjegjësimi luan rol të madh në këtë betejë dhe këtë herë targetuan studentët nga Kolegji AAB, në mënyrë që të pasojnë informatat me kohë dhe ta dinë si ta njohin sëmundjen e simptomat e saj.
Nga ana tjetër, Dr. Ekrem Hyseni, nga Klinika e Onkologjisë, tha se çelësi i suksesit është nëse kjo sëmundje detektohet herët, duke rritur kështu gjasat për shërimin e saj. Sipas Hysenit, studentët edhe pse janë mosha të reja dhe nuk preken nga kjo sëmundje, ata mund ta kenë një familjar apo mik që ka nevojë për ndihmë dhe kështu secili nga ta bart përgjegjësi në supet e veta. Studentët parashtruan pyetje në lidhje me stadet e sëmundjes, se si mund të parandalohet dhe cilët janë hapat e parë që duhen ndërmarrë për këdo që përballet me këtë sëmundje.






Ato thanë se kjo eksperiencë, iu kishte ndihmuar që të krijojnë shoqëri të reja, të dinë se si organizohet jeta akademike, njëkohësisht duke i njoftuar të tjerët për studimet në Kolegjin AAB.

Kolegji AAB ka marrëveshje me dhjetëra universitete evropiane në programin e mobilitetit të studentëve, ku studentët mund të aplikojnë për të ndjekur një semestër akademik në njdonjërin nga ta.

KOLEGJI AAB ORGANIZON KONFERENCËN RAJONALE "HAPËSIRA MËSIMORE NË ARSIM"

17 tetor 2022

Më 21 tetor në Kolegjin AAB do organizohet Konferenca Rajonale "Hapësira mësimore në arsim", ku në spikamë është prezentimi i rezultateve të kërkimeve shkencore në fushën e dizajnimit të hapësirave mësimore, nga akademikët, studiuesit apo studentët.

Koordinatori i konferencës, prof. Xhavit Rexhaj nga Kolegji AAB, ka treguar detajet në lidhje me organizimin e kësaj konference, që është e para në vendin tonë që trajton një tematikë të këtillë.
"Konferenca ka karakter rajonal, dhe kontribuon në përcaktimin e parimeve dhe udhëzimeve se si të dizajnohen, si të projektohen hapësirat mësimore në arsimin e lartë në tërë Evropën", ka bërë të ditur Rexhaj, duke shtuar se në konferencën që do të zhvillohet në Kolegjin AAB do të diskutohet gjendja me hapësirat mësimore në përgjithësi, si dhe të shkëmbehen mendime të ndryshme nga palë të ndryshme.

Prof. Rexhaj theksoi se pjesëmarrës në konferencë do të jenë dhjetëra persona nga shtetet evropiane, si Spanja, Anglia, Polonia, Italia, Austria, Gjermania, Portugalia, dhe të ftuarit e tjerë nga rajoni. Në mesin e folësve kryesorë të kësaj konference do të jenë emra të njohur të shkencës si, Pablo Campos Salvo-Sotelo nga Universiteti Politeknik i Madridit, Spanjë; Prof.dr. Theodore Leiber nga EA Baden-Wurttemberg, Gjermani; Dr. James Williams nga Birmingham City University, Britani e Madhe; dhe Prof.dr. Bardhyl Musai nga Universiteti i Tiranës, Shqipëri.



Synimet e kësaj konference rajonale janë hartimi i parimeve të dizajnimit të hapësirave të arsimit, e cila ka munguar deri tani, ndërsa krahas konferencës do të mbahet edhe një simpozium ku specifikisht do të trajtohen hapësirat mësimore në arsimin e lartë.

Konferenca Rajonale që do mbahet në Kolegjin AAB, organizohet me përkrahje profesionale nga partnerët implementues të projektit "Hapësirat Mësimore në Arsimin e Lartë", i financuar nga fondet e programit Erasmus Plus të Komisionit Evropian.

SHTATË STUDENTË TË FAKULTETIT EKONOMIK FILLOJNË PUNËN PRAKTIKE NË FINCA

19 tetor 2022

Shtatë studentë të Fakultetit Ekonomik në Kolegjin AAB, janë zgjedhur për praktikë tre mujore në institucionin financiar FINCA. Kjo praktikë ka të hapur mundësinë e punësimit, për secilin nga ta që tregon performancë të shkëlqyeshme gjatë këtij tre mujori.

Studentët që kanë nisur praktikën shprehën mirënjohje ndaj Kolegjit AAB, e në veçanti ndaj stafit akademik të Fakultetit Ekonomik, për punën e zellshme dhe përkrahjen e vazhdueshme që iu kanë ofruar.



DREJTORI I BIBLIOTEKËS SË KOLEGJIT AAB PJESË E KONFERENCËS "COBIS 2022" NË MARIBOR TË SLLOVENISË

20 tetor 2022

Në Konferencën Ndërkombëtare COBISS 2022, të organizuar nga IZUM që po mbahet për të 23 herë në Maribor të Sllovenisë, këtë vit po merr pjesë edhe drejtori i Bibliotekës së Kolegjit AAB, Urim Sallauka.



Ai tha se Biblioteka e Kolegjit AAB, për 13 vite me radhë ka bashkëpunuar me IZUM, organizuesin e konferencës, ndërsa tregoi detaje në lidhje me temat që ishin diskutuar në konferencë. "Konferenca ka të bëjë me katalogun e librave COBISS, të cilin e përdorin Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria, Serbia dhe disa biblioteka në Kosovë. Jemi ftuar në këtë konferencë për të parë mundësinë që edhe Biblioteka e Kolegjit AAB të pasurohet me katalogun COBISS", tha ndër të tjera Sallauka. Tutje ai shtoi se pret që përmbajtja e konferencës të ofrojë njohuri të reja, dhe të adresohen sfida interesante.

PROF. LAURA LUCENO NGA MADRIDI FTOHET PËR LIGJËRATË NË KOLEGJIN AAB

20 tetor 2022

Fakulteti i Arteve të Kolegjit AAB do të mirëpresë me 21 tetor, profesoreshën Laura Luceno nga Universiteti Politeknik i Madridit për të zhvilluar ligjëratë për studentët e këtij fakulteti.

Tema e kësaj ligjërate "Architectural and Urban spaces for Learning&Teaching in creative disciplines: the case of fashion catwalks" do të bëjë bashkë studentët në hapësirat e Fakultetit të Arteve prej orës 10:30. Arti bashkon të gjithë!



PARTNERËT E PROJEKTIT PËR HAPËSIRAT MËSIMORE NË ARSIMIN E TAKOHEN NË AAB

20 tetor 2022

Në Kolegjin AAB, është mbajtur takimi i menaxhmentit të projektit për "Hapësirat mësimore në arsimin e lartë", para hapjes së konferencës rajonale që do të bëhet nesër. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues nga Kolegji AAB dhe nga gjashtë universitete evropiane si: Gjermania, Spanja, Portugalia, Polonia, Anglia dhe Austria.

Tema të diskutimit në këtë takim ishin arritjet e deritanishme të këtij projekti që financohet nga programi i Komisionit Evropian Erasmus+, dhe gjithashtu puna në hartimin e parimeve për dizajnimin e hapësirave mësimore të arsimit të lartë në Evropë.

Ndërsa, nesër në Kolegjin AAB hapet konferenca rajonale "Hapësirat mësimore në arsim", ku përveç hapjes do të mbahet edhe një simpozium në lidhje me këtë konferencë.









MBAHET KONCERTI ME MUZIKË JAPONEZE "KOTO CONCERT" NË TEATRIN KAMERTAL AAB

21 tetor 2022

Mbrëmë në Teatrin Kamertal të Kolegjit AAB, është mbajtur "Koto Concert" nga dy artiste të njohura japoneze, Atsuko Suetomi dhe Rokufumi Izumi.





Ky koncert është organizuar në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën e Japonisë në Kosovë. Pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë tingujt e instrumentit kombëtar japonez të quajtur "koto", ndërsa pati edhe vallëzime tradicionale japoneze.

Kolegji AAB, shpreh mirënjohjen ndaj ambasadorit të Japonisë në Kosovë, Keisuke Yamanaka, për bashkëpunimin dhe promovimin e ndërsjelltë kulturor përmes organizimeve të tilla.

FILLON PUNIMET KONFERENCA RAJONALE "HAPËSIRA MËSIMORE NË ARSIM"

21 tetor 2022

Sot është hapur zyrtarisht konferenca rajonale e organizuar nga Kolegji AAB, me temën "Hapësira mësimore në arsim".

Kjo konferencë ka për qëllim prezantimin e rezultateve të kërkimeve të fundit shkencore të kryera nga studiues dhe stafi akademik nga rajoni i Ballkanit Perëndimor në fushën e hapësirës mësimore në arsim, ku solli të ftuar nga universitetet më të njohura në rajon dhe Evropë.

Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, në fjalën hyrëse foli për zhvillimin e hapësirave arsimore në Kolegjin AAB, si dhe rezultatet që janë arritur deri tash.

Në cilësinë e folësve kryesorë në këtë konferencë u paraqitën: Prof. Dr. Bardhyl Musai, nga Universiteti i Tiranës; Prof. Dr. Pablo Campos Calvo Sotelo, nga Universiteti San Pablo CEU; Prof. Dr. Theodor Leiber Evalag, nga Universiteti i Augsburgut; Maria Joao Rosa, nga Universiteti i Aveiro si dhe James Williams, nga Universiteti i Birmingham.

Gjatë fjalimeve u diskutuan dhe shkëmbyen idetë në lidhje me hapësirat mësimore, në bazë të perspektivës arkitekturore, projektimit të tyre, trendeve aktuale dhe zbatimin e hapësirave në arsimin e lartë.








MBAHET SIMPOZIUMI "HAPËSIRAT NË ARSIMIN E LARTË"

21 tetor 2022

Në kuadër të konferencës rajonale për hapësirat e mësimit në arsim, në ditën e fundit u mbajt edhe simpoziumi dedikuar hapësirave mësimore në arsimin lartë. Të ftuar në këtë ngjarje shkencore ishin studiues nga rajoni si: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe nga disa vende të Evropës. Ata diskutuan se si arsimi i lartë përcakton hapësirat në arsim dhe si duhet të jenë të zhvilluara ato, duke sjellur përvojat e tyre në lidhje me këtë temë.





Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha bashkë me prof. dr. James Williams nga Birmingham University, bënë hapjen e simpoziumit ku thanë se prezantimet që do të paraqiten, do të merren në konsideratë më vonë, në lidhje me projektin që ka të bëjë me "Hapësirat e mësimit në arsim". Ndërsa Prorektori për Çështje Mësimore i Kolegjit AAB, Prof.ass.dr.Shemsedin Vehapi, tregoi për ndërlidhjen e hapësirave me konceptin e mësimdhënies me studentin në qendër. Ai tha se në Kolegjin AAB, rol të madh kanë hapësirat arsimore, por edhe mjedisi që siguron hapësira të mjaftueshme për realizimin e të gjitha veprimtarive, në veçanti programeve studimore që ofrohen.






Tutje prof. dr Theodor Leiber (Evaluation Agency Baden-Württemberg, Gjermani), që ishte edhe një nga partnerët e kësaj konference, ka dhënë propozime për parimet e dizajnimit të hapësirave të arsimit të lartë.
Në fund të simpoziumit pati pyetje për folësit dhe diskutime, ndërsa u shpërndanë edhe certifikata mirënjohjeje.

PROFESORI I AAB-së, ALEKSANDAR TAKOVSKI MBAJTI LIGJËRATË NË UNIVERSITETIN E HELSINKIT

24 tetor 2022

Profesori i Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, Prof.asoc. dr.Aleksandar Takovski, ka mbajtur një ligjëratë në Universitetin e Helsinkit – Finlandë, në kuadër të Programit për Antropologji Kulturore dhe Sociale të Universitetit të Helsinkit.






Prof. Takovski prezantoi të dhënat nga hulumtimi i tij: "Through the Laughing Glass", para profesorëve dhe hulumtuesve të njohur. Hulumtimet qe prezantoi prof. Takovski, kanë një rëndësi të veçantë pasi informojnë të tjerët për aspektet gjuhësore dhe kulturore të një vendi, duke lënë hapsirë për komunikim të mirëfilltë mes etnive të ndryshme.

DEKANI I FAKULTETIT JURIDIK PJESË E "SAMITIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR 2022"

25 tetor 2022

Në "Samitin e Ballkanit Perëndimor 2022" që u mbajt në Prishtinë, mori pjesë edhe dekani i Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, Veton Vula.

Në këtë Samit morën pjesë edhe personalitete të rëndësishme në vend si Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, Ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ish presidenti i Parlamentit Evropian, Martin Schulz, ish kryeministri i Greqisë, George Papandreu dhe ish ndihmës sekretar i SHBA-ve për Evropën dhe Azinë, West Mitchel.







Temë kryesore e këtij samiti ishte ndërtimi i urave për paqe, prosperitet dhe solidaritet në Ballkanin Perëndimor.

KOLEGJI AAB BASHKËORGANIZATOR I TRAJNIMIT NDËRKOMBËTAR ME UNIVERSITETIN "DOKUZ EYLÜL"

25 tetor 2022

Në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin "Dokuz Eylül" nga Turqia, Fakulteti i Infermierisë i Kolegjit AAB do të jetë bashkorganizator i trajnimit ndërkombëtar ku do të marrin pjesë profesionistë shëndetësor nga vendi, rajoni e bota.



Trajnimi me temën "Knowledge of Patients with Hypertension About Lifestyle, Compliance with Medications and Complications of Hypertension in Kosovo", do të mbahet nga prof. Elizabeta Sheremetaj. Derisa nga universiteti turk "Dokuz Eylül", Dilek Sezgin do flasë në lidhje me temën "Nursing Care Management of Patients with Pulmonary Arterial Hypertension".

Aktiviteti mbahet me 27 tetor në orën 12:30-14:00, kurse qëllim i këtij trajnimi është edhe përfshirja e studentëve të Fakultetit të Infermierisë të Kolegjit AAB në praktikat më moderne në shëndetësi dhe njohjen me hierarkinë e sistemit shëndetësor në vende të ndryshme të botës.

U MBAJT TRAJNIMI PËR MODELET E TRANSFERIT TË KËRKIMEVE DHE TEKNOLOGJISË NGA EDUTASK

26 tetor 2022

Një pjesë e stafit akademik të Kolegjit AAB, ndoqën trajnimin dyditor të organizuar nga EduTask. Trajnimi me titull "Modelet e transferit të kërkimeve dhe teknologjisë", u udhëhoq nga ekspertja ndërkombëtare Prof. ass. Petra Karanikic.





Ky trajnim ishte një prej shumë të tjerëve që janë pjesë e projektit të titulluar "Nxitja e aktiviteteve të hulumtimit aplikativ në Kosovë", që për qëllim ka shkëmbimin e ideve dhe shpalosjen e mundësive të hulumtuesve, dhe ndërlidhjen e hulumtimeve të tyre me industrinë.

Pjesëmarrja e Kolegjit AAB në trajnime të tilla, zgjeron edhe më tutje bashkëpunimin me partnerë të shumtë, dhe kontribuon në avancimin profesional të stafit.

TRYEZË E PËRBASHKËT DISKUTIMI E STUDENTËVE TË AAB-së DHE STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "METROPOLITAN" NGA TIRANA

27 tetor 2022

Studentët e Klubit të Debatit të Fakultetit të Gjuhës Angleze nga Kolegji AAB dhe studentët e Universitetit "Metropolitan" nga Tirana, u takuan për herë të dytë që të ndajnë eksperiencat e tyre studentore.





Ata diskutuan për rëndësinë e aktiviteteve që ndihmojnë në zhvillimin profesional dhe personal të tyre. Ky diskutim u mundësoi studentëve të Kolegjit AAB dhe atyre të UMT-së të ndajnë përvojat e tyre në projekte dhe aktivitete studentore, qofshin ato projekte shkencore, sociale apo humanitare, por që në fokus kanë avancimin dhe përgatitjen për tregun e punës.

Të dy palët shkëmbyen ide për bashkëpunimin e radhës në të cilin do të përfshihen edhe shumë studentë të tjerë të këtyre dy institucioneve.







EVP TRAJNIMET: "MENAXHIMI I DHIMBJES"

27 tetor 2022

Në vazhdën e trajnimeve për Edukimint e Vazhdueshëm Profesional, Fakulteti i Infermierisë organizon trajnimin e radhës më datën 10 nëntor. Tematika e këtij trajnimi do jetë "Menaxhimi i dhimbjes", me ligjëruese Edona Haxhijaj.



Për këtë trajnim do të mund të aplikojnë të gjitha profilet shëndetësore dhe jo-shëndetësore, të cilët dëshirojnë të mësojnë më shumë për sfidat në kujdesin shëndetësor, dhe menaxhimin e dhimbjeve te pacientët me sëmundje të ndryshme.

NË AAB U MBAJT KONFERENCA E 13-TË VJETORE E SHKENCAVE MJEKO-LIGJORE

27 tetor 2022

Për herë të parë në Kosovë u mbajt edicioni i 13-të i Konferencës Vjetore të Shkencave Mjeko-Ligjore, nikoqir i së cilës ishte Kolegji AAB. Kjo konferencë treditore është organizuar në bashkëpunim me Akademinë Ballkanike të Shkencave Mjeko-Ligjore, e ku morën pjesë mbi 100 pjesëmarrës nga e mbarë bota.





Kryetari i kësaj konference, njëherit ligjërues në Kolegjin AAB, Prof. dr. Naim Uka në fjalën hyrëse falënderoi pjesëmarrësit, të cilët i inkurajoi të shkëmbejnë njohuritë dhe përvojën nga fusha të ndryshme të shkencave kriminalistike, duke përmirësuar dhe ndërtuar kërkimet dhe studimet më të larta shkencore.

Ndërsa Prorektorja për Shkencë dhe Kërkime në Kolegjin AAB, Dr. Uranela Demaj, tha se është e gëzuar me faktin se edhe studentët do jenë pjesë e kësaj konference, për të mësuar gjëra të reja rreth këtyre kërkimeve shkencore. Të pranishëm ishin edhe Zv. Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, z. Blerim Gashani dhe Prof. dr. Ersi Kalfoğlu, Presidente e BAFS.

Përveç konferencës u mbajtën edhe punëtori dhe seanca të shumta, në të cilat u trajtuan tema me rëndësi nga fusha e shkencave mjeko-ligjore.













"NJË VIT PA BUQEN..." – TAKIMI PËRKUJTIMOR NË NDERIM TË VEPRËS DHE JETËS SË BURBUQE BERISHËS

27 tetor 2022

Në Teatrin AAB "Faruk Begolli", u mbajt takim përkujtimor në një vjetorin e kalimit në amshim të regjisores Burbuqe Berisha. Familjarët, miqtë e kolegët e Burbuqes, kujtuan me mall punën dhe angazhimin e madh që ajo ka bërë në sferën e kulturës, duke dhënë kontribute të pashlyeshme.



Motra e Burbuqes, Trëndelina Berisha, tha se ndihet krenare për sukseset që ajo ka shënuar dhe se si kujtohet vepra e jeta e saj pas një viti.

Miku i saj i afërt dhe aktori i njohur, Ilir Tafa, falënderoi për pjesëmarrje të pranishmit, duke thënë se kujtimet për miken e tij Buqen, kanë mbetur të pashlyeshme dhe secili në Kolegjin AAB mban në zemër një kujtim për të.




Shkurta Aliu, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, tha se humbja e Burbuqes ishte humbja e një figure shumë të rëndësishme të artit. Ajo shtoi se Ministria e Kulturës do angazhohet në maksimum që trashëgimia e saj të përcillet deri te gjeneratat e tjera me shumë krenari.






KOLEGJI AAB BASHKORGANIZATOR I PANAIRIT TË UNIVERSITETEVE FRANCEZE

28 tetor 2022

Në Bibliotekën Kombëtare të Prishtinës me 31 tetor nga ora 10:00 deri në 15:00, do të mbahet Panairi i Universiteteve Franceze, ku bashkëorganizator është Kolegji AAB. Ky panair do shërbejë si mundësi për zbulimin e programeve mësimore, shkëmbimeve dhe mundësive për të studiuar në Francë me përfaqësuesit e shumtë të universiteteve franceze.

Pjesëmarrja e Kolegjit AAB si bashkorganizator në këtë edicion të panairit, luan një rol të rëndësishëm në krijimin e raporteve me universitetet franceze dhe mundësitë për studentët në eksplorimin akademik edhe jashtë kufijve



FAKULTETI JURIDIK NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME UNIVERSITETIN E SILESIAS TË POLONISË

31 tetor 2022

Përfaqësuar nga Dekani i Fakultetit Juridik, Veton Vula, ky fakultet ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Silesias në Katowice të Polonisë.

Marrëveshja përfshin bashkëpunimin akademik me interes të përbashkët, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, projekte Erasmus, seminare, e konferenca shkencore. Koordinator i implementimit të marrëveshjes nga Kolegji AAB u emërua prof. Mensut Ademi.



Universiteti i Silesias në Katowice është themeluar para më shumë se pesë dekadash dhe ofron studime në mbi 70 programe të nivelit bachelor, master e doktoraturë.





IP "DUA" PUNËSON SHTATË STUDENTE TË KOLEGJIT AAB

31 tetor 2022

Bashkëpunimet e Kolegjit AAB me institucionet parashkollore kanë ndihmuar studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale që shumë më shpejt të përfshihen në tregun e punës. Shtatë studente nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, tashmë punojnë si edukatore në kopshtin parashkollor "Dua".



Studentja Drenushë Gashi është punësuar si menaxhere e kopshtit, ndërsa Valza Konjuhi, Elizabeta Hoxha, Vanesa Elezaj, Ardita Veliqi, Floriana Morina e Arjeta Rukovci, janë punësuar si edukatore në këtë kopsht.

IP "Dua" gjendet në komunën e Fushë Kosovës, ku bëjnë pjesë fëmijët e grupmoshave 0-6 vjet.

NËNTOR 2022

PREZANTOHET PROGRAMI "WORK AND TRAVEL" PËR STUDENTËT E AAB-së

1 nëntor 2022

Në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës, në Kolegjin AAB u mbajt sesion informues nga Worki, për programin "Work and Travel". Në këtë sesion studentët e Kolegjit AAB u informuan mbi mundësitë e punësimit në Gjermani ose në Amerikë për të krijuar kështu aventura e përvoja të reja e të paharrueshme.









Përmes këtij programi studentët do kenë mundësinë të jetojnë në një vend tjetër si dhe të punojnë gjatë pushimeve verore, për 90 ditë.

QENDRA PËR PUNËSIM E FERIZAJT ZHVILLON AKTIVITET INFORMUES PËR STUDENTËT E AAB-së

1 nëntor 2022

Në hapësirat e kampusit të Kolegjit AAB në Ferizaj, u mbajt një aktivitet nga Qendra për Punësim e kësaj komune. Kjo qendër ka shprehur vullnetin për bashkëpunim me studentët e Kolegjit AAB, duke ofruar punë praktike me pagesë ta.





Drejtori i kësaj qendre Naim Gashi, tha se kjo mundësi ofrohet në mënyrë që studentët të mos i lënë anash studimet por edhe të fillojnë qasjen në tregun e punës.

Përfaqësuesit e Qendrës për Punësim në Ferizaj u pritën nga drejtori i degës së Kolegjit AAB, prof.dr.Shaip Bytyqi.

HAPET ZYRTARISHT EKSPOZITA DIGJITALE "ESCAPE" NË KOLEGJIN AAB

1 nëntor 2022

Në bashkëpunim me zyrën e Aleancës Franceze në Prishtinë, në Galerinë e Arteve të Kolegjit AAB, u hap zyrtarisht ekspozita digjitale "Escape".

Kjo ekspozitë që do jetë e hapur për një javë, është përshëndetur nga rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, i cili tha se është kënaqësi e veçantë kur në kuadër të bashkëpunimit me zyrën franceze organizohen ngjarje të tilla në Kolegjin AAB.











Drejtoresha e Aleancës franceze, Anne Sophie, tha se është tejet e lumtur dhe e nderuar që është pjesë e hapjes së ekspozitës digjitale "Escape", duke shtuar se përmes saj mundësohet promovimi i diversitetit në digjitalizim.
Ekspozita digjitale "Escape" pret të gjithë të interesuarit ta vizitojnë atë në Galerinë e Arteve të Kolegjit AAB.

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME IP "KINDERLAND"

2 nëntor 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale i Kolegjit AAB ka nënshkruar një tjetër marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e pjesës praktike për studentët.

Ky bashkëpunim është nënshkruar nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, Hysen Kasumi dhe udhëheqësve të IP "Kinderland".



Kolegji AAB në kuadër të marrëveshjeve të vazhdueshme me institucione parashkollore, përgatit studentët që të kryejnë praktika që iu ndihmojnë si gjatë studimeve ashtu edhe pas përfundimit të tyre.



SHTËPIA E NJOHUR BOTUESE "SPRINGER" PUBLIKON STUDIMIN E DY PROFESORËVE TË AAB-SË

2 nëntor 2022

"Kompetencat digjitale të arsimtarëve të ardhshëm në Kosovë" është studimi i fundit i dy profesorëve të AAB-së, Hasan Saliu dhe Arberore Bicaj, të cilin e ka botuar shtëpia e njohur botuese, "Springer", e indeksuar në Scopus dhe Web of Science.



Qëllimi i këtij studimi i realizuar nga profesorët Saliu dhe Bicaj, ka qenë të identifikohet niveli i përgatitjes së studentëve për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në punën e tyre si mësimdhënës të ardhshëm në Kosovë. Gjetjet nga ky studim janë nxjerrë duke analizuar lëndët e ofruara gjatë studimeve universitare në Kosovë, nëse ato arrijnë të zhvillojnë kompetenca digjitale sipas këtyre tre grupimeve: (a) kompetenca në përdorimin e përgjithshëm të kompjuterëve, (b) kompetenca e mësimdhënies digjitale dhe (c) kompetenca digjitale profesionale.

Studimi i profesorëve të AAB-së është botuar në kuadër të përmbledhjes studimore Digital Literacy for Teachers, ku janë përfshirë 25 studime nga vende të ndryshme nga Europa, Amerika dhe Azia, e redaktuar nga profesori polak Lukasz Tomczyk dhe profesoresha italiane Laura Fedeli.

U MBAJT TRAJNIMI PËR STUDENTË "KOMUNIKIMI, TË FOLURIT NË PUBLIK DHE GJUHA E TRUPIT"

3 nëntor 2022

Studentët nga Fakulteti i Gjuhës Angleze dhe Administratës Publike të Kolegjit AAB, kanë marrë pjesë në trajnimin "Komunikimi, të folurit në publik dhe gjuha e trupit". Ky trajnim u mbajt nga specialisti i komunikimit Rildo Ngjela, me një eksperiencë të pasur dhe shumëvjeçare si trajnues që ka në fokus grupe të ndryshme në Shqipëri.









Studentët e Kolegjit AAB, u përfshinë në disa aktivitete grupore ku shfaqën aftësitë e tyre në komunikim me publikun. Derisa patën rastin të studionin edhe mënyrën e komunikimit të disa personazheve publike dhe reagimet e tyre në situata të ndryshme televizive.

REVISTA PRESTIGJIOZE GPIR E SHTËPISË BOTUESE "SAGE PUBLISHING", PUBLIKON STUDIMIN E PROFESORIT SHPEND VOCA

3 nëntor 2022

Studimi i titulluar „Vlerësimet për viktimizim ndërlidhen me gatishmërinë për të kontaktuar ish-armiqtë përmes empatisë dhe mirëbesimit" është studim me dizajn korrelacional, i profesorit të AAB-së Shpend Voca, i cili është publikuar nga revista prestigjioze me faktor të lartë indeksimi, "Group Processes & Intergroup Relations" (GPIR), e që botohet nga Sage Publishing.



Studimi tregon se besimi që lufta ka shkaktuar vuajtje si te anëtarët e grupit që i takojnë pjesëmarrësit ashtu edhe te ish-armiqtë nxit gatishmërinë më të madhe për të kontakuar ish-armiqtë, një aspekt shumë i rëndësishëm për ndryshime pozitive në raporte ndërgrupore në shoqëritë e pas-luftës.

Në anën tjetër, besimi se anëtarët e grupit që i takojnë pjesëmarrësit kanë vuajtur më shumë se ish-armiqtë zbeh gatishmërinë për të kontaktuar ish-armiqtë, kështu duke mbajtur të tensionuar marrëdhëniet në shoqëritë e pas-luftës.

Për më shumë, punimin mund ta lexoni në këtë link: https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/13684302221084859

TRE STUDENTË TË KOLEGJIT AAB FILLOJNË PUNËN PRAKTIKE NË BANKËN PËR BIZNES

3 nëntor 2022

Sistemimi dhe angazhimi i studentëve qoftë në praktika profesonale, qoftë në vende pune, po vazhdon çdo ditë në koordinim të Qendrës për Karrierë me fakultetet përkatëse.



Edhe tre studentë të tjerë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike e Fakultetit Ekonomik, së fundmi filluan punën praktike në institucionin financiar Banka për Biznes.

Studentët Diellza Hajredini, Nderim Krasniqi e Xhafer Qata thanë se janë shumë të lumtur për këtë mundësi, të cilën e shohin edhe si një hap shumë të rëndësishëm drejt avancimit të tyre profesional.

OJQ "DYVO" MBAJTI LIGJËRATË PËR NDOTJEN PLASTIKE DHE INOVACIONIN NË INDUSTRI

3 nëntor 2022

Organizata Joqeveritare "DYVO" mbajti ligjëratë në lidhje me "Ndotjen plastike dhe inovacionin në industri" për studentët e Fakultetit të Arkitekturës. Studentët patën rastin të bashkëbisedojnë gjatë kësaj ligjërate, duke shprehur idetë e tyre dhe pikëpamjet se sa material i rrezikshëm mund të jetë plastika.







OJQ DYVO, tha se pret bashkëpunime të tjera me studentët e Kolegjit AAB, duke treguar se mund të marrin pjesë në punëtori, projekte, maratona të dizajnit dhe në ligjëratat e ardhshme që do të organizohen.

QENDRA E KARRIERËS ORGANIZOI TRAJNIMIN "PARAPËRGATITJE PËR TREGUN E PUNËS"

4 nëntor 2022

Në kuadër të aktiviteteve të Qendrës së Karrierës të Kolegjit AAB, në bashkëpunim me GIZ DIMAK u mbajt trajnimi i radhës në lidhje me parapërgatitjen për tregun e punës.



Para studentëve të Kolegjit AAB, nga GIZ DIMAK u prezantuan modele se si duhet të shkruhet një CV, cover letter dhe si zhvillohet një intervistë pune. Numri i studentëve të interesuar ishte shumë i madh, ndërsa treguan për përvojat e tyre që kanë në lidhje me aplikimin për vende të punës dhe se si mendojnë se duhet të plotësohen kualifikimet e kërkuara.





Në fund pati edhe improvizime të një interviste pune, ku studentët praktikuan se si zhvillohet një e tillë me punëdhënësit dhe aplikuesit për një vend të caktuar pune.

PROMOVOHET LIBRI I PROFESORËVE TË AAB-së "KIRURGJIA PËR INFERMIERË"

4 nëntor 2022

Në Kolegjin AAB u mbajt promovimi i librit "Kirurgjia për Infermierë", i autorëve Luan Jaha, Agreta Gecaj-Gashi dhe Idriz Sopjani. Të tre autorët janë profesorë në Fakultetin e Infermierisë të Kolegjit AAB dhe pikërisht ky libër u dedikohet infermierëve, me fokus në kirurgji.













Në promovimin e librit, autorët thanë se ndihen të privilegjuar që sadopak po japin kontributin e tyre në lëminë e kirurgjisë, duke i ndihmuar kështu infermierët e rinj dhe studentët.

Prof. ass. dr. Luan Jaha, tha se në këtë libër kanë bërë bashkë përvojën e tyre me dy autorët e tjerë, prof. ass. dr. Agreta Gecaj-Gashi dhe prof. ass. dr. Idriz Sopjani, duke shtuar se ky libër do t' u shërbejë infermierëve të punojnë me kompetencë dhe se kompetenca është elementare në profesionin e tyre.

Prorektorja për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, Venera Llunji, ndër të tjera tha se promovimi i librave të tillë ndihmon më tutje zgjerimin në fushat shkencore dhe përgatitjen profesionale të studentëve.

I pranishëm në këtë promovim ishte edhe doajeni i kirurgjisë kosovare, Dr. Sadri Bajraktari, i cili vlerësoi tejmase punën e bërë, derisa shtoi se kontributi në këtë fushë ka rëndësi të madhe për gjeneratat e ardhshme.

Libri përbëhet nga 16 kapituj që mbulojnë tema bazike në kirurgji.

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "KIDS CLUB"

8 nëntor 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale i Kolegjit AAB, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Kids Club" nga Prishtina.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi shërben që studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, t' u ofrohet mundësia për punë praktike në IP "Kids Club".





Dekani i fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, Hysen Kasumi shtoi se marrëveshja të tilla bashkëpunimi ngërthejnë në vete rëndësinë e madhe për të ardhmen e studentëve.

AKTIVITETE STUDENTORE NË SHËNIM TË DITËS BOTËRORE TË RADIOLOGJISË

8 nëntor 2022

Në Ditën Botërore të Radiologjisë, qytetarët e Prishtinës patën rastin të kryejnë kontrolle falas nga stafi profesional dhe studentët e Kolegjit AAB. Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, qytetarët morën edhe informata në lidhje me radiologjinë, ku plotësuan një pyetësor për të parë se sa janë të informuar në lidhje me këtë fushë.






Studentët e Fakultetit të Radiologjisë, u dhanë udhëzime qytetarëve për radiologjinë si dhe promovuan programin studimor që ofrohet nga Kolegji AAB.

KOLEGJI AAB FITUES I PROJEKTIT "LIGJET DHE RREGULLATIVAT EVROPIANE TË TË BËRIT BIZNES", NË KUADËR TË ERASMUS+

9 nëntor 2022

Në kuadër të programit Jean Monnet të Erasmus+, Kolegji AAB ka fituar projektin "Ligjet dhe rregullativat evropiane të të bërit biznes". Ky është një modul i krijuar ku ligjet, rregulloret dhe standardet evropiane të të bërit biznesit janë të kontekstualizuara nga këndvështrimi i arritjeve akademike nga njëra anë dhe nga ana tjetër, mund të shërbejnë si njohuri transformuese për të mundësuar një të ardhme të rritjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet bizneseve vendore në Kosovë dhe konsumatorëve evropian.



Ky modul do të përfshihet këtë vit si lëndë zgjedhore, në nivelin Master, në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB, ndërsa të paktën 60 studentë do të ndjekin modulin çdo vit. Moduli do të ofrohet për dy semestra në dy grupe paralele.

Rikujtojmë që ky është projekti i dytë të cilin Kolegji AAB e ka fituar në kuadër të programit Jean Monnet dhe do të koordinohet nga prof. ass.dr. Donat Rexha.

AAB DEGA NË FERIZAJ NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME "KOSOVAJOB"

9 nëntor 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj u bë nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet përfaqësuar nga drejtori i degës, prof.ass.dr. Shaip Bytyqi dhe përfaqësuesi i "Kosovajob", Shkamb Kërleshi.



Të dy palët u shprehën të lumtur për marëveshjen e arritur dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, ndërkohë që përfaqësuesi i kësaj platforme, Shkamb Kërleshi, mbajti edhe një sesion informues për studentët. Ai u tregoi atyre se si mund të marrin pjesë në punë praktike në institucione të ndryshme, ku platforma KosovaJob shërben si urë lidhëse duke iu mundësuar qasje më të lehtë me punëdhënësit.

KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME UNIVERSITETIN "ANADOLU" TË TURQISË

10 nëntor 2022

Një tjetër marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar mes Kolegjit AAB dhe njërit prej universiteteve më të mira publike të Turqisë, "Anadolu University". Kjo marrëveshje e nënshkruar ngërthen në vete: shkëmbimin e stafit, studentëve dhe studiuesve kërkimorë.



Gjithashtu në kuadër të kësaj marrëveshje përfshihen edhe organizimi i aktiviteteve dhe leksioneve të përbashkëta kërkimore, pjesëmarrja në seminare dhe takime akademike si dhe shkëmbimi i materialeve akademike. Marrëveshja me "Anadolu University" i shtohet listës së gjatë të partnerëve prestigjiozë të Kolegjit AAB nga vendi, rajoni e bota.

UDHËHEQËSIT E AAB U PRITËN NË TAKIM NGA ZYRA E ERASMUS+ KOSOVA

10 nëntor 2022

Rektori i Kolegjit AAB Bujar Demjaha, bashkë me Prorektoren për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Venera Llunji dhe udhëheqësen e Zyres së Projekteve në AAB, Erëza Mehmeti, kanë vizituar zyret e Erasmus+ Kosova.

Ata u pritën nga udhëheqësit e Erasmus+, me ç' rast u diskutua në lidhje me planet e radhës të programit Erasmus+, e ku në qendër janë idetë dhe mundësitë e reja për zhvillim në institucionet arsimore, si Kolegji AAB.




NË TEATRIN KAMERTAL AAB U DHA SHFAQJA "LE PRÉNOM"

11 nëntor 2022

Mbrëmë në Teatrin Kamertal të Kolegjit AAB, u dha shfaqja e pjesës teatrale "Le Prénom", në gjuhën frënge. Kjo shfaqje zgjoi interesim të madh tek të pranishmit, për shkak të temës që trajtonte, një komedi e realizuar me mjeshtëri nga grupi teatral franko-zviceran me origjinë shqiptare "Théâtre Kurora".








Në këtë shfaqje pati të ftuar përfaqësues të ambasadës franceze, nga ambasada e Zvicrës dhe Kanadasë, dhe studentët e fakultetit të gjuhës frënge të Universitetit të Prishtinës.

Kjo shfaqje u organizua për nder të shkrimtarit të njohur Ali Podrimja, duke qenë kështu një ndër aktivitetet e shumta që Kolegji AAB mban në kujtim të veprës dhe jetës së tij.

KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN "BARLETI" TË TIRANËS

11 nëntor 2022

Përfaqësues të Universitetit "Barleti" nga Tirana, vizituan Kolegjin AAB me ç' rast u bë edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.









Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, me këtë rast tha se kjo marrëveshje luan rol të rëndësishëm si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët. Ndërsa nga universiteti "Barleti", thanë se njohin kushtet ideale që ofron Kolegji AAB për studentët dhe kjo ishte një shtytje që të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi.

Nga të dyja palët u shpreh interesimi për bashkëpunimet e radhës dhe thellimin e tyre duke pasur parasysh dobitë që sjellin ato në sfera të ndryshme.

ERASMUS MUNDUS: THIRRJE PËR APLIKIM PËR STUDIME MASTER NË BELGJIKË

12 nëntor 2022

Të gjithë studentët e Kolegjit AAB, tanimë kanë mundësinë që rrugëtimin e tyre akademik ta vazhdojnë edhe jashtë vendit. Programi ERASMUS MUNDUS ofron këtë mundësi, ku studentët mund të vazhdojnë nivelin master në universitetin e Ghent, Belgjikë.



Kjo ftesë vlen për të gjithë studentët e interesuar, të cilët njëkohësisht plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjitha detajet tjera mund t 'i gjeni në faqen zyrtare të universitetit Ghent.

ZGJIDHET KRYESIA E RE E KLUBIT TË EKONOMISTËVE TË RINJ TË KOLEGJIT AAB

13 nëntor 2022

Është zgjedhur kryesia e re e Klubit të Ekonomistëve të Rinj të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, me kryetare Fationa Geci dhe nënkryetar Rexhep Pajaziti.

Dekani i Fakultetit Ekonomik, Medain Hashani, iu uroi suksese kryesisë së re të klubit, duke shtuar se do kenë përkrahjen e vazhdueshme për çdo iniciativë që ata ndërmarrin.















Kryesia e re tha se gjatë mandatit të tyre do angazhohen që të organizohen kuize të ndryshme, aktivitete dhe ligjërata me përfaqësues të bankave apo institucioneve të ndryshme ekonomike. Aktivitetet e Klubit do të nisin në koordinim me menaxhmentin e Fakultetit, në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë që do të mbahet nga datat 14 – 20 nëntor.

U MBAJT LIGJËRATË SPECIALE PËR ORGANET E ADMINISTRIMIT LOKAL

14 nëntor 2022

Studentë nga Fakulteti i Administratës Publike të Kolegjit AAB, kanë mbajtur ligjëratë të hapur virtuale me prof. dr. Jusuf Zeneli nga Maqedonia e Veriut. Kjo ligjëratë trajtoi temën "Organet e administrimit lokal", ku në qendër ishte aspekti krahasues mes legjislacionit të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe legjislacionit të Republikës së Kosovës.



Prof. Zeneli i cili mban pozitën e dekanit të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ishte i hapur për pyetjet e studentëve të Kolegjit AAB, duke krijuar kështu një diskutim të përbashkët për këtë temë.

HAPET ZYRTARISHT JAVA GLOBALE E NDËRMARRËSISË (GEW 2022) NË KOLEGJIN AAB

14 nëntor 2022

Sot është hapur zyrtarisht Java Globale e Ndërmarrësisë, ku nikoqir i kësaj ngjarje madhështore është Kolegji AAB me partnerë ICK. Të ftuar në ceremoninë hapëse ishin ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë, Rozeta Hajdari, përfaqësues nga ambasadat e Japonisë, Kroacisë, Francës në Kosovë, Drejtori Ekzekutiv i Qendrës Inovative në Kosovë (ICK), Uranik Begu dhe Drejtori Ekzekutiv në Odën Amerikane në Kosovë, Arian Zeka.













Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, iu uroi javë të mbarë të pranishmve duke thënë se përzgjedhja që Kolegji AAB të jetë nikoqir i kësaj ngjarje është një nder, pasi është dhënë kontribut për punësimin e mijëra të rinjve nga komuna të ndryshme të Kosovës, që kanë studiuar në Kolegjin AAB.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë, Rozeta Hajdari, në fjalën e saj tha se ka shpresë te rinia e Kosovës në zhvillimin e mëtutjeshëm të industrisë e ndërmarrësisë, pasi ata janë resursi kryesor. Ndërsa, Uranik Begu, drejtor ekzekutiv në ICK- Qendra Inovative në Kosovë, njëherit bashkëorganizator i kësaj jave, tha se është kënaqësi që JGN në këtë vit jubile shënohet në Kolegjin AAB dhe se ka shumëçka për të treguar e krenuar ndër këto vite.





Në fund të hapjes zyrtare u mbajt diskutim mes panelistëve rreth: "Rolit të investimeve Joint venture në zhvillimin e ndërmarrësisë në Kosovë".
Java Globale e Ndërmarrësisë 2022, do të zgjasë nga 14-20 nëntor, ndërsa çdo ditë do të zhvillohen aktivitete, panele dhe ngjarje që ndërlidhen me ndërmarrësinë.

ME AKTIVITETE STUDUDENTORE SHËNOHET DITA BOTËRORE E DIABETIT

14 nëntor 2022

Sot është shënuar Dita Botërore e Diabetit, ndërsa studentët e Fakultetit të Infermierisë të Kolegjit AAB, kanë ofruar falas matjen e glikemisë për studentët e interesuar.



Glikemia, që njihet si test për matjen e sheqerit në gjak, ofrohet edhe nesër në sheshin e Prishtinës nga studentët e Kolegjit AAB, duke filluar nga ora 09:00-13:00, në kuadër të organizimit të Drejtorisë së Shëndetësisë së Prishtinës për "Javën e Diabetit".

Aktivitete të tilla nga ky fakultet shërbejnë për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe për t' i ndihmuar ata që të evidentojnë problemet e tyre shëndetësore.

UNICEF DHE RRJETI CSR OFROJNË PUNË PRAKTIKE ME PAGESË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

14 nëntor 2022

Në Kolegjin AAB, përfaqësues nga UNICEF dhe Rrjeti CSR kanë mbajtur prezantim për të informuar studentët për punë praktike me pagesë.
Studentëve iu prezantua nisma e emërtuar "KosovoGeneralUnlimited", që ndërlidhet me fuqizimin e të rinjve për zhvillimin e shkathtësive përmes punës praktike. Në këtë nismë pjesëmarrës do të jenë 10,000 të rinj gjatë dy viteve të ardhshme dhe studentët e Kolegjit AAB mund të jenë prej tyre për aplikim.






Punët praktike ndihmojnë studentët e Kolegjit AAB që në të ardhmen të ndërtojnë CV, mundësi të trajnimeve për një karrierë sa më të suksesshme. Detajet dhe linku për aplikim për punë praktike me pagesë: www.kosovogenu.com

QENDRA PËR PUNËSIM OFRON PUNË PRAKTIKE ME PAGESË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB NË FERIZAJ

15 nëntor 2022

Qendra për Punësim ka mbajtur sesionin e dytë informues në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj, ku njoftoi studentët për punë praktike me pagesë. Gjatë këtij sesioni të pranishëm ishin edhe pjesëtarë të KFOR-it, që veprojnë në kuadër të kësaj qendre, të cilët zhvilluan takim me drejtorin e kampusit të Kolegjit AAB në Ferizaj.



Studentët patën rastin të njoftohen nga stafi i qendrës në lidhje me punën praktike me pagesë në këtë institucion, në diskutimet e përbashkëta që u zhvilluan në hapësirat e kampusit gjatë tërë ditës.

ERASMUS+: HAPET THIRRJA PËR APLIKIM NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA "SUAS" NË GJERMANI

15 nëntor 2022

Kolegji AAB hap thirrjen për shkëmbim studentor, në kuadër të programit Erasmus+ në University of Applied Sciences (SUAS), Schmalkalden-Gjermani. Ky shkëmbim do të bëhet për semestrin veror të 2023 dhe të drejtë aplikimi kanë studentët aktiv të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB.



Të gjithë studentët e interesuar mund të plotësojnë formularin e aplikimit përmes këtij linku: https://forms.gle/xhTyGvPpVhsPPd8y7

Data e fundit për aplikim është 18.11.2022, ora 13:00.

FKF NËNSHKROI MARRËVESHJE ME UNIVERSITETIN "BARLETI"

15 nëntor 2022

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Universitetit "Barleti" nga Tirana.







Kjo marrëveshje përfshin shkëmbimin e stafit akademik dhe administrativ, shkëmbimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave, aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor; organizimin e përbashkët të konferencave shkencore, seminareve, tryezave dhe pjesëmarrjen në takime akademike dhe forma tjera bashkëpunimi.

Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i fakultetit të Kulturës Fizike dhe Aportit, prof.asoc.dr. Fatmir Pireva dhe dekani i universitetit "Barleti" prof. dr. Artan Shyti.

"GROWTHLAB SOLUTIONS" PREZANTON PROGRAMIN E PUNËS PRAKTIKE ME PAGESË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

15 nëntor 2022

Është mbajtur aktiviteti i radhës në kuadër të Javës së Ndërmarrësisë në Kolegjin AAB. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të GrowthLab Solutions, të cilët para studentëve të Kolegjit AAB treguan përvojat e tyre ndërsa prezantuan programin e punës praktike si mundësi për të interesuarit.



Jon Mulliqi, alumni nga Universiteti "George Washington", themelues i GrowthLab Solutions, tha se kompania e tyre ndërlidhet me ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit dhe konsulenca financiare për tregun amerikan. Ai u tregoi studentëve se si është të punosh për tregun amerikan si dhe metodat që duhet zgjedhur për t' u përshtatur.

Kurse, Kreshnik Paçarada gjithashtu nga GrowthLab Solutions, u prezantoi studentëve të Kolegjit AAB programin për punën praktike me pagesë, për të cilën tha se është një mundësi ideale me kohëzgjatje prej tre muajsh.






Në fund kompania falënderoi Kolegjin AAB për privilegjin që kanë ndarë që të bëjnë prezantimet e tyre dhe kontributin që mund ta kenë në këtë sferë.

STUDENTJA MIMOZA QERIQI PUNËSOHET NË KOPSHTIN "ARDHMËRIA JONË"

16 nëntor 2022

Mimoza Qeriqi, studente e Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, është një nga studentet e shumta që tashmë është punësuar në njërin nga kopshtet e fëmijëve si edukatore. Ajo ka filluar punën në kopshtin "Ardhmëria jonë", derisa shprehu vullnetin dhe gatishmërinë që ka për këtë profesion.



Mimoza, tha se mundësitë që i janë ofruar gjatë studimeve nga stafi akademik, ligjëratat dhe mësimet që ka marrë i kanë ndihmuar që të ushtrojë sa më mirë këtë profesion tani edhe në praktikë.

GEW2022 – AKTIVITETI I RADHËS MBAHET NË KAMPUSIN E KOLEGJIT AAB NË FERIZAJ

16 nëntor 2022

Kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, këtë herë në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj, ku ndërmarrësi Betim Çerkini, i diplomuar në Kolegjin AAB, në një tryezë diskutimi foli për rolin dhe rëndësinë e kësaj jave.



Çerkini, i cili udhëheq fabrikën e prodhimit të eksplozivit "Ex Project", i shoqëruar nga Dekani i Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Medain Hashani ishte i hapur për të diskutuar me studentët se çfarë iniciativa mund të ndërmarrin ata në të ardhmen për të qenë të suksesshëm. Ai tha se rol të rëndësishëm për të shënuar suksese në karrierën e tij kishte pasur edhe fakti që studioi në Fakultetin Ekonomik të Kolegjit AAB duke i ndihmuar që biznesin e tij ta zhvillonte nga atë tregtar në prodhues.

Studentët parashtruan pyetje në lidhje me sfidat që Çerkini kishte hasur gjatë rrugës së tij dhe cilat janë hapat që duhen bërë për të qenë i suksesshëm në ndërmarrësi.

GEW2022 –TRYEZË STUDENTORE NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" TË PEJËS

16 nëntor 2022

Studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB kanë zhvilluar tryezë diskutimi me studentët e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë të Universitetit "Haxhi Zeka". Në tryezën studentore "Sfida e start-up bizneseve në Kosovë", secili pjesëmarrës pati rastin të flasë për përvojat dhe sfidat e tyre. Gjithashtu studentët treguan se tashmë kanë filluar të mendojnë për botën e biznesit dhe rrugën më të lehtë për sukses.









Ky organizim i tryezës së diskutimit u bë falë bashkëpunimit që Kolegji AAB ka me Universitetin "Haxhi Zeka" të Pejës, ndërsa nga përfaqësues të dy institucioneve u tha se përveç që kanë për qëllim të socializojnë studentët mes vete, duan që në të ardhmen ata të jenë ndërmarrës të aftë.

#AABALUMNITALK SJELL STORJEN E EMINA HYSENIT, DREJTORESHË E RADIO KFOR-it

17 nëntor 2022

Emina Hyseni, drejtoreshë e dy radiostacioneve të KFOR, para studentëve të Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB prezantoi rrugëtimin e saj profesional në kuadër të forumit #AABAlumniTalk.

Emina, tha se kishte dashuri për gazetarinë qysh nga fëmijëria e saj dhe se studimet patjetër duhej të kishin lidhje me këtë profesion. Pas studimeve në Kolegjin AAB, ajo tha se iu hapën shumë dyer në jetë. Dhe një nga dyert më të rëndësishme ishte avancimi në karrierë, duke realizuar ëndrrën e saj për të punuar në radio. Emina u tha studentëve që të mos dorëzohen dhe të ndjekin ligjëratat e aktivitetet, pasi në këtë mënyrë do të arrijnë cakun e tyre profesional.











Në fund studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB patën dhjetëra pyetje për të ftuarën, në lidhje me hapat e vështirësitë që pati gjatë këtij rrugëtimi.

"AAB Alumni Talk", është një nga aktivitetet e shumta që Qendra për Karrierë e Kolegjit AAB ka organizuar, duke sjellur kështu para studentëve njerëz të suksesshëm, figura publike që do i motivonin ata që të mos ndalen në përpjekjet e tyre akademike.

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME IP "INTERNATIONAL KINDER GARTEN"

17 nëntor 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale ka nënshkruar marrëveshjen e radhës me një institucion parashkollor, duke iu mundësuar kështu studentëve që në të ardhmen të kryejnë praktikën dhe të punësohen.

Nga IP "International Kinder Garten", me drejtoreshë Mimoza Dema dhe menaxhere Erxhina Ismajli-Lalloshi, u shprehën të privilegjuar për këtë bashkëpunim me Kolegjin AAB pasi konsiderohet hap i rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm nga të dyja palët.



Ky kopsht punon me metodologjinë e kopshteve zvicerane, duke qenë kështu një mundësi ideale për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB që të ushtrojnë profesionin e tyre dhe për t' u punësuar.



GEW2022 – "PrishtinaSKY" STORJE SUKSESI E ALUMNI FERIT KULETA

17 nëntor 2022

Në kuadër të aktiviteteve që po zhvillohen për të shënuar Javën Globale të Ndërmarrësisë, janë ftuar edhe të diplomuar e studentë të AAB-së, që kanë shënuar suksese në karrierë.

Në një ngjarje të tillë, Ferit Kuleta, pronar i agjencisë së fluturimeve "PrishtinaSKY", foli para studentëve të Kolegjit AAB se si kishte filluar idenë për këtë biznes dhe hapat që kishte ndjekur për të arritur te suksesi. E gjithë kjo, falë angazhimit të tij dhe mësimeve që mori gjatë studimeve në Kolegjin AAB. Ai tha se gjatë kohës sa ishte në studime kishte mësuar gjëra që mund t' i vendoste në praktikë dhe kjo ishte ndihma më e madhe që mund t' i ofrohej nga Kolegji AAB.









Studentët patën pyetje për Kuletën në lidhje me avantazhet dhe disavantazhet që kishte pasur që kur filloi rrugën si ndërmarrës, ndërsa e shijuan edhe storien e tij të mbushur përplot rrëfime të ndryshme.

NË GEW2022 FLITET PËR NGJASHMËRITË DHE DALLIMET E NDËRMARRËSISË NË RAJON

17 nëntor 2022

Me temën "Ngjashmëritë dhe dallimet e ndërmarrësisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni", është mbajtur tryezë diskutimi në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë në Kolegjin AAB.

Të ftuara ishin katër ndërmarrëse dhe profesoresha, të cilat treguan përvojat e tyre në fushën e ndërmarrësisë si dhe krahasuan sfidat që kalojnë bizneset në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.









Romina Radonshiqi, profesoreshë dhe ndërmarrëse tregoi për studentët e Kolegjit AAB, se në Shqipëri ende ka probleme me fuqi punëtore dhe kjo krijon ngecje te krijimi i ndërmarrjeve . Derisa Bruna Merko gjithashtu nga Shqipëria, shpalosi angazhimin që kishte bërë për të nisur një revistë ditore në Kosovë, e cila kishte rezultuar tejet e suksesshme.

Një tjetër ndërmarrëse Mia Morina, që njëherazi është edhe studente e Kolegjit AAB, tha se biznesi që e ka krijuar ajo funksionon që më shumë se 8 vjet, duke këshilluar studentët tjerë që të përcjellin me kujdes iniciativat apo thirrjet nga ministritë e ndryshme për subvencione apo çkado që lidhet me krijimin e një ndërmarrje.

Kurse dy profesoreshat e Kolegjit AAB, Florije Miftari dhe Pranvera Dalloshi, kërkuan nga studentët që të kenë guximin të rrezikojnë, pasi siç thanë ato çelësi i vendeve të reja të punës janë ndërmarrjet.

STUDENTËT E PRODUKSIONIT MEDIAL PJESË E FESTIVALIT NDËRKOMBËTAR "THE WORLD IN FIRENCE"

18 nëntor 2022

Studentët e programit Produksion Medial të Fakultetit të Komunikimit Masiv, për të dytën herë morën pjesë në festivalin e njohur ndërkombëtar "The World in Firence", me një prezantim dinjitoz që mori lavdata të mëdha nga udhëheqësit e festivalit.





Në prezantimin që u bë online, profesori Luan Tashi, bashkë me studentin e tij Art Ukça, treguan në lidhje me projektin që kishin filluar nga muaji shtator dhe që përfshinte pesë pika.

Secila prej këtyre pikave përfshinte përmbledhje për qytetin e lashtë romak – Ulpianën, Kështjellën e Artanës (Novobërdës), Sahatkulla në Prishtinë, Biblioteka Kombëtare dhe Muzeu i Kosovës që u fotografuan dhe dizajnuan në mënyrë profesionale nga studentët e këtyre fakulteteve.

Ekspozita ku do shfaqen fotografitë dhe posterët e studentëve të Kolegjit AAB, mbahet në kompleksin monumental "Santa Croce" të Firences.

FSHK NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN DIGJITALE "FERIZAJ"

18 nëntor 2022

Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Jusuf Qarkaxhija, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën Digjitale "Ferizaj". Ky bashkëpunim ka për qëllim që studentët e këtij fakulteti të kryejnë punën praktike në këtë shkollë digjitale. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve bën pjesë edhe zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta, vizitat e studentëve në shkollë, dhe anasjelltas.





Kjo do të jetë një mundësi e radhës për studentët e kampusit të Kolegjit AAB në Ferizaj, për avancim profesional të tyre.

GEW2022 – MBAHET TRAJNIMI "HARTIMI I IDESË DHE PËRGATITJA E PLANIT TË BIZNESIT"

18 nëntor 2022

Studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, patën mundësinë të ndjekin trajnimin "Hartimi i idesë dhe përgatitja e planit të biznesit", i cili u zhvillua në kuadër të GEW2022. Trajnimi u udhëhoq nga znj. Fiknete Balaj, nga "Cacttus".







Në trajnim u elaborua zhvillimi i idesë dhe planit të biznesit, duke përmendur hapat që duhet ndjekur. Balaj shtoi se duhen pasur parasysh faktorë të shumtë që do ndikonin në krijimin e një biznesi si: parashikimet financiare dhe risqet e biznesit, analiza e konkurrencës, konceptet bazë të marketingut etj.

Gjatë gjithë kohës trajnimi ishte interaktiv, ku studentët kishin mundësinë të thellojnë njohuritë për çështjet që u interesonin ne lidhje me temën.

GEW2022 – MBËSHTETJA E GRAVE NDËRMARRËSE NË KOSOVË

18 nëntor 2022

Pesë gra ndërmarrëse ishin të ftuara në takimin e radhës që u zhvillua në shënim të Javës Globale të Ndërmarrësisë, në Kolegjin AAB: Vesa Rezniqi – Pallaska nga UNDP, Vlora Avdiu Burani – EBRD, Vlora Tuzi Nushi – UN Women, Brikena Berisha – profesoreshë/ hulumtuese, Nita Halimi – ndërmarrëse.









Në këtë takim që u drejtua nga Prorektorja Venera Llunji, u fol për rolin e grave në ndërmarrje dhe ndikimin e tyre në fuqizimin e rolit të gruas qoftë në vendimmarrje, politikbërje apo udhëheqje. Hapësirë të veçantë diskutimi mori edhe aspekti i mbështetjes që marrin gratë ndërmarrëse qoftë nga institucionet vendore apo edhe nga fondet ndërkombëtare.

#AABALUMNITALK SJELL DY RRËFIME SUKSESI NGA FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

19 nëntor 2022

Melisa Osmani dhe Betim Hyseni, të diplomuar në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB, janë rikthyer sërish në hapësirat ku përfunduan suksesshëm studimet për të treguar për punën që po bëjnë tani.





Melisa Osmani, futbolliste e njohur në Kosovë, shpalosi rrugën që ndoqi për t' u bërë një nga lojtaret më të mira, duke shtuar se tani është në përfundim të kursit për trajnere të FIFA. Nëdrsa, Betim Hyseni, tashmë është punësuar në detyrën e profesorit në ASK dhe çdo ditë e vëren ndikimin e rëndësinë e studimeve.

Të dy thanë se meritat e Kolegjit AAB për sukseset e tyre të tanishme zënë një vend të veçantë, madje ata treguan edhe për eksperiencën që patën si përfitues të programit Erasmus+, ku vazhduan semestrin veror në një nga universitetet më prestigjioze në Evropë, atë të Masaryk, Çeki.

GEW 2022 - "PSE DËSHTOJNË START-UP BIZNESET"

19 nëntor 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Gjakovë u mbajt diskutim i hapur me studentët në temën "Pse dështojnë start-up bizneset".
Ky diskutim që u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Fakulteti Ekonomik për të shënuar Javën Globale të Ndërmarrësisë, solli në panel dy emra të njohur në botën e biznesit, Agron Mustafa dhe Butrin Batalli. Ata sollën pikëpamjet e tyre dhe informatat e rëndësishme me arsyet përse dështojnë start-up bizneset dhe si menaxhohen krizat në raste të tilla.





Mustafa, përmendi pasionin për biznes që sipas tij është një ndër shtyllat kryesore që të ketë rezultate në vazhdim, kurse Batalli theksoi fuqinë e komunikimit brenda një organizate, biznesi apo kompanie e që luan rol të mos falimentojë ndërmarrja në kohë krizash, çfarëdo qofshin ato.

Kështu studentët përmes bashkëbisedimit arritën të identifikojnë edhe vetvetiu shkaktarët e këtyre dështimeve duke shtruar pyetjet se si mund të evitohet kjo dukuri.

GEW2022 – U MBAJT PUNËTORIA "NDËRMARRËSI I SUKSESSHËM DHE HARTIMI I PLANIT TË BIZNESIT"

19 nëntor 2022

Aktiviteti i radhës në kuadër të GEW2022 në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj, ishte punëtoria "Ndërmarrësi i suksesshëm dhe hartimi i planit të biznesit" të cilin e drejtoi prof. Pleurat Mustafa.

Në punëtori u trajtua me shembuj konkretë hartimi i një plani të suksesshëm biznesi.

Disa nga studentët pjesëmarrës treguan eksperiencat e tyre në krijimin e bizneseve që tashmë i kanë krijuar, por u demonstruan edhe shembuj dhe ide që dolën gjatë punëtorisë.







GEW2022 - KRYETARI I KOMUNËS SË GJAKOVËS ARDIAN GJINI DISKUTOI ME STUDENTËT E AAB-së

21 nëntor 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Gjakovë, kryetari i kësaj komune Ardian Gjini, ka zhvilluar diskutim të hapur me studentët e Fakultetit Ekonomik, në kuadër të aktiviteteve të shumta të Javës Globale të Ndërmarrësisë.

"Roli i komunës në nxitjen dhe mbështetjen e inovacioneve", ishte tema e diskutimit ku kryetari Gjini tha se komuna e Gjakovës ka të ndarë një buxhet të caktuar për inovacion, ndërsa pritet edhe krijimi i dy qendrave inovative "Bone vet" dhe "Jakova Innovation Centre".

Studentët kishin pyetje për Gjinin në lidhje me mosfunksionalizimin e zonës ekonomike në komunën e Gjakovës, për të cilën ai tha se ka rëndësi të jashtëzakonshme dhe projekti është tejzgjatur si shkak i ndërrimit të pushteteve.







Tutje Gjini u pyet edhe për mbështetjen financiare sa u përket ideve të reja, pasi të rinjtë pohuan se kanë nevojë më së shumti për një përkrahje të tillë.

PËRMBYLLET JAVA GLOBALE E NDËRMARRËSISË NË KOLEGJIN AAB

22 nëntor 2022

Është përmbyllur me sukses Java Globale e Ndërmarrësisë, duke shënuar kështu një javë me aktivitete të shumëta në të tri kampuset e Kolegjit AAB.

Në aktivitetin përmbyllëse u mbajt tryeza: "Sfidat e ndërmarrësve gjatë fazës së inflacionit në Kosovë", ku morën pjesë përfaqësues nga ndërmarrjet private dhe akterë institucionalë, e të cilën e drejtoi dekani i Fakultetit Ekonomik, Medain Hashani.

Në këtë tryezë, drejtori ekzekutiv i Viva Fresh Logistic, Xhevdet Rexhepi, shpalosi sfidat e problemet që kanë hasur si ndërmarrje në fazën e inflacionit, duke thënë se në raste të tilla mbështetja nuk duhet të mungojë nga institucionet dhe as nga partnerët tjerë.

Kurse kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, foli rreth zhvillimeve të fundit ekonomike në vend, bashkë me masat që janë ndërmarrë nga qeveria për t' u ndihmuar qytetarëve, dhe bizneseve që të kalojnë krizat globale të inflacionit







Në ditën mbyllëse të GEW2022, u mbajt edhe një debat në temën: "Ndikimi i ikjes së fuqisë punëtore në veprimtarinë biznesore. A janë duke u rritur pagat në sektorin privat?". Pjesë e këtij debati ishin Berat Mustafa, CEO nga Kompania Fluidi, njëherit përfaqësues nga sektori i prodhimit; Esad Islami, përfaqësues nga sektori i Gastronomisë dhe profesoresha e Fakultetit Ekonomik, Roberta Bajrami.

Java Globale e Ndërmarrësisë, që u mbajt në Kolegjin AAB, mundësoi që dhjetëra ndërmarrës të suksesshëm të ndajnë përvojat e tyre, qoftë me studentët apo me panele ekspertësh, duke besuar në reflektim për përmirësimin e mëtejmë të gjendjes në këtë fushë.

STUDENTJA ELDA SALLAUKA, NJË PUNONJËSE E DALLUAR NË MARKETINGUN DIGJITAL

22 nëntor 2022

Një nga njoftimet për trajnim nga kompania NextSeo, i kishte shërbyer studentes Elda Sallauka që sot të jetë pjesë e kësaj kompanie të suksesshme si punonjëse e saj.

Elda ishte bërë pjesë e trajnimit "Hyrje në Marketing Digjital dhe SEO" për 5 javë me radhë, për të vazhduar më pas me punën praktike për 5 javë të tjera. Kurse tani ajo bën 3 vjet prej kur është punësuar dhe është pjesë e kësaj kompanie.



Ajo tha se ky njoftim nga Kolegji AAB, i shërbeu si urë lidhëse për të gjetur një punë të re, dhe se përherë është mirënjohëse për njoftimet e tilla që janë në të mirë të studentëve. Tutje, Elda shtoi se edhe studimet në Kolegjin AAB nënkuptojnë mundësi në profesione të shumta që ndërlidhen me botën e komunikimit.

STUDENTËT E AAB-së MARRIN PJESË NË TURNEUN SPORTIV TË FESTAVE TË NËNTORIT, NË SHKUP

23 nëntor 2022

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup në bashkëpunim me Kolegjin AAB, kanë organizuar gara në fustsall dhe volejboll për nder të festave të nëntorit, ku garuan ekipe të studentëve nga Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB dhe të UNT. Në një atmosferë tejet të ngrohtë studentët patën mundësinë përveç të garojnë edhe të shoqërohen në një përballje miqësore mes tyre.

Përgjegjësi i programit studimor të sportit dhe shkencave sportive nga universiteti "Nënë Tereza", prof. dr. Blerim Saiti, iu uroi mirëseardhje studentëve bashkë me prorektorin prof. dr. Shemsedin Vehapi dhe dekanin e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB, prof. dr. Fatmir Pireva.







Prorektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Shemsedin Vehapi falënderoi universitetin për mikpritjen, derisa shtoi se do të kenë përkrahjen e Kolegjit AAB kurdo që të jetë nevoja. Ndërsa kryetari i komunës së Çairit, Visar Ganiu, tha se universiteti "Nënë Tereza" vlerëson lartë mbështetjen që kanë marrë nga Kolegji AAB gjatë themelimit të këtij programi studimor.

Në fund nga komuna e Çairit ndau mirënjohje për Kolegjin AAB, për mbështetjen si në aspektin e përcjelljes së përvojës ashtu edhe me sigurimin e kuadrit mësimor.

U MBAJT LIGJËRATË PËR PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

24 nëntor 2022

Aktivisti Besnik Leka, ka mbajtur ligjëratë për studentët e Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB, në lidhje me "Rëndësinë e përfshirjes së burrave në parandalim e dhunës me bazë gjinore".
Leka tha se kjo përfshirje është e domosdoshme, pasi ka rol në parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Gjatë kësaj ligjërate studentët patën mundësinë të bashkëbisedojnë me Lekën, në lidhje me rëndësinë që ka përfshirja e burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore.











Tutje studentët realizuan edhe një aktivitet ku renditën emocionet nga ato të cilat i shprehin më shumë, tek ato që hezitojnë t' i shprehin, duke i vënë në pah kështu dallimet që kishin rezultatet në fund.

Këto ligjërata për studentët e Kolegjit AAB, synojnë që të ngrisin vetëdijen për barazinë gjinore te studentët, duke mësuar gjithashtu edhe mbi rolin që ata kanë në shoqëri.

STUDENTËT E AAB-së ZHVILLOJNË KURS TË PËRBASHKËT ME STUDENTËT E IZRAELIT

24 nëntor 2022

Ka filluar zbatimi i projektit "Të njihemi nëpërmjet gjuhës angleze", në kuadër të bashkëpunimit që Fakulteti i Gjuhës Angleze ka krijuar me Western Galilee College nga Izraeli. Studentët e të dy institucioneve do të mbajnë ligjërata të përbashkëta në kuadër të lëndës "Integrated Language Skills", me mësimdhënëset Dr. Samia Zeid nga WGC dhe Eriona Ajvazi, Kolegji AAB.






Ky projekt i përbashkët ka për qëllim krijimin e një rrjetëzimi midis studentëve të të dy shteteve dhe ndërgjëgjësimin kulturor nëpërmjet komunikimit.
Gjatë orës së parë, ndër të tjera, studentët bënë prezantime rreth Kosovës, rreth monumenteve dhe vendeve turistike që duhet të vizitohen në Kosovë, si dhe rreth traditave dhe kulturës vendase. Njëjtë do të veprojnë edhe studentët nga WGC në orën e ardhshme.
Klasat e përbashkëta do të vazhdojnë deri në përfundim të kursit për të vazhduar me projektin e radhës.

ORGANIZATA "YMCA" MBAN TRAJNIM ME STUDENTËT, PËR NDALJEN E DHUNËS NË BAZA GJINORE

24 nëntor 2022

Përfaqësues nga organizata "YMCA" kanë filluar trajnimin me studentët e Kolegjit AAB, i cili ka të bëjë me ndaljen e dhunës në baza gjinore. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të programeve Y dhe Y+ nga kjo organizatë.









Studentët e Fakultetit të Psikologjisë dhe Gjuhës Angleze patën rastin të jenë pjesë e disa aktiviteteve ku u ndanë në grupe, për të diskutuar në lidhje me barazinë gjinore se cilat janë përfitimet që do ketë shoqëria. Më pas u prezantuan edhe disa statistika të përgjithshme të fenomeneve të dhunës në Kosovë.





Më tej u mbajtën edhe katër punëtori, të cilat paraqisnin detyra të ndryshme për studentët të ndarë në grupe, duke nisur nga dhuna seksuale, burrat si kujdestarë, çfarë është puna e grave, etj..
Në fund të këtij trajnimi studentët pjesëmarrës të Kolegjit AAB do të kontaktohen për punëtoritë që mbahen nga organizata, duke pasur kështu rolin e edukatorit në shkolla të mesme në Kosovë, ndërsa secila orë që do mbahet nga ta do njihet edhe ndërkombëtarisht.

AAB PJESË E SEMINARIT PËR BASHKËPUNIM ME PROGRAMIN ERASMUS+

25 nëntor 2022

Kolegji AAB mori pjesë në seminarin për bashkëpunim me programin Erasmus+, ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë të Francës dhe atyre të Ballkanit Perëndimor.

Ky seminar u mbajt në Tiranë me 22 dhe 23 nëntor, derisa nga Kolegji AAB pjesëmarrës ishin: dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Aida Alla; dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, Hysen Kasumi; koordinatorja për Sigurim të Cilësisë, Diellza Olluri dhe zyrtarja për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Projekte, Erëza Mehmeti.





Ideja e këtij seminari ishte rritja e bashkëpunimit në arsimin e lartë mes vendeve pjesëmarrëse në program, ndërsa Kolegji AAB synon të krijojë kontakte të reja për t' u identifikuar partnerët potencialë për bashkëpunimet në projektet Erasmus+.



FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "FOLEJA JONË"

25 nëntor 2022

Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, Hysen Kasumi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin Parashkollor "Foleja jonë". Ky institucion do t' iu ofrojë mundësinë studentëve të Kolegjit AAB, që të kryejnë pjesën praktike në të gjitha ambientet e "Foleja jonë".

Në këtë mënyrë studentët do kenë rastin që të krijojnë përvojë, duke pasur më shumë gjasa për punësim pas përfundimit të studimeve ose gjatë tyre.





AMBASADORI FRANCEZ NË KOSOVË: "KOSOVËS I ËSHTË DHËNË DRITA E GJELBËR PËR VIZAT"

25 nëntor 2022

Me temën "Diplomacia franceze", Ambasadori i Francës në Kosovë, Sh.T. Olivier Guérot, ka mbajtur ligjëratë para studentëve të Fakultetit të Administratës Publike. Me këtë rast ambasadori francez tregoi detajisht fazat të cilat ka kaluar Franca, të ndërlidhura me revolucionet e shumta, pastaj të drejtat e njeriut e deri te sekularizmi shtetëror, derisa shtoi se secili hap ka luajtur rol në shtetformim dhe mbarëvajtje të proceseve.

Ndër të tjera, ambasadori Guérot tha se ndihet tejet i lumtur që pati rastin të mbajë ligjëratë para studentëve të Kolegjit AAB dhe se shpreson që kjo do t' i informojë ata për rëndësinë që ka diplomacia në një shtet.








Përveç temës së ligjëratës, studentët e Kolegjit AAB shfrytëzuan mundësinë të bëjnë pyetje edhe për çështjet aktuale në raport me vendin tonë, duke pasur parasysh ndikimin e Francës në proceset ndërkombëtare. Në pyetjen e studentëve në lidhje me qëndrimin e Francës për liberalizimin e vizave për Kosovën, ambasadori Guérot tha se kurrë nuk ka qenë më afër, ndërsa shtoi se çdo përpjekje kërkon angazhim të madh, por tanimë Kosovës i është dhënë drita e gjelbër dhe ky është hapi kryesor që liberalizimi do të ndodhë.

E DIPLOMUARA VALDETE HOXHA NDAN RRËFIMIN E SAJ NË #AABALUMNITALK

25 nëntor 2022

AAB Alumni Talk, që ka për qëllim të takojë studentët e diplomuar të cilët kanë shënuar suksese profesionale me studentët aktual, ka vazhduar me Valdete Hoxhën, e diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale të Kolegjit AAB.

Valdetja, tash punon si mësuese, ndërsa tha se është puna që e bën me më së shumti kënaqësi. Ajo për studentët aktualë të Kolegjit AAB, pati një këshillë: "Mësuesi duhet të jetë hulumtues e në hap me kohën, ku puna praktike, trajnimet janë tejet të nevojshme për avancim e përgatitje në këtë profesion".







QENDRA E KARRIERËS ORGANIZON TRAJNIM FALAS PËR APLIKACIONET E MS OFFICE

26 nëntor 2022

Qendra e Karrierës së Kolegjit AAB në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike organizon trajnim pa pagesë për studentët për zhvillimin e shkathtësive në përdorimin e aplikacioneve të Microsoft Office.



Kjo pako e këtij trajnimi do përmbajë:

- MS Word,
- MS Excel,
- MS PowerPoint,
- MS Access.

Qëllimi i këtij trajnimi është që studentit t' i sigurojë njohuri të domosdoshme, me të cilat do të mundet t' i përcjellë informacionet duke shfrytëzuar teknologjitë ekzistuese bashkëkohore. Trajnimi zgjat 3 javë dhe do mbahet në laboratorët e Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB.
Për të siguruar vendin tuaj, regjistrimin duhet ta bëni në emailin: gresa.makolli@aab-edu.net deri më 30 nëntor 2022.

LIS QARKAXHIJA NGA "JULIUS MAXIMILIANS – UNIVERSITY OF WÜRZBURG", MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

29 nëntor 2022

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB ishin të pranishëm në një ligjëratë me të ftuar Lis Qarkaxhija, ligjërues në Julius Maximilians – University of Würzburg.
Qarkaxhija foli para studentëve në lidhje me temën "Graph Attention Networks and Differential Pooling", ku sqaroi rolin e grafeve të cilat po përdoren çdo ditë e më shumë si struktura abstrakte për reprezentimin e modeleve të ndryshme si në rrjetet sociale, rrjetet e-commerce, molekulat, etj.
Gjatë ligjëratës u diskutua për dy nga modelet më të njohura për mësimin e reprezentimit të grafeve të quajtura Graph Attention Networks (GAT) and DIFFPOOL e që përdoren për klasifikim të tyre.





KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME SHOQATËN PROFESIONALE TË INFORMATICIENTËVE TË KOSOVËS (SHPIK)

29 nëntor 2022

Rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Bujar Demjaha ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (SHPIK), e përfaqësuar nga Bekim Kasumi. Me këtë marrëveshje bashkëpunimi synohet ofrimi i ndihmës për studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB në ngritjen e shkathtësive digjitale dhe atyre të ndërmarrësisë e inovacionit.





Gjithashtu, kjo marrëveshje ka për qëllim ofrimin e ndihmës akademike, logjistike dhe profesionale nga Kolegji AAB, për të rinjtë që marrin pjesë në programet e mentorimit dhe trajnimit të SHPIK.

Në këtë mënyrë studentët e Kolegjit AAB, kanë mundësinë të ndërlidhen në tregun e punës duke marrë pjesë në trajnime profesionale që ndihmojnë ata në zhvillimin e aftësive të tyre.

STUDENTJA MIRLINDA GASHI ZARIQI PUNËSOHET SI EDUKATORE

29 nëntor 2022

Mirlinda Gashi Zariqi, sapo ka mbaruar studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, dhe është punësuar si edukatore. Ajo tha se vazhdimisht e kishte ndjerë dëshirën për të mësuar në lidhje me edukimin e mirëqenien e fëmijëve, ku më pas vendosi që të studiojë në këtë fakultet të Kolegjit AAB.

Tashmë ajo është punësuar si edukatore, në IP "VIP Kids", për të qenë njëra ndër shumë studentë të tjerë të Kolegjit AAB që arrijnë të punësohen menjëherë pas diplomimit.



Mirlinda shtoi se është shumë falënderuese ndaj Kolegjit AAB, e në veçanti stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale, për përgatitjen e studentëve në pavarësimin e tyre dhe nxitjen e pasionit për profesionin që do të ushtrojnë.

STUDENTI BESART PIREVA SHËNON FITOREN E PARË NË BOKSIN PROFESIONIST NË ITALI

30 nëntor 2022

Studenti i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Besart Pireva, ka luajtur ndeshjen e parë në boksin profesionist ku edhe ka shënuar fitore.

Ai u ndesh me boksierin Eprahim Valentin nga Kameruni, në kategorinë super të mesme me peshë 76.2kg. Pas 6 raundeve, Besart Pireva arriti ta rrëzojë tre herë kundërshtarin derisa lajmin për fitoren e tij e publikuan edhe mediat italiane, duke e cilësuar atë si "e ardhmja e boksit në Itali".



Besart Pireva ka vazhduar karrierën e tij në boksin profesionist me klubin Italian Castelfildardo, ndërsa ndjek studimet në vitin e tretë në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB.

KOLEGJI AAB PJESË E PANAIRIT TË PUNËS, KARRIERËS DHE NDËRMARRËSISË

30 nëntor 2022

Kolegji AAB ka marrë pjesë në Panairin e Punës, Karrierës dhe Ndërmarrësisë 2022, që po mbahet në sallën "1 Tetori". Të interesuarit janë njoftuar për mundësitë që ofron Kolegji AAB, si institucioni më i madh në vend dhe rajon për arsimin e lartë. Secili nga ta ka pasur rastin që të njoftohen detajisht në lidhje me programet e Kolegjit AAB, për nivelet bachelor dhe master.







Në panair morën pjesë numër i konsiderueshëm i vizitorëve, ndërsa patën pyetje në lidhje me punët praktike, trajnimet dhe aktivitetet që ofrohen në Kolegjin AAB.

Panairi është organizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (KDWV).

DHJETOR 2022

STUDENTËT E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE MORËN PJESË NË KONFERENCËN E INTEGRITETIT TË INFORMACIONIT

1 dhjetor 2022

Studentë nga programi i Sigurisë Kibernetike të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, kanë marrë pjesë në konferencën e integritetit të informacionit të organizuar nga platforma DISICON. Pjesëmarrja në këtë konferencë u realizua falë bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB dhe Institutit Kombëtar Demokratik (NDI).





Konferenca dy ditore kishte për qëllim diskutimin e të gjeturave të raportit të teknologjisë 5G dhe implikimet e saj në Kosovë duke diskutuar dhe takuar ekspertë të fushave të ndryshme.



Kjo pjesëmarrje e studentëve u shërben atyre të krijojnë kontakte me ekspertë lokalë e ndërkombëtarë, gjithashtu edhe të praktikojnë njohuritë e tyre të deritanishme.

Ndër vite me radhë, studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, kanë ofruar mbështetjen e tyre në proceset e ndryshme teknologjike dhe organizimet e Institutit Kombëtar Demokratik, duke qenë pjesëmarrës aktivë në çdo bashkëpunim.

DOKUMENTARI "PLAGËT E LIRISË" SHFAQET PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË PSIKOLOGJISË

1 dhjetor 2022

Në Teatrin Kamertal të Kolegjit AAB është shfaqur dokumentari "Plagët e lirisë" për studentët e Fakultetit të Psikologjisë. Ky dokumentar trajton njërën prej temave më të ndjeshme të shoqërisë, atë të invalidëve të luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, të cilët kanë rënë në zona të minuara.





Dekani i Fakultetit të Psikologjisë, prof. Naim Telaku, tha se shfaqja e këtij dokumentari tregon pasojat psikologjike që kanë sjellur te viktimat përvojat e tilla dhe sfidat që kanë kjo kategori e shoqërisë, me përkrahjen që duhet dhënë ndaj tyre.





Përveç dokumentarit u organizua edhe një panel diskutimi me Xhevdet Smajli, ish ushtar i UÇK-së në Sektorin e Deminimit, prof.ass.dr. Mimoza Shahini dhe Fatmir Grejqevci nga TV Dielli (Radio Kosova e Lirë). Xhevdet Smajli ish ushtar i UÇK-së, që kishte humbur shikimin pasi ra në mina të vendosura nga ushtarët serbë tha se ishte një përvojë tejet e hidhur, por sërish kishte gjetur vullnetin për t' u angazhuar e integruar në shoqëri, pavarësisht barrierave që kishte hasur vazhdimisht.

"Dihet që dikush duhet me i dhënë sytë për t' i fituar të gjithë të tjerët", tha ndër të tjera Smajli, duke treguar efektin psikologjik dhe traumat që shkaktojnë këto ngjarje te viktimat.

FTOHEN STUDENTËT DHE STAFI AKADEMIK TË APLIKOJNË NË PROGRAMET E AMERICAN COUNCIL

1 dhjetor 2022

Në kuadër të marrëveshjes të Kolegjit AAB me American Council, ftohen studentët dhe stafi akademik i Kolegjit AAB të aplikojnë në dy programe. Këto programe janë: SUSIs for Scholars (për studiuesit), dhe Glogal UGRAD (për studentët).

Qëllimi i dy programeve është t' u ofrojë profesorëve dhe studentëve mundësinë për të thelluar njohuritë e tyre mbi shoqërinë, kulturën, vlerat dhe institucionet amerikane.

Për informacione të detajuara rreth instituteve, kandidatët e interesuar mund të vizitojnë: https://exchanges.state.gov/non-us/program/study-us-institutes



Në lidhje me aplikimin dhe mundësitë që ofrojnë programet: https://xk.usembassy.gov/the-2023-summer-study-of-the-united-states-institute-susis-for-scholars/

VEPRIMTARI DHE SHKRIMTARI RESHAT SAHITAJ PROMOVON LIBRIN "DIPLOMACIA PAS PERDEVE"

1 dhjetor 2022

Në Kolegjin AAB u promovua libri "Diplomacia pas perdeve", i veprimtarit dhe shkrimtarit Reshat Sahitaj. Ky libër që flet për rolin që kanë pasur diplomatët e huaj dhe të vendit, për të promovuar Kosovën veçanërisht në kohën e luftës për të njoftuar botën mbi situatën, u vlerësua lart edhe nga mysafirja speciale në Kolegjin AAB, politikanja e njohur gjermane, ish deputete e Parlamentit Evropian, Doris Pack.









Ajo tha se ka tentuar vazhdimisht që zëri i Kosovës të dëgjohej në Parlamentin Evropian, sidomos në kohën kur po ndodhte lufta në vitet 1998-1999. Pack shtoi se është tejet falënderuese ndaj shkrimtarit Sahitaj, që ka vlerësuar kaq lart kontributin e saj, për të cilin tha se është bërë vetëm që gjeneratat e reja të jetojnë të lirë e në paqe.

Autori Reshat Sahitaj tregoi se libri është një punë 20 vjeçare, i bazuar në përvojat që ai ka pasur por edhe ngjarjet e tjera të rëndësishme në Kosovë. Ndër të tjera, tha se libri është një kontribut modest nga ana e tij.





Edhe prof.assc.dr Eqrem Zenelaj recensent i librit, përmendi faktin se ky libër trajton tema tejet të rëndësishme, duke renditur kronologjikisht të gjithë personalitetet që luajtën rol kyç në historinë e shtetndërtimit të Kosovës.

AAB NDERON ME ÇMIMIN PËR DEMOKRACI DHE INTEGRIME, ISH DEPUTETEN E PE, DORIS PACK

1 dhjetor 2022

Në një ceremoni solemne, të mbajtur në Teatrin AAB "Faruk Begolli", Kolegji AAB ka nderuar një nga figurat më të rëndësishme, që dha kontribut e mbështetje për çdo proces në Kosovë, ish deputeten e Parlamentit Evropian, politikanen e njohur gjermane, Doris Pack.

Asaj iu nda "Çmimi Ndërkombëtar për Demokraci dhe Integrime" i Kolegjit AAB, nga rektori Bujar Demjaha. Në fjalimin e tij, Demjaha tha se për kontributin që dha zonja Pack që nga kohët e vështira e sfiduese për Kosovën, e deri në pavarësi dhe liri, i janë të gjithë mirënjohës. Ai e cilësoi zonjën Pack si politikane intelektuale, e ndershme dhe një zonjë të dalluar.












Zonja Pack shprehu mirënjohjen e thellë për nderimin që i është bërë nga Kolegji AAB, duke shtuar se kontributi i saj ishte një obligim për të mirën e një populli dhe një shteti si Kosova. Ajo shtoi se ky çmim dhe mirënjohja që i bëhen, tregojnë qartë se si ndjehet populli i Kosovës për të.









Politikanja Tërmkolli, vlerësoi rolin e zonjës Pack në përfshirjen e gruas në politikë dhe vendimmarrje, derisa tha se ajo na ndihmoi në tërë rrugëtimin drejt lirisë dhe ndërtimin e një shtetit demokratik.

NË BASHKËPUNIM ME ODËN SLLOVENE TË BIZNESEVE MBAHET TRAJNIM PËR NDËRMARRËSINË

2 dhjetor 2022

Në bashkëpunim me Odën Sllovene të Bizneseve në Kolegjin AAB, është mbajtur trajnim për personalitetin e ndërmarrësit si dhe motivimin e tij në të bërit biznes.

Studentët e Kolegjit AAB, bashkë me shumë biznese të ndryshme të Kosovës morën pjesë në këtë trajnim, duke u njoftuar në detaje për çështjet që janë edhe në interesin e tyre. Përveç tjerash, studentët patën rastin të takohen me përfaqësues të bizneseve që janë anëtarë të Odës Sllovene të Bizneseve.





Gjatë trajnimit u parashtruan edhe shumë tema të tjera që kishin të bënin me: çfarë duhet të dimë për të qenë ndërmarrës të suksesshëm, cilat janë hapat e rëndësishëm për t' i qartësuar qëllimet, dhe si janë të ndërtuara kompetencat.

PROGRAMI GLOBAL I SHKËMBIMIT UNIVERSITAR HAP AFATIN E APLIKIMIT PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

2 dhjetor 2022

Të gjithë studentët e nivelit bachelor të Kolegjit AAB ftohen të aplikojnë në programin global të shkëmbimit universitar, që iu ofron bursa studentëve për të studiuar një semestër të vitit akademik në SHBA. Studimet për një semestër do të realizohen në një kolegj ose universitet të SHBA-ve, pa diplomë.

Global UGRAD është program i Byrosë së Çështjeve Arsimore dhe Kulturore, të Departamentit të Shteteve të Bashkuara, që synon të rekrutojë pjesëmarrës nga prejardhje të nënpërfaqësuara e që nuk kanë pasur mundësi të studiojnë në SHBA.

Të gjithë aplikantët e suksesshëm i pret një ekspozim i thellë ndaj shoqërisë, kulturës dhe institucioneve akademike amerikane, njëkohësisht duke rritur aftësitë e tyre profesionale.

Afati për aplikim vlen deri me 15 dhjetor 2022.

Në lidhje me informatat rreth programit, kritereve dhe formës së aplikimit, vizitoni këtë link: https://xk.usembassy.gov/ugrad/

FILLOJNË TRAJNIMET PËRDORIMIN E APLIKACIONEVE TË MS OFFICE

5 dhjetor 2022

Kanë filluar trajnimet pa pagesë për studentët në përdorimin e aplikacioneve të Microsoft Office, të organizuara nga Qendra e Karrierës dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB. Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, Jusuf Qarkaxhija, në fillim të trajnimit iu uroi mirëseardhje studentëve, duke u thënë se kjo është hera e parë që janë të hapura edhe për fakultetet e tjera.











Ky trajnim do të mbahet i ndarë në tre grupe, ndërsa do zgjasë për tri javë ku secili student do certifikohet për pjesëmarrje dhe për rezultatet e arritura. Pakoja e trajnimit përmban zhvillimin e shkathtësive në përdorimin e aplikacione të Microsoft Office: MS Word, MS Excel, MS PowerPoint, MS Access.
https://aab-edu.net/fillojne-trajnimet-pa-pagese-nga-kolegji-aab-per-perdorimin-e-aplikacioneve-te-microsoft-office/

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME "CAMBRIDGE KIDS"

6 dhjetor 2022

Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, Hysen Kasumi, ka nënshkruar marrëveshjen e radhës të bashkëpunimit me Institucionin Parashkollor "Cambridge Kids". Në këtë marrëveshje parashihet që IP "Cambridge Kids", t' u ofrojë mundësinë studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB të kryejnë praktikën në të gjitha ambientet e këtij institucioni.



Kështu studentët do përfshihen që nga studimet në praktika, për të mësuar metodat me të cilat punohet në institucionet parashkollore, duke u njohur me rrethana dhe faktorë të shumtë që ndërlidhen me këtë profesion.

FILLOJNË AKVITETET E FORUMIT TË FAKULTETIT EKONOMIK "GUEST SPEAKER"

6 dhjetor 2022

Ka nisur muaji i "Guest Speaker" në Kolegjin AAB, me të ftuarin e parë, z.Gazmend Selmani, themelues i IBAS & PBC Group.





Selmani, para studentëve të Fakultetit Ekonomik, tregoi në lidhje me përvojën e tij si ndërmarrës dhe themelimin e kompanive IBAS & PBC Group, që tashmë janë të njohura edhe në tregun ndërkombëtar. Ai shtoi se studentët duhet të angazhohen vazhdimisht dhe të jenë këmbëngulës, pasi sipas tij, mund të arrijnë edhe më shumë suksese se kompanitë e mëdha në vend.

Aktiviteti është mbajtur në kuadër të lëndës "Informatikë Biznesi" dhe është udhëhequr nga prof. Fidan Qerimi.

Forumi "Guest Speaker", pritet të sjellë personalitete të rëndësishme në Kolegjin AAB, si persona me influencë në biznes, politikbërje apo çfarëdo fushe tjetër, në mënyrë që të sjellin tregimin e tyre dhe ta ndajnë atë me studentët e Kolegjit AAB.





STAFI I KOLEGJIT AAB PJESË E SESIONIT INFORMUES RRETH "PARANDALIMIT TË NGACMIMEVE SEKSUALE NË VENDIN E PUNËS"

8 dhjetor 2022

Pjesëtare të stafit të Kolegjit AAB ka marrë pjesë në sesionin informues të organizuar nga UN Women në Kosovë, për parandalimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës.







Sesioni ishte pjesë e projektit "Komponenti gjinor në promovimin e punës së denjë përmes menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë", ku u diskutua për shqyrtimin e politikave të parandalimit të ngacmimit seksual në universitete, dhe hapat e parë të identifikimit të lehtë të ngacmimit seksual, me inkurajimin e raportimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të shkëmbejnë përvojat dhe politikat e universiteteve të tyre, ndërsa morën pjesë rektorë, ligjërues, e drejtues të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Nga Kolegji AAB të ftuara ishin: drejtoresha e Administratës, Albulena Ramadani, koordinatoret për Sigurim të Cilësisë, Aida Thaqi e Diellza Olluri, profesoresha e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Eriona Ajvazi, si dhe koordinatorja e Qendrës së Karrierës, Gresa Makolli.

"GUEST SPEAKER" NË AAB, E FTUAR NDËRMARRËSJA BLERINA MATI

8 dhjetor 2022

Një tjetër ndërmarrëse e suksesshme në Kosovë, ishte e ftuara e radhës në forumin "Guest Speaker" në Kolegjin AAB.

Blerina Mati, themeluese e kompanisë "B Ideas", kompani kjo që ofron strategji marketingu, konsulenca dhe ide, tregoi për sfidat që kanë gratë ndërmarrëse në Kosovë, si paragjykimet dhe probleme tjera të përditshme.







Studentët patën pyetje për Blerinën, rreth asaj se çfarë e bën kompaninë e saj më të besueshme, cilat janë synimet në të ardhmen dhe për angazhimin e ekipit që punon.
Ky aktivitet u mbajt në kuadër të lëndës "Biznesi ndërkombëtar", i udhëhequr nga profesoresha e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Shqiponja Nallbani.

PROREKTORJA LLUNJI, PJESË E KONGRESIT BOTËROR PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

8 dhjetor 2022

Prorektorja për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kolegjit AAB, prof. ass. dr. Venera Llunji, po merr pjesë në Kongresin Botëror për persona me aftësi të kufizuara. Ky kongres do të mbahet me 8 dhe 9 dhjetor në Prishtinë, ku për herë të parë nikoqire është Kosova.
Prorektorja Llunji është ftuar të jetë pjesë e kongresit ku do diskutohet rreth gjithëpërfshirjes dhe prosperitetit të personave me aftësi të kufizuara.



Pjesëmarrja e Kolegjit AAB në kongrese të tilla synon që çdo kategori e shoqërisë të jetë e përfshirë, të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe të integrohet në çdo fushë.

GIZ DIMAK, MBAN TRAJNIM PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB NË KAMPUSIN E FERIZAJT

8 dhjetor 2022

Qendra e Karrierës në bashkëpunim me GIZ DIMAK ka mbajtur trajnimin e radhës për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB në kampusin e Ferizajit.

Trajnimi për përgatitje për tregun e punës, përfshinte këto module të veçanta: shkrimi i një CV, si të shkruhet një letër motivuese dhe simulime të intervistave.



Studentët e kampusit të Ferizajt, të cilët i ndoqën trajnimin e vlerësuan atë, duke thënë se u mundëson ta dinë se çfarë përgatitjesh duhet bërë për tregun e punës dhe çka kërkohet nga ta.

HAPET ZYRTARISHT KONFERENCA E TRETË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE "LUFTË, KONFLIKT DHE SHOQËRI" NË KOLEGJIN AAB

9 dhjetor 2022

Ka filluar zyrtarisht punimet Konferenca e Tretë Virtuale Shkencore "Lufta, konflikti dhe shoqëria" në Kolegjin AAB.

Në hapje të konferencës, Dr. Uranela Demaj, prorektore për Shkencë dhe Hulumtime Kërkimore në Kolegjin AAB, ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit e konferencës, ndërsa prezantoi temat e sesioneve që pritet të diskutohen dhe theksoi rëndësinë e temave që pritet të trajtohen.








Zv/rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. ass. Shemsedin Vehapi, tha se kjo konferencë do të kontribuojë jashtëzakonisht në thellimin e hulumtimeve shkencore që kanë rëndësi të veçantë edhe për Kolegjin AAB. Ai falënderoi edhe folësit kryesorë të konferencës që vinë nga Belgjika, Anglia dhe Hungaria. Nëdrsa prorektorja për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, prof. ass. dr. Venera Llunji, theksoi se Kolegji AAB synon që përmes konferencave të thellojë bashkëpunimet me universitetet ndërkombëtare dhe të rrisë prezencën e vet ndërkombëtarisht.

Partnerë të edicionit të tretë të Konfercës Virtuale Shkencore janë Universiteti i Shkencave Sociale të Aplikuara nga Lituania, Universiteti Savonia për Shkenca të Aplikuara nga Finlanda, Universiteti Masaryk nga Çekia, Universiteti Shtetëror i Shkencave të Aplikuara Šiauliai nga Lituania, Kolegji Universitar "Edward Bernays" nga Kroacia, Universiteti St. Klement Ohridski dhe Instituti për Kërkime dhe Studime Evropiane, nga Maqedonia e Veriut.

MINISTRJA E DREJTËSISË ALBULENA HAXHIU, MBAN LIGJËRATË VETËDIJËSUESE PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

9 dhjetor 2022

Ministrja e Drejtësisë Albulena Haxhiu, ka mbajtur ligjëratë vetëdijësuese për studentët e Kolegjit AAB, në kuadër të fushatës ndërkombëtare 16 ditore të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave. Haxhiu, ka diskutuar me studentët e pranishëm për gjendjen dhe raportin e drejtësisë me viktimat e dhunës si dhe hapat që janë ndërmarrë deri tani në luftimin e kësaj dukurie negative.





Ajo tregoi për fushatën sensibilizuese që po mbahet, e cila ka filluar me 25 nëntor dhe Kosova ka marrë për herë të parë përsipër ta drejtojë atë, ku tha se qëllimi i kësaj fushate ishte të shtrihet në secilën komunë dhe zonë, e veçanërisht në zonat ku statistikat e dhunës janë shqetësuese.

Tutje, ministrja Haxhiu shtoi se femicidi është jashtëzakonisht i shprehur në shoqërinë tonë, për shkak të sistemit patriarkal dhe shpeshherë mosfunksionimit të drejtësisë.









Studentët dhe profesorët e Kolegjit AAB, i parashtruan pyetje ministres Haxhiu në lidhje me vettingun në drejtësi, rritjen e dënimit për kryesit e krimeve, progresin e proceseve që ndërlidhen me drejtësinë dhe pyetje rreth funksionimit të niveleve komunale në lajmërimin e rasteve te nivelet kompetente.

FAKULTETI JURIDIK SHËNOI DITËN NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

10 dhjetor 2022

Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, 10 Dhjetorit, Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB, ka organizuar një tryezë diskutimi së bashku me misionin e OSBE në Kosovë, me temën: "Dinjitet, Liri dhe të Drejta për të gjithë"

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Kosovë, si: përfaqësuesi i komunitetit islam në Kosovë, përfaqësues të kishës katolike, të kishës protestane evangjeliste.

Hapjen e kësaj tryeze e bëri prorektorja për Shkencë e Kolegjit AAB, prof. Uranela Demaj, më pas përfaqësuesit fetarë diskutuan nga këndvështrimet e tyre në lidhje me diversitetin fetar dhe se si feja duhet të jetë instrument për paqen.

Dekani i Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, prof. Veton Vula, tha se ekzistenca autonome e komuniteteve fetare është e domosdoshme për pluralizmin në një shoqëri demokratike, duke shtuar se problemi qëndron në ruajtjen e pluralizmit dhe funksionimin e duhur të demokracisë.



AMBASADORI FINLANDEZ SH. T. MATTI NISSINEN LIGJËROI PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB

10 dhjetor 2022

"Politika e jashtme e Finlandës", ishte tema e ligjëratës që ambasadori finlandez Sh. T. Matti Nissinen mbajti për studentët e Kolegjit AAB.

Ngjashmëritë e shumta mes kushtetutës së Finlandës dhe asaj të Kosovës dhe sfidat shtetërore të të dyja vendeve ishin disa nga temat në të cilat u ndal diplomati finlandez në këtë ligjëratë. Ambasadori Nissinen, tha se është tejet i impresionuar nga pritja dhe interesimi i studentëve për këtë ligjëratë, ndërsa shpjegoi në detaje zhvillimin e Finlandës nga historiku i këtij shteti e deri në këndvështrimet e sotme. Pavarësia, dallimi i partive politike, vështirësitë e shumta, ishin vetëm disa nga temat që ambasadori diskutoi me studentët.





Në fund ai iu përgjigj pyetjeve të studentëve të Kolegjit AAB, në lidhje me problemet që kanë pakicat në Finlandë, mënyrën si zhvillohet politika dhe diplomacinë finlandeze në vendet tjera.

ZV.MINISTRI I DREJTËSISË NË MAQEDONINË E VERIUT MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E AAB-së

12 dhjetor 2022

Me rastin e 10 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Fakulteti Juridik organizoi një ligjëratë me të ftuar special, zv/ministrin e drejtësisë të Maqedonisë së Veriut, prof. dr. Agim Nuhiu.

Përveç temës rreth mekanizmave dhe instrumenteve mbrojtës të drejtave të njeriut, z.Nuhiu diskutoi edhe në lidhje me praktikat e zbatimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Studentët patën pyetje për z. Nuhiun, në lidhje me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe funksionimin e ligjit nëse ato shkelen nga individë të ndryshëm.



KRYETARI I OEK, LULZIM RAFUNA, I FTUAR NË MUAJIN E "GUEST SPEAKER" NË KOLEGJIN AAB

12 dhjetor 2022

Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës ka qenë i ftuari i radhës në muajin e "Guest Speaker", që po mbahet gjatë muajit dhjetor në Kolegjin AAB. Rafuna para studentëve solli temën "Politikat Doganore dhe roli i Odës Ekonomike të Kosovës", duke shpjeguar funksionimin e këtyre politikave në lidhje me eksportin dhe importin.

Për rolin e Odës Ekonomike të Kosovës, Rafuna tha se deri tani 16 mijë biznese janë anëtare të kësaj ode dhe mundësojnë trajnime të shumta që të punësuarit të zhvillojnë njohuritë e tyre për biznes.








Kjo ligjëratë nga Rafuna është mbajtur në kuadër të lëndëve "Biznesi Ndërkonbëtar", dhe "Qeverisja, risku dhe etika", nga prof. Vjollca Hasani e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB.
"Guest Speaker" do të vazhdojë në ditët e ardhshme me profesorë të njohur nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare.

DEKANI HYSEN KASUMI, FOLËS KRYESOR NË "INTERNATIONAL MULTIDISCIPLINARY SCIENTIFIC CONFERENCE"

12 dhjetor 2022

Në edicionin e pestë të "International Multidisciplinary Scientific Conference", dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, prof. ass. dr. Hysen Kasumi, ka qenë i ftuar si folës kryesor.
Kasumi, në ekspozeun e tij trajtoi temën "Sfidat me të cilat përballen mësuesit e anglishtes në vendet e Ballkanit Perëndimor". Ai përmendi sfidat e shumta që kanë këta mësues dhe çfarë duhet ndërmarrë për të lehtësuar këtë proces.





Konferenca u mbajt në Tetovë të Maqedonisë së Veriut, ndërsa u trajtuan edhe tema tjera me rëndësi për zhvillimin e procesit mësimor, si përshtatja e teksteve, përkthimi i tyre, neologjizmat e shumta në tekste dhe metodat që përdoren në arsim.





FGH PARTNER NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE TË ARSIMIT DHE KULTURËS NË GJUHËN E HUAJ

13 dhjetor 2022

Fakulteti i Gjuhës Angleze i Kolegjit AAB dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, për të tretën herë ishin partnerë në organizimin e Konferencës së pestë Ndërkombëtare të Arsimit dhe Kulturës në Gjuhën e Hua, e cila u mbajt në Durrës.



Përveç rolit në angazhimin drejt qëllimit të konferencës, kjo shërbeu edhe si pikëtakim për përfaqësues të shumë universiteteve partnere nga shtete si: SHBA, Itali, Kroaci, Kosovë, Indi, etj..

Dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, dr. Aida Alla, prezantoi prioritetet dhe aktivitetet shkencore të fakultetit që udhëheq, duke i ftuar të pranishmit në konferencat e radhës.

Në këtë konferencë me punimet e tyre morën pjesë edhe mësimdhënëset e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, Eriona Ajvazi e Toska Haxhidauti, të cilat morën vlerësime pozitive nga kolegët e tyre, duke shpresuar për bashkëpunime tjera edhe në të ardhmen.

KOSOVO GENERATION UNLIMITED FTON STUDENTËT NË PROGRAMIN PËR PUNË PRAKTIKE

14 dhjetor 2022

Kosovo Generation Unlimited, ka hapur programin për punë praktike dhe fton të gjithë studentët e interesuar të Kolegjit AAB, të cilët duan të krijojnë përvojë pune në mjedise profesionale të aplikojnë.



Krahas punës praktike që ofrohet për të gjithë të rinjtë nga mosha 16-24 vjeç dhe zgjat 3 muaj, ku praktikantët do kompenzohen me 170 euro në muaj, do të ofrohen edhe në trajnime të ndryshme profesionale.

Në lidhje me detajet rreth punës praktike dhe mënyrës së kompenzimit vizitoni platformën online: kosovogenu.com

UNIVERSITE DE TOULON I FRANCËS, FTON STUDENTËT E KOLEGJIT AAB TË APLIKOJNË PËR BURSA STUDIMORE

14 dhjetor 2022

Universite de Toulon në Francë, ka hapur thirrjen për bursa për studentët e nivelit master të Kolegjit AAB. Të gjithë studentët që kanë njohuri të gjuhës frënge (C1), dhe gjuhës angleze (B2), që i plotësojnë kriteret për aplikim, inkurajohen të aplikojnë.



Afati i fundit për aplikim: 27 janar 2023.
Për detaje dhe kriteret që duhet të plotësoni klikoni në linkun:
https://www.univ-tln.fr/Bourses-d-excellence-Master-de-l-UTLN-2023-2024-Etudiants.html

MBAHET PUNËTORIA "MEDIA NË MES: E KALUARA DHE E ARDHMJA: LUFTA DHE PAQJA"

14 dhjetor 2022

Për studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv – Gazetari të Kolegjit AAB, sot ka filluar punëtoria "Media në mes: E kaluara dhe e ardhmja: lufta dhe paqja". Kjo punëtori është organizuar nga Byroja për Çështje Arsimore dhe Kulturore e Departamentit Amerikan të Shtetit, me Meridian International Center si partner zbatues, dhe Kolegjit AAB. Tema e parë që u trajtua në këtë punëtori ishte "Media në mes: E kaluara dhe e ardhmja: lufta dhe paqja", derisa të ftuar ishin fotoreporteri Ilaz Bylykbashi, publicisti Ibrahim Berisha dhe gazetari e reporteri i luftës, Zeqir Bekolli.









Dekani i Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, prof. ass. dr. Hasan Saliu, bëri hapjen e punëtorisë duke i ftuar studentët të marrin pjesë dhe të informohen me periudhat e rëndësishme të vendit, dhe mënyrën se si kanë raportuar mediat atëbotë.

Fotoreporteri Ilaz Bylykbashi, prezantoi para studentëve fotografitë të cilat i kishte realizuar gjatë kohës së luftës në Kosovë, demonstratave dhe shumë periudhave tjera të rëndësishme.

Ndërsa publicisti Ibrahim Berisha, diskutoi me studentët në lidhje me mënyrën se si mediat kishin raportuar për luftën në Kosovë, të gjitha ngjarjet në mënyrë kronologjike të cilat kishin shënuar historinë.





Nga ana tjetër, gazetari e reporteri i luftës, Zeqir Bekolli, duke pasur përvojën direkte nga vendngjarja kur zhvillohej lufta në Kosovë, tregoi në lidhje me përjetimet e tij dhe të qytetarëve të cilat më pas ishin dokumentar me anë të fotove dhe raportimeve nga ai.

Në fund të kësaj punëtorie studentët do të pajisen me certifikata mirënjohje, për pjesëmarrje dhe kontribut në diskutim e bashkëbisedim.

BIBLIOTEKA E AAB I DHURON MBI 40 LIBRA BIBLIOTEKËS SË QYTETIT TË SUHAREKËS

14 dhjetor 2022

Drejtori i Bibliotekës së Kolegjit AAB, Urim Sallauka, sot ka dorëzuar donacionin prej 41 librave (47 ekzemplarë) për Bibliotekën e Qytetit të Suharekës.







Kjo u realizua pas një takimi me drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të komunës së Suharekës, Lorika Gashi, e cila tha se është falënderuese për këtë ndihmë të Kolegjit AAB.

Gjatë takimit u tha se ky donacion është vetëm fillimi i bashkëpunimit, mes Bibliotekës së Kolegjit AAB dhe Bibliotekës së Qytetit të Suharekës.

Këto libra u dhuruan për nevojat e përdoruesve të kësaj biblioteke dhe përdoruesve të tjerë në këtë institucion.

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME "BALKAN SUNFLOWERS KOSOVA"

15 dhjetor 2022

Rrjetit të partnerëve të Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, i është shtuar edhe Organizata Joqeveritare "Balkan Sunflowers Kosova". Kjo përmes marrëveshjes së nënshkruar nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr. Hysen Kasumi dhe drejtorit të OJQ-së, Muhamet Arifi.

"Balkan Sunflowers Kosova", do t' iu ofrojë studentëve të Kolegjit AAB të kryejnë punë praktike dhe vullnetare në të gjitha ambientet e OJQ-së.

Të dy palët shprehën dëshirën dhe vullnetin për bashkëpunim edhe në të ardhmen, në sfera që do ndihmonin të ardhmen e studentëve të Kolegjit AAB.





"DISCOVER AMERICA" PREZANTON PROGRAMIN "BRIDGE USA/ WORK AND TRAVEL"

15 dhjetor 2022

"Discover America" ka prezantuar për studentët e Kolegjit AAB programin "Bridge USA/ Work and Travel", që ofron mundësinë për punë dhe udhëtim në SHBA në një periudhë të caktuar kohore. Drejtori i "Discover America", Agron Kamberi, tha se ky program iu mundëson studentëve të përjetojnë kulturën dhe jetën amerikane, perfeksionimin e gjuhës angleze, përvojë unike në vendet më të bukura në SHBA, përvojë pune 3-4 muaj në kompani amerikane dhe shumë përfitime tjera.

Kamberi bëri të ditur se studentët do marrin certifikatë për përfundimin e këtij programi, ndërsa shtoi se çdo student mund të aplikojë, mjafton të ketë njohuri mesatare të gjuhës angleze.









ZGJIDHET KRYESIA E RE E KLUBIT TË DEBATIT TË FAKULTETIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

15 dhjetor 2022

Është zgjedhur kryesia e re e Klubit të Debatit të Fakultetit të Administratës Publike, të Kolegjit AAB. Kryetar është zgjedhur studenti i Kolegjit AAB, Genc Morina ndërsa nënkryetarë studentët: Blenda Selmani, Doruntina Syla dhe Elion Nuza.



Dekani i Fakultetit të Administratës, Prof. Ass. Dr. Petrit Bushi, i uroi suksese kryesisë së re, duke theksuar se do kenë përkrahjen e vazhdueshme nga dekanati për çdo inicativë. Kryesia e re e Klubit të Debatit tha se do vazhdojnë me aktivitetet dhe do angazhohen në debate që do trajtojnë tematika të ndryshme, por edhe të sjellin përfaqësues nga institucionet publike të vendit dhe rajonit në Kolegjin AAB.

NË DITËN E DYTË TË PUNËTORISË PËR STUDENTËT E KOMUNIKIMIT MASIV U FOL PËR LAJMET E RREME

16 dhjetor 2022

Ka vazhduar dita e dytë e punëtorisë për studentët e Komunikmit Masiv të Kolegjit AAB, e përkrahur nga Byroja për Çështje Arsimore dhe Kulturore e Departamentit të Shtetit Amerikan.

"Pse lajmi i rremë: përmasa dhe efekti", ishte tema e ligjëratës që u mbajt nga gazetari Kreshnik Gashi, i cili për studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB, tregoi në lidhje me vërtetimin e lajmeve të rreme dhe sa efekt kanë ato te masa. Ndër të tjera, ai iu tha studentëve që një nga shtyllat kryesore për të qenë gazetar i suksesshëm është kredibiliteti që ata krijojnë.







Ndërsa Prof. Dr. Ibrahim Berisha, trajtoi rolin e propagandës në media, mashtrimin dhe identifikimin. Ai përmendi disa raste bashkë me studentët kur propaganda në media kishte luajtur rol në përcaktimin e audiencës, por edhe përmendi hapat që ndihmojnë në identifikimin e saj.

Studentët që morën pjesë në këtë punëtori, parashtruan pyetje në lidhje me shkaktarët e propagandës nga media, efektet e lajmeve të rreme dhe historikun e tyre.

NË FORUMIN "GUEST SPEAKER", FLET NARCIZE MUSTAFI NGA BANKA POPULLORE E MAQEDONISË SË VERIUT

16 dhjetor 2022

Me temën "Procedurat operative të Bankës Populllore në tregun e parave", Narcize Mustafi, përgjegjëse e njësisë së Zyrës së Bankës Populllore të Maqedonisë së Veriut, ka qenë e ftuara e radhës në muajin e "Guest Speaker" të Kolegjit AAB.









Mustafi, ka treguar në lidhje me procedurat që aplikon banka ku ajo punon dhe se si funksionojnë ato. Ndër të tjera ajo përmendi edhe problemet me inflacionin në vitet e fundit, duke treguar për studentët e Kolegjit AAB, se si ka vepruar Banka Populllore e këtij vendi.

Ky aktivitet është mbajtur në kuadër të lëndës "Tregjet dhe institucionet financiare", e udhëhequr nga profesoresha e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Florije Miftari.

U PROMOVUA LIBRI "100 VJET ME SHQIPËRINË" I DIPLOMATIT LLESH KOLA

16 dhjetor 2022

Në Teatrin Kamertal të Kolegjit AAB u bë promovimi i librit "100 vjet me Shqipërinë", i ish ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Itali, diplomatit Llesh Kola. Libri flet për marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA-të nga viti 1880-1990.









Në promovim morën pjesë përfaqësues të ambasadave shqiptare si ish ambasadori i Kosovës në Stokholm të Suedisë, Lulzim Peci, ish ambasadori i Kosovës në Itali, Albert Prenkaj, kryediplomati shqiptar Edmond Panariti, përfaqësues diplomatik nga Mali i Zi, dhe një numër i madh i studentëve të Kolegjit AAB.

Dekani i Fakultetit të Administratës Publike. Prof. Dr. Petrit Bushi, tha se falë angazhimit të Klubit të Debatit nga ky fakultet deri tani janë bërë 23 promovime librash, ndërsa theksoi se ky libër është tejet i veçantë pasi do t' iu shërbejë brezave të rinj, dhe tregon qartë e saktë se çka është diplomacia dhe roli i saj.



Kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Prof. Dr. Lulzim Tafa, vlerësoi faktin që autori Kola ka vendosur ta promovojë librin në Kolegjin AAB, duke thënë se kjo është zgjedhja e duhur pasi edhe studentët kanë mundësinë të jenë pjesë e ngjarjeve të tilla.

Prof. Ass. Dr. Donik Sallova, bëri një analizë të shkurtër të librit, ndërsa tha se promovimi vjen pikërisht në 100 vjetorin e raporteve Shqipëri-SHBA, që evidenton shpresën e shqiptarëve te Amerika, dhe kjo do t' u mundësojë lexuesve e studiuesve të shohin evoluimin e marrëdhënieve nga këndvështrimi i diplomacisë amerikane. Ndërsa, ambasadori i parë i Kosovës në SHBA, Avni Spahiu ky libër është një trajtim i marrëdhënieve shqiptaro-amerikane që paraqet një vepër që mbulon rrallësinë studimore të këtyre raporteve, në publicistikën dhe historiografinë shqiptare.

STUDENTËT E AAB DHE OJQ "BALKAN SUNFLOWERS KOSOVA" ORGANIZOJNË AKTIVITET HUMANITAR

17 dhjetor 2022

Është mbajtur një aktivitet humanitar nga studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, në hapësirat e kampusit në bashkëpunim me organizatën joqeveritare "Balkan Sunflowers Kosova". Gjatë këtij aktiviteti studentët përmes një ekspozite kanë paraqitur punimet e tyre, të cilat kanë qenë në shitje bashkë me kartolinat me motive të festave të fundvitit.











Mjetet financiare të grumbulluara do të shërbejnë për blerjen e mjeteve didaktike për nxënësit e Qendrave Mësimore, që janë të mbështetura nga kjo OJQ, ku bëhet mësim plotësues për fëmijët e klasave parafillore dhe fillore.

VAZHDON PROJEKTI I STUDENTËVE "ANGLISHTJA NGA UNË TE TI" PËR FËMIJËT E SOS FSHATIT

19 dhjetor 2022

Për herën e katërt me radhë studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, kanë dhënë kontributin e tyre duke mbajtur falas kurse të gjuhës angleze për fëmijët e fshatit SOS, Prishtinë. Në ditën informuese të programit profesional-vullnetar "Anglishtja nga unë te ti", ishte e pranishme punonjësja sociale dhe koordinatorja e programit Hana Shala, që informoi studentët për specifikat e fshatit SOS.








Dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Prof. Dr. Aida Alla, u shpreh se suksesi i këtij programi qëndron në vazhdimësinë e tij, që kultivon ndjenjën e vullnetarizmit te brezat e rinj.

Nga ky program profesional vullnetar përfitojnë 100 fëmijë, të cilët kanë nevojë për mbështetje financiare dhe sociale. Rreth 35 mësuese vullnetare i nënshtrohen një trajnimi disa javësh në lidhje me metodologjinë e mësimdhënies, të udhëhequr nga profesori i Fakultetit të Gjuhës Angleze, Niman Dreshaj.

Programet e tilla nga Fakulteti i Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB, janë kthyer në një traditë tashmë bashkë me shumë aktivitete tjera.

AMBASADORI I NORVEGJISË SH.T. JENS ERIK GRONDAHL, MBAJTI LIGJËRATË PËR DIPLOMACINË NORVEGJEZE

19 dhjetor 2022

Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Sh.T. Jens Erik Grondahl, ishte ambasdori i radhës që vizitoi Kolegjin AAB dhe mbajti ligjëratë për diplomacinë norvegjeze para studentëve të Administratës Publike.






Ambasadori Grondahl, tha se është tejet i nderuar që u ftua në Kolegjin AAB, duke shtuar se është institucioni më i madh arsimor në rajon, gjë për të cilën studentët duhet të jenë krenarë që janë pjesë e Kolegjit AAB.

Në ligjëratën e tij ai foli për detajet e kushtetutës së Norvegjisë, pavarësinë, parlamentarizmin ndërsa tha se shteti prej nga vjen duhet të integrohet në Bashkimin Evropian. Tutje z.Grondahl shpalosi detaje për karrierën e tij si diplomat duke nisur nga Afrika Perëndimore, Kroacia, e për të vazhduar në Kosovë nga viti 2019.

Studentët e Kolegjit AAB shfaqën interesim të madh për të njohur diplomacinë norvegjeze, duke bërë pyetje rreth sistemit shtetëror, historisë, dhe ngjarjeve të rëndësishme që përcollën ndërtimin e shtetit nordik.

PROF. BASHKIM RRAHMANI I FTUAR NË FORUMIN E CETINJËS 2022

19 dhjetor 2022

Në Forumin e Cetinjës 2022, me titull "Evropa e Hapur apo Ballkani i mbyllur", mori pjesë Prof. Dr. Bashkim Rrahmani, nga Fakulteti i Administratës Publike. Rrahmani, është ftuar nga PEN Klubi i Malit të Zi dhe nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në mesin e shumë intelektualëve të njohur nga Sllovenia, Kroacia, Bosnje e Hercegovinë, Mali i Zi, Serbia.



Gjatë këtij forumi, Rrahmani paraqiti një kumtesë në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE, si dhe për iniciativën e Ballkanit të Hapur.

Në fund të forumit u përpilua një deklaratë nga grupi punues, që do t' u dërgohet institucioneve ndërkombëtare, ku theksohet rreziku për destabilizim të rajonit, veçanërisht në Mal të Zi, Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Teksti i kësaj deklarate u aprovua nga të gjithë pjesëmarrësit.

I FTUARI I RADHËS NË "GUEST SPEAKER" BIZNESMENI SHKËLZEN JUSAJ

19 dhjetor 2022

Shkëlzen Jusaj drejtor i Petrol Company, si i ftuar i radhës në "Guest Speaker", ka folur në lidhje me temën "Të qenurit i suksesshëm". Jusaj, tregoi praktikat dhe hapat që ai ka ndjekur gjatë karrierës së tij, për të arritur suksese dhe rezultatet që gëzon tani.

Ai për studentët e Kolegjit AAB, tha se janë disa pika kryesore që duhet zbatuar për të realizuar ëndrrat e tyre, ato janë: edukimi, përvoja, përkushtimi dhe disiplina. Për secilën nga këto Jusaj foli në detaje.









Studentët kërkuan të dinë se si kanë ndikuar faza e pandemisë dhe inflacionit në biznesin që Jusaj drejton, pastaj vështirësitë në rrugëtimin e tij dhe nëse mendon se ka arritur synimet deri tani.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të lëndës "Menaxhment", nga profesori i Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Agron Mustafa.

I FTUARI I RADHËS NË "GUEST SPEAKER" PROFESORI MILAIM TAHIRI, NGA SHBA

19 dhjetor 2022

Profesori i Matematikës në Manchester Community College dhe Central Connecticut State University, Milaim Tahiri, ishte i ftuari i radhës në "Guest Speaker".

"Pse natyra flet me gjuhën e matematikës dhe roli i saj në fushën e ekonomisë dhe biznesit", ishte tema të cilën e trajtoi prof. Milaim Tahiri. Ai foli për rrugëtimin e tij që kishte bërë për të depërtuar si kuadër akademik në SHBA, ndërsa përmendi edhe kohën kur ofronte mësime për lëndën e matematikës, bashkë me shumë profesorë tjerë shqiptarë.









Ai dha një mesazh të qartë për gjeneratat e reja duke thënë se "dija është pasuri që askush nuk mund ta merr nga ju, andaj duhet luftuar për të".

Aktiviteti u mbajt në kuadër të lëndës "Matematikë për ekonomi dhe biznes", të profesoreshës së Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Roberta Bajrami.

STUDENTET E FSHS REALIZUAN VIZITË PUNE NË SHKOLLËN FILLORE "KELMEND RIZVANOLLI"

20 dhjetor 2022

Studentet e Fakultetit të Shkencave Sociale, programi Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve në kampusin e Gjakovës, zhvilluan aktivitet me rastin e festave të fundvitit në shkollën fillore "Kelmend Rizvanolli" me klasën parafillore.

Pjesë e aktivitetit ishte përgatitja e kartolinave nga ana e fëmijëve për urimin e festave të fundvitit. Përpos kësaj studentet e Kolegjit AAB ndanë dhurata për fëmijët e kësaj shkolle.



CERTIFIKOHEN STUDENTËT PJESËMARRËS TË PROJEKTIT EJO

20 dhjetor 2022

Në kuadër të projektit EJO, studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB, janë certifikuar nga PLAY International Kosova, pasi përfunduan me sukses trajnimin mbi Lojërat Sociale, Sportive dhe Bashkëpunuese.









Këto lojëra përfshijnë zhvillimin e aftësive, njohurive dhe sjelljeve për të udhëhequr aktivitete sportive gjithëpërfshirëse me fëmijët dhe për të promovuar vlerat e respektit dhe bashkëpunimit.

Studentët e Kolegjit AAB, implementuan nga 3 sesione të metodës Socio-Sport, metodë që inkurajon zhvillimin e aftësive jetësore. Gjatë kësaj kohe ata u vlerësuan nga trajnerët e PLAY International Kosova, të cilët falënderuan dekanin e Fakultetit të Kulturës Fizike të Kolegjit AAB, Prof. Fatmir Pireva, për kontributin dhe energjinë pozitive që kanë përcjellur te pjesëmarrësit.

Ky aktivitet u zhvillua në radhë të bashkëpunimit që Kolegji AAB ka me PLAY International Kosova, dhe mësimdhënësit e nxënësit e shkollës "British School of Kosova".

FSHS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "SHTËPIA E FËMIJËVE – MONTESSORI"

20 dhjetor 2022

Listës së partnerëve profesionalë të Fakultetit të Shkencave Sociale, iu shtua edhe Institucioni Parashkollor "Shtëpinë e fëmijëve – Montessori" nga Prishtina. Kjo përmes marrëveshjes së nënshkruar nga dekani Prof. Ass. Dr. Hysen Kasumi, dhe drejtoresha e këtij institucioni parashkollor, Samire Krasniqi.





Ky institucion që punon me një metodologji të veçantë, siç është ajo e Montessori, do t' u mundësojë studenteve, përveç tjerash edhe punë praktike gjatë periudhës së studimeve.

I FTUAR NË "GUEST SPEAKER", PROF. DR TAUNO KEKALE NGA FINLANDA

22 dhjetor 2022

Prof. Dr. Tauno Kekale, nga "Vaasa University of Applied Sciences" dhe përfaqësues i kompanisë "Merinova Ltd", është mirëpritur nga prof. Vjollca Hasani dhe studentët e Fakultetit Ekonomik për një ligjëratë virtuale. Ligjërata me temën "The new requirements for conformance: the ESCG directives – The governance and equality audits – Kërkesat e reja për përputhshmëri: Direktivat ESCG – Auditimet e qeverisjes dhe barazisë", u prezantua nga Kekale si i ftuari i radhës në forumin "Guest Speaker" të Kolegjit AAB.






Prof. Kekale, diskutoi çështjen e standardeve evropiane që kanë të bëjnë me mjedisin, përgjegjësinë sociale dhe qeverisjen lokale. Këto standarde sipas tij janë mënyrat e vetme për t' i menaxhuar kompanitë dhe kështu do ekzistojë një pasqyrë që tregon se a janë të denja kompanitë për të qenë pjesë e tregut.

Studentët e pranishëm parashtruan pyetje në lidhje me këto standarde dhe kompaninë për të cilën punon Kekale, duke dashur të dinë më shumë edhe për mundësinë e bashkëpunimit për aktivitetet e radhës.

REKTORI I KOLEGJIT AAB ZHVILLON TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E UNIVERSITETIT TË TIRANËS

23 dhjetor 2022

Rektori i Kolegjit AAB, Prof. Bujar Demjaha, bashkë me dekanin e Fakultetit të Psikologjisë, prof. Naim Telaku dhe Prof. Xhavit Rexhaj, janë pritur në një takim miqësor në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.



Gjatë takimit u diskutua përfundimi i projektit të përbashkët, ndërsa u dorëzuan edhe libri i abstrakteve të konferencës "Post Pandemic Challenge in Psychology and Education", e cila u mbajt disa ditë më parë në Tiranë, ku bashkëorganizator ishte Kolegji AAB.

Përfaqësuesit nga dy institucionet gjatë takimit u pajtuan të formalizojnë bashkëpunimin, përmes nënshkrimit të një marrëveshje.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IP "DIELLI"

23 dhjetor 2022

Programi Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve, që ofrohet edhe në kampusin e Ferizajt, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IP "Dielli".

Drejtori i degës së AAB në Ferizaj, Prof.ass.dr. Lulzim Shabani tha se po punohet në vazhdimësi që të krijohet rrjeti i partnerëve për të gjitha programet studimore që ofrohen në Kolegjin AAB në Ferizaj. Një e tillë është edhe marrëveshja me IP "Dielli", përmes së cilës studentëve do t' u mundësohet kryerja e punës praktike gjatë studimeve.



Të dy partnerët u zotuan edhe në realizimin e projekteve të përbashkëta në ditët në vazhdim.

I FTUAR NË "GUEST SPEAKER" PROFESORI DAVID BOGATAJ NGA "NOVA UNIVERSITY" SLLOVENI

23 dhjetor 2022

Profesor David Bogataj nga "Nova University" i Sllovenisë, përmes një lidhje online ka folur me studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, në lidhje me temën "Menaxhimi i resurseve njerëzore në shoqëritë e moshuara".






I ftuar në forumin e Fakultetit Ekonomik "Guest Speaker", pof.Bogataj tha se plakja e popullsisë evropiane po nxit kërkesën për kujdes shëndetësor dhe shërbime të kujdesit social, duke bërë që shpenzimet publike për shërbimet e kujdesit afatgjatë të PBB-ve të vendeve anëtarë të BE-së, pritet të dyfishohen në gjysmën e shekullit të ardhshëm.

Gjatë kësaj ligjërate, u paraqit modeli i zvogëlimit të shumëfishtë i cili mund të përdoret për projeksione afatgjata të numrit të njerëzve, të varur nga ndihma e të tjerëve.

Studentët e pranishëm përmes pyetjeve të parashtruara, patën rastin të mësojnë statistika dhe të dhëna të ndryshme nga tema e trajtuar.

FKF DHE KOK MBAJTËN TRAJNIM PËR TRAJNERËT E HENDBOLLIT

23 dhjetor 2022

I mbështetur nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), në bashkëpunim me Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, është mbajtur trajnim për trajnerët e hendbollit. Trajnimi u bë sipas RINKCK konventës, që nisi me 25 nëntor 2022 duke u zhvilluar për disa module, ndërsa u vlerësua si tejet i suksesshëm.



20 trajnerë pjesëmarrës morën diplomat pas përfundimit të trajnimi, të ndara nga presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, njëherësh nënpresident i KOK. Saraçini, falënderoi ligjëruesit dhe Kolegjin AAB për bashkëpunim profesional duke theksuar se shkollimi i kuadrove është një nga prioritetet e FHK-së.

Në këto javë pati ligjërues të ndryshëm si Prof. Dr. Nazim Myrtaj, Prof. Dr. Jeton Havolli, Leonard Cula. Kurse këtë fundjavë ishte edhe ekspertja e EHF-së, Prof. Dr. Lidija Bojiq-Çaçiq, nga Kroacia.

REKTORI BUJAR DEMJAHA U PRIT NË TAKIM NGA REKTORI I UNIVERSITETIT METROPOLITAN TË TIRANËS

23 dhjetor 2022

Rektori i Kolegjit AAB, prof. Bujar Demjaha është pritur në një takim miqësor në Universitetin Metropolitan të Tiranës, nga rektori i këtij institucioni, Prof. Dr. Nikolla Civici.

Në takim u fol për mundësitë e rritjes së bashkëpunimit në mes të dy institucioneve në fusha të ndryshme, sidomos në teknologjinë informative, arkitekturën dhe ekonominë.

Rektori Demjaha ishte i shoqëruar nga prof. Xhavit Rexhaj, dhe dekani i Fakultetit të Psikologjisë në Kolegjin AAB, prof. Naim Telaku.









FKF NËSHKRUAN MARRËVESHJE ME FEDERATËN E NOTIT TË KOSOVËS

24 dhjetor 2022

Marrëveshja e nënshkruar në mes Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Federatës së Notit të Kosovës, do të ndihmojë studentët e këtij fakulteti për të kryer pjesën praktike. Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i Fakultetit të Kulturës Fizikë dhe Sportit të Kolegjit AAB, Prof. Asoc. Dr. Fatmir Pireva dhe Kryetari i Federatës së Notit të Kosovës, Besnik Halili.







Organizimi i përbashkët i konferencave shkencore, seminareve, tryezave, pjesëmarrje në takime të ndryshme, dhe ndihma reciproke profesionale e informacione tjera, ishin disa nga pikat e marrëveshjes që do zbatohet nga dy palët.

LUM RAMABAJA, NË "GUEST SPEAKER" FLET PËR TË ARDHMEN E INTELIGJENCËS ARTIFICALE

26 dhjetor 2022

Eksperti i Inteligjencës Artificiale, Lum Ramabaja, ka folur në "Guest Speaker" për të ardhmen e kësaj inteligjence, duke specifikuar gjërat me rëndësi që studentët e Kolegjit AAB duhet të dinë.

Derisa e ardhmja e njerëzimit po krijohet dhe formohet bazuar në inteligjencën artificiale, atëherë të gjitha zhvillimet e reja teknologjike bazohen në të dhe kështu e ardhmja e saj mund të parashikohet



Për të gjitha këto dhe detaje të tjera, Lum Ramabaja nga kompania "Open Cybernetics", mbajti ligjëratë ku ndër të tjera theksoi edhe dallimet mes shkencës së të dhënave (data science), machine learning dhe inteligjencës artificiale.

Pas ligjëratës mysafiri i "Guest Speaker", u përgjigj në pyetjet e studentëve të pranishëm të Kolegjit AAB.






STUDENTËT E FERIZAJT ORGANIZUAN AKTIVITETE ARGËTUESE ME "DOWN SYNDROME KOSOVA"

27 dhjetor 2022

Me qëllim të dhënies së kontributit ndaj komunitetit, studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze të Kolegjit AAB në kampusin e Ferizajt, kanë organizuar një ditë përplot aktivitete me shoqatën "Down Syndrome Kosova". Anëtarë të kësaj shoqate u mirëpritën në hapësirat e kampusit të Kolegjit AAB, ku zhvilluan aktivitete të shumta argëtuese dhe edukative.

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Gjuhës Angleze, ofruan ligjërata në gjuhën angleze që ndërthureshin me pikturë dhe muzikë. Përfaqësuesit e shoqatës, ftuan studentët të vazhdojnë punën praktike profesionale si mësimdhënës të gjuhës angleze në këtë shoqatë.



Kolegji AAB është i përkushtuar në misionin për shërbimin ndaj shoqërisë, duke vazhduar të organizojë aktivitete të ngjashme edhe në të ardhmen.

RILIND ÇOÇAJ, TANI MËSIMDHËNËS NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS I FTUAR NË #AABALUMNITALK

27 dhjetor 2022

Promovimi i studentëve të suksesshëm të Kolegjit AAB që bëhet nga Qendra e Karrierës, këtë radhë solli studentin Rilind Çoçaj. Ai ka përfunduar studimet në nivelin bachelor në Fakultetin e Arkitekturës të Kolegjit AAB, për të vazhduar në Politecnico di Milano nivelin master dhe tashmë doktoraturën në Venedik të Italisë në drejtimin e kompozicionit të arkitekturës.









Tërë suksesi i Rilindit filloi kur ai do aplikonte për studime në nivelin master, duke pasur mundësi të pranohet në universitetet e 4 qyteteve të ndryshme, por zgjodhi Milanon. Përveç që përfundoi studimet në Politekniko di Milano, Rilindi u angazhua si mësimdhënës në këtë universitet, kurse tani ka fituar titullin Doktor Shkence.

Gjatë ligjëratës në "Alumni Talk", ai tregoi për sfidat që pati gjatë studimeve, duke theksuar se është kënaqësi të ndajë eksperiencën e tij me studentët tjerë, për ta kuptuar se si Kolegji AAB ka qenë një nga shtyllat motivuese të tij dhe baza e fillimit të suksesit.

Rilind Çoçaj tashmë është angazhuar edhe si mësimdhënës në Fakultetin e Arkitekturës të Kolegjit AAB.

DREJTORESHA E QKSGJ MBAJTI LIGJËRATË PËR STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK

27 dhjetor 2022

"Integrimi Evropian dhe Barazia Gjinore", ishte tema e ligjëratës së mbajtur nga Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, Luljeta Demolli. Kjo ligjëratë u mbajt në kuadër të lëndës "Impakti i Bashkimit Evropian në shtetndërtimin e Kosovës", që është pjesë e projektit Erasmus të Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB.



Studentët pjesëmarrës shfaqën interesim për temën e trajtuar, duke dëgjuar shembuj të barazisë gjinore dhe statistikave nga vendet evropiane por edhe në Kosovë.

I FTUAR NË "GUEST SPEAKER", GURAKUQ KASTRATI - EKSPERT PËR LËVIZJEN E LIRË TË MALLRAVE

27 dhjetor 2022

Për të folur në lidhje me "Legjislacionin dhe Standardet Evropiane për produkte", eksperti për Lëvizjen e Lirë të Mallrave, Gurakuq Kastrati, ka bërë një prezantim para studentëve të nivelit master të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB.









Ky prezantim është mbajtur në kuadër të "Guest Speaker", ndërsa është udhëhequr nga profesorët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Prof. Pranvera Dalloshi dhe Prof. Donat Rexha, të lëndës "Ligjet dhe Rregulloret Evropiane të Biznesit".

Kastrati, theksoi se standardizimi i produkteve dhe plotësimi i kërkesave për konformitet sigurojnë mbrojtjen dhe shëndetin e konsumatorit.

Studentët shprehën interesim në lidhje me rëndësinë e markimit CE për grupet e produkteve që e kanë të detyrueshme. Në këtë rast, Kastrati shpjegoi përmes shembujve praktikë, ndikimin dhe rolin që luan kjo fushë në jetën e konsumatorit.

DY STUDENTE NGA FGH PËRFUNDOJNË ME SUKSES STUDIMET SEMESTRALE NË NORVEGJI

27 dhjetor 2022

Diellza Salicana dhe Erza Mushkolaj, dy nga studentet e dalluara të Fakultetit të Gjuhës Angleze të në nivelin master, përmes programit për shkëmbimin e studentëve Erasmus+ ishin pjesë e sistemit arsimor skandinav, në njërën nga universitetet më të mira private në Norvegji, "NLA Høgskolen".
Diellza dhe Erza, thanë se përveç familjarizimit me një sistem tjetër akademik, kjo përvojë u ndihmoi të zgjerojnë njohuritë në sfera të ndryshme të jetës, duke takuar njerëz nga mbarë bota dhe duke eksploruar vende më turistike në Evropë.







Ato inkurajojnë studentët e Kolegjit AAB, që të paktën njëherë gjatë studimeve të jenë pjesë e programit Erasmus+, për të pasur një përjetim të pazëvendësueshëm.

STUDENTI DONAT FUGA PËRFUNDON SEMESTRIN DIMËROR NË UNIVERSITETIN SAVONIA, FINLANDË

28 dhjetor 2022

Një nga studentët e zellshëm të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, Donat Fuga, ka përfunduar semestrin dimëror në Universitetin Savonia të Finlandës. Donati, përfundoi këtë semestër si pjesë e programit të shkëmbimit të studentëve, Erasmus+, derisa falënderoi Kolegjin AAB për këtë mundësi të ofruar, që shërben në avancim akademik e kulturor.



"Ishte një rast jashtëzakonisht i mirë për mua, u njoha me studentë nga gjithë bota, në këtë mënyrë pata mundësi të avancoj akademikisht dhe të shkëmbej përvoja e njohuri me shoqërinë e re", tha ai.
Donat Fuga, njëkohësisht është edhe nënkryetar i Unionit Studentor të Kolegjit AAB.

REKTORI BUJAR DEMJAHA TAKOHET ME DREJTORIN MENAXHUES TË SWISS UMEF UNIVERSITY

28 dhjetor 2022

Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha është pritur në SWISS UMEF University, ku u takua me drejtorin menaxhues të këtij institucioni, z. Djawed Sangdel. Bashkëpunimi mes dy institucioneve ishte një nga temat kyçe të takimit, duke përfshirë këtu shkëmbimin e studentëve dhe stafit. Edhe bashkëpunimet në fushën e kërkimit shkencor, me fokus në lëminë e turizmit, ekonomisë, biznesit, administratës publike dhe diplomacisë zunë një vend tjetër të veçantë gjatë këtij takimi.









Ndërkohë pritet të shqyrtohen mundësitë e programeve të reja studimore me "Double Degree", kurse në fillim të vitit 2023, ky bashkëpunim do të formalizohet me marrëveshje zyrtare.

PËRMBYLLEN TRAJNIMET PËR MS OFFICE, PJESËMARRËSVE U NDAHEN CERTIFIKATA

28 dhjetor 2022

Pas tre javësh trajnime pa pagesë për studentët, për përdorimin e aplikacioneve të Microsoft Office, që u organizuan nga Qendra e Karrierës të Kolegjit AAB, tashmë janë certifikuar studentët pjesëmarrës. Trajnimi që u mbajt i ndarë në tre grupe, përfshiu një pako që përmbante zhvillimin e shkathtësive në përdorimin e aplikacioneve të Microsoft Office.



Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Prof. Jusuf Qarkaxhija dhe Prorektorja për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr. Venera Llunji, përgëzuan studentët pjesëmarrës për angazhimin dhe vullnetin e treguar gjatë këtyre javëve.





AUDITORI ALBAN LUFI PREZANTON "STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR"

28 dhjetor 2022

Auditori i certifikuar, njëherësh anëtar i ACCA (Association of Chartered Certified Accountants), Alban Lufi, në kuadër të "Guest Speaker", solli një prezantim me temën "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar- Vështrim i Përgjithshëm".






Lufi, që aktualisht është udhëheqës i konsulencës në kompaninë e auditimit "BDO Kosova", anëtare e "BDO International" me seli në Mbretërinë e Bashkuar, para studentëve të Kolegjit AAB prezantoi aspektin praktik të kërkesave kryesore të "Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNK/SNRF)". Ky prezantim u mbajt në kuadër të lëndës "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – IFRS", me rekomandim të profesorit të Fakultetit Ekonomik, Ylber Prekazi.

Studentët e Fakultetit Ekonomik të nivelit master parashtruan pyetje për kërkesat specifike dhe trajtimet që kërkon standardi i caktuar gjatë punës në kontabilitet dhe raportim financiar.

KOLEGJI AAB DHE FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR ORGANIZOJNË SEMINAR ME TEMËN "ANTI-DOPING DHE DUKURITË NEGATIVE NË SHKOLLË"

30 dhjetor 2022

Kolegji AAB në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor, kanë organizuar seminarin e përbashkët në temën "Anti-doping dhe dukuritë negative në shkollë".
Në këtë seminar morën pjesë mësimdhënës nga mbarë Kosova, që për qëllim kishte vetëdijësimin e mësimdhënësve të Edukatës Fizike për këto dukuri negative, dhe masat parandaluese që duhet ndërmarrë.

Fjalën hyrëse e mbajti dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit prof. ass.dr. Fatmir Pireva, dhe kryetari i Federatës së Sportit Shkollor, Ardian Telaku, të cilët u uruan punë të mbarë seminarit dhe pjesëmarrësve.









STUDENTI ENGJËLL LIMANI PËRFUNDON SEMESTRIN DIMËROR NË UNIVERSITETIN SAVONIA TË FINLANDËS

30 dhjetor 2022

Si edhe shumë studentë të tjerë të Kolegjit AAB në shkëmbim akademik, edhe Engjëll Limani ka përfunduar semestrin dimëror në Universitetin Savonia të Finlandës. Studenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike pati fatin që në kuadër të programit Erasmus+, të përjetojë eksperiencë më ndryshe në sferën akademike për të cilën tha se është tejet mirënjohës ndaj Kolegjit AAB.

"Programi Erasmus+ që bën shkëmbimin e studentëve në universitetet më prestigjioze në botë, më dha rastin që të kem në bagazhin tim akademik një përjetim të paharrueshëm. E tërë kjo falë Kolegjit AAB, që përveç më ndihmoi gjatë studimeve tani më ofroi mundësinë ideale", u shpreh Engjëlli ndër të tjera.



Buletini 2021/22
Përmbledhje e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2022

Redaktor:
Zija Rexhepi

Zyra për Marrëdhënie me Publikun:
Erona Salihu
Fitore Zeqiri
Doruntina Alshiqi

Layout:
Nderim Sekiraça

Prishtinë, janar 2023